INSTITUTI I TRASHËGIMISË SHPIRTËRORE
E KULTURORE TË SHQIPTARËVE - SHKUP

STUDIME ALBANOLOGJIKE

13

Shkup, 2016

Kryeredaktor
Prof. Dr. Qemal Murati

Redaksia
Prof. Dr. Qemal Murati
Dr. Naim Halimi
Dr. Izaim Murtezani
Dr. Bukurije Mustafa
Dr. Besnik Emini

Sekretar i Redaksisë
Dr. Besnik Emini

Adresa e Redaksisë:
Instituti i Trashëgimisë Shpirtërore e Kulturore të Shqiptarëve
Kutia Postare nr. 171
1000, Shkup
Republika e Maqedonisë

Adresa elektronike:
studimealbanologjike@yahoo.com
studimealbanologjike@itsh.edu.mk

ISSN 1857-6958
UDK 930.85
COBISS.MK-ID 82595850

PËRMBAJTJA

Skender ASANI
SHQIPTARËT DHE HEBRENJTË NË LUFTËN E DYTË BOTËRORE....**7**

Moikom ZEQO
ZEF MIRDITA, DIJETARI I MADH SHQIPTAR I FORMATIT EVROPIAN.....**13**

Eqrem ÇABEJ
NJË GJUHË SHKRIMI E NJËSISHME.....**21**

Thanas L. GJIKA
KUJTIME PËR PROFESORIN EQREM ÇABEJ.....**27**

Xhevat LLOSHI
SULME ANTISHQIPTARE NËN PETK SHKENCOR.....**41**

Naser FERRI
KULTI I HYJNESHËS DEA SYRIA NË SCUPIN DARDAN.....**47**

Qemal MURATI
DHJETË POPUJ TË BALLKANIT ME DHJETË TË VËRTETA NË XHEP PËR "AUTOKTONINË" E TYRE.....**55**

Hidajete AZIZI
GJENDJA E STUDIMEVE ONOMASTIKE NË MAQEDONI.....**63**

Haredin XHAFERI
LOKUCIONET ME VLERË PËREMRI NË GJUHËN SHQIPE.....**75**

NJERIU QË DINTE GJITHÇKA.....**81**

Shpëtim ÇUÇKA
UMBERTO EKO – VËSHTRIM PËRMES PËRKTHIMESH E LEXIMESH.....**85**

Ismail SYLA
VITI I GJENIUT KADARE (2016).....**89**

Mimoza CIKA-KELMENDI
NJË KADARE PAS LETRAVE……..**93**

Lirak KARJAGDIU
NOLI PËRKTHYES I LETËRSISË ANGLEZE DHE AMERIKANE.....**95**

Jolanda LILA
IRONIA SI PJESË E STRUKTURËS POETIKE TEK ALI PODRIMJA.....**113**

Roger COHEN
LUFTA E TRETË…….....**121**

James PETTIFER
SI U MANIPULUA HISTORIA E BALLISTËVE NË MAQEDONINË PERËNDIMORE……....**125**

Faik KONICA
VESET E PANDREQSHME TË SHQIPTARËVE.....**135**

Ferid MUHIQ
APOLOGJIA E BALLKANIT.....**141**

Ardian EMINI - Alfred MARLEKU
PRESHEVA PAS SHPËRBËRJES SË REPUBLIKËS FEDERATIVE TË JUGOSLLAVISË.....**147**

Ilir A. ZYLFIU
FILLESAT E ARSIMIT SHQIP NË PRESHEVË E RRETHINË.....**163**

Sevdail DEMIRI
KONTROLLI POLITIK NDAJ PUNËS DHE PËRMBAJTJES SË GAZETËS "FLAKA E VËLLAZËRIMIT" NË SHKUP.....**169**

Ermal MEHMETI
TRADITA E KËNDIMEVE POLIFONIKE.....**173**

Angjelina HAMZA
ROLI FEMRËS NË FAMILJE.....**177**

FAQE KUJTIMI E LAVDIE: ISMET JASHARI - KOMANDANT KUMANOVA (*Naim HALIMI*).....**183**

Gabriela TOPUZOVSKA
AKTIVITETI I MINISTRISË SË SHËNDETIT POPULLOR DHE ZHVILLIMI I SHËRBIMIT EPIDEMIOLOGJIK NË MAQEDONI (1945-1947).....**187**

RECENSIONE

NJË VEPËR ORIGJINALE DHE JOKONVENCIONALE (*Ylber Hysa,* "*Shqiptarët dhe të tjerët: nga Madona e Zezë deri te Molla e Kuqe*") (Oliver Jens SCHMITT).....**197**

PREZANTIM I DENJË I MITOLOGJISË DHE KULTURËS POPULLORE SHQIPTARE (*Elsie Robert, A Dictionary of Albanian Religion, Mythology and Folk Culture, Hurst & Company, London 2001, f.357; Elsie Robert, Leksiku i Kulturës Populllore Shqiptare- besime, mitologji, fe, doke, rite, festa dhe veçori kulturore, Skanderbeg books, Tiranë 2005, f.282)* (Naser FERRI).....**199**

ASPEKTE INTERESANTE TË BESIMEVE POPULLORE SHQIPTARE (*Azem Qazimi, Fjalor i mitologjisë dhe demonologjisë shqiptare, të kremte, rite e simbole, SHB Plejad Tiranë, 2008, f.196)* (Naser FERRI).....**204**

KRONIKA DHE SHKENCORE

NJË VIT I FRYTSHËM BOTIMESH (*Xhevat LLOSHI*).....**209**

POEZIA E JETËS SIME *(ligjërata lamtumirëse e pensionimit)* (*Avzi MUSTAFA*).....**215**

SKENDER ASANI

SHQIPTARËT DHE HEBRENJTË NË LUFTËN E DYTË BOTËRORE

Në historinë e njerëzimit ekzistojnë ngjarje që lënë gjurmët e tyre. Lufta e Dytë Botërore është njëra nga ngjarjet më tragjike për gjithë njerëzimin. Gjatë kësaj lufte ndodhi Holokausti, eliminimi fizik i 6 milionë hebrenjve të pafajshëm, vetëm për shkak të religjionit apo etnisë së tyre. Kjo është një nga shenjat më të errëta nga Lufta e Dytë Botërore dhe nga tërë historia e njerëzimit, veçanërisht në ndërgjegjen e një gjeneratë të tërë të personave që kontribuuan, lejuan apo edhe morën pjesë në këtë tragjedi.

Shqipëria dhe shqiptarët ishin Barka e Noes për hebrenjtë e dëbuar. Shqiptarët, në këtë mënyrë, jo vetëm që ofruan ndihmën e tyre, por gjithashtu vërtetuan mbështetjen që në një kaos të tillë ishte më se e nevojshme. Hebrenjtë kishin besim te shqiptarët, pasi e dinin fjalën e ndershme shqipe BESA, me të cilën shqiptarët hapin derën jo vetëm për miqtë, por, edhe për të gjithë ata që kanë nevojë.

Gjatë historisë, shumë popuj u zhdukën plotësisht nën presion dhe dhunë sistematike. Edhe shqiptarët ishin nën presion të njëjtë përgjatë një shekulli të tërë. Në Ballkan ekzistonte një presion i egër për asimilim nga sisteme të ndryshme shtetërore, veçanërisht në territoret të populluara me shqiptarë[1]. Si pasojë, shumë shkencëtar shfrytëzuan studimet e tyre për të paraqitur teza mbi atë se si shqiptarët arritën të mbijetojnë dhe të mos asimilohen. Formula e mbijetesës e popullit shqiptar ishte simboli i tyre personal: njerëzimi, solidarizimi dhe fjala e dhënë (besa). Nuk është rastësi që këto janë edhe cilësitë e Nënë Terezës që më vonë kishte mundësinë t'i shpërndajë nëpër gjithë botën. Gjatë Luftës së Dytë Botërore, Shqipëria u shndërrua në destinacion kryesor në Gadishullin Ballkanik, si e vetmja dalje për popullin hebre. Në botë nuk ka edhe një komb tjetër, si hebrenjtë, një popull që vuajti aq shumë, mbijetoi deportime të shumta, eksode dhe emigrime masive në anë të ndryshme të botës dhe përsëri arriti të mbijetojë dhe të ruajë identitetin e tij. Në historinë e njerëzimit, ka ngjarje që shënojnë epoka të caktuara apo që kanë vënë vulën në periudha të ndryshme. Prandaj, Holokausti dhe likuidimi fizik i gjashtë milionë viktimave të pafajshme, vetëm për shkak të racës dhe religjionit, apo etnisë, është një nga pikat më të errëta në historinë e njerëzimit dhe ndërgjegjen e të gjithë atyre që shkaktuan, zhvilluan dhe lejuan që të ndodhte një tragjedi e tillë.

[1] Shqipëria administrative dhe territoret e populluara me shqiptarë në Mbretërinë Jugosllave

Lidhjet kulturore ndërmjet shqiptarëve dhe hebrenjve, për të cilat ka mjaft artikuj dhe të dhëna të arkivuara, janë një komunikim i dukshëm që ka ekzistuar për shekuj të tërë[2]. Në memorien e tyre historike dhe kombëtare, shqiptarët kanë ruajtur plot dëshmi të bashkekzistimit të tyre me hebrenjtë, që prej periudhës së ilirëve. Siç edhe është vërtetuar, lëvizjet e hebrenjve Sefardi prej Spanjës drejt Ballkanit dhe zonave shqiptare[3], datojnë qysh në shekujt 15 dhe 16. Megjithatë, ekziston një mundësi që të kenë ardhur edhe para deportimit nga Spanja, në vitin 1492[4]. Individë dhe grupe më të vogla të Hebrenjve kanë arritur në Shqipëri në periudhën midis viteve 1915 dhe 1925 dhe në fillim të viteve 30 - ta të shekullit të kaluar. Sipas burimeve historike, në Shqipëri hebrenjtë kanë arritur në dy mënyra, në vijën ligjore dhe jo ligjore. Është për t'u përmendur fakti se gjatë viteve 30 - ta, ekzistonte një iniciativë ndërkombëtare nga ana e Kombeve të Bashkuara në Gjenevë për të krijuar, jashtë Shqipërisë, një atdhe të mundshëm për hebrenjtë e rrezikuar në Evropë[5] (Shqipërisë së sotme administrative - S.A).

Gjatë viteve 30 – ta të shekullit të kaluar, antisemitizmi u përhap në shkallë të lartë në disa shtete me regjime fashiste të Evropës. Rrethanat shoqërore, politike dhe religjioze në Shqipëri, më së miri janë shpjeguar nga diplomati i SHBA -ve i akredituar në Tiranë, Herman Bernstein, i cili në vitin 1934 potencoi:

"*Në Shqipëri, në këtë vend të vogël e të bukur në detin Adriatik, nuk kanë probleme me Hebrenjtë. Nuk ka shenja të diskriminimit të tyre, jo sepse komuniteti hebre është i vogël, por sepse Shqipëria është një nga shtetet e rralla në Evropë ku nuk ka paragjykime religjioze dhe urrejtje racore, edhe pse vetë Shqiptarët kanë tre religjione që i ndan ata*"[6].

Në fillim të Luftës së Dytë Botërore (1938-1939), një numër i madh i hebrenjve nga Gjermania, Austria, Polonia, Franca, Hungaria, Italia dhe mbretëria e Jugosllavisë, arritën të braktisin shtetet e tyre dhe të arratisen në Shqipëri, në rrugë të ligjshme dhe të paligjshme. Një pjesë e tyre e shfrytëzoi Shqipërinë si shtet tranzit/ për kalim në Shtetet e Bashkuara të Amerikës dhe në shtetet tjera të botës.

Deportimi dhe likuidimi i egër dhe i pamëshirshëm i popullit hebre shkallën më të lartë e arrtit pas okupimit të Ballkanit nga ana e Gjermanisë fashiste. Kjo ishte dhe një nga arsyet kryesore që hebrenjtë braktisën Ballkanin, veçanërisht Mbretërinë Jugosllave dhe pjesën e Vardarit në Maqedoni, e cila më vonë u okupua

[2] Arkivi Qendror Shtetëror (AQSH), F.179, viti.1941; F.162, viti.1943; F.271, viti.1943; F.228, viti1943; F.346, viti 1935; F.153, viti.1943; F.152, viti.1938-1944.

[3] Shqipëria administrative dhe territoret e populluara me shqiptarë në Mbretërinë Jugosllave

[4] Bema Haralanova, Vojnata i evreite vo Shumen, Vtorata svetovna vojna i Balkanite (Sbornik dokladi i naucni sposhtenia, të prezantuara në konferencën ndërkombëtare shkencore në vitin 2002, 170; Shaban Sinani, *Shqiptarët dhe Hebrenjtë*, Tiranë, 2014, 15.

[5] Shaban Sinani, *Shqiptarët dhe Hebrenjtë*, Tiranë, 2014, 9. Shqipërisë së sotme administrative, Skënder Asani, më poshtë S.A.

[6] Apostol Kotani, *The Hebrews In Durin Centuries*, Tiranë, 1996, 39.

nga Bullgaria (Maqedonia, S.A)[7]. Sipas statistikave zyrtare, mijëra hebrenj nga Evropa u arratisën në Shqipëri[8].

Arkivi Shtetëror në Tiranë disponon me një dokumentacion të pasur arkivor i cili flet qartë për urdhrat e shkruara, dekretet të lëshuara nga administrata shtetërore në Shqipëri, mbi format e arratisjes së popullit hebre nga Bullgaria dhe Jugosllavi dhe shpëtimin, strehimin e tyre në Shqipëri dhe përkujdesja e tyre në kampet e hapura në Kavajë, Shijak, Krujë, Burrel etj[9]. Ky dokumentacion tregon se pjesa më e madhe e hebrenjve të cilët arritën të vijnë në Shqipëri pranuan dokumente zyrtare për udhëtim me qëllim që të mund të lëvizin lirshëm nëpër territorin e Shqipërisë. Hebrenjve u ishte thënë se, edhe pse Shqipëria është akoma nën okupimin italian, megjithatë, ishte destinacioni i vetëm ku ende kishte ngelur pak njerëzim dhe ku mund të pranonin mbështetje të plotë nga populli shqiptar, vendi i vetëm në Ballkan ku kishin gjasa reale për të shpëtuar veten nga okupatori gjerman. Këto pohime mbështeten me deklaratat e tyre të dhëna para organeve policore, por edhe nga deklaratat e tyre të mëvonshme të dhëna nëpër mediat e shkruara[10].

Hebrenjtë që erdhën në Shqipëri gjatë luftës, ishin në gjendje të dobët ekonomike. Përveç veshmbathjeve që kishin sjellë me vete, nuk kishin asgjë tjetër[11]. Kjo u konfirmua edhe nga autoritetet të cilët ishin në kufi në kohën kur hebrenjtë hynë në Shqipëri. Në mënyrë që t'i ndihmojnë për ta tejkaluar këtë gjendje të rëndë, populli shqiptar u ofroi zemërgjerësinë, mikpritjen dhe humanizmin e plotë të tyre[12].

Shqipëria dhe populli Shqiptar ishte e vetmja rreze shprese për hebrenjtë e arratisur të cilët kërkonin strehë në shtëpitë e tyre gjatë Luftës së Dytë Botërore. Sipas dokumentacionit të arkivuar prej Arkivit Shtetëror në Tiranë, mësohet se ka pasur një lëvizje të madhe të hebrenjve nga Evropa juglindore drejt Shqipërisë. Hebrenjtë i strehuan në Shqipëri pasi merrnin informata se atje komuniteti hebrenj pranonte mbështetje të plotë nga ana e popullit shqiptar dhe se fjalën e dhënë (besën) shqiptarët nuk e kanë shkelnin asnjëherë. Hebrenjtë janë trajtuar institucionalisht, u janë dhënë dokumente identifikimi, libreza mjekësore dhe leje

[7] Gjatë Luftës së Dytë Botërore, territori i Maqedonisë ishte okupuar nga Bullgaria (prej 19.04.1941 deri në 09/09.1944) pas marrëveshjes ndërmjet Bullgarisë dhe Gjermanisë në Prill-Maj të vitit 1941. Në 12 Mars 1943 forcat policore Bullgare të mbështetura nga forcat ushtarake Bullgare deportuan 793 familje hebrenjsh nga Manastiri, 3351 njerëz u dërguan në monopolin në Shkup, ndërsa prej zonës së Shkupit, 3800 persona janë detyruar të lëvizin dhe në 22, 25 dhe 29 Mars, u deportuan në kampet e koncentrimit në Treblinka-Poloni; Ivan Haxhievski, Багрската државна и воneта власт во Вардарската Македонија меѓу 1941-1944 година.

[8] Apostol Kotani, *The Hebrews In During Centuries*, Tiranë, 1996, 39

[9] AQSH, F.179, viti.1941; F.162, viti 1943; F.271, viti 1943; F.228, viti. 1943; F.346, viti 1935; F.153, viti.1943; F.152, viti. 1938- 1944.

[10] AQSH, F.179, viti.1941; F.162, viti 1943; F.271, viti 1943; F.228, viti. 1943; F.153, viti. 1943, F.152, viti. 1938- 1944.

[11] Shaban Sinani, *Shqiptarët dhe Hebrenjtë*, Tiranë, 2014, 161-178.

[12] Apostol Kotani, *The Hebrews In During Centuries*, Tiranë, 1996, 23.

pune[13]. Pas kapitullimit të Italisë fashiste, forcat fashiste gjermane, në Shqipërinë e okupuar, lëshuan urdhra dhe dekrete për persekutimin e hebrenjve, dhe kishte një mbikëqyrje strikte për ndjekjen e lëvizjeve të tyre dhe më vonë kishte edhe përpjekje për zhdukjen e tyre. Kështu, Ministria e Brendshme kërkoi nga autoritetet që brenda pesë ditëve t'i largonte të gjithë hebrenjtë nga Shqipëria. Kishte urdhër që duhet të jepen informata lidhur me vendet të përkohshme dhe permanente të hebrenjve në Shqipëri, si dhe informata se kush u jep strehim, etj[14]. Pas lëshimit të këtyre urdhrave, shqiptarët filluan në mënyrë të paligjshme t'i strehojnë hebrenjtë, jo vetëm në strehimore, por edhe nëpër familjet e tyre. Për shkak të armikut të përbashkët - fashizmit gjerman, hebrenjtë, në luftën kundër fashizmit, mbajtën anën e popullit shqiptar[15].

Shqipëria nuk bën pjesë në listën e shteteve ku janë deportuar hebrenjtë. Pas përfundimit të luftës, populli hebre filloi të kthehet në shtetin e tij. Megjithatë, ata asnjëherë nuk harruan se çfarë bëri populli shqiptar për ta[16]. Pasi përfundoi Lufta e Dytë Botërore, shumë familje apo individë hebrenj, të cilët arritën të mbijetojnë terrorin e luftës, filluan të kthehen në atdheun e tyre. Kishte edhe shumë hebrenj jugosllavë të cilët arritën që ta mbijetojnë fundin e Luftës së Dytë Botërore në Shqipëri.

Në 22 Tetor të vitit 1944, Unioni i Komunave Religjioze Hebraike në Jugosllavi ripërtëriu punën e tyre[17] dhe menjëherë filloi të punojë në mënyrë aktive për ripërtëritjen e jetës dhe punës së gjithë komunave hebraike në territorin e Jugosllavisë.

Në 26 dhjetor të vitit 1944, në takimin e parë pas luftës, Bordi i Çlirimit Maqedono -Hebraik dhe Komuniteti Religjioz Maqedono-Hebraik ripërtërin

[13] AQSH, F.179, viti.1941; F.162, viti 1943; F.271, viti 1943; F.228, viti. 1943; F.346, viti 1935; F.153, viti.1943; F.152, viti. 1938- 1944.

[14] AQSH, F.162, viti 1943; F.271, viti 1943; F.228, viti. 1943; F.153, viti.1943; F.152, viti. 1944.

[15] Pas përfundimit të Luftës së Dytë Botërore, 69 shqiptarë janë shpallur burra të drejtë; Apostol Kotani, *The Hebrews In During Centuries*, Tiranë, 1996, 85-90.

[16] Të dhënat e lartpërmendura janë marrë prej fondeve arkivore në Arkivin Qendror Shtetëror në Republikën e Shqipërisë në Tiranë. Ato përmbajnë një sërë faktesh dhe argumentesh për sa i përket lidhjeve të ngushta midis hebrenjve dhe shqiptarëve gjatë historisë. Është për t'u theksuar se çështja hebreje në lidhje me shqiptarët e territorit të Kosovës dhe Maqedonisë do të ngelë e paqartë për dekada me radhë për shkak të mungesës së institucioneve shkencore. Institucionet shkencore ishin nën influencën e fortë të shtetit për të mos zbuluar të vërtetën. Deri vonë, në Serbi dhe Kosovë, por edhe në këtë konferencë shkencore, kishte trillime se shqiptarët të mobilizuar nga Gestapo, u kanë dorëzuar fashistëve një numër të madh hebrenjsh. Duke dashur që të izolojnë kontributin shqiptar për mbrojtjen e hebrenjve (vetëm me shqiptarë të Shqipërisë së sotme administrative), disa historianë madje edhe në këtë konferencë janë munduar që të përhapin një tezë për një lidhje ndryshe, ndërmjet shqiptarëve të Kosovës dhe Maqedonisë, për sa i përket çështjes hebreje; AQSH, F.179, viti 1941; F.162, viti 1943; F.271, viti. 1943; F.228, viti. 1943;F 346, viti 1935; F.153, viti.1943; F.152, viti. 1938-1944.

[17] Mladenka Ivankovic. Jevreji u Jugoslaviji (1944-1952). Kraj ili novi početak. LION. Beograd. 2009. S. 67.

aktivitetin e tyre[18]. Prej analizave të dokumentacionit arkivor të dhënë nga Arkivi Shtetëror i Republikës së Maqedonisë - sektori lokal Shkup, mund të vërehet se takimet e tyre pas luftës gjatë periudhës 1945-1946, më së shumti ishin për Hebrenjtë që ktheheshin nga Shqipëria në Maqedoni. Sipas literaturës shkencore maqedonase për sa i përket komunitetit hebre në Maqedoni, numri i atyre që u kthyen në Maqedoni pas luftës ishte 100 deri në 150 persona.

Si shenjë falënderimi, solidarizimi dhe sakrificës, hebrenjtë e Jugosllavisë i dërguan një letër Qeverisë Demokratike të Shqipërisë, në maj të vitit 1945, ku shkruhej: " Kur hebrenjtë e Jugosllavisë prej Jugosllavie, Polonie, Gjermanie dhe vende të tjera mbyteshin dhe vriteshin nga Nazistët, duke përfshirë këtu burra, gra dhe fëmijë, ishte një popull në Ballkan i cili u ngrit lart çdo teorie racore dhe mbi civilizimin perëndimor, e ky është populli i guximshëm dhe mikpritës shqiptar...Në historinë e kësaj lufte duhet të vuloset se një popull i vogël, por i përulur dhe heroik, ishte ndoshta i vetmi nga të gjithë popujt e okupuar evropian i cili e parandaloi ekzekutimin dhe deportimin e hebrenjve"[19].

[18] Zhamila Kolonomos, dr. Vera Veskoviq-Vangel. Evreite vo Makedonija vo Vtorata Svetska Vojna (1941-1945). Zbornik na dokumenti. II. Akademia Maqedonase e Shkencave dhe Arteve, Shkup. 1986, dok. 713,. c.1107-1108.

[19] Apostol Kotani, *The Hebrews In During Centuries*, Tiranë, 1996, 92-93

MOIKOM ZEQO

ZEF MIRDITA, DIJETARI I MADH SHQIPTAR I FORMATIT EVROPIAN

Mbylli sytë në Zagreb në moshën 80 vjeçare Zef Mirdita, dijetar i shquar me një profil të përveçëm, historian, hulumtues i mitologjive, kërkimtar i etnogjenezës iliro-shqiptare, historive të popujve antikë të Ballkanit, krishterimit të hershëm dhe mesjetar. Zef Mirdita ka lindur më 13 Mars 1936 në Prizren të Kosovës. Në vitin 1958 studioi në Zagreb të Kroacisë për filozofi, më 1972 doktoroi për "Dardanët dhe Dardania në antikë". Nga viti 1993 ka punuar si këshilltar shkencor në Institutin Kroat të Historisë ku ka udhëhequr projektin shkencor "*Vllehtë, populllsi e vjetër ballkanike nga fillet historike deri në ditët tona*". Zef Mirdita është specializuar në Universitetin "La Sapienza" në Romë, pastaj në Heidelberg në 1991 dhe në Munih të Gjermanisë më 1992. Livrat dhe punimet shkencore të Zef Mirditës janë botuar në shqip, kroatisht, frëngjisht, anglisht, gjermanisht, italisht. Unë i kam librat e shkruar nga Zef Mirdita të dhuruara me dedikas prej tij dhe e kam takuar dy herë. Në fillim në vitin 1973 kur ai erdhi në Shqipëri për herë të parë, madje mori pjesë edhe në një ekspeditë arkeologjike shqiptare sepse mbështeste tezën e etnogjenezës iliro-shqiptare. Unë punoja në gazetën "Drita" si redaktor letrar dhe u takova në Institutin Arkeologjik të Tiranës, ku së bashku me prof. Selim Islamin patëm një bisedë për ilirologjinë dhe arkeologjinë. Herën e dytë Zef Mirdita erdhi në Tiranë në vitin 2004, më takoi në zyrën time në Muzeun historik kombëtar, pastaj në një ceremoni në Presidencën e Shqipërisë ku u dekorua nga presidenti Alfred Moisiu. Vlerësime të larta Zef Mirdita ka marrë edhe nga Akademia kroate e shkencave dhe arteve në Zagreb si dhe nga presidentja e Kosovës Atifete Jahjaga. Kam patur letërkëmbim me Zef Mirditën gjatë viteve. Në vitin 1979 kam shkruar për librin e tij "Studimet dardane". Në vitin 1981 në revistën "Iliria" kam botuar një recension shkencor për veprën shumë të rëndësishme të Zef Mirditës "Antroponimia e Dardanisë në kohën romake". Kam shkruar dhe shkrime të tjera po për të. Lajmi i vdekjes së Zef Mirditës më ka pikëlluar shumë, jam i bindur se vlerësimi real për këtë figurë të jashtëzakonshme shkencore të kombit shqiptar do të bëhet më shumë në të ardhmen. Zef Mirdita qe një mjeshtër i madh i analizës, i referencës shkencore bibliografike dhe arkeologjike si dhe i metodologjisë moderne të parashtrimit dhe të sintezës së mirëfilltë. Studimet e tij për Dardaninë dhe iliricitetin e Kosovës në antikitet janë substanciale dhe të patjetërsueshme. Dhe të mos harrojmë që një vështrim të tillë historik dhe konceptual ai e ka bërë dhe e ka botuar shumë më përpara arritjes së Pavarësisë së Republikës së Kosovës. Për të patur një ide më të thukët dhe më konkrete për natyrën shkencore të veprës së Zef Mirditës së madh po parashtroj më

poshtë një nga studimet e mia për të, pikërisht për kultet e lashta të dokumentuara në Dardani.

Dr. Zef Mirdita më ka dërguar me postë në Muzeun Historik Kombëtar librin e tij *"Religjoni dhe kultet e dardanëve dhe Dardanisë në Antikë",* Zagreb, 2001, me këtë dedikim *"Dr. Moikom Zeqos, me një respekt të veçantë dhe të përzemërt, nga autori – Zef Mirdita, Zagreb 12.03.2002"*. Tek Zef Mirdita është sinteza e historianit që njeh dhe shtjellon arkeologjinë.

Ai është figurë e shquar e shkencës shqiptare, por i njohur edhe në metropolet e shkencë historike europiane. Përgatitja e tij, erudicioni, metodologjia moderne e bëjnë Zef Mirditën një emër të madh për kontributin serioz në etno-gjenezën iliro-shqiptare, sidomos për origjinën etnike të shqiptarëve në Dardani, Kosovën e sotme. Modest, larg bujës mediatike ky dijetar race, ka këmbëngulur për gjetjen e fijeve të këputura midis shekujve dhe mijëvjeçarëve për të rikonstruktuar një histori të besueshme të antikës në Dardani, bazuar në një burimologji të dhënash të pafund arkeologjike dhe historike, por edhe në rrafshin kulturologjik, ose të aspekteve të spikatura të qytetërimit iliro-shqiptar.

Ai i takon qarkut shkencor të Zagrebit, ku objektiviteti shkencor ngrihet lart, në ndryshim nga shumë skajëzime subjektiviste, madje edhe shoviniste të disa dijetarëve jugosllavë, që për arsye politike e mohonin përkatësinë iliro-shqiptare të popullit të Kosovës. Përkundër kësaj trysnie të ideologjizmit absurd të shkencës, dr. Zef Mirdita, së bashku me ilirologun e madh dr. Aleksandër Stipçeviq, po në Zagreb, ju përkushtua të vërtetës objektive në histori dhe në arkeologji.

Libri i tij "Religjioni dhe kultet e dardanëve dhe Dardanisë në Antikë" është vepra e tij më e rëndësishme në këtë hulli. Libri është një sintezë e konstruktuar qartë shkencërisht. Në pjesën I të librit flitet për *"Kultet epihorike (vendase) të dardanëve"*. Të dhënat për këto kulte burojnë nga dëshmitë e përmendoreve përgjithësisht të epokës romake perandorake. Në këtë epokë kemi mbijetesën e kulteve ilire edhe sipas "interpretatio romana". Në thelb kemi idenë e paraleleve mitologjike për të arritur në një njësim sinkretik. Pra mitet dhe simbolet e tyre emërore janë dygjymtyrësh, d.m.th. krahas emrit vendas dardan kemi edhe emrin kultik romak. Një bashkëjetesë si bashkëpërfshirje mitologjike, formë e njëjtë e një identiteti të dyfishtë. Kjo tregon se panteoni romak ishte i hapur për mitet e popujve që nuk ishin romakë. Romakët e lashtë duke pranuar nderimin e kulteve të popujve të tjerë, që i sundonin, pranonin një lloj "nacionalizmi rilegioz" të të tjerëve. Kjo dukuri sinkretike përveç anës mitologjike kishte edhe kuptim politik dhe shoqëror. Në aspektin historik arrihet kështu në një "kujtesë mitologjike" të ilirëve dardanë, që vjen "e balsamosur" në mbishkrimet e hershme dhe rafigurimet përkatëse. Po katalogoj disa nga hyjnitë vendore të Dardanisë, sipas librit të cituar të dr. Zef Mirditës.

I. ANDINUS

Tek ilirët ka ekzistuar hyjnia e plleshmërisë dhe e vegjetacionit. Tek dardanët është quajtur ANDINUS. Dëshmohet në dy ara votive. Në Kaçanik gjejmë këtë dëshmi: – Deo Andino l sevir [aug(ustalis?)] l sc(rum) Tib(erius) l Cl(audius)

certus l b(e)n(eficiarius) co(n)s(ularis) leg(ionis) VII Cl(audiae) v(otum) s(olvit) l'(ibens) m(erito) l Clem(ente) et Prisco co(n)s(ulibus). Ndërsa ajo e Vuçitërnës (Vushtria e sotme) është si vijon:

– Deo IIIII l [An(d)[in]o)] IIII l VI. P IIIII DA.

Mbishkrimi i Kaçanikut është i qartë dhe i lexueshëm, ai i Vuçitërnës është i paqartë dhe vështirë lexohet. Pastaj nuk dihet as identiteti i dedikuesit. Të dy mbishkrimet janë të shekullit I.

Sipas M. Garašaninit, kjo hyjni mund të identifikohet me *Vidasus Magla,* kurse në interpretatio romana edhe me *Silvanin*. I pranueshëm del mendimi i A.Mayerit, sipas të cilit ky kult do të mund të paraqiste zotin e shigjetës, plleshmërisë, gjeneratave ose vendit.

II. ATTA

Kulti i hyjnisë vendëse ATTA. Në një arë votive të gjetur në Nish, lexojmë:

-Attae I Sac(rum) I Melio(ris) v(otum) s(olvit).

Kemi të bëjmë me hyjninë *Atto patrius*. Nuk mund të konsiderohet si hyjni frigase – *Attis*. Dativi duhet të jetë: *Atti, Attini, Attidi*. Në një mbishkrim nga Aquileia na dëshmohet:

-ATTE PA ΓA

H.Steudingu e lexon si *Atte Papa*. Leximin e tillë e pranon edhe F.Cumon. Kemi të bëjmë me një hyjni vendëse. *Atta,* në të gjitha gjuhët indoevropiane është hipokoristikë për *at* që do të thotë *babë*. Kemi të bëjmë me kultin epihorik, përkatësisht të pajtorit të vatrës shtëpiake. *Atta* si antroponim është i dëshmuar në Moesia Superior, si p.sh. në Naissus, pastaj në territorin e Municipium Ulpianum.

III. DARDANIA

Përveç personifikimit hyjnor të provincave ka ekzistuar edhe personifikimi hyjnor i qyteteve. Kështu ekziston kulti i Britanisë, por edhe kultet pajtorë të qyteteve, siç ishin ato të Nereut dhe të Celit, me epitetet Augusta dhe Santa, pastaj është edhe Dii-deae Dacaiarum, e siç do të shohim më vonë edhe Dea Syria, Dea Vocontiorum, Celeia Sancta, Norea Sancta, Dea Brigantia, Dea Mogontia, etj.

Në Banjën e Kurshumlisë (Aquae Bassinae?), më 1937 u zbulua një altar votiv, nga mermeri i bardhë, në të cilin dëshmohet kulti i hyjneshës DARDANIAE. Këtë altar e ka ngritur një i huaj dhe në të lexojmë:

-Dar(daniae) Sac(rum) l Philoxenus Aug(ustorum) l n(ostrorum trium) ser(vus) vilic(us) l stat(ionis) Aquar(um) Bas() I^0 templum ex voto l a solo restituit l v(otum) l(ibens) s(olvit) l (±5] V G Senec(ione) et Aemiliano co(n)s(ulibus).

Më 1984, në fshatin Smirë te Vitia, sërish u gjet një arë votive kushtuar hyjneshës së Dardanisë:

-Deae Dard(aniae) I Artor(ius) I Heracli I tus spec(ulator) leg(ionis) IIII Fl(aviae) I v(otum) s(lvit) m(erito) I Gentiano et Basso I co(n)s(ulibus).

Po ashtu, në Gllavnik është gjetur një arë e thyer, në pjesën e epërme të së cilës lexohet: DEAE DARD(ANIAE). Kjo, deri më tani nuk është botuar dhe gjendet në

lapidarin e Muzeut Arkeologjik në Prishtinë. Kulti i Dardanisë është dëshmuar edhe në Daki, në Romula Malva, më 1969, në një fragment të një relievi:

-[Da]rdanic(a)e posui(t);

dedikues i të cilit ka qenë Aureliusi, dekurion municipal. Këtë kult e kanë bartur me vete emigrantët dardanë.

Në Apulum, hyjnesha është paraqitur në një trajtë romake, me një qingj në duar, pranë një altari, në të cilin shihet gjeli i gatshëm për flijim. Në figurën e dytë, ku edhe gjendet mbishkrimi, që përmban të njëjtin përkushtim, paraqitet hyjnesha e ngjashme. Pranë saj shihet një shportë me bukë dhe fruta. *Dea Dardaniae* apo *Dardanicae* është hyjneshë e tipit sinkretik, e natyrës dhe plleshmërisë, e ndoshta edhe e karakterit Ktonik.

Është adhuruar në trevën e Dardanisë. Supozohet se ka qenë hyjneshë e shëndetit, ngjashëm me ato të Eskulapit dhe të Hygisë.

– Dedikuesi Philoxenus, e ka ripërtëritur tempullin e saj që gjendet te burimet termale, sot Banja e Kurshumlisë, ashtu siç është rasti i altarit nga Smira, i cili lokalitet nuk është shumë larg nga Banja e Kllokotit. Dedikuesi i altarit të parë, Philoxenusi, ka qenë nëpunës i stacionit doganor, atëherë mund të konstatohet se kjo hyjneshë ka qenë edhe pajtore e stacioneve doganore, përkatësisht personifikim i *Genius loci* ose *Genius stationis*. Në vendin e zbulimit të altarit të parë, ka qenë edhe stacioni doganor. Ndërkaq, ky i dyti, nga Smira, meqenëse dedikuesi i tij ka qenë *speculator leg(ionis) IIII Fl(aviae),* mund të konsiderohet edhe si personifikim i *Geniusit* të njësisë ushtarake. Paraqitet si hyjni karakteristike për trevën dardane. Kulti i saj mund të konsiderohet si pajtor i tërë territorit dardan, në kohën romake.

IV. MELCIDI, si hyjni dëshmohet në Ulpiana, në një arë votive me mbishkrimin:

I(ovi) O(ptimo) M(aximo)
Melcid All(cius) Octa
Vianus veteranus cum
Suis v(otum) p(osuit)

Për Melcidin si hyjni vendase e Dardanisë ka folur për herë të parë vetëm dr. Zef Mirdita. Ai e botoi mbishkrimin në "Novitas epigraphicae e Dardania collectae" në revistën Avest (Arheološki Vestnik. Slovenska Akademia), 1980, nr.31. f. 186.

Dr. Zef Mirdita nuk e përcakton rolin e këtij hyu, por mendon se duket të kishte një ekuivalencë të lartë të njëllojtë me Jupiterin në panteonin romak.

Ai shënon: "nuk kam guxim të lëshohem në supozime linguistike me përfundime kategorike, por prap se prap jam i mendimit se këtu është fjala për emrin e një hyjnie epihorike, me kuptimin *Culminalis,* apo *Aepifius*, por në gjuhën vendase.

Sidoqoftë, përkundër kësaj hipoteze, MELCIDI do të jetë hyjni e lartë epihorike dardane" (shih faqet 49-50 të librit të Mirditës).

V. VEZZAIOS

Në territorin e Dardanisë, por jo edhe në territorin e gjerë të Moesia Superior, është kulti i EZZAIOS. Ky kult i dedikohet Zeusit. Mirëpo, me një epitet të tillë Zeusin nuk e ndeshim, përveç si *Zeus Aseis*. A.Mócsy mendon se kjo hyjni mund t'i takojë panteonit semit ***Ba'al Hezza** – *zoti i kohës*. Mirëpo ky, duke u nisur nga fakti se emrat trakas, me prapashtesën *–zaios* dhe emri *Izaios*, janë të karakterit të emrave teoforikë trakas, mendon se këtu ka të bëhet me një hyjni trakase. S.Dušanići, është i mendimit se këtu mund të vendoset një lidhje me tempullin e njohur të Zeusit në qytetin Aizanoi. Në këtë tempull përmendet epiteti *Aezanensis*për Jupiterin, kurse në tekstin grek për Zeusin, jo. Në monedhat e hershme të Azisë së Vogël, përmendet etniku EZEANITΩN. Sipas Herodotit, emri etnik Azanoi rrjedh nga Aizena, përndryshe i biri i Tantalit. Kjo dëshmohet edhe në mbishkrime dhe në monedha. S.Dušanići, emrin AÏξανοί, në kuptim të mirëfilltë e trajton si etnik, të nxjerrur nga toponimi *Aiza ose *Aizos, i cili me prapashtesën –αÏος, formon teonimin 'ΕζζαÏος. Prandaj konstaton se kjo është hyjni trakase dhe se aty ka ekzistuar tempulli kushtuar Zeusit.

Po qe se merret si i saktë interpretimi i lartpërmendur, atëherë, dedikuesi Apolon Menelau është një imigrant nga Frigia, i cili lidhjen me vendlindjen e mban përmes adhurimit të këtij kulti.

Ardhja e tij në Dardani, me siguri ka të bëjë me veprimtarinë e xehetarisë. Ky kult është dëshmuar në një arë votive, të gjetur në Ulpianë:

– 'Απολλώνιος I Μενελάου 'αlνεστησε τόν βlωμόν ΰεώ Διί l 'Εζζαιώ εύχήν;

e cila është e fundit të shekullit I

VI. IUPITER ULPIANENSIS

Kulti i IUPITERIT është dëshmuar edhe me epitetin e emrit të qytetit, sikur është rasti edhe me emrin e qytetit të Ulpianës. Në Dardani, është fjala për arën votive, të gjetur në Batushë:

-I(ovi) O(ptimo) M(aximo) l VPP l d(omini) d(ivinae) et Gen[io] l Stationis pro s(alute) d(omini) n(ostri) imp(eratoris) l Severi Ale – l XANDRI l Aug(usti) l Valerianus l specul(ator) leg(ionis) IIII F[laviae] S(everianae) A(lexandrianae) v(otum) s(olvit) I(ibens) m(erito) Aug(usto) (sic!) Severo Alexand(ro) Aug(usto) [II] et Aufid[io] Marcello [II co(n)s(ulibus).

Identifikimi i Iupiter Ulpianensis e ka bërë E.Čerškovi, i cili shkronjat VPP i lexon si VLP(IANENSIS), gjë që është shumë afër realitetit.

Nga kjo shihet qartë se kjo hyjni vendëse që është identifikuar me Jupiterin, ka qenë karakteristike për Ulpianën, si pajton i këtij qyteti.

Kemi kështu një panteon të fragmentuar të hyjnive vendase që nderoheshin në Dardani.

Përveç emrave të njohur epigrafikisht të hyjnive vendase në Dardani, dr. Zef Mirdita flet edhe për një hyjni pa emër.

VII. KULTI I HYJNISË SË PANJOHUR

Në Ravne është gjetur busti prej bronze me diademë, për të cilin mendohet se mund të paraqet hyjneshën e plleshmërisë.

E njëjta figurinë i mban bustet e perandorit dhe të perandoreshës, ndoshta të Antonin Piut dhe të Faustinës, dhe konsiderohet si hyjnesha Roma ose Tutella.

Sidoqoftë, meqë nuk kemi diçka më të saktë, sipas së cilës dëshmi do të ishte përcaktuar natyra dhe funksioni i kësaj hyjnie, ndonëse ekziston mundësia e përkatësisë hyjneshës së plleshmërisë këtë hyjni e radhitin në kuadër të HYJNISË SË PANJOHUR.

Hyjnia e Panjohur është një subjekt tepër interesant dhe joshës, sepse është hyu i mungesës së emrit.

A përfaqëson ky Hy i Panjohur një simbol kryesor panteonik? Nëse e kemi paraqitjen skulpturore të tij, pse nuk e kemi emrin?

Tek Aktet e Apostujve thuhet se Shën Pali kur ishte midis filozofëve paganë në Athinë e pa një monument ku shënohej Hyu i Panjohur.

A ka lidhje kjo gjë me rastin e Hyut të Panjohur në Dardani. Për mendimin tim është shumë e vështirë që të vërtetohet një identifikim edhe në sfondin e krishterimit të hershëm të paktën si ndikim tek banorët e Dardanisë. Por problemi mbetet i hapur padyshim.

Në faktet e mësipërme më tepër flet arkeologjia dhe epigrafia.

Por duket qartë mungesa e dijes për ritualet që shoqëronin kultet, pra gati nuk dimë asgjë për institucionin funksionues ceremonial dhe me tërësinë e sistemit mendor mitologjik të dardanëve si ftillëzues dhe praktikues të miteve të tyre. Theksoj se:

Është e qartë se kultet ilire në Dardani janë formuar shumë më përpara sundimit romak, por në periudhën perandorake romake këto kulte mbijetojnë si përshtatje por edhe si modifikime të një lloj lirie religjioni e cila paracaktohet edhe si një mirëkuptim politik zyrtar i pushtetit perandorak për shumë arsye substanciale të ekuilibrave të brendshëm të kohës për popujt e ndryshëm etnikë brenda suazës shtetërore të perandorisë.

Sinkretizmi mitologjik në këtë rast duhet konceptuar si pranim i hapur i individualitetit etnik ilir të dardanëve dhe ky "zyrtarizim" nënkupton se në kalendarin e tyre mitologjik dardanët ishin të lejuar, pra kishin emërtimet përkatëse të ceremonialeve së bashku me tekstet orale (kujtesore) për hyjnitë e tyre.

Kulti i *Jupiter Ulpianensis* duket si titullar panteoni, emri autokton i këtij hyu ka humbur.

Dokumentimi në Shqipëri i hyut ilir *Jupiter Parthinus,* pra i fisit ilir të parthinene, tregon se ilirët e kanë patur një kryehyjni qendrore të panteonit të tyre.

Kulti i Dardanisë, si hyjneshë pajtore paraqet një interes maksimal dhe emërtues për provincën, pra njeh de facto dhe de jure një komunitet të qëndrueshëm dhe krejt të dallueshëm ilir të Dardanisë antike.

Karakteri femëror i hyjneshës Dardania duket ta ketë fillesën shumë të hershme, që nga mitologjia e matriarkatit. Unë personalisht do të shihja një lidhje të largët të rafigurimit femëror të hyjneshës Dardania me statuetat prehistorike të idhujve të çuditshëm dhe të jashtëzakonshëm të Dardanisë. Por kjo është një temë studimore më vete që kërkon një hulumtim të shumanshëm dhe të saktë.

Por është me rëndësi kryesore të thuhet se rafigurimi skulpturor i hyjneshës Dardania është deri më sot dëshmia më e patjetërsueshme e artit skulpturor të ilirëve për panteonin e tyre të humbur dhe të zhbërë në mijëvjeçarë.

Libri shkencor i dr. Zef Mirditës përfshin në fund edhe mendimet e dy specialistëve të spikatur, diturakë të mëdhenj që janë marrë seriozisht me problemet historike dhe kulturologjike të ilirëve.

Prof. dr. Aleksandër Stipçeviç shkruan kështu:

"Ky libër është fryt i një pune shumëvjeçare të hulumtimeve të autorit mbi dardanët e në veçanti jetës së tyre shpirtërore.

Para se t'i hynte punës së shkrimit të kësaj sinteze autori ka publikuar një sërë artikujsh mbi këtë problematikë, në gjuhën shqipe dhe në gjuhë tjera, mirëpo tek tani në dorë kemi studimin i cili përbashkon të gjitha rezultatet e tij të gjertanishme dhe e cila lexuesve do t'u jetë burim i pamënjanueshëm i informatave për hulumtime të mëtejme.

Religjioni i dardanëve, si ai kohëve parahistorike po ashtu dhe ai i antikës, është një temë e frytshme për çdo historian të religjionit, sepse në hapësirën dardane janë kryqëzuar shumë sisteme religjioni qysh në parahistori, e në veçanti pas ardhjes në kontakt me popujt përreth dhe religjionet e tyre, të cilat Dardaninë e kanë kthyer në një vend jashtëzakonisht interesant për studim. Të gjithë ata që në të ardhmen do të merren me fenomenet e religjionit në atë hapësirë do të kenë në këtë libër një themel solid mbi të cilin do të mund të ndërtojnë njohuritë e reja eventuale, ose të ndërthurin zbulime të reja, të cilat me siguri do të pasojnë në të ardhmen.

Zhvillimi i hovshëm i jetës së pasur shpirtërore në Dardani shihet më së miri nga lista e emrave të hyjnive të cilat autori i ka përpunuar në mënyrë sistematike dhe me themel.

Pa marrë parasysh se merret me të kaluarën e kamotshme, ky libër ka dimensionin e tij aktual që shihet nga gjendja ende e parregulluar në të cilën ndodhet sot ajo hapësirë.

Nuk guxojmë të harrojmë se këtu flitet mbi jetën shpirtërore të hapësirës e cila në shekujt e mëvonshëm do të përjetojë ndryshime të mëdha disa nga të cilat nuk kuptohen dot nëse nuk njihet gjeneza e tyre e largët parahistorike dhe antike.

Libri është shkruar në gjuhën shqipe, mirëpo do të duhej përkthyer edhe në ndonjërën nga gjuhët botërore, do të ishte e udhës në anglisht, sepse ka edhe nga ballkanologët, e jo vetëm nga politikanët, të cilët nuk i njohin proceset të cilat kanë ndodhur këtu dhe që kanë sjellë shumë halle të cilat i mundojnë banorët e sotëm të Dardanisë së dikurshme."

Kurse prof. dr. Marin Zaninoviç shënon:

"Vepra ka një vlerë të jashtëzakonshme shkencore, e punuar me bazë në burime (material epigrafik) dhe literaturë të pasur shkencore.

Edhe pse e kufizuar vetëm në territorin e Dardanisë, duke patur parasysh se ajo ishte pjesë përbërëse e Perandorisë Romake, vepra për nga tematika megjithatë bën pjesë në historiografinë europiane e më gjerë dhe trajton fenomenin e rëndësishëm shpirtëror-fetar të njerëzve të këtij territori nga koha e Neolitikut e deri te antika e vonshme.

Me këtë vepër prof. Zef Mirdita ka treguar dhe vërtetuar se zotëron shkëlqyeshëm me materien dhe metodologjinë shkencore e cila mund t'u jetë udhërrëfyes të tjerëve në trajtimin e problematikës së lartpërmendur për territore tjera.

Edhe pse e shkruar në gjuhën shqipe, duke iu falënderuar përmbledhje së gjerë të përmbajtjes në gjermanisht, ajo do t'u jetë e përdorshme edhe shkencëtarëve të cilët nuk e njohin këtë gjuhë.

Me këtë prof. Zef Mirdita ia ka prezantuar pasurinë shpirtërore të dardanëve dhe Dardanisë shkencës europiane dhe asaj më të gjerë."

EQREM ÇABEJ

NJË GJUHË SHKRIMI E NJËSISHME

Kur Komisia Letrare e Shkodrës, në "Parimet e rregullat" që caktoi për drejtshkrimin e shqipes aty nga fillimi i vitit 1917, vendosi që zanorja ë e pathekse, grupet zanore *ie, ue, ye* dhe grupet bashkëtingëllore *mb, nd e ngj* do të shkruhen të plota ashtu si i ruan këto toskërishtja e pjesërisht dhe disa nëndialekte të gegërishtes, ajo mund të shtonte e të thoshte që ashtu të plota kanë ekzistuar ato dhe janë shkruar pak shekuj më parë në krejt truallin e gegërishtes dhe se janë të gjithëmbarshme të gjuhës. Dihet se shkrimtarët e vjetër të Veriut, të shekullit XVI e XVII, gjer aty nga mesi i shekullit XVIII, Gjon Buzuku, Pjetër Budi, Frano Bardhi, Pjetër Bogdani, Gjon Nikollë Kazazi e të tjerë, ndër ta edhe ndonjë anonim, ruajtës të një tradite gojore e shkrimore të gjuhës, i kanë përdorur të plotë këta tinguj, këto grupe zanoresh e bashkëtingëlloresh, dhe se më anë tjetër këto ndihen dhe sot e kësaj dite në disa treva anësore e si të tilla më konservative të fushës dialektore të gegërishtes.

Në kohën e shpërnguljes së elementit shqiptar për në Itali, i cili rridhte kryesisht prej krahinave jugore të vendit, disa nga tiparet themelore të dallimit midis dialekteve kishin zënë vend me kohë në gjuhë, po më anë tjetër disa të tjera ndryshime që vërehen në shekujt e mëpastajmë, ende nuk kishin marrë rrugë; në vend të tyre ishin në përdorim fjalë, forma fjalësh dhe ndërtime fjalish të përbashkëta për mbarë gjuhën. Shohim kështu që midis gjuhës që përdor p.sh. Gjon Buzuku prej Veriu dhe asaj që shkruajnë arbëreshët e Italisë duke nisur me Lekë Matrangën prej Siqelie krahas me dallimet dialektore ka edhe pika takimi të shënueshme.

Pika takimi të tilla vërehen edhe midis gjuhës së atij autori dhe dialekteve shqiptare të Greqisë, si edhe midis këtyre dialekteve dhe atyre të Italisë më njërën anë, dhe gjuhës të së tjerëve autorë të vjetër të Veriut më tjetrën anë. Shkurt pra, në këto variante gjuhësore të Veriut e të Jugut, dialektore e letrare, pasqyrohet kudo në vijat e saj të përgjithshme një shqipe e kalimit nga koha paraturke në kohën e parë të sundimit osman, nga perioda paraletrare në periodën letrare. Është një njësi gjuhësore që manifestohet në variacione të shumëllojshme.

Për arsye të ndryshme të karakterit historik, ekonomik e social, me mungesën e një organizimi shtetëror të mirëfilltë e të një qarkullimi rrugor të rregullt, me shpërnguljet e brendshme të popullsisë sidomos prej katundeve në qytete, me rrugët e ndryshme të marrëdhënieve tregtare, me kontaktet e pakta krahinë me krahinë, me dallimet fetare të reja që erdhën e iu shtuan dallimeve konfesionale që ekzistonin qëmoti në vend, për këto e për të tjera arsye, që është vështirë të gjurmohen në hollësitë e tyre, ligjërimet e ndryshme të shqipes në periodën osmane morën një rrugë jo aq afruese sesa më fort larguese, pra në një farë vështrimi një

zhvillim më fort divergjent se konvergjent. Këtyre arsyeve të një karakteri të përgjithshëm jashtëgjuhësor vjen e u shtohet edhe një faktor i natyrës gjuhësore.

Tradita e shkrimit, e cila në kohët e para kishte marrë një hov të ri në Shqipëri, për disa rrethana të brendshme e të jashtme, më një anë për t'i vënë sadopak një ledh depërtimit të fuqishëm të islamizmit në vend, më anë tjetër duke u përfshirë në fushatën e Kundërreformës në Europë, vërtet se nuk u ndërpre krejt në periodën prej shekullit XVI gjer në Rilindjen letrare të shekullit XIX, si vazhdon të mendohet shumëkund gjer më sot, po megjithatë ra fashë në shumë pikëpamje.

U kufizua më një anë në një letërkëmbim tregtar e privat, më anë tjetër në shkrime të hartuara me qëllime praktike të shërbimit fetar, më anë tjetër me disa shkrime letrare laike të një karakteri pak a shumë privat, që mezi qarkullonin përbrenda disa rretheve shoqërore të ngushta. Asnjë nga këto shkrime, fetare e laike, nuk arriti të ngrihej në shkallën që të shihte dritën e botimit. Arsyet për këtë vetëm pjesërisht mund të kenë qenë të natyrës praktike, si do të ishin mungesa e shtypshkronjave dhe e mjeteve pekuniare. Arsyeja kryesore e këtij shkimi mbrapa, e kësaj rënieje letrare do kërkuar më fort në mungesën e një ideje sociale më të përgjithshme, e cila në çdo vend e në çdo kohë ka vënë njerëzit në lëvizje dhe ka gjetur mjetet e realizimit. Mungesa e një ideje të tillë bëri që këto shkrime mbetën qëllim në vetvete dhe nuk patën asnjë lidhje, asnjë konvergjencë në mes të tyre. Gjuhët e përbashkëta të shkrimit e të literaturës zakonisht ndërtohen mbi një bazë dialektore të caktuar.

Kjo ndërkaq përbën pikënisjen për një zhvillim të mëtejmë, nuk merret e gjitha ashtu si është, në tërësinë gjuhësore konkrete të saj. Shpeshherë asimilohen në atë mes edhe elemente të ndonjë dialekti tjetër ose dialektesh të tjera, ndonjë nga tiparet fonetike, morfologjike, sintaktike a leksikore të tyre, të cilat vijnë e integrohen në sistemin e gjuhës së përbashkët, ose përndryshe shërbejnë si model për të modifikuar ndonjë tipar të kësaj, që si tepër i veçantë ndihet nevoja që t'i shtrohet një reformimi.

Krahas me këto procese të një karakteri aktiv vërehet në atë mes edhe një proces i përkundërt, më fort negativ, i cili konsiston në këtë, që dialektet e tjera me kohë heqin dorë nga disa tipare vetjake të tyre, gjë që u hap rrugë formave të përgjithshme, lehtëson derdhjen e këtyre përrenjve në lumin e përbashkët të gjuhës. Arsyet që determinojnë marrjen e një dialekti të caktuar si bazë të përbashkët të gjuhës së shkrimit mund të jenë të ndryshme, sikundër tregon edhe vëzhgimi i formimit të gjuhëve letrare të popujve të ndryshëm të Europës. Aty ndikon ku epërsia kulturore e sociale e një krahine të caktuar të vendit, ku pozita qendrore e një dialekti, ku ekzistenca e një tradite letrare të formuar, që nëpërmes të një shkrimtari a disa shkrimtarëve me format arrin në një formë të përpunuar të gjuhës dhe bëhet kështu model për të tjerët, sikundër ndodhi p.sh. në Itali. Më shpesh vihet re ndërkaq se aty kanë çuar peshë si faktorë vendimtarë prestigji i një epërsie politike dhe të tjera arsye jashtëgjuhësore. Përgjithësisht mund të thuhet se zakonisht të gjitha këto komponente ndikojnë së toku në formimin e një gjuhe të përbashkët, natyrisht në shkallë e me përpjesëtime të ndryshme, ku më shumë njëra, ku tjetra.

Po të këqyret së këndejmi gjendja e shqipes si gjuhë shkrimi e literature, ajo mund të përvijohet shkurt në këtë mënyrë:

I pari dokument i datueshëm i gjuhës shqipe, Formula e Pagëzimit e vitit 1462, pra e epokës së Skënderbeut, në pajtim me rrethanat e kohës ruan një tipar dialektor të dallueshëm, *shpertit* për "shpirtit" të ligjërimit të Matit. Duke kaluar te shkrimtarët e mëpastajmë, me Gjon Buzukun në krye, vihet re më një anë një shkallë mjaft e përpunuar e gjuhës, një gjuhë letrare, më anë tjetër një formë gjuhësore me tipare mjaft të përbashkëta, me gjithë ndryshimet lokale në trajtat e fjalëve. Këto rrethana flasin për dy sende: E para, që gjuha ka qenë shkruar edhe më parë, gjë që dëshmon shprehimisht që më 1332 arqipeshkvi i Tivarit Guillelmus Adae, i cili njihet dhe me emrin Brocardus. E dyta, që këta autorë nuk kanë shkruar në dialekt me kuptimin e mirëfilltë të fjalës, po në një formë mbidialektore të gjuhës, në një farë koineje të Shqipërisë Veriore, me pikësynim që shkrimet e tyre të ishin të kuptueshme për një masë më të hapët besimtarësh. Kjo shihet qartë nga karakteri mjaft konvergjent i gjuhës së tyre, megjithëse ata rridhnin, sikundër dihet, prej krahinash së ndryshme të kësaj treve. Vetë dubletat që ndeshen në veprën e Buzukut, *kun* dhe *kon, ordhënit* e *ordënit, lem* edhe *letë, thanë* e *thashunë* etj., tregojnë që ky autor herë ngrihej në një formë gjuhësore më të përgjithshme, herë binte në ligjërimin lokal të vetin; kurse te pasardhësit e tij lëkundjet janë më të rralla, norma gjuhësore paraqitet e ngulur më mirë, ka shkuar më përpara.

Duke kaluar përsipër fazës së një fare amullie që u ravizua më lart dhe duke ardhur në shekullin XIX, shihet se idetë e shekullit të dritës (shekullit XVIII) dhe ato të romantizmit nisin e përhapen dhe në Shqipëri edhe në diasporën shqiptare. Romantizmi, i cili në Europën Juglindore u shtri më vonë, në një kohë kur në Perëndim kishte zënë fill natyralizmi, në këto vise, në pajtim me kushtet sociale e politike, zhvilloi më fort anën nacionale. Ndihmoi në zgjimin e ndjenjës së kombësisë, në vlerësimin e gjuhës amtare, në dashurinë për poezinë popullore dhe në përpjekjet për mbledhjen e saj, shumëkund nën shtysën e ideve të Herderit rreth vlerave të këngës popullore europiane. Në trevën shqiptare pemët e para të kësaj lëvizjeje mendore, e cila këtu ndërkaq u ushqye edhe me ide të shprehura që më parë nga disa fuqi të vendit, u dukën së pari, që në gjysmën e parë të atij shekulli, tek arbëreshët e Italisë me Jeronim De Radën në krye. Shkrimtarët e Rilindjes e çuan më tej këtë lëvizje dhe e ngritën në një shkallë nacionale. Për mbledhjen e folklorit pak u bë, me përjashtim të "*Bletës shqipëtare*" të Th. Mitkos; po ç'u la mënjanë në këtë fushë, u kompensua më së miri me anën letrare e gjuhësore. Visaret e ligjërimit popullor zunë të mblidhen e të hyjnë në literaturë, më anë tjetër gjuha letrare u pasurua me leksema të reja, pjesërisht të marra prej gurrës popullore ashtu si ishin, pjesërisht të farkuara kryesisht me lëndë gjuhësore të vendit, edhe pse shpeshherë si kalke, si përkthime, pas gjedhes së gjuhëve të tjera, përbrenda kuadrit të leksikut modern ndërkombëtar. Nuk është vendi këtu të shtjellohet në hollësitë e saj puna e kryer në këtë drejtim prej K. Kristoforidhit, J. Vretos, N. Frashërit, S. Frashërit, më vonë prej F. Konicës, F. Nolit, L. Gurakuqit e të tjerëve. Vetëm do të përmendet që Tahir Boshnjaku prej Gjakove që më 1835 shtiu në përdorim disa fjalë si *mësues, nxanës, digues, dis, folës, kallxues, shtis*, e të tjera si *pështim, randim, rrënim, rrëzim*, të cilat me të tjera rrugë u bënë pastaj pronë e

leksikut abstrakt të gjuhës shqipe. Duke e shikuar punën e kryer prej shkrimtarëve të shekullit të XIX në tërësinë e saj, shihet se ka një vijë zhvillimi në thelb të pandërprerë që nga tradita letrare e shekujve të mëparmë, një rilindje të vërtetë të asaj tradite të vjetër, edhe m'anë tjetër një fill të pakëputur që shpie në rrethanat e sotme. Po të shtrohet pyetja nëse në formimin e një gjuhe të përbashkët sidomos në shkrim, ka marrë pjesë në një masë më të madhe veprimtaria gjuhësore-letrare apo komponentja e fuqive jashtëgjuhësore, për Shqipëri përgjigjja është kjo, që - si në shumicën e vendeve të Europës - shtysa kryesore erdhi nga ana e këtyre fuqive. E ngritur që më parë në një shkallë më të lartë të përdorimit dhe e gatitur për një zhdrivillim të mëtejmë nga puna e kryer në shekullin e kaluar, shqipja mori formë si gjuhë shkrimi me tendencë për njësim në të ardhmen, kryesisht që prej themelimit të një shteti shqiptar e këtej, që kur ajo u bë shprehje e një njësie shtetërore të centralizuar. Kjo gjë gjeti pasqyrimin e saj dhe në shkrim dhe në drejtshkrim, në fushën fonetike po aq sa në leksik, dhe u zhvillua përherë e më shumë në këto fusha. U arrit me kohë në njësimin e disa trajtave fonetike e gramatikore, në ndjekje të rregullave të Komisisë Letrare të Shkodrës dhe të Kongresit të Lushnjës të vitit 1920. Puna më e madhe aty u krye ndërkaq në pasurim të visarit të fjalëve.

Me rrethanat e reja që u krijuan u desh të plotësoheshin nevojat e gjuhës së administratës e të fushave të tjera të veprimtarisë shtetërore, të ekonomisë, të teknikës, të arsimit e të kulturës, të sferës ushtarake etj. Për hir të së vërtetës duhet të thuhet se kjo punë jo e pakët, më shumë se prej personalitetesh të njohura, e prej shkrimtarësh e studiuesish të gjuhës, u krye prej masës anonime, prej nëpunësish të thjeshtë, administratorësh, juristësh, arsimtarësh, ushtarakësh, teknikësh degësh të ndryshme e prej së tjerësh. Një pasurim më i tejmë e shumë më i madh se më parë u arrit ndërkaq në ditët tona, kur pas çlirimit të vendit mori përmasa të reja industria, arsimi, dija, ekonomia, bujqësia, teknika e të tjera degë të veprimtarisë njerëzore.

Për të rrokur me një vështrim këtë rrugë zhvillimi në rrjedhë të disa brezave, mjafton të krahasojmë Fjalorin e gjuhës shqipe të vitit 1954 me atë të Hahnit që është i vitit 1854, ose dhe me atë të Kristoforidhit të vitit 1904. Aty shihet përparimi që është arritur në pasuri të fjalorit jo vetëm në një shekull, po edhe brenda një gjysmëshekulli. Një gjuhë e përbashkët, përtej caqeve shtetërore, mbetet shprehja e një njësie nacionale dhe e një shkalle të caktuar të kulturës së bashkësisë që e flet. Përpjesëtimi aty është i karakterit të drejtë, në mënyrë që sa më e fortë të jetë ajo njësi, sa më e ngritur ajo shkallë kulture, aq më e formuar paraqitet gjuha e përbashkët, si në të folur dhe sidomos në shkrim.

Një gjuhë e tillë qëndron kështu përmbi dialektet, është një madhësi mbidialektore, në një farë vështrimi emëruesi i përbashkët dhe sinteza e tyre. Ajo paraqet një realitet dhe njëkohësisht rezultatin e një farë abstraksioni, të formuar gjatë kohës, në mënyrë që nuk përputhet krejt me një dialekt territorial të caktuar, as edhe me dialektin që përbën bazën e saj. Sikundër u tha edhe më lart, gjuha e përbashkët e shkrimit edhe lë jashtë ndonjë element të këtij dialekti, edhe përvetëson me kohë elemente të dialekteve të tjera. Në këtë mënyrë kjo gjuhë bëhet një njësi brenda ndryshimeve. Duke qenë ajo edhe treguesi i shkallës së kulturës të

një populli, një popull i kulturuar ndër të tjera dallohet edhe për një gjuhë shkrimi të formuar e të njësishme. Në dallim nga gjuha e folur e nga dialektet e saj, e cila si më e lirë, më shpejt kalon nëpër ndryshime në kohë, gjuha e shkrimit, si shprehje e një kulture që është, i mbahet një tradite.

Ajo ka përgjithësisht një karakter konservativ, me të cilin ushtron bile një ndikim përmbi gjuhën e folur duke ngadalësuar ritmin e ndryshimeve që kjo pëson. Ky karakter i saj përcaktohet nga disa rregulla, të cilat në tërësinë e tyre përbëjnë drejtshkrimin e një gjuhe. Ato janë më të ngulëta se rregullat nëpër të cilat përshkohet gjuha e folur dhe bëhen gjithmonë e më të ngulëta, më të qëndrueshme, sa më shumë të marrë formë gjuha e shkrimit dhe e literaturës. Sa më fort kjo t'i afrohet njësimit, aq më shpejt zhduken në atë mes dhe përjashtimet nga rregullat, format dyjare të fjalëve e të trajtave gramatikore. Rregullat drejtshkrimore rrjedhin nga një realitet, e ky është shkalla e zhvillimit që ka arritur gjuha si tërësi në një cak kohe të caktuar. Drejtshkrimi duhet t'i përgjigjet këtij realiteti.

E shikuar nga këto pikëpamje parimore, forma e shkruar e shqipes, si ajo e përdorimit të përditshëm, si ajo e nivelit letrar, që prej kohësh kur dëshmohet së pari me shkrim, paraqitet me një vijë zhvillimi, e cila karakterizohet nga një aksiomatikë e caktuar. Aksioma e parë është që kjo formë gjuhësore gjatë përdorimit të saj është thjeshtuar gjithmonë e më shumë në trajtat e sistemit fonetik e gramatikor dhe është pasuruar në visar të fjalëve. Ky proces vazhdon dhe sot e kësaj dite, duke shkuar gjuha më një anë drejt thjeshtimit, më anë tjetër drejt pasurimit.

Aksioma e dytë është konvergjenca

Rregullat e drejtshkrimit ndaj tërësisë së këtij janë të krahasueshme me gurët e veçantë me të cilët ngrihet një ndërtesë; dhe si këta gurë, edhe ato rregulla kanë vendin edhe peshën e vet si elemente përbërëse të një tërësie. Po peshë kryesore në këtë mes ka tërësia.

Nuk është pa rëndësi që një fjalë e caktuar e shqipes të shkruhet me një ë të pathekse më pak ose më shumë, me një r të fortë ose të thjeshtë, me l palatale apo velare, me sh a me ç në pozicion nistor, dhe për këto çështje e të tjera si këto po diskutohet që t'u japim rrugë përbrenda mundësive të sotme. Po qenësore, esenciale në këtë mes, në dallim nga periodat e mëparme të historisë së shkrimit të shqipes, është që vija e zhvillimit gjuhësor shkon drejt konvergjencës. Dhe ajo shkon në thelb vetvetiu, në pajtim me ligjet e brendshme të gjuhës. Ky proces nuk mund të çmohet kurrë mjaft në rëndësinë e tij. Ai ka për të vepruar më tej edhe në të ardhmen. Aksioma e tretë përmban njëkohësisht edhe një rregull. Gjuha e shkrimit ka dalë në analizë të fundit prej gjuhës së gjallë të popullit që e flet. Në pajtim me këtë, edhe rregullat që përcaktojnë përdorimin e saj duhet të dalin nga të dhënat e këtij realiteti gjuhësor.

Fjala që Eqrem Çabej mbajti në "Kongresin e drejtshkrimit të gjuhës shqipe", që u zhvillua në Tiranë më 20-25 nëntor 1972.

THANAS L. GJIKA

KUJTIME PËR PROFESORIN EQREM ÇABEJ

Nga koha sudentore: Ora e fundit e leksioneve.

Ndjehem fatlumtur që kam pasur rastin të njihja nga afër profesorin Eqrem Çabej, personin tek i cili shprehjet ***Shkencëtar i Madh*** dhe ***Njeri i Madh*** ishin në harmoni të plotë. Sa herë sillja në mendje kujtime të ndryshme për të, ndjeja kënaqësi.

Këto kujtime desha t'i shkruaja e botoja në vitin 2008, me rastin e 100-vjetorit të lindjes së profesorit, vit i cili u shpall ***Viti Eqrem Çabej***, por u stepa, sepse mendova se ata që e kishin njohur më nga afër dhe për kohë më të gjatë se unë si profesorët Emil Lafe, Xhevat Lloshi, Jani Thomai, Gjovalin Shkurtaj etj, mund të shkruanin gjëra me më shumë vlerë dhe më bukur se unë. Mirëpo në vitin 2011, mbas disa komunikimesh me bijën e tij, zonjën Brikena Çabej, e cila nuk u kursye të më ndihmonte me korrigjime e saktësime, i shkrova e i botova kujtimet e mia. Duke parë se këto kujtime vijojnë të lexohen me interes, në shkurt-mars të vitit 2016 i ripunove dhe i pasurova më tej.

* * *

Profesor Eqrem Çabej jepte në degën Gjuhë Letërsi Shqipe të Fakultetit të Historisë e të Filologjisë kursin e plotë të leksioneve *Historia e Gjuhës Shqipe*, vepër origjinale e tij. Këtë lëndë ai e zhvillonte në dy semestra, gjatë semestrit të dytë të kursit të tretë dhe gjatë semestrit të parë të kursit të katërt. Ai ishte pedagogu më mbresëlënës i fakultetit, ndoshta dhe i gjithë Universitetit të Tiranës. Ai ishte nga ato rastet kur përputhen tek një person i vetëm gjithë të mirat: pamja e bukur fizike, bukuria shpirtërore, aftësitë profesionale, sjellja fisnike dhe talenti. Mbas shkërmoqjes së diktaturës, kur shpërtheu shfaqja e pakënaqësive të ndrydhura, ky profesor ishte një nga personalitetet e pakta të kulturës sonë, që nuk u kritikua për asgjë prej askujt, dëshmi e vlerave të tij.

Ishte burrë i gjatë e i pashëm, elegant, me një shikim të ëmbël, gjithnjë i natyrshëm, asnjëherë pozant ose kërcënues. Mbante kapelë republikë, kur ecte i vetëm, ecte shpejt me hapa të gjatë, si atlet. Përshëndetja e tij na bënte përshtypje: të shikonte në sy dhe pasi ulte pak kokën, e çonte pak kapelën me dorën e djathtë. Në sallën e leksionit, ose në korridoret e fakultetit, si dhe gjatë viteve që punova në institut, nuk e pashë kurrë të parruar dhe asnjëherë nervoz. Gjithnjë i matur në të folur, madje pak i ngadalshëm. Na sillej sikur ishim të barabartë me të. Leksionet i mbante gjithnjë duke folur në këmbë tek katedra, kurse fragmentet që sillte për ilustrim mendimesh prej stukuesve të tjerë i lexonte. Kur lexonte vinte syzet. Vënia dhe heqja e syzeve i kishte shumë lezet. Disa fjalë kyçe të leksionit i shkruante në

dërrasën e zezë. Fliste me zë jo të lartë, gjë që e shtonte qetësinë në sallë. Ato që shqiptonte ai, ne përpiqeshim t'i përpinim. Në pamjen dhe sjelljen e tij kishte diçka madhështore që të tërhiqte e të bënte për vete. Leksionet e tij, ndonëse trajtonin probleme të vështira, ishin plotësisht të kuptueshme. Në to sundonte analiza logjike dhe argumentimi, rrallë përdorte fjalë të huaja, gjithçka ishte e qartë.

Profesori përdorte disa shprehje të vetat, midis të cilave më kanë mbetur në mendje dy. Shprehjen: *Për hir të së vërtetës, duhet pranuar se*, e përdorte për të miratuar një mendim të kundërshtuar më parë, kurse shprehjen: *Këtë, një Zot e di*, e përdorte për të treguar dyshim ndaj një mendimi ose hipoteze të pazgjidhur. Këtë shprehjen e dytë, e cila ishte një shprehje popullore shumë e vjetër, e shqiptonte duke ngritur deri te fytyra e tij gishtin tregues të dorës së djathtë. Shprehjen e parë filluan ta përdornin me gojë e me shkrim dhe disa pedagogë, studiues e studentë, por shprehjen e dytë nuk guxonte ta thoshte askush tjetër veç tij. Për bindjet e tij fetare ishte e vështirë të krijoje një mendim të qartë. Ai asnjëherë nuk hapi ndonjë bisedë me temë fetare. Botëkuptimi dhe sjellja e tij ishin brumosur që në rini gjatë jetës në Austrinë e qytetëruar, prandaj ishte i çliruar prej shumë dobësive që manifestonin shqiptarët e lindur dhe plakur brenda atdheut. Në sjelljen dhe pamjen e tij binin në sy tipare prej një europiani të vërtetë, tipare që nuk i gjeje as në të krishterët e muhamedanët e përkorë.

Ora e fundit e mësimit me të, aty nga fundi i dhjetorit 1965, më ka mbetur në mendje. Atë orë, profesori nuk shpjegoi lëndë nga teksti, por duke na konsideruar kolegë, na dha disa këshilla për jetën tonë të ardhshme. Për të krijuar afrimitet me ne, atë orë ai foli ulur. Këshillat e asaj ore më kanë lënë mbresë, ndoshta sepse, kujtimi i mjaft prej tyre më bën të ndjehem fajtor. Ndjehem fajtor, sepse në rininë time dhe më vonë nuk i vlerësova sa duhej dhe nuk i zbatova si duhej...

Mbasi u vendos qetësia, profesori filloi:

-Ju do të bëheni mësues. Mësuesia nuk është profesion, ajo është mision. Ju do të punoni për formimin e njeriut. Gabimet që mund të bëni ju me nxënësit, janë të pakorrigjueshme. Po ta formosh shtrembër karakterin e një njeriu, është shumë, shumë e vështirë, në mos e pamundur, ta ndreqësh atë.

Ju duhet të edukoni përmes sjelljes suaj, përmes shembullit tuaj. Në rast se ju silleni keq, edhe sikur të mbani dhjetëra leksione morali, ose leksione për nevojën e sjelljes së mirë, nxënësit nuk do të përfitojnë asgjë, ata do të ndikohen kryesisht prej sjelljes suaj. Shembulli të bën ta ndjekësh njeriun.

Kur punoni, punoni seriozisht dhe me ritmin e duhur. Mos u merrni me biseda gjatë punës. Kur të pushoni, pushoni vërtet. Mos e përzieni kohën e punës me kohën e pushimit dhe as kohën e pushimit me atë të punës. Ata të cilët gjatë punës bëjnë muhabete dhe gjatë pushimit përpiqen të kryejnë ndonjë punë të mbetur në mes, nuk arrijnë rezultatet e duhura.

Mos jini kategorikë kur shprehni mendimet tuaja.

Gjithçka shikojeni me sy kritik.

Kur mendoni ndryshe, mos e konsideroni veten tepër të rinj dhe të paformuar për të shprehur dyshime, për të hapur diskutime.

Mos kini turp të pyesni për gjëra që nuk i keni të qarta. Gjërat e paqarta nuk mbahen mend.

Mos bëni asnjë punë shkel e shko.
Mos filloni të shkruani diçka pa e pasur të qartë në kokën tuaj.
Mos lini asnjë punë pa e përfunduar plotësisht dhe si duhet.
Mos merrni dhe mos lejoni t'ju marrin dinjitetin nëpër këmbë.
Jeta e njeriut është një fragment i planeve, dëshirave dhe ëndrrave të tij, prandaj kushtojuni planeve, dëshirave dhe ëndrrave tuaja kryesore....

Profesor Çabej nuk i pëlqente djallëzitë dhe jetonte thjesht

Mbasi mbarova fakultetin, në verë të vitit 1966 u emërova redaktor në *Radio Tirana*. Në vitet 1967-1969 punova në redaksinë e kulturës dhe përgatisja emisionet*Enciklopedia e Radios, Në Botën e Shkencës dhe Teknikës, Universiteti Popullor i Radios, Përkujtim Datash Historike*, etj. Midis bashkëpunëtorëve që më ndihmonin për materiale të ndryshme kisha aktivizuar edhe agronom Ilia Mitrushin, specialist i dendroflorës shqiptare. Ai kishte studiuar në Grac të Austrisë. Aty për më se një vit, ai, Eqremi e Lasgush Poradeci, kishin qenë studentë në degë të ndryshme e jetonin në shtëpi të ndryshme nëpër familjet e vendasve.

Një herë ing. Mitrushi (ky nuk e quante veten agronom, por ingjinier) e solli materialin në fund të orarit zyrtar dhe iu luta të shkonim bashkë. Po ecnim drejt lumit Lana. Ilia më tregoi se prof. Norbert Jokli, albanologu më i shquar i kohës, i ftonte këta tre studentë shqiptarë një herë në dy javë të dielave për vizitë në shtëpi të tij. Aty ai hapte diskutime për probleme të gjuhës shqipe. Eqremi ndonjëherë mungonte.

-*Unë me Lasgushin*, shtoi Ilia, *mendonim se Eqremi mungonte sepse si student i rregullt i Joklit i kishte dëgjuar ato diskutime në leksione. Mirëpo Jokli një të djelë tha:*

-*Çabeu është i ri, për të ka më shumë rëndësi një shëtitje me një vajzë të bukur sesa diskutimet e mia që i ka dëgjuar në auditor*. (Ing. Mitrushi, profesor Aleks Buda dhe Lasgush Poradeci, e përdornin formën e shquar të mbiemrit: *Çabeu / Çabeut / Çabeun,* njësoj si *Skënderbeu / Skënderbeut / Skenderbeun* dhe jo si e përdorim ne sot: *Çabej / Çabejt /* Çabejn).

Ing. Mitrushi desh të më tregonte me këtë thënie të prof. Joklit, se Eqremi i ri nuk kishte qenë një student i mbyllur, nga ata që ne i quanim "peshkop", por dhe qejfli e modern, që dinte ta vlerësonte shoqërinë me vajzat e bukura. Unë kisha idenë se Çabej kishte qenë gjithnjë si tani, njeri i përkorë dhe i përkushtuar pas studimeve. Për ta ngacmuar z.-in Mirtushi thashë:

-*Profesor Eqremi më duket pak naiv dhe njeri i padjallëzuar*.

-*Eqremi dhe ne të tjerët që kemi studiuar në Austri dukemi naivë, por nuk jemi të tillë. Ne i kuptojmë fare mirë djallëzitë e të tjerëve, por nuk bëjmë vetë djallëzira. Ne u rrimë larg djallëzive, sepse e kemi të qartë ku të shpien ato...*

Kjo përgjigje ma qartësoi më tepër karakterin e profesorit dhe ma shtoi dashurinë e respektin për të. Një gjë e ngjashme më ndodhi edhe në një nga takimet me z. Nush Shllaku, i cili kishte qenë nxënës i gjimnazit të Shkodrës rreth vitit 1935. Padër Gjergj Fishta i ftuar prej pedagogut Eqrem në një nga orët e mësimit të letërsisë shqiptare, u kishte thënë nxënësve:

-Eqremi ka le me u ba klerik, por i asht kushtue shkencës.

Si redaktor i Radjos, për të përgatitur emisionet shfrytëzoja përveç bashkëpunëtorëve të jashtëm dhe nja dy revista të huaja që vinin në bibliotekën e atij institucioni. Një ditë shtatori të vitit 1969, duke shfletuar revistën franceze *Science et Vie* (*Shkenca dhe Jeta*), pashë brenda saj një disk me incizime. Mësova se në Francë kishte filluar krijimi i enciklopedive zanore, me incizime të personaliteteve të artit, shkencës, kulturës, politikës, etj. Më shkoi mendja se mund ta filloja dhe unë një punë të tillë sado modeste me disa njerëz të shquar të botës shqiptare. Disa ishin incizuar prej kolegëve të mi, ose prej meje në emisione të ndryshme, por shiritat nuk i ruanim. I sugjerova shefit të redaksisë, z. Ruzhdi Pulaha që t'i ruanim disa disqe me incizime me këtë synim, por ai më tha se shiritat ishin mall importi dhe sot për sot ruhen vetëm incizimet e fjalimeve të udhëheqësve kryesorë të partisë. Në Shqipëri nuk ka filluar hartimi i enciklopedisë së shkruar me fjalë, enciklopedisë zanore kushedi kur i vjen radha...

Atëherë mendova të bëja diçka vetë, së pari me profesorin më të dashur, prof. Çabejn. E takova dhe i thashë se doja të incizoja një leksion përmbledhës të tij, me synimin që ta ruante ai e familja për kohën kur mund të krijohej një enciklopedi zanore. Ai më tha se i kishte të incizuar disa leksione të *Historisë së Gjuhës Shqipe*. Më ftoi për t'i dëgjuar dhe pastaj të vendosnim ç'duhej bërë. Vend takimi ai la shtëpinë e tij, mbi Unazë, në lagjen Varri i Bamit.

Aty, gjatë tetor-nëntorit '69, të dielave njoha familjen e profesorit. Zonja Shyhret, nikoqirja e shtëpisë, në minutat e para të pritjes vinte rrotull me lëvizje të shpejta, na qeraste rregullisht me ëmbëlsira të bëra vetë e ndonjë shurup frutash, pastaj ulej për të dëgjuar dhe ajo. Ishte elegante dhe shumë e kujdesshme. Ishte një dibrane e vërtetë, shtëpinë e mbante shumë pastër, në biseda ishte e shpejtë, hazër xhevap, si i thonë fjalës; gjykimet i formulonte shpejt e saktë. Kuzhina dhe dhoma e pritjes ku pata rast te rrija, ishin mobiluar thjesht, me disa kolltuqe, divane e karrige të bëra dikur nga marangozët privatë, që ndryshonin prej mobilieve uniforme që prodhonte kombinati *Misto Mame*, të cilat i gjeje në apartamentet tona.

Djali, Artani 16 vjeçar, i gjatë, i ngjante babait. Kishte qejf të konsultonte herë pas here fjalorin francez *Petit Larousse*. Ndjehej se kishte lexuar shumë për moshën e tij. Mori pjesë vetëm në dëgjimin e leksionit të parë, herët e tjera, pas përshëndetjeve, shkonte te dhoma e vet, ku lexonte e studionte.

Vajza, Brikena 12 vjeçe, ngjante nga të dy prindërit. Ishte elegante dhe e shkathët si mamaja, por vështrimin e kishte të qetë e meditativ si të babait. Ajo kishte qejf të lexonte në dhomën e vet, ose të luante jashtë me shoqet. Nuk erdhi kurrë për të dëgjuar leksionet.

Pata rast të njihja dhe tre nga nipat e profesorit, Tanushin, Hysenin dhe Fatosin, djem të gjatë, seriozë dhe të pashëm, nuk ngjanin midis tyre. Hyseni kishte diçka të ngjashme me profesorin në qëndrim dhe buzëqeshje. Ata erdhën herë njëri herë tjetri, herë dy bashkë. Një të diele rastisi të vinte për vizitë në atë orë dhe mjeku Flamur Topi, i cili ishte mik i familjes. Unë e njihja, sepse ai ishte gazetar i jashtëm në *Radio Tirana*.

Për disa të diela me radhë dëgjuam nga një leksion, një orë e gjysmë. Prej z-njës Shyhret mësova se ditët e diela profesori i shfrytëzonte zakonisht për të

shkruar letra, për të bërë ndonjë vizitë a shëtitje. Ai mbante korrespondencë të rregullt me shumë studiues e miq austriakë, gjermanë, francezë, rumunë, italianë, etj. Nuk dij a i shkruante letrat duke përdorur letër kopiativ për të ruajtur një kopje për vete, apo jo. Mësova gjithashtu se profesori pëlqente të lexonte shpesh herë duke qëndruar në shtrat gjysmë shtrirë e duke vendosur librin në një copë kartoni, të cilën e mbante me dorën e majtë mbështetur mbi gjoks. Kurse për të shkruar, më shpesh ai ulej te tavolina e punës.

Shyhreti e qortoi veten se tani që kishin ardhur në këtë apartament larg pazarit nuk gjente kohë për të shkuar shpesh për të blerë peshk të freskët, ushqimin e nevojshëm për bashkëshortin e saj.

Të dielën e parë të dhjetorit ’69 dëgjuam leksionin e fundit. U thashë se incizimet kishin cilësi të mirë dhe duheshin ruajtur me kujdes. Prej tyre mund të riprodhohej një material më i shkurtër, duke e hedhur në një bobinë të re, etj.

Para se të ngrihesha për të ikur, profesori tha se kishte dëgjuar që zyra e kuadrit të Universitetit po kërkonte të merrte disa kuadro të rinj, midis të cilëve ishte përmendur dhe emri im, pra unë mund të transferohesha nga *Radio Tirana* tek *Instituti i Historisë e i Gjuhësisë* (në atë kohë ky institut varej nga *Universiteti i Tiranës*). Pastaj më pyeti nëse kisha kërkuar unë që të transferohesha, apo drejtoria e Institutit po më kërkonte me që kisha mbaruar fakultetin me nota të larta. I thashë se puna në Radio ishte shumë robotike, aspak shpirtërore dhe nuk më pëlqente. Unë kisha kërkuar disa herë të vija me punë në institut, sepse më pëlqente të merresha me studimin e jetës dhe krijimtarisë të rilindësve tanë, të cilët i admiroja.

- *Gëzohem, që ke kërkuar vetë të vish aty. Nuk ka më mirë sesa ta zgjedhësh punën vetë. Kur ta zgjedhin punën të tjerët, shpesh herë bëhen gabime*, tha ai dhe shtoi: *Unë fëmijët e mi i nxis të mësojnë, të lexojnë dhe të luajnë me shokët, por nuk iu imponoj asnjë lloj drejtimi, atë duhet ta gjejnë vetë...*

Gjatë viteve kur punova në Institut: prof. Çabejn e admironim të gjithë

Në janar të vitit 1970, u realizua transferimi im nga *Radio Tirana* në *Institutin e Historisë e të Gjuhësisë*. Në Radio punën e fillova me qejf, por shumë shpejt e ndjeva se nuk ishte e ardhmja ime në atë punë. Mezi i shtyva tre vjet e gjysmë. Natyrisht përfitimi ishte i madh, u njoha nga afër me gazetarë të aftë e të talentuar, si Fuat Bozgo, Ruzhdi Pulaha, Kiço Blushi, Nasi Lera, me spikerë të talentuar si Haki Bejleri, Kiço Fotiadhi, Vera Zhei, Meropi Xhai, Luiza Papavangjeli, etj. Aty mësova proceset e incizimit e të daktilografimit; u njoha me intelektualë të formuar jashtë shtetit që punonin si përkthyes si Viktor Kraja, Abaz Xhomo, etj. Puna e atjeshme ma shkundi ngathtësinë. Në institut fillova punë në sektorin e letërsisë shqiptare, ku ishin punësuar para meje Klara Kodra, Jorgo Bulua, Luan Kokona, Floresha Haxhia (Dado) me shef Koço Bihikun.

Profesor Çabej, për të më uruar mirë se erdhe në Institut, më ftoi një ditë për kafe. Shkuam bashkë tek një ëmbëltore në rrugën e Kavajës karshi kishës katolike, të cilën në atë kohë e kishin transformuar në pallat sporti dhe nga jashtë i kishin bërë disa maskime që të kujtonte kamionët që parakalonin për festën e 1 Majit të veshur me kompesato e beze. Eqremi mori një tas të vogël me hashure, unë një

kafe, të dyja kushtonin nga 7 lekë të asaj kohe. Më sqaroi se hashurja i kujtonte fëmijërinë, familjen e Gjirokastrës. Pastaj më uroi për punën e re:

-Bëre mirë që kërkove të vish në Institut, këtu është vendi më i mirë për të vijuar formimin tënd shkencor. Tani je në moshën më të mirë për të mësuar gjuhë të huaja...

Unë i thashë se ndoshta do të ishte më mirë të kisha ardhur menjëherë nga bangat e shkollës, tani jam gati 26 vjeç dhe më duket se jam vonë për të mësuar gjuhët e huaja, të cilat i dij jo mirë.

-Jo, ma preu ai*, ti ke ardhur në moshën më të mirë. Vitet e punës në Radio Tirana të bënë mirë, ke njohje më të gjerë për jetën, ke tjetër horizont. Kujtesën e ke akoma të freskët, pastaj tani je më i pjekur. Pjekuria të bën më të ndërgjegjshëm dhe ta shton vullnetin për studim.*

Unë, pas pak, për t'u treguar i zgjuar, formulova një ankesë ndaj mbreti Zog, se ai duhej të kishte bërë më shumë për ekonominë, arsimin dhe shkencën.

-Mbreti Zog nuk duhet fajësuar shumë, tha profesori*, në atë kohë ishte zor të bëhej më tepër. Ai u përpoq t'ia kthente fytyrën Shqipërisë nga Europa, por shqiptarët nuk ishin të gatshëm. Mbaj mend se mbreti kishte dhënë urdhër që të punësoheshin vajzat dhe gratë. Mirëpo në tërë Tiranën mezi pranoi një grua, a vajzë e moshuar, që të punësohej tek zyra e postës. Kur u ktheva nga Shkodra në Tiranë, pashë se shumica e meshkujve bënin xhiro duke kaluar nga ajo rrugë për ta parë fytyrën e asaj femre te dritarja e punës. Për ta ishte diçka dëfryse, ose e çuditshme.*

Ne shqiptarët gjejmë gjithnjë shkaqe jashtë vetes sonë për prapambetjen tonë. Në kohën e Mbretit Zog e dëgjoja shpesh thënien "fajin na e ka Turqia që na la shumë prapa", pas Luftës (ai nuk e përdorte togfjalëshin *Luftës Nacional Çlirimtare*), *kemi shtuar dhe thënien "fajin na e ka Ahmet Zogu që na la prapa". Ne duhet t'i shohim shkaqet e prapambetjes sonë së pari te vetja jonë, duhet të punojmë më shumë.*

Pasanikët shqiptarë, në kohën e Turqisë dhe të Mbretërisë i kishin qypat plot me florinj, por asnjëri prej tyre nuk bëri ndonjë investim në bujqësi ose industri.

Çdo gjë do kohën e vet...

Herën tjetër e ftova unë profesorin për kafe. Gjatë atyre minutave u hap biseda për punën e tij lidhur me etimologjinë e fjalëve të shqipes. U çudita kur tha se edhe gjuhëtarë të tjerë mund të merren me studime të tilla, mjafton pasioni dhe këmbëngulja. Tha se atë e bëri etimolog jo shkolla, po puna e vazhdueshme e me pasion. Pastaj shtoi:

-Shumë shpjegime të mia për origjinën e fjalëve mund dhe duhet të diskutohen, studimet etimologjike në fushë të shqipes duhet të pasurohen edhe nga të tjerë...

Në vitin 1974 u hartua rregullorja e kualifikimit shkencor, u dhanë orjentime se si do të kandidonim për të mbrojtur gradat shkencore *Kandidat i Shencave Filologjike* dhe *Doktor i Shkencave Filologjike*. Ne që do kandidonim në fushën e letërsisë për gradën e parë na u caktuan katër provime dhe hartimi i një vepre studimore si disertacion. Për provimin e zgjeruar të historisë së letërsisë na u dha një listë shumë e gjatë veprash letrare, ku përfshiheshin edhe veprat e disa autorëve të ndaluar si Ernest Koliqi, Pader Gjergj Fishta, Faik Konica, etj. Mirëpo midis

veprave me studime nuk na u dha asnjëra prej veprave studimore të profesor Çabeut ku trajtoheshin probleme të letërsisë si *Për gjenezën e literaturës shqipe, Studime italo-shqiptare* dhe *Elemente të gjuhësisë e të literaturës shqipe*. Kur ia hapa bisedën rreth këtij problemi, profesori nuk shprehu asnjë shqetësim dhe nuk dha asnjë sqarim mbi arritjet e tij në fushën e studimeve letrare. Ai nuk donte të më impononte mendimet e tij. Unë duhej t'i lexoja e gjykoja vetë ato vepra.

Në sjelljet, veprimet, bisedat e tij binte në sy karakteri burrnor. Ndryshe nga ne të tjerët, profesor Çabej në biseda e shkrime nuk i përmendte emrat *parti* dhe *Enver*. Koha kur u shfaq edhe më dukshëm karakteri i tij i fortë ishte koha mbas vdekjes së djalit të tij. Vdekje tepër tronditëse, por që ai nuk e lëshoi veten, ruajti po atë temperament, po atë dashuri për punën, po atë sjellje me njerëzit.

Mirëpo fakti që ne, ish studentët e tij ndjenim për të një admirim të hapur, nuk durohej prej drejtorisë dhe instancave partiake. Në vitin 1973-74, kur udhëheqja e partisë rimori luftën kundër shfaqjeve të huaja, në *Institutin e Gjuhësisë dhe të Letërsisë* u organizua një mbledhje, për të luftuar shfaqje të tilla. Në fakt, punonjësit e Institutit ishin njerëz të thjeshtë, pa pretendime, shikonin punën, mirëpo dhe midis tyre duheshin gjetur ndikimet e huaja, dhe organizata bazë e partisë, sipas orientimeve, i kishte gjetur. U kritikua së pari zonjusha Beatriçe Keta për mbajtje të fundeve të shkurta. Beatriçja ishte vajzë e gjatë e pamartuar, fundet deri tek gjunjët i shkonin për bukuri. Të gjithë e pëlqenim atë pikërisht për ato fundet që i sajonte vetë me gusto, por ja që duhej kritikuar. Kritika vijoi, jo më kundër ndonjë punonjësi, po me sulm ndaj fëmijës së vetme të profesor Çabejt. U kritikua vajza e tij, atëherë 16-17 vjeçe, se mbante minifunde.

Për herë të parë e pashë profesorin të reagonte i revoltuar e nervoz. U ngrit me furi dhe tha me zë të lartë:

-*Këto janë shpifje, ime bijë hodhi shtat shpejt këto dy vjet dhe fundet e fustanet i rijnë tek gjuri, këtë nuk e bën për ndjekje mode*.

Nja tre vjet më vonë, kur Brikena, vajza e tij, që ishte studente, shkoi në aksion ku i mblodhi gjuri ujë, në fakultet i varrën një fletë-rrufe, ku e kritikonin se mbante flokët e gjata, si ndikim i modës perëndimore...

Për të tilla sulme ndaj vajzës, fëmijës së vetme, që i kishte mbetur profesorit pas vdekjes tragjike të djalit, ne na vinte turp, por nuk guxonim të flisnim. Përmes terrorit partia shtet na kishte kallur frikën në mendjet e në zemrat tona dhe ne ishim pajtuar me të si të ishte një ndjenjë e qëndrim i moralshëm. Kuptohej se të tilla sulme synonin që të na e shkulnin atë nga zemrat tona.

Për turpin e politikës së partisë, Eqrem Çabej nuk u sulmua vetëm si person e si familje, por edhe në plan shkencor. Kështu, në fund të viteve 50-të Eqremi mbaroi transkriptimin dhe transliterimin shkencor të veprës monumentale *Meshari* të Don Gjon Buzukut. Kjo vepër e tij mban datë botimi vitin 1962, sepse u dërgua e u botua atë vit në Rumani, por në fakt atë e dërgoi ambasada jonë nga Bukureshti pas disa vjetësh, kur kishte filluar lufta kundër fesë. Ballkanologët rumunë u shprehën me superlativa.

Për t'i treguar botës së huaj se partia e vlerësonte shkencën, kësaj vepre iu dha *Çmimi i Republikës i klasit të parë*, por ajo nuk u nxor kurrë në shitje. Preteksti ishte se kjo vepër mund të përdorej si vepër liturgjike nga besimtarët e krishterë...

Vepra, së cilës ky studiues i kushtoi pjesën më të madhe të jetës dhe me të cilën dëshmoi aftësitë e rralla, formimin e lartë si komparativist dhe talentin e vet, është puna për shpjegimin e origjinës së fjalëve të shqipes. Mbas botimit të shumë artikujve me karakter etimologjik në revistën shkencore *Studime Filologjike* dhe në revista të huaja, ai ndërmori ripunimin, zgjerimin dhe përgatitjen për botim të veprës madhore *Studime Etimologjike në Fushë të Shqipes* në disa vëllime. Në vitin 1975 dorëzoi për botim dy vëllimet e para, prej të cilëve, më 1976 u botua vetëm vëllimi i dytë. Vëllimi i parë nuk u lejua të botohej me preteksin se autori përmendte aty me respekt Faik Konicën dhe Mustafa Merlika Krujën, si eruditë shqiptarë që kishin dhënë ndihmesë në fushën e etimologjisë së gjuhës shqipe. Ky fakt u quajt gabim ideologjik, mbivlerësim i dy figurave *reaksionare*, por profesori nuk pranoi t'i hiqte emrat e tyre dhe vlerësimet për ta. Kështu vëllimi i parë u pezullua dhe u botua vetëm mbas vdekjes së tij, kur nxënësit e tij ia *redaktuan* (hoqën) ato fjalë e shprehje. Vëllimet e tjera, ndonëse ishin pothuaj gati, u botuan pak nga pak por jo të gjitha deri më 1990 e më vonë...

Ata që donin ta përulnin Himalajën e shkencave albanologjike, përpiqeshin si e si të mos ia botonin veprat, sidomos kryeveprën, ose kur detyroheshin t'ia botonin, të mos ia nxirrnin në qarkullim.

Profesor Çabejn, sa qe gjallë, e respektuan dhe e gëzuan si e meritonte intelektualët dhe zyrtarët shqiptarë të Kosovës, sidomos punonjësit shkencorë të *Institutit Albanologjik të Prishtinës*. Shtëpia botuese *Rilindja* botoi një përmbledhje të veprës së tij në gjashtë vëllime, botim luksoz, me format të madh, lidhur me kapakë të fortë ngjyrë çokollatë. Punonjësit shkencorë të *Institutit Albanologjik*, pedagogët e *Fakultetit Filozofik* dhe studentët e Kosovës me pritjet shumë të përzemërta plot respekt, që i bënin prof. Çabejt gjatë vajtjeve të tij për leksione në Prishtinë, i krijuan atij emocione dhe gëzime të mëdha, të cilat na i tregonte me një ngazëllim të përmbajtur.

Në vitin 1975 mua më komunikuan qarkullimin, meqenëse kisha qenë martuar me vajzën e zv. ministrit të tregtisë, Vasil Katit, i cili u arrestua atë vit me grupin e shpallur *armiq në ekonomi*. Unë, si shumica e atyre që u ndodhi kjo fatkeqësi, u ndava nga bashkëshortja, por ky veprim i imi nuk i kënaqi anëtarët e partisë së Institutit. Ata vendosën të më qarkullonin. Shokët filluan të më rrinin pak ftohtë...

Një ditë, mbas punës, kur po ecja vetëm në rrugën e Kavajës drejt qendrës, m'u afrua profesor Çabej dhe e bëmë rrugën bashkë. Zakonisht ai punonte nga ora 8:00 deri 13:00, atë ditë ndoshta kishte pasur ndonjë mbledhje që po shkonte në shtëpi me vonesë. Duke ecur e pyeta pse nuk e merrte autobusin e Unazës për të mos u lodhur.

-Më pëlqen të eci në këmbë, e konsideroj si fizkulturë. Pastaj kam mendimin se ne që na bie rruga të kalojmë nga Qendra e Tiranës, kemi një favor, njihemi të parët me ndryshimet që mund të ndodhin në qendër. Këtë favor nuk e kanë ata që kalojnë rrugëve anësore.

Për të më dhënë kurajë, hapi bisedën rreth qarkullimit. U çudita kur tha pa ndrojtje:

- *Qarkullimi, për kuadrot e rinj është i dëmshëm, sepse i shkëput nga procesi i kualifikimit.* ***Qarkullimi për ty është çkualifikim***.

Ndoshta këtë mendim ai e kishte thënë edhe gjetkë... Im vëlla, kur dëgjoi prej meje mendimin e profesorit, mori kurajë dhe shkoi e u ankua tek një punonjës i Komitetit të Partisë së Tiranës, te z. Bujar Kolaneci, i cili kishte punuar më parë në Kinostudio si ekonomist filmi. Ky duket se ndërhyri dhe organizata bazë e partisë së Institutit nuk nguli këmbë për të realizuar qarkullimin tim. Mbasi disa rrethe u përgjigjën se nuk kishin vende pune, qarkullimi im u la në qetësi. Pra profesori me idenë e ***çkualifikimit*** dhe Bujar Kolaneci me ndërhyrjen e tij, më shpëtuan nga qarkullimi, se kushedi si do më kishte shkuar filli, po të kisha shkuar diku mësues fshati.

Figura e profesor Çabejt ishte shumë autoritare. Me personalitetin e tij, pa qenë kurrë shef, pa pasur asnjë pushtet administrativ, ai ndikonte tek punonjësit më tepër se drejtori, sekretari i partisë dhe shefat e sektorëve. Mbi të gjitha ai na bënte për vete me praninë e tij, me sjelljen korekte, me kulturën profesionale dhe thellësinë e analizave shkencore. Ai rezatonte kulturë në çdo lëvizje, në çdo fjalë. Rezatimi i kësaj kulture ndjehej tek të gjithë punonjësit e Institutit, madje nuk e teproj të them se kultura e autoriteti i tij ndikonin edhe tek komunistët e sigurimsat. Nuk ishte e rastit që valët e qarkullimit në vitet 1967-68 dhe 1973-74 në Institutin tonë u kaluan më lehtë se në institutet e tjera shkencore. Sejcili prej punonjësve përpiqej të ishte sado pak *më zotni*, sado pak *më Eqrem*. Kjo përpjekje deri diku i kishte fisnikëruar ata. Në atë institut, mendoj se jo rastësisht, *nuk realizohej plani i arrestimeve*, asnjë punonjës i tij nuk u arrestua gjatë mëse 30 vjetëve...

Në lagjen *Ali Demi*, mjaft afër me pallatin ku banoja unë, ishte dhe shtëpia e poetit Lasgush Poradeci. Shkoja tek ai bashkë me Julian, gruan time poete. Një ditë Lasgushi, duke qeshur, tha:

-*Unë jap karakterizime shumë të shkurtra për njerëzit. Ja dëgjoni si e karakterizoj Skënder Luarasin: Shumë patriot, shumë demokrat, shumë nevrik*.

-*Të lumtë se e paske qëlluar,* i thashë unë që e njihja karakterin e Skënderit, *po për profesor Eqremin a mund të japësh ndonjë karakterizim?*

-*Pa tjetër,* tha Lasgushi dhe duke u drejtuar sikur do të recitonte, deklaroi: *Njeri shumë zotni, shkencëtar shumë i zoti.* E duartrokitëm ne dhe vajza e tij, Maria, që ndodhej aty.

Lasgushi për të treguar se kuadrot e formuar në Austri kishin marrë krahas formimit profesional dhe formim të lartë kulturor, tha:

-*Sot Shqipëria është mbushur me shkolla, shkollim merret nga të gjithë, ama kulturë, shqiptari nuk ka hiç fare*.

Vite më vonë, kur profesor Çabej kishte vdekur, erdhi në Shqipëri z. Henrik Genscher, Ministër i Jashtëm i Gjermanisë Federale dhe tha se Gjermania është gati t'i japë Shqipërisë vit për vit nga 4.000 (katërmijë) bursa studimi për shkolla të mesme profesionale, për shkolla të larta dhe studime pasuniversitare. Unë, si simpatizant i kuadrove me kulturë gjermane, e pyeta profesor Kostallarin kur u ndodhëm bashkë:

-Pse nuk e pranoi udhëheqja e partisë sonë propozimin e z. Genscher? Të studiojnë katërmijë shqiptarë në Gjermani do të thotë të rigjenerohet inteligjenca shqiptare.

-Po në Shqipëri kishte vetëm disa kuadro me kulturë gjermane dhe ne nuk i mposhtëm dot, ma ktheu ai. *Të formohen 4.000 kuadro në Gjermani vit për vit, do të thotë që fëmijët e udhëheqjes që janë formuar e po formohen në Francë të mos kenë më vlerë dhe drejtimin e Shqipërisë ta marrin njerëzit me kulturë gjermane*.

Eqrem Çabej e jepte opinionin e tij për të tjerët me fjalë jo fyese

Në mbledhjet e sektorit dhe në mbledhjet e Këshillit Shkencor të Institutit, sa herë bëheshin diskutime artikujsh ose veprash të punonjësve shkencorë, binte në sy ndryshimi midis diskutimeve të profesor Çabejt dhe profesorëve të formuar në shkollën sovjetike, ose në atë të vendit që ishte një shkollë në formim e sipër. Profesori, së pari përpiqej të vinte në dukje vlerat e punimit dhe vështirësitë që kishte kaluar studiuesi, pastaj ndalej për të vënë në dukje dhe dobësi e mangësi, pa hyrë në hollësira, jepte dhe ndonjë rrugë për kapërcimin e tyre. Raporti midis pjesës vlerësuese dhe asaj kritike ishte gati në proporcion të barabartë. Kurse profesorët dhe shefat e sektorëve që ishin formuar në shkollën sovjetike ose që po formoheshin gjatë punës në Institut, shquheshin për vëmendjen e madhe që i kushtonin diskutimit të dobësive, për të cilat ndaleshin në shumë hollësira, kurse vlerat e punimeve i përmendnin me një a dy fjali. Kjo frymë diskutimi duke i dhënë rëndësi të dorës së parë kritikave, mendoj se ishte krijuar nën presionin e ideologjisë sunduese të luftës së klasave, ose ndoshta fshehte egoizmin e diskutantëve dhe dëshirën për të treguar se ata ishin shumë të aftë...

Kultura europiane sipërore manifestohej tek profesori në çdo veprim e bisedë. Ai nuk merrej kurrë me thashetheme dhe nuk komentonte punën ose karakterin e dikujt në mungesë të tij. Nervozizmi, hakmarrja, mosmirënjohja, ishin të huaja për të.

Në ato vite drejtor i institutit ishte profesor Androkli Kostallari, studiues i formuar në shkollën ruse, në *Universitetin Lomonosov*. Në moshë të re kishte mbetur jetim, shkollën e mesme e kishte kryer në gjimnazin e Shkodrës. Kishte qenë partizan, mbas L2B u dërgua për studime në Moskë, ku përvetësoi arritjet e shkencës gjuhësore sovjetike. Mbas kthimit në atdhe udhëheqja e partisë e emëroi në *Institutin e Shkencave*, pastaj drejtor në *Institutin e Historisë e të Gjuhësisë*. Këtu mori dhe detyrën e shefit të sektorit të leksikologjisë, atë të kryeredaktorit të revistës *Studime Filologjike* dhe të kryetarit të *Këshillit Shkencor* të institutit. Ky studiues shquhej për ambiciet shkencore, për formim solid në fushën e leksikologjisë, aftësi organizative, etj., por si karakter njerëzor linte për të dëshiruar... Gjatë bisedave tona private me të, ndjeheshim shpeshherë ngushtë, por si frikamanë që ishim, nuk e kundërshtonim për pasionin me të cilin ai shprehte kritikat e tij ndaj kolegëve, sidomos ndaj profesorëve Çabej e Domi, në mungesë të tyre. Duke kritikuar këta profesorë, ai synonte të krijonte idenë se ai ishte më i zoti se ata. Për fat të keq këtë ves të tij e morën dhe disa punonjës shkencorë, sidomos shefa sektorësh. Kurse gjatë bisedave tona private me këta dy profesorë ne nuk

dëgjuam kurrë pakënaqësi e kritika personale ndaj Androkli Kostallarit, apo dikujt tjetër.

Drejtori, sa herë hynte në institut, hynte me zhurmë duke u mëshuar takave të këpucëve, të cilat i kishte prej sholli, ose të veshura me pafta hekuri. Donte patjetër të tërhiqte vëmendjen e atyre që ndodheshin në korridor, salutonte me zë të lartë dhe për t'u treguar masovik ndalonte e takohej me ata që gjente aty. Kurse profesor Eqremi hynte në institut pa zhurmë me ecjen e tij të shpejtë, salutonte duke ngritur kapelën dhe mund të ndalej vetëm po të kishte ndonjë porosi për dikë që ndodhej në korridor.

Kur u kthye profesor Dhimitër Shuteriqi prej Italie, ku kishte bërë një ekspeditë kërkimore nëpër fshatrat arbëreshe, mbajti në *Lidhja e Shkrimtarëve* një takim ku tregoi për rezultatet e kësaj ekspedite. Midis tjerash ai tregoi se kishte gjetur, pra se i kishin dhënë për të dorëzuar në Arkivin e Shtetit, mjaft dorëshkrime poezish dhe veprash të poetëve arbëreshë. Profesor Shuteriqi e mbylli bisedën duke thënë:

- *E shikoni këtë çibuk*, dhe tregoi çibukun me të cilin pinte vetë duhan, *ky është çibuku i Jeronim De Radës, ma dhanë bashkë me penën e poetit, të cilën e dorëzova në Arkivin e Shtetit bashkë me dorëshkrimet...*

Ne që e dëgjuam ulëm kokat. Nuk na erdhi mirë që ky personalitet i letërsisë dhe i shkencës shqiptare kishte mbajtur për vete një relike me vlerë muzeale të De Radës. Të nesërmen rastisi që të pinim kafe me Eqremin dhe ia treguam ato që dëgjuam prej Dhimitër Shuteriqit. Po prisnim që dhe ai ta quante atë *hajdut*, si e kishim quajtur ne në bisedat tona. Mirëpo profesori e formuloi mendimin e tij pa asnjë fjalë fyese:

-*Nuk është mirë që njeriu të mos dijë ç'është e tija dhe ç'është e shtetit*.

Vizitat e fundit: Kujtimet për jetën e profesorit duhen shkruar

Në nëntor të vitit 1979 profesor Çabej u sëmurë rëndë. Sapo ishte kthyer nga Vjena, ku ishte dërguar për të mbajtur leksione, i shoqëruar prej leksikologut Jani Thomai. Apartamenti ku i kishte strehuar ambasada jonë nuk kishte ngrohje. Mushkëritë i kishin mbledhur ujë. Doktorët e përcaktuan sëmundjen: *kancer në mushkëri*, sëmundje që në atë kohë ishte e pashërueshme dhe përparonte shumë shpejt.

U pikëlluam të gjithë kur mësuam se ai nuk e kishte të gjatë. Filluam t'i bënim vizita për t'i dhënë kurajo. Jani Thomai, Minella Totoni, Gjovalin Shkurtaj dhe unë, që jetonim bashkë në një pallat të bërë me punë vullnetare anës lumit Lana, shkuam për vizitë. Profesori rrinte i qetë, nuk ankohej, tregonte ndonjë përshtypje nga Vjena, ndonjë plan për punën e ardhshme. Ishte periudhë dimri, ndaj ai rrinte në kuzhinë, i vetmi ambient me ngrohje. Aty na priti zonja Shyhret sipas zakonit të saj.

Mbas disa ditësh a javësh, profesorin e dërgoi shteti në Romë, ku e operuan. Kur u kthye, shkova për vizitë sërish, kësaj radhe me bashkëshorten time. Shyhreti po lante disa tufa me spinaq te çezma, i kishte duart akull të ftohta.

-*Doktorët këshilluan që Eqremi të hajë sa më shumë zarzavate*, tha Shyhreti. *Atij dhe neve na pëlqejnë zarzavatet, por ti Julia e di sa punë do spinaqi, dhe tregoi duart e skuqura prej ujit te ftohtë*.

Kësaj radhe, profesori rrinte dhe më i qetë. Shyhreti e kishte shoqëruar në Romë dhe thoshte se mjekët italianë, me sjelljen e tyre shumë xhentile, me të folurën e qetë me zë të ulët, me ato rrobat e tyre shumë të bardha, i ishin dukur si *engjëj*.

Unë dhe Julia nuk ngopeshim së pari *engjëllin* që kishim para syve tanë, të cilin nuk kishim për ta parë më...

Ceremonia e varrimit të tij u zhvillua me një pjesëmarrje njerëzish shumë më të madhe se ceremonia e varrimit të djalit të tij. Gjithçka u zhvillua si atëherë me seriozitet, askush nuk qau me zë, lotët rrëshqisnin nëpër faqe, ose gëlltiteshin me ngashërim. Disa njerëz rrinin brenda në apartament, shumë të tjerë tek shkalla e pallatit, akoma më shumë rreth pallatit dhe të tjerë në rrugë. Kortezhi u bë shumë i gjatë, pikëllimi ishte shumë i madh. Ndjehej se Tirana dhe gjithë Shqipëria kishin humbur një personalitet vërtet të madh, që e donte pa ndërhyrjen e organeve të shtetit...

Profesor Çabej u nda nga jeta më 13 gusht 1980, në moshën 72 vjeçare, kur ishte ende shumë i gjallë e me kapacitet të plotë mendor. Ai u largua nga kjo jetë pa e humbur bukurinë fizike e shpirtërore, duke na lënë në kujtesë figurën e një njeriu madhështor dhe ndikues.

Me rastin e dyvjetorit të vdekjes, më 13 gusht 1982, në institut nuk po ndjehej se do të shkonte kush tek familja e profesorit, si një vit më parë. Atëherë vendosa të shkoja me Palok Dakën, mikun më të mirë të profesorit dhe timin. Paloka kishte punuar me profesorin që nga viti 1949, që kur ishte krijuar *Instituti i Shkencave*. Ai ruante shumë kujtime për të, madje dhe shumë intimitete. Ai më kishte treguar se si e kishin sulmuar profesorin në vitet e mbrapta 1967-1968. Në mbledhjen e organizuar në institut për të dënuar shfaqjet e huaja, në prani të Manush Myftiut, anëtar i Komitetit Qendror të PPSH-së dhe Fadil Paçramit, sekretar i parë i Komitetit të Partisë të Tiranës, drejtori i institutit, Androkli Kostallari e sulmoi profesor Çabejn. E quajti *kuadër që i nënshtrohej shkencës borgjeze*. Si argument ai përmendi se Çabej në studimet e tij nuk citonte rezultatet e arritura të shkencës shqiptare që po zhvillohej nën kujdesin e partisë; dhe se me rastin e vdekjes së albanologut gjerman Maximilian Lambertz, ai kishte shprehur në shkrimin nekrologjik vetëm lavdërime, kur dihej se ky studjues borgjez kishte përkthyer në gjermanisht poemën *Lahuta e Malsisë* të poetit *reaksionar* Gjergj Fishta.

Profesori e kishte mbrojtur veten me pak fjalë:

-Për citimet në veprat e mia shkencore unë ndjek parimin ndërkombëtar, sipas të cilit citohen vetëm veprat e botuara në shtypin e lartë, pra në libra dhe revista shkencore. Unë nuk kam cituar e nuk mund t'i citoj rezultatet e studiuesve tanë që janë botuar nëpër dispensa, sepse artikujt e botuar në to konsiderohen jo përfundimtare, mbasi janë në përpunim e sipër. Botime të tilla nuk i ruan as Biblioteka Kombëtare.

Për studiuesin Maximilian Lambertz dhashë vlerësime pozitive, sepse në shkrime nekrologjike nuk shprehen kritika e rezerva.

I ndodhur ngushtë Manush Myftiu e mbylli diskutimin duke thënë se partia e ka vlerësuar Lambertz-in me titull të lartë dhe në nekrologji vërtet shprehen vetëm vlera dhe jo kritika...

Duke kujtuar të tilla momente gjatë ecjes në këmbë i thashë Palokës se duhej t'i shkruante kujtimet e tij për profesorin dhe t'i thoshte z-njës Shyhret, se ajo dhe njerëz të tjerë të afërt duhej të shkruanin kujtimet për profesorin. Kur arritëm në shtëpi nuk gjetëm njerëz të tjerë përveç zonjës së shtëpisë dhe një vëlla të profesorit, avokatin Ferid, një burrë që i ngjante atij, por ishte më i shëndoshë. Ai jetonte në Lushnjë bashkë me vëllain tjetër Ihsanin, mjek.

Paloka e gjeti rastin dhe tha se mbledhja e kujtimeve për jetën e profesor Çabeut është punë me vlerë dhe duhet bërë sa më parë. Zonja Shyhret nënqeshi, dhe tha: *po, po*, duke na lënë të kuptonim se ajo e vlerësonte këtë mendim dhe se një ditë do të ulej për të shkruar kujtimet e saj...

Profesor Çabej më ndihmoi edhe i vdekur

Kur erdha në Amerikë më 1996, 52-vjeçar kisha gradën Doktor i Shencave Filologjike dhe titullin Profesor i Asocuar. Duke mos ditur anglishten u detyrova të punoja pjatalarës, ndihmës kuzhinier, pastrues, roje, punëtor fabrike në turnin e tretë, etj. Shkova në shkollë nate dhe munda të mësoja anglisht në nivelin që ta flisja dhe ta shfrytëzoja për studime. Atëherë thashë me vete: ky është ai qarkullimi që më mbeti pa bërë në rini. Tani nuk jam më fillestar, ky qarkullim nuk do të më çkualifikojë, prandaj duhet të filloj të merrem dhe me punë shkencore. Dhe fillova të lexoja e të grumbulloja materiale për sqarimin e problemit se a kishte punuar apo jo shën Pali gjatë udhëtimeve të tij në trojet ilire, gjë që ai vetë e kishte pohuar në letrën drejtuar besimtarëve të Romës.

Pas gati tetë vjet pune me përqendrim të lartë arrita të provoja e ta shpija përpara traditën gojore shqiptare e cila thoshte se shën Pali kishte punuar në territore shqiptare (atë kohë ilire). Këtë mendim para meje e kishin formuluar me disa të dhëna, por pa sjellë prova bindëse disa historianë, si italiani Daniele Farlato (1817), amerikani E. Jacques (1995) dhe shqiptarët Marin Barleti (1520) e Kristo Frashëri (2001). Unë e shpura këtë rezultat më tej, duke provuar me shumë argumente se shën Pali jo vetëm kishte punuar për krijimin e kishave të para të krishtere në troje ilire, por dhe kishte shkruar dy letra në Durrës (Dyrrach) dhe një letër në Nikopol të Epirit.

Duke ditur se në mbarë Mesdheun, pra dhe në gadishullin Italik deri në shekullin IV përdorej greqishtja si gjuhë predikimi midis besimtarëve dhe se latinishtja u bë gjuhë fetare, gjuhë e kishës, vetëm mbasi u përkthye *Bibla* prej shën Jeronimit në fund të shek IV fillim i shek V, më lindi një mendim. Përhapja e Krishterimit në qytete ilire prej vetë shën Palit e nxënësve të tij që në shek I dhe pastaj në shek II-IV duhej të ishte kryer në gjuhën greke, gjuha e predikimeve fetare të atyre shekujve, herë herë duke përdorur dhe përkthyes nga greqishtja në ilirisht. Në këtë proces predikimi, terminologjia fetare në ilirisht duhej të kishte hyrë fillimisht prej greqishtes duke u përshtatur në gjuhën vendase. Pra duhej që të vërtetoja se disa fjalë nga kjo terminologji, gjuha ilire (prej së cilës u trashëguan te pasardhësja e saj, shqipja) i kishte marrë, ashtu si latinishtja, drejtpërdrejt nga greqishtja e lashtë që në shekujt I-IV dhe jo nga latinishtja, ndikim i së cilës në këtë fushë kishte filluar vetëm gjatë shek V e këtej.

Mirëpo, hipoteza se shqipja i kishte marrë fjalët e terminologjisë fetare prej latinishtes ishte formuluar prej disa studiuesve gjermanë në kohën kur sundonte mendimi se krishterimin në popullin ilir e kishin sjellë misionarë të ardhur prej kishës së Romës. Këtë mendim e kishte pranuar dhe profesor Çabej. Me një fjalë më duhej që për origjinën e disa fjalëve kishëtare të jepja një shpjegim ndryshe nga ai që kishte dhënë idhulli im. Mendo e stërmendo. Herë pas here sillja në mend fjalët e tij:

-Kur mendoni ndryshe, mos e konsideroni veten tepër të rinj dhe të paformuar për të shprehur dyshime, për të hapur diskutime. Shumë shpjegime të mia për origjinën e fjalëve mund dhe duhet të diskutohen, studimet etimologjike në fushë të shqipes duhet të pasurohen.

Shkova në Shqipëri dy herë, bleva gjashtë vëllime të fjalorit etimologjik të Çabejt dhe lexova e rilexova vëllimin e parë (hyrja teorike) mbajta shënime, lexova me kujdes shpjegimet për shumë fjalë. Lexo e vra mendjen, kujto profesorin e prapë lexo, prapë vra mendjen dhe më në fund dhashë shpjegimet e mia se disa fjalë si *apostull-i, ungjill-i, engjëll-i, kish,ë-a*, e disa fjalë të tjera të Krishterimit, të cilat latinishtja i kishte marrë vetë prej greqishtes, edhe ilirishtja (nëna e shqipes) i kishte marrë drejtpërdrejt prej greqishtes dhe jo prej latinishtes.

Më 2007 e botova librin tim *Kur dhe Ku u Shkrua Dhiata e Re* dhe shkova në Tiranë ku organizova promovimin e tij në Muzeu Kombëtar. Aty kisha trajtuar dhe këtë problem. Mirëpo punonjësit e institutit, pikërisht ata që merreshin me studime gjuhësore, si Seit Mansaku, etj, vlerësuan aspekte të ndryshme të veprës, por u stepën, nguruan të jepnin gjykime për nënkapitullin ku jepja sqarimet e mia etimologjike për këto fjalë. Dukej se ata vuanin nga mendimi se brezi ynë ishte i papërgatitur për të dhënë ndihmesë në fushën e etimologjisë. Ata e kishin kthyer Çabejn në një tabu, gjë që ai vetë nuk e kishte dashur, madje e kishte luftuar.

Me këshillat e punën e tij, profesor Çabej më ndihmoi edhe mbas vdekjes, këtu në Amerikën e largët, duke më dhënë kurajën e nevojshme për të punuar edhe në fushën e tij, aq të vështirë...

Tani vonë mësova se profesor Kolec Topalli ka hartuar e do të botojë një fjalor etimologjik të shqipes në tre vëllime. Ky studiues gjatë diktaturës kishte pasur fat të ndryshëm nga ai i shumë gjuhëtarëve që punuan në të njëjtin institut me profesor Çabejn. Ai, për shkak të "biografisë së keqe" kishte punuar si mësues fshati në rrethet Kukës, Gramsh e Krujë. Mirëpo pasioni për gjuhën shqipe e shtynte, që edhe në atë kohë të vështirë, të merrej me përkushtim me studime në fushën e gjuhës shqipe, sidomos të fonetikës e gramatikës së saj. Dorëzonte artikuj shkencorë për t'ia botuar në revistën *Studime Filologjike*, por redaksia ia vononte me vite botimin e tyre.

Shkërmoqja e diktaturës solli dhe për këtë studiues mundësi të reja. Duke punuar me pasion për kualifikim të mëtejshëm dhe rezultate të reja, ai ka kohë që po i shpie përpara studimet në fushën e historisë së gjuhës sonë dhe ja tani dhe në fushën e etimologjisë së fjalëve të saj. Po të ishte gjallë profesor Çabej do të ndjehej i lumtur që një nxënës i tij, akademiku Kolec Topalli, po e shpie përpara veprën dhe porositë e tij.

XHEVAT LLOSHI

SULME ANTISHQIPTARE NËN PETK SHKENCOR

Nuk ma merrte mendja se në një përmbledhje punimesh shkencore, të botuara më 2014 në Moskë, do të dilte edhe një artikull i përdalë politikisht nga një autore jo ruse.

Përmbledhja mban titullin "*Sllavët myslimanë në Ballkan: gjuha, kultura, identiteti*". Është botuar nga Instituti i Sllavistikës i Akademisë së Shkencave të Rusisë dhe ka 310 faqe. Ndër 12 shkrimet, artikulli në fjalë titullohet *Homo slavicus dhe homo balcanicus – probleme të identitetit në epokën e globalizimit (gjendja në Kosovë)*. Lexuesi ynë le të mos çmeritet as nga togfjalëshat latinisht, as nga globalizimi, sepse janë vetëm marifete për t'u dukur shkencore kjo paçavure antishqiptare prej 17 faqesh. Autorja është bullgare: Krasimira Koleva. Që në rreshtat e parë ajo na e quan popullsinë e Kosovës të përzier nga ana etnike dhe këtu nuk jep asnjë mbështetje për një pohim të tillë. Por andej nga fundi është ngatërruar dhe i ka shpëtuar që, gjithnjë sipas asaj, në Kosovë 92 për qind janë shqiptarë. Edhe me një numër të tillë, po të marrim shifrat e një botimi enciklopedik të Oksfordit në fillim të shekullit XXI, në Bullgari ishin 85 për qind bullgarë etnikë, në Francë francezët ishin 86,5 për qind, në Federatën Ruse ishin rusë vetëm 82 për qind, në Ukrainën e shkretë vetëm 73 për qind e kështu me radhë. Çfarë kuptoka ajo me popullsi të përzier?

Por kësaj bullgareje i duhej ta niste kështu, që të vijonte më tej për ta shtrembëruar si përbërjen, edhe ndarjen etnografike. Rrjedhimisht, edhe Prizreni e Prishtina qenkan me popullsi të përzier. Gora e Kosovës e paska qendrën në Dragash dhe përfshika mikroarealin e Zhupës me qendrën në Prizren, si dhe Podgorien. Që ta kuptojnë shqiptarët, që nënkuptohet se sipas asaj nuk marrkan erë nga këto punë, me fjalë të tjera kjo do të thotë se Lidhja e Prizrenit na qenka themeluar në një mikrorajon të Zhupës. Gora sot qenka e ndarë mes tre shteteve: në Kosovë me 18 fshatra, në Shqipëri 8 në rrethin e Kukësit dhe dy në Maqedoni. Për banorët ka përdorur emërtimet: goranë, torbeshë, poturnakë, shopë, sllavomaqedonas të islamizuar dhe zhupcë. (Është detyrë e studiuesve tanë t'i ndriçojnë këto emërtime, sepse edhe në botimet enciklopedike ose në fjalorët gjuhësorë ne nuk i përfshijmë dhe e lëmë fushën të lirë të spekulojë kushdo si i vjen për hosh). Për goranët (që u quajtën të tillë edhe në Kushtetutën e Kosovës më 2008) pohon se janë shiitë dhe shqiptarët i thërrasin torbeshë, ndërsa zhupët vetëm gjatë shtegtimeve të brendshme kanë mësuar shqipen e folur.

Autorja është mbështetur gjerësisht në burimet serbe, të cilat dihet se çfarë propagandonin, dhe ka zhvarrosur gjithë sajimet e tyre të një shekulli e gjysmë më parë. Por duke ardhur në ditët e sotme autorja me keqardhje përmend, se pas Luftës

II Botërore shteti bullgar hoqi dorë nga tokat bullgare perëndimore dhe jug-perëndimore, madje edhe nga sfera e ndikimit politik. E quaj për detyrë t'ia freskoj kujtesën kësaj gruaje, se gjatë Luftës II Botërore, për fatin e keq të popullit bullgar, Bullgaria u rreshtua me nazifashistët dhe u katandis në vendet e mundura. Dhe vendet e mundura pas një lufte botërore duhet të paguajnë, madje është fare pak vetëm t'u priten kthetrat për sfera të ndikimit politik. Fryn në këto faqe era e Bullgarisë së Madhe. Nuk është ndonjë gjë e re dhe e papritur. Ca vite të shkuara bullgarët u detyruan prej trysnisë së jashtme të tërhiqnin nga qarkullimi një enciklopedi të tyren pikërisht sepse përshkohej nga kjo frymë.

Duke ardhur tashti te konflikti në Kosovë, kjo palo studiuese nuk flet asgjë për tragjedinë e popullit të Kosovës, por vetëm vë në dukje se në anën e UÇK-së morën pjesë vahabistë (një sekt problematik për fundamentalizmin e tij), ndërsa bashkësia myslimane nuk na qenka distancuar, përkundrazi, pati procese intensive të klerikalizimit. Gjithandej në këto faqe kundërmon gjithashtu edhe era e përçarjes fetare.

Por ka edhe më. Autorja shkon deri aty, sa të deklarojë se identiteti shqiptar shfaqet jo nëpërmjet shenjave konfesionale dhe gjuhës, por nëpërmjet . . . lindshmërisë. Këtu në vend të shkencës kemi politikë lakuriqe me sfond racist. Nuk është parë dhe as është dëgjuar ndonjëherë në sociologjinë dhe antropologjinë botërore, që identiteti etnik u përcaktoka nga pjelljet. Mund ta kem gabim, por do të shtoj diçka lidhur me këtë. K. Koleva është pedagoge e Universitetit të Shumenit në Bullgarinë veri-lindore. Në atë krahinë ka një pakicë turke, kundrejt së cilës edhe sot qëndrimi nuk është aspak në përputhje me standardet e Bashkimit Europian, ku bën pjesë Bullgaria. Me sa duket, atje qenka ushqyer me këto përçudnime raciste mbi baza etnike dhe fetare.

Por ka edhe më. Gjendja e sotme në këto vise të Kosovës sipas saj është rezultat i regjimit totalitar dhe nacionalizmit në ish Jugosllavinë, si dhe . . . i kontrollit, që po vazhdon nga ana e NATO-s dhe e OKB-së. Ajo ankohet edhe kundër "Rrugës së Kombit" Prizren-Durrës, e cila "siguron daljen e Kosovës në Detin Adriatik dhe është një enklavë ekonomike, që i jep një shtysë tjetër shqiptarizimit të Gorës, ndërsa shoqërohet me uljen e tolerancës." Tashti nuk mund ta marrim seriozisht dikë, që na dalka edhe kundër OKB-së dhe prandaj vetëm mund të qeshim, kur ajo qahet edhe për humbjen e elementëve të kulturës materiale e të zejeve tradicionale. Dhe e dini se çfarë janë këto zeje kaq karakteristike e tradicionale? Janë: djathi i Sharrit, byrekët, boza, hallva, qebapët, të gjitha dikur "marka tregtare" e brezave të tërë. E po që dikush të mos e dijë, se hallva, byrekët, qebapët e më the të thashë nuk kanë qenë jo vetëm kudo nëpër Ballkan, po edhe në gjithë Perandorinë Osmane, kjo është të vësh duart në kokë për nivelin e njohurive të dikushit për këtë fushë, në të cilën qenka studiuese.

Por ka edhe më, pak durim, sepse nuk mund ta mbyll pa sjellë edhe një citim si qershia mbi tortë: "Nëpërmjet firmave të Hashim Thaçit dhe të Agim Çekut enklava e Gorës po shndërrohet nga një enklavë kulturore në ekonomike me mjetet ekonomike tipike për rajonin – me drogat dhe me trafiqet e paligjshme". Këtu mua më mbarojnë edhe kritikat brenda kufijve të mirësjelljes, përndryshe do të më duhet ta prish gojën e të shkruaj gjëra që nuk i mban letra.

Ndërkaq, përsëri nuk ma merrte mendja se edhe një tjetër bullgare notuaka po në të njëjtat ujëra. Veselka Tonçeva në shkrimin *Këngë tradicionale nga krahina e Gollobordës: variante nga Shqipëria lindore,* edhe kjo e nis me një anë politike: vë në dukje se marrëdhëniet diplomatike të Shqipërisë me Bullgarinë u vendosën më 1914. Bukur, unë këtë nuk e dija, por nuk po shqit dot se çfarë lidhjeje ka kjo me këngët e dasmës. Ndërkaq marr vesh gjithashtu, se marrëdhëniet e Bullgarisë me Gollobordën u ndërprenë pas vitit 1945. Nuk besoj se ka nevojë të përsëris ato që sapo shpreha më sipër, sepse pas vitit 1945 do të thotë pas Luftës II Botërore. Këto në gjuhësi quhen eufemizma, domethënë për të mos e emërtuar atë që është në të vërtetë. Pas vitit 1990 nisën ekspeditat bullgare. Përsëri këtu do të më lejohet të shpreh pakënaqësinë time për etnologët shqiptarë, sepse nga vëllime të tilla marrim vesh sesa shumë ekspedita po bëhen nga studiues sllavë për sllavët nëpër viset shqiptare, kurse nga ana jonë as e vëmë këtë ujë në zjarr. Po shënoj kalimthi vetëm kaq: studiuesi rus M. M. Makarcev nga Moska ka botuar në këtë përmbledhje punimin *Gjuha e sllavëve të Elbasanit. Shtrimi i çështjes,* në të cilin mes të tjerash vëren se në Elbasan më 1448 erdhën 15 familje nga Shkupi në Elbasan, kurse më 1930 këtu kishte 100 bullgarë myslimanë dhe 10 ortodoksë. Kurse ne, me keqardhje të madhe e vë në dukje, nuk studiojmë milionat shqiptarëve që po derdhen gjithandej nëpër botë.

Do të them dy fjalë edhe për Veselkën, që do të thotë gaztore. Ajo e mohon kategorikisht se në Gollobordë ka pasur ndonjë ndikim të kulturës tradicionale shqiptare dhe të traditës muzikore shqiptare. Arsyeja na qenka se Golloborda i paska kthyer kurrizin Shqipërisë dhe u orientua nga Lindja (përsëri një eufemizëm: domethënë nga Bullgaria!), meqë mezi ka 100 vjet që bën pjesë në Shqipëri. Me demek gjatë sundimit osman Golloborda paska qenë buzë Detit të Zi. Por edhe kjo autore del si tjetra ose me kujtesë të shkurtër, ose me dobësi për aritmetikën që nga shkolla fillore. Ajo merret gjatë me një këngë dasme, e cila më kujtoi vargun e parë të këngës sonë "Berberi që rruan mbrenë". Afëritë folklorike mes popujve të Ballkanit janë diçka gjerësisht e njohur dhe e pranuar. Por autorja na thotë se këtë këngë të ngjashme e ka gjetur te një botim i Miladinovit i vitit 1861 nga Përlepi, te A. Dozoni më 1879 dhe te V. Ikonomovi nga Dibra, të botuar më 1893. Sikur më duket që të gjitha këto data janë një çikë më shumë sesa 100 vjet më parë. Gjithsesi, e quaj të nevojshme që studiuesit tanë të interesohen për librat e V. Tonçevës, doktore në filologji në Institutin e Etnologjisë dhe Folkloristikës në Sofje, e cila ka bërë ekspedita edhe në Gorë e në Prespën e Vogël, ka botuar "Bullgarët nga Golloborda, Shqipëri. Traditat, muzika, identiteti", Sofje, 2009; "Gora e panjohur", 2012, dhe ka hartuar librin "Bullgarët në Gollobordë, Shqipëri. Gjuha, zakonet, muzika.", 2011.

Duke lexuar këto materiale m'u kujtua se mjaft vjet më parë në një konferencë shkencore në Gjermani pati edhe një diskutim për gjendjen në Ballkan. Aty dëgjova një gjuhëtare të njohur bullgare, e cila foli pikërisht kundër ndërhyrjes së NATO-s në Kosovë. E quajta një lajthitje dhe e pata harruar, sepse në ndërgjegjen time janë të rrënjosura të tjera gjëra. Që në janar 1867 iluministi i madh bullgar, P. Sllavejkovi kishte përshëndetur abetaret shqipe, përhapjen e ideve iluministe dhe punën për bashkimin kulturor të shqiptarëve. Në fund të shekullit XIX Sofja u bë

vatër miqësore për rilindësit tanë, për botimet dhe gazetarinë. Nga shekulli i kaluar po përmend vetëm emrat e Bojka Sokollovës, që ka dhënë ndihmesë të paçmuar edhe me bibliografitë, ose historianin Strashimir Dimitrov dhe përkthyesen e veçantë Marina Marinova. Nga ky shekull i ri po kujtoj vetëm Ludmill Stankovin, i cili ka botuar më 2009 një libër të gjerë prej 530 faqesh "*Gjuha shqipe*", duke shkruar me kompetencë dhe dashamirësi. Si shpjegohen atëherë gjëmat e mësipërme?

Është e qartë se midis studiuesve bullgarë ka edhe një rrymë, për të cilën më e pakta është të thuash se nuk po ecën sipas prirjeve të sotme europiane. Vërehet se jo vetëm ndër disa përfaqësues të atij vendi, por edhe të disa vendeve të tjera, ka një ringjallje të ëndrrave mesjetare për perandoritë e përmbysura nga historia, ose edhe një nostalgji për gjendjen para Luftës II Botërore me frymë fashiste. Rrjedhimisht, dukuria duhet parë në një kuadër më të gjerë.

Vëmendja ndaj Europës Jug-lindore është shfaqur prej më shumë se dy shekujsh nga ana e fuqive të mëdha për arsye gjeo-strategjike. Vetë emërtimi "Ballkani" ose vendet ballkanike nuk është përdorur nga popujt e kësaj treve, por nga perandoritë e interesuara për të. Rrjedhimisht, edhe studimet ballkanike, madje edhe nocioni i 'lidhjes gjuhësore ballkanike' janë përpunuar brenda kornizës së këtij interesi gjeo-politik. Ballkanistika ka ndjekur ngritjet dhe uljet e atij interesi, madje do ta quaja jo të pafrytshme, që të bëhej një krahasim me trajtimin dërrmues që i ka bërë "orientalistikës' Eduard Saidi. Ndërkaq, në shek. XXI kanë ndodhur ndryshime të gjera, sidomos me përfshirjen e disa vendeve në Bashkimin Europian. Për pasojë, nga njëra anë, ka rënë edhe vëmendja ndaj ballkanistikës te disa qarqe europiane me traditë në këtë fushë. Por njëkohësisht vërehet një rizgjim i politikave të përpunuara para Luftës I Botërore nga Gjermania dhe Turqia, ndërsa gjeopolitika e Bashkimit Sovjetik dhe sot e Federatës Ruse ka pasur vazhdimësi. Me këtë shpjegohet përse edhe studimet ballkanistike ruse nuk kanë njohur ndonjë rënie të thellë.

Brenda kësaj kornize kanë gjetur vendin e tyre edhe studimet albanistike. Dëshmia më e mirë janë mbledhjet shkencore dhe botimet e ndryshme të dhjetëvjeçarëve të fundit. Mjafton të citoj përmbledhjet e vëllimshme *Studia Linguistica et Balcanica* botuar në vitin 2001 në Sankt-Peterburg, kushtuar kujtimit të shkencëtares së njohur dhe albanologes A. V. Desnickajës (1912-1992). Nuk mund të mos përmend se prej L. N. Kaminskajës aty njoftohet se është zbuluar një dorëshkrim i pabotuar për fonetikën e shqipes. Në seminarin e drejtuar prej M. A. Matuseviçit në Katedrën e fonetikës është studiuar shqiptimi i shqipes, duke u mbështetur te regjistrimet e zërit të D. Agollit, Kokomanit dhe Mëzezit, studentë atë kohë në Leningrad. A nuk do të ishte interesante t'i dëgjonim edhe ne ata zëra tashmë të largët? Etnologu A. Novik na kumton, se "Veshje shqiptare të periudhës së sundimit osman në Ballkan gjenden në muzetë e Sankt-Peterburgut", në Koleksionin e Kunstkamerës prej vitit 1898 dhe në Muzeun etnografik; në këtë të dytin kryesisht nga dhurata prej Shqipërie për diktatorin J. V. Stalin. Më 2012 ka dalë edhe një vëllim tjetër po me atë titull, *Studia Linguistica et Balcanica*, sërish kushtuar A. V. Desnickajës, duke përfshirë edhe mjaft kumtesa të autorëve shqiptarë.

Është për të ardhur keq që një institut akademik studimesh shkencore ka lejuar të përfshihen në botimet e tij shkrime të atilla, të ndotura nga ana politike. Pavarësisht prej kësaj, është e nevojshme që studiuesit tanë të njihen me botimet e ndryshme edhe kur nuk u përmbahen standardeve shkencore, për të qenë të informuar se çfarë qarkullon dhe kështu të përpunojnë qëndrimet e tyre, duke mos u shkëputur nga dija botërore ose duke mos i mbyllur sytë përpara propagandës nën petkun shkencor, e cila meriton përgjigje me argumente dhe jo me falsifikime.

Norbert Jokli, duke e çmuar talentin e studentit të ri shqiptar, e mbajti afër atë dhe kështu u zhvillua midis tyre një miqësi e ngushtë dhe një bashkëpunim i frytshëm, që ndihmoi aq shumë për ta përudhur Çabejn e ri në studimin e thelluar shkencor kur ishte ende student. Në përputhje me kërkesën e Universitetit të Vjenës që, për ta marrë diplomën me gradën e doktorit në profilin përkatës studenti duhej të mbaronte një disertacion, diplomanti E. Çabej zgjodhi për këtë qëllim temën *Studime italo – shqiptare* (*Italoalbanische Studien*). Për këtë disertacion ai punoi me zell të madh dhe shkoi e mblodhi material pranë arbëreshëve të Sicilisë në vitin 1932. Disertacioni u mbrojt më 7 tetor 1933 para prof. dr. Paul Kreçmerit, prof. dr. Norbert Joklit dhe prof. dr. Karl Paçit dhe për këtë atij iu dha diploma për gradën doktor nga Universiteti i Vjenës. Diploma është nënshkruar nga të tre profesorët e lartpërmendur përkrah vlerësimit *shkëlqyeshëm* (*Ausgezeichnet*).

NASER FERRI

KULTI I HYJNESHËS DEA SYRIA NË SCUPIN DARDAN

Scupi antik që gjendej në fshatin Zllokuçan afër Shkupit të sotëm (gërmadhat e tij shihen dhe gërmohen edhe sot), gjatë parahistorisë dhe antikitetit ishte udhëkryq i rëndësishëm i rrugëve të rëndësishme magjistrale të cilat shpienin nga veriu i Evropës përmes Ballkanit drejt Greqisë dhe tutje në Lindje.

Mu për shkak të pozitës së vet strategjike gjeografike Scupi me kalimin e kohës ishte shndërruar në udhëkryq të qytetërimeve dhe kulturave të ndryshme, kështu që në territorin i cili gjatë periudhës së sundimit romak i përkiste kolonisë Scupi (*Colonia Flavia Scupinorum, Colonia Flavia Felix Dardanorum*)[1] ishin të dukshme ndikimet e qytetërimit dardan (qendër e të cilit ishte) grek, romak si dhe ndikimi i një sërë qytetërimesh orientale, gjë që pasqyrohej në të gjitha sferat e jetës, e posaçërisht në fushën e besimeve religjioze dhe të mitologjisë.



[1] Dragojević-Josifovska B., Inscriptions de la Mesie Superieure, vol. VI, Scuoi et la region de Kumanovo, Beograd 1982, f. 90 n. 66; f. 57 n. 15; f. 74 n.42.

Fragmenti i pllakës kushtuar hyjneshës Dea Syria, zbuluar në kalanë e Shkupit

Pos të tjerash, në Scupin antik ishte një ndër qendrat e kultit (jashtë vendit të origjinës së saj) të hyjneshës së lashtë siriane Atargatis. Atargatis e cila në lashtësi ishte hyjneshë e tokës si Kybele dhe Dhemetra, ishte pajtore e shoqërisë, hyjneshë e natyrës, e ujit, e pjellorisë, e jetës shoqërore dhe religjioze dhe e fatit.[2] Anembanë Perandorisë romake njihej si *Dea Syria*, ndërsa për shkak të faktit që kulti i saj ishte bërë sinkretik[3] ai edhe ishte përhapur në të gjitha anët e botës së asaj kohe ajo njihej si *Atargatis, Derceto, Ataratha, Deasura, Iasura* dhe identifikohej me hyjneshat *Astarte, Ishtar*[4]*, Venus Urania, Hera, Rhea, Kybele, Afrodita dhe Arthemida Azzanathcona*.[5]

Përndryshe, kulti i kësaj hyjneshe nuk u takonte në mënyrë strikte besimeve mistere me elemente të fshehta e orgjiastike.[6] .

Në vitin 1948 në fshatin Dolno Nerezi afër Scupit antik me rastin e punimeve ndërtimore rreth kanalit Treska-Vardar u zbuluan dy monumente interesante epigrafike

Monumenti i parë ishte pllaka (tabula ansata)[7] prej mermeri në tekstin e të cilës përmendet një person me origjinë nga Italia Veriore emri i të cilit nuk është ruajtur e i cili ishte bartës i funksioneve të larta: decurio, duumvir dhe quaestor i kolonisë së Scupit (që këtu përmendet si Colonia Flavia Felix Dardanorum)[8], i cili me shpenzime të veta (impensa sua)[9] e ngrit tempullin dhe pllakën që ia kushton hyjneshës e cila zihet ngoje në fund të mbishkrimit si Dea Syria[10].

Monumenti tjetër ishte një altar prej guri gëlqeror i zbuluar në Dolno Nerezi në po të njëjtën kohë dhe të njëjtin vend me të parin dhe në fillim të tekstit kishte vetëm pjesën e parë të formulës përkushtimore DE për të cilën supozohet dhe ka mundësi të ketë qenë formula "Deae Syriae".Të dy monumentet janë zhdukur shumë shpejtë pas zbulimit[11].

Në vitin 1967 i murosur në muret e Kalasë së Shkupit u zbulua një fragment i pllakës prej mermeri në të cilin ishin ruajtur pjesët e tekstit: S]anct[issimae]/ [D]eae[Syriae(?)...] (hyjneshës më të shenjtë Dea Syria).[12]

---

[2] Morford M.&Lenardon R.J., Classical Mythology, Longman Publischers USA 1994, f. 309.

[3] Mirdita Z., Religjioni dhe kultet e dardanëve dhe Dardanisë në antikë, Zagreb 2001, f. 70-71.

[4] Mirdita Z., Religjioni dhe kultet e dardanëve dhe Dardanisë në antikë, Zagreb 2001, f. 70.

[5] Mythology, Myths , Legends&Fantasies, Grange Books 2003, f. 325.

[6] Morford M.&Lenardon R.J., Classical Mythology, Longman Publischers USA 1994, f. 309.

[7] Dragojević-Josifovska B. 1982, f. 57-58 n.15; Klaić B., Rječnik stranih riječi i izraza, Zagreb 1980, f. 1318.

[8] Dragojević-Josifovska B. 1982, f. 58 n.15.

[9] Žepić M., Latinsko-hrvatski rječnik, Lexicon latino-croaticum, Školska knjiga, Zagreb.2000, f, 122.

[10] Dragojević-Josifovska B. 1982, f. 57 n.15.

[11] Dragojević-Josifovska B.1982, f. 58 n.16.

[12] Dragojević-Josifovska B.1982, f. 58 n.17.

Të gjitha monumentet e cekura i kushtohen hyjneshës siriane të njohur me emrin Dea Syria, emri origjinal i së cilës ishte Atargatis, të cilën e konsideronin nënë të mbretëreshës Semiramida.[13].

Koha dhe vendi i krijimit të kultit

Kulti i kësaj hyjneshe u krijua në Siri, prej nga gjatë shekullit II p.e.s. në Perëndim e sollën skllevërit dhe tregtarët, ndërsa në kohën e Perandorisë romake pjesëtarët e ushtrisë romake e përhapën kultin e kësaj hyjneshe anembanë Perandorisë.

Përndryshe hyjnesha Atargatis ishte tejet e popullarizuar në Sirinë Veriore, ku në Hierapolis (Manbij i sotëm afër Alepit) nderohej me bashkëshortin e saj Hadad në tempullin e lashtë, të cilin në vitin 300 p.e.s. e kishte rindërtuar mbretëresha Stratonika, bashkëshortja e mbretit Seleuku I, dhe ku për kultin e saj kujdeseshin tregtarët dhe mercenarët grekë, të cilët këtë hyjneshë e konsideronin si një lloj Afrodite. Së bashku me Hadadin dhe hyjin Simios[14] nderoheshin si trini hyjnore.[15]



Paraqitja figurale e hyjneshës sirenë Atargatis-Dea Syria

[13] Curotto E., Dizionario della mitologia universale, con tavole fuori testo, fonti e bibliografia, Società Editrice
Internazionale, Torino 1958, f. 63.
[14] Bellinger G., Leksikon mitologije, Državna Založba Slovenije, Ljubljana 1997, f. 410.
[15] Bellinger G. 1997, f. 50.

Hyjneshën Atargatis e quanin edhe "Zonja e madhe e tokave të Sirisë Veriore", ndërsa tek grekët njihej me emrin Derceto ose Derketo, por edhe Dea Syria dhe konsiderohej kryehyjneshë siriane, madje për hir të saj grekët e kishin ndërtuar tempullin e madh në Ephesos. Në disa raste nëpër mbishkrime paraqitej edhe në formë të shkurtër Deasura.

Me emrin Ataratha ajo njihej në Urhai (Edessa), madje si hyjneshë për hir të së cilës ithtarët e saj vetëlëndohëshin, bile në shumë raste edhe e kastronin vetveten[16].

Sipas një kronike të krishterë nga fillimi i shekullit III kundër kësaj dukurie të vetëlendimeve dhe vetëkastrimit ndërmori masa mbreti Abgar, i cili pasi e pranoi krishterimin urdhëroi që çdonjërit i cili e lëndon ose e kastron (amputon testiset) vetveten, t'i pritet nga një dorë. Thuhet se që nga ajo kohë askush më nuk u vetëlendua për hir të kësaj hyjneshe.

Sipas linguistëve, emri i saj përbëhej nga dy pjesë: *Atar*, trajtë e emrit vetjak e ngjashme me emrin biblik *Ashtoreth*, me emrin fenikas *Ashtart* dhe me emrin grek *Astarte*, dhe nga prapashtesa *gatis* (nga emri grek *dados* = peshk) kështu që gjuhëtarët e përkthejnë emrin e kësaj hyjneshe si "Atar -hyjnesha e peshqve."

Përhapja e kultit nëpër Perandorinë Romake

Ndoshta për këtë arsye edhe në tempujt e kësaj hyjneshe në Ascalon (qytet i qepëve) që më vonë u riemërua në Hierapolis dhe Edessa kishte hurdha apo pishina ku kultivoheshin peshqit të cilët guxonte t'i prekte vetëm prifti i kësaj hyjneshe. Disa udhëtarë në shkrime të veta dëshmojnë që edhe në vitin 1936 në një "manastir të dervishëve "afër qytetit Tripoli të Libanit ekzistonte një hurdhë me peshq kushtuar hyjneshës Atargatis. Në këtë mënyrë disa e shpjegojnë edhe abstenimin e sirianëve nga ushqimet e përgatitura nga peshku[17].

[16] Bellinger G. 1997, f. 50.

[17] Cavendish R.&Ling T., Mitologija, Ilustrirana enciklopedia, Mladost Zagreb 1982, f. 92-94.



Një paraqitje tjetër figurale e hyjneshës sirenë Atargatis-Dea Syria

Nga Siria, kulti i hyjneshës Atargatis u përhap më së pari në ishullin Dellos e pastaj nëpër tërë Greqinë, e më vonë edhe në Sicili, në Romë (në fillim të shekullit II dhe gjatë shekullit III para erës sonë[18] e nga aty edhe në Perëndim (në këtë mënyrë edhe në Dardani) duket falë tregtarëve sirianë si dhe skllevërve dhe mercenarëve, të cilët e përhapen kultin e kësaj hyjneshe deri tek kufijtë më veriorë të Perandorisë romake[19] duke e identifikuar shpeshherë me hyjnesha të tjera siç ishte rasti me hyjneshat: Dhemetra, Astarte, Ishtar, Venus Urania, Hera, Rhea, Kybela, Afrodita dhe Arthemida Azzanathcona.

Atargatis ishte hyjneshë qiellore e cila nderohej si Nëna e Madhe dhe Hyjneshë e pjellorisë së Tokës dhe Ujit, dhe konsiderohej si kryehyjneshë e mitologjisë siriane. Kësaj hyjneshe i dedikoheshin pëllumbi si simbol i hyjneshës së dashurisë dhe peshku si simbol i pjellorisë dhe i jetës në ujë. Kulti i saj lidhej aq shume me peshkun saqë ajo shpeshherë paraqitej në formë sirene: gjysmë femër e gjysmë peshk. Varianti grek i mitit thotë se ajo ishte një nimfë e cila ishte dashuruar në një bari dhe pasi mbeti shtatzënë me të e vrau bariun dhe vetë nga turpi u hodh në liqen nga i cili e nxorën nimfat dhe pas kësaj ajo u shndërrua në sirenë.

[18] Dhama T., Fjalor i mitologjisë, Tiranë 1987, f. 47.
[19] Cavendish R.&Ling T. 2004, f. 92-94.

Sipas mitit, vajza e saj Semiramida u bë mbretëreshë asiriane dhe për hir të saj u ndërtuan "Kopshtet e varura" të cilët njihen si njëra nga 7 mrekullitë e botës antike[20].

Tempulli më i madh i kushtuar hyjneshës Atargatis i quajtur Atargateion gjendej në Hierapolis, njërin nga 5 qytetet e mëdhenj në bregdetin e Detit Mesdhe, rreth 60 km. nga Jerusalemi. Sipas Herodotit, ky tempull i hyjneshës Atargatis ishte më i vjetri dhe shërbeu si model për ndërtimin e tempullit të hyjneshës Afrodita (Afërdita) në ishullin Qipro. Në Ascalon-Hierapolis në të njëjtin tempull në cilësi të bashkëshortit të Atargatis nderohej hyji Hadad që konsiderohej Ba'al (Zotërues)[21] lokal, ndërsa Atargatis nderohej si Belit (Zonjë) lokale. Ajo njihej edhe si "Sunduese e shtatë deteve". Sipas dëshmive të autorëve antikë, tempulli ishte i dekoruar në mënyrë luksoze dhe pos të tjerash kishte edhe shtatoren e kësaj hyjneshe (të stolisur me ar dhe xhevahire) të shoqëruar me dy luanë. Kjo shtatore kishte shokën magjike e cila e identifikonte me hyjneshën Afrodita, si dhe elementet të tjera që e identifikonin me hyjneshën Astrate. Afër tempullit gjendej liqeni i shenjtë i mbushur me shumë lloje të peshqve, të cilët ushqeheshin në mënyrë të veçantë, e madje disa nga këto peshq kishin emra dhe ishin edhe të stolisur me gurë të çmueshëm. Ishte gjë rreptësisht e ndaluar që peshqit të preken apo të hahen, përveç në raste të ceremonisë së quajtur "theapagy" kur priftërinjtë i hanin peshqit për nder të hyjneshës si një lloj sakramenti.

Priftërinjtë e hyjneshës Atargatis kishin veshje orientale dhe përcilleshin me këngë, vallëzim dhe muzikë sillnin vetën deri në gjendje transi, dhe pastaj të privuar nga ndjenjat bënin akte të vetëlëndimit dhe vetëpastrimit (vetamputimit të testisëve) në mënyrë të ngjashme si priftërinjtë e hyjneshës orientale Kybele[22].

Identifikimi i Dea Syria me hyjnesha të tjera të popullarizuara në botën antike

Në Romë dhe nëpër provinca perëndimore Atargatis njihej me emrin Dea Syria (hyjnesha e Sirisë), ndërsa kultin e saj aty e sollën skllevërit, tregtarët dhe mercenarët nga Sicilia. Ajo u adoptua në panteonin romak ku u identifikua në kult sinkretik me Venus Urania (Venera Qiellore) dhe nderohej së bashku me kryehyjin Jupiterin (që identifikohej me hyjin Hadad).[23]

Në provincat ballkanike kulti i hyjneshës Atargatis ka gjasë të ketë arritur nga Greqia ose nga Deti i Zi përmes Danubit meqë, pos në Scupi, gjurmët e kultit të kësaj hyjneshe janë dëshmuar në mënyrë epigrafike edhe në Maqedoni, Daki dhe Dalmaci, madje gjithmonë në formën e latinizuar "Dea Syria" apo Hyjnesha siriane.[24]

[20] Curotto E. 1958, f. 62.
[21] Robinson H.S&Wilson K., Mythes and legends of all nations, Bantam Edition 1961, f. 21.
[22] Morford M.&Lenardon R.J. 1994, f. 310.
[23] Ferri N., Mythologia Viva-Mitologjia e gjallë 2012, f. 163-166..
[24] Morford M.&Lenardon R.J. 1994, f. 309.

Është indikativ fakti që gjurmët e tempullit si dhe të tri monumentet kushtuar hyjneshës Dea Syria janë zbuluar buzë lumenjve Treska dhe Vardar dhe afër tregut, gjë që i dëshmon rrënjët origjinale të kultit të hyjneshës siriane Atargatis.

Bartësit e kultit të hyjneshës pa dyshim ishin me origjinë orientale të cilët edhe e sollën dhe e përhapen këtë kult në Ballkan, por siç shihet nga teksti i një mbishkrimi, në mesin e adhuruesve të kësaj hyjneshe në Scupi kishte edhe italikë të pasur të cilët bartnin funksione të larta në Senatin dhe në administratën e kolonisë të Scupit.

Scupi - qendër e jetës religjioze

Rajoni i qytetit antik të Scupit së bashku më rrethinën e Kumanovës së sotme, ishin qendër e kulteve me origjinë orientale meqë në Scupi dhe në fshatin Llopatë të Kumanovës janë zbuluar gjurmë të monumenteve epigrafike ose mbetje të tempujve kushtuar, pos hyjneshës Dea Syria, edhe hyjit Dolichenus[25], që rrjedh nga hyji Ba'al i Azisë së Vogël dhe i cili ishte identifikuar me Jupiterin romak duke krijuar hyjin sinkretik Iuppiter Dolichenus;[26] pastaj hyjneshës greke Nemesis[27], e cila nderohej shumë nga ushtarakët romakë si hyjneshë e cila sjell drejtësi, fitore dhe e hakmarrje;[28] e po ashtu edhe gjurmët e kultit të hyjit sinkretik grekoegjiptian të periudhës ptolemeide Serapis[29] (në të cilin ishin shkrirë kulti i Ozirisit dhe ai i Apisit)[30], si dhe gjurmë relativisht të shumta të kultit të hyjit indo-persian të dritës- Mithra[31], i cili ishte kulti i fundit pagan që u përhap në Perandorinë romake dhe e ndalonte prezencën e femrave në ritet fetare[32], dhe gjatë katër shekujve të parë të erës sonë (posaçërisht prej vitit 250 e deri në vitin 313 të erës sonë) ishte rival tejet serioz i krishterimit në garë për fenë zyrtare të Perandorisë romake.[33]

Ky është njëri ndër faktet të cilët e plotësojnë mozaikun e imazhit të besimeve dhe jetës shpirtërore në përgjithësi në Dardaninë romake dhe që dëshmojnë se Scupi dhe Maqedonia Veriperëndimore kishin rëndësi të veçantë në aspektin religjioz gjatë antikës meqë këtu, pos kulteve autoktone dardane dhe kulteve të

[25] Dragojević-Josifovska B. 1982, f. 161-162 n. 208.
[26] Marič R., Antički kultovi u našoj zemlji, Beograd 1933, f. 79.
[27] Dragojević-Josifovska B. 1982,f. 56 n. 12.
[28] Thoulin S. The Greek Mythology, Toubis Edition, Athene 1995, f. 60; Dizionario illustrato di mitologia greca e
romana, I miti, gli eroi, le leggende, i luoghi mitologici del mondo greco e romano, Crescere Edizion, Varese
2012, 334.
[29] Dragojević-Josifovska B. 1982, f. 59 n.19.
[30] Oakes L.&Gahlin L., Ancient Egypt, Hermes House, London 2002, f.231.
[31] Dragojević-Josifovska B. 1982, 163-166 n. 209, 210, 212;
[32] Philip N., Annotated Myths&Legends, Kindersley , London 2001, f.21.
[33] Morford M.&Lenardon R.J. 1994, f. 307; Dixon-Kennedy M., Encyclopedia of Greco-Roman Mythology,
Santa Barbara-California, Denver-Colorado, Oxford-England 1998, f. 210.

hyjnive të panteonit oficiel romak, ishin edhe selitë e kulteve jozyrtare me origjinë orientale prej nga këto kulte edhe përhapeshin më tutje.

CULT OF SYRIAN GODDESS DEA SYRIA IN DARDANIAN SCUPI
(Summary)

Among other main centers of worshiping the cult of classical Syrian goddess Atagatis was also Scupi, in Dardania. There were found several altars, as well as the remains of the temple, which proved a massive worship the cult of the goddess Atagatis in Roman Dardania.

Dea Syria or Deasura was supreme Syrian goddess, as well as goddess of soil, nature, fertility, water, and social and religious life, and also a goddess of happiness. According to this characteristics, she was identified with the goddesses Ishtar, Venus, Hera, Kybele, Aphrodite, Arthemis, Demeter, and other similar female deities. She was treated also as the goddess of sea, a patron saint to sailors, presented as a syren, and fish was dedicated to her.

Her cult was transferred from Syria via island Delos, Greek land and the Black Sea to Dardania, i.e. Scupi and Lopate (near Kumanovo), where epigraphic findings proved existence of this cult, worshiped together with the cult of the god Jupiter Dolichenus.

Traces of the worship of this cult of the Syrian goddess complete the image of believes and spiritual life in Roman Dardania. It proves that Scupi was one among centers of spiritual life, where were worshiped numerous cults, from native (Dardanian) cults, Greek and Roman cults, to the cults of the deities of the Oriental (Persian, Syrian, Egyptian) origin.

QEMAL MURATI

DHJETË POPUJ TË BALLKANIT ME DHJETË TË VËRTETA NË XHEP PËR "AUTOKTONINË" E TYRE

Në Ballkanin e lashtë, me popullsi antike të perënduara, dy popuj mund të merren si vazhdues të drejtpërdrejtë: shqiptarët dhe grekët e sotëm. Vazhdimësia e kombeve të tjera të sotme ballkanike është dhe nuk mund të jetë një gjë që kuptohet vetvetiu. Ajo do kuptuar vetëm "si problem", e jo si fakt i fortë" (Katiçiç). Me fjalë të tjera, pretendimet e popujve të tjerë për autoktoni në Ballkan janë johistorike dhe groteske. Popujt ballkanas janë shumë të politizuar. E, rrjedhimisht, edhe gjuhët i politizojnë, e mistifikojnë historinë e tyre dhe e nihilojnë gjuhën e tjerit.

Obsesioni i të qenit më i lashtë në Ballkan

Termi i ashtuquajtur "autoktoni" te popujt e sotëm të Ballkanit ka marrë shpesh një përdorim jolinguistik, si të thuash me përmasa manipulimi groteske, për ta paraqitur veten si më të vjetër në këtë Gadishull dhe për të fituar njëfarë legjitimiteti truallsor të viseve përkatëse. Megjithatë, siç ka vënë re me mprehtësi ballkanologu i shquar Victor Friedman:

"*Kur flitet në kuptimin e mirëfilltë linguistik, shihet se dialektet indoevropiane që u bënë shqiptare dhe greke kanë qenë pararendëset e gjuhëve që fliten sot në Ballkan nga pasardhësit e atyre dialekteve indoevropiane, të cilat lingvistikisht zëvendësuan disa nga gjuhët e mëparshme më të vjetra – indoevropiane dhe joindoevropiane. Gjurmët e atyre gjuhëve të mëparshme në gjuhët e sotme – për sa mund t'i hetojmë ato, sepse nuk janë të shumta – përmbahen vetëm te disa detaje fonologjike dhe te disa fjalë me prejardhje të paqartë etimologjike. Domethënë, gjuhët që u bënë shqipe dhe greke nuk janë gjuhët e para në Ballkan, por janë vetëm gjuhët e para nga shumësia e sistemeve gjuhësore që fliten sot në Ballkan. Gjuha latine ka ardhur më vonë në këto hapësira, dhe gjithashtu ka zëvendësuar një ose disa gjuhë të mëparshme. Megjithatë, nga pikëvështrimi linguistik, gjuhët romano-ballkanike i takojnë familjes së gjuhëve romane, domethënë kjo gjuhë erdhi pas atyre dialekteve që u bënë shqipe dhe greke. Gjuhët sllave ballkanike janë pasardhëse të një gjuhe të ardhur në Ballkan pas latinishtes ballkanike, duke zëvendësuar edhe këto një ose disa gjuhë të mëparshme. Gjuha rome me folësit e saj nga India sipas të gjitha gjasave ka ardhur ndërmjet shek. 11-12, kurse xhudezmo (ladino, hebraishtja) në fund të shek. 15. Armenishtja është përhapur në Ballkan përpara se të vinte Perandoria osmane me osmanishten*" (Friedman 2009: 17)

Kjo është në vija të përgjithshme pasqyra më e saktë e Ballkanit linguistik në raport me "autoktoninë" e gjuhëve që fliten sot e që janë folur dikur në këto hapësira, në historinë e tyre të ndërliqshme, e cila duhet të kuptohet ashtu siç është në të vërtetë, e jo me paragjykime e shtrembërime.

Porse, tipari karakteristik i "homo balcanicus" që ka të bëjë me autoktoninë, me obsesionin e të qenit më i lashti në Ballkan, është ushqimi spiritual i përditshëm i tij. Në një ese të tij për problemin e identiteteve ballkanike, publicisti i njohur Gazmend Kapllani, për të treguar se çfarë është Ballkani, tregonte një histori që lidhej me mbiemrin tij:

"U gjenda një herë në një takim gazetarësh ballkanikë dhe atje dikush më pyeti për mbiemrin. *Kapllani* u përgjigja unë. *Kapllani*, u hodh turku, është turqisht. Jo tha një grek, është greqisht. Jo tha një bullgare, është bullgar. Vetëm shqip nuk ishte! Në fakt është që të gjitha bashkë. *Kapllan* në Shqipëri, *Kapllanoglu* në Turqi, *Kaplanis* në Greqi, *Kaplanoviç* në Serbi, *Kaplanofski* në Bullgari e kështu me radhë. Sepse Ballkanasit kanë dalë nga e njëjta mitër historike. Ky është bekimi dhe mallkimi i tyre. Ngjajnë shumë me njëri-tjetrin, janë pothuajse e njëjta gjë. Prandaj edhe sot e kësaj dite rivendikojnë të njëjtët heronj, të njëjtët shenjtë, të njëjtët demonë. Kur erdhi koha e formimit të shteti-komb duhet të bindnin vetveten që janë krejt të ndryshëm. Sikur kishin zbritur në tokë secili prej tyre nga planetë të ndryshme. Si mund të bëhej kjo përveçse duke sajuar dokrra dhe mitologji të jashtëzakonshme? Deri në budallepsje".

Tani po shtyhemi pak në histori për të parë realitetet dhe mendësinë e "homo balcanicus" për autoktonicitetin. Në kohën antike, në një territor relativisht të ngushtë të Gadishullit të Ballkanit, banonin popuj të paktë në numër: *ilirë, grekë, makedonë, trakë, dakë, mizë*. Mendohet që ilirët shtriheshin kryesisht në pjesën perëndimore e qendrore e edhe trakasit derdheshin nga lindja deri në perëndim, grekët shtriheshin në jug, makedonët në qendër, e dakët në veri. Nuk duan qitur në harresë edhe popuj të tjerë që u integruan si pushtues në qytetërimin e përgjithshëm të popujve të Gadishullit Ballkanik, si *keltët, gotët* (*gjermanë*), *avarët, hunët*, që qëndruan në këtë rajon si stacion të përkohshëm për t`u dyndur më pas në vise të tjera.

Periudha afro tetëqindvjeçare e sundimit romak në Gadishullin tonë, solli si pasojë zhdukjen a shuarjen e gjuhëve të ndryshme jo latine në Ballkan: *makedonishtja, ilirishtja, trakishtja,* etj. Një degë e ilirëve në jug të Ballkanit i shpëtoi romanizimit duke ruajtur identitetin e vet bashkë me gjuhën (Ajeti 2001: 14). Ajo konsiderohet se mund të jetë shqipja.

Në Ballkanin e lashtë, me popullsi antike të perënduara, dy popuj mund të merren si vazhdues të drejtpërdrejtë: shqiptarët dhe grekët e sotëm. Vazhdimësia e kombeve të tjera të sotme ballkanike është dhe nuk mund të jetë një gjë që kuptohet vetvetiu. Ajo do kuptuar vetëm "si problem", e jo si fakt i fortë" (Katiçiç). Me fjalë të tjera, pretendimet e popujve të tjerë për autoktoni në Ballkan janë johistorike dhe groteske. Në këtë kuptim, qëndron ajo thënia e famshme e Uinston Çerçil (Winston Churchill), më 1941, se "*Ballkani prodhon më tepër histori sesa është në gjendje të konsumojë*".

Në Gadishullin e sotëm të Ballkanit është një e keqe shumë e përhapur që çdo komb të quhet i veçantë dhe më i vjetri i këtij rajoni. Këtë mani studiuesit frëngj Pierre

Cabanes e Bruno Cabanes (Cabanes 2001: 188) e kanë quajtur me të drejtë *etje për autoktoni.* Siç theksojnë këta studiues të shquar, në shtetet e krijuara nga shpërbërja e ish-Jugosllavisë, të habit shtrirja që ka marrë kjo *etje për autoktoni*. Të shohim tani se si na paraqitet kjo dukuri te popujt e Ballkanit, sidomos te popujt sllavë të Jugut.

Ajo që dihet me siguri për Ballkanin, është ky fakt historik: *Elementi i parë, që e pranojnë të gjithë, është se sllavët e Jugut depërtuan në Gadishullin Ballkanik nga fundi i shekullit VI dhe u vendosën në ato vise që përbëjnë Serbinë e Maqedoninë sllave gjatë shekullit pasardhës* (Cabanes 2001: 209). Ndonëse kjo është një e vërtetë plauzibile, e pakundërshtueshme, serbët, sllovenët, kroatët, boshnjakët e maqedonasit nuk denjojnë të rikrijojnë e të përvetësojnë origjina nga më grotesket të popullsive antike dhe paraantike, siç do t`i paraqesim ato në vijim, bashkë dhe me origjinat e disa popullsive të tjera (arumune, greke, shqiptare).

Miti për serbët, si "populli më i vjetër"

I. Te shkrimtarët bizantinë të shek. XI-XV, sipas prirjes që popujt e mesjetës të merrnin emra të popujve antikë, *serbët* janë quajtur me emrin trakas *Tribal* të Herodotit dhe Tukididit, të cilët qysh në periodën romake i takuan së kaluarës. Ndërkaq në kohën e Komnenit serbët parapëlqyen të quhen me emrin e Dalmacisë së madhe romake *Dalmat* (Jireçek 1952: 3).

Te serbët është ngulitur miti se janë populli më i vjetër ("*Srbi, narod najstariji"*). Historiani serb Radivoj Radić, profesor i rregullt në Fakultetin Filozofik të Beogradit dhe shef i Katedrës dhe Seminarit të Bizantologjisë, për mitet serbe dhe keqpërdorimin e tyre do të shprehet:

"Nisam siguran da je mit o "Srbima, narodu najstarijem" potrošen. Bez obzira na svoju neutemeljenost, on i dalje ima nemali broj pristalica. Knjige pseudoistoričara koji istrajavaju na njemu i dalje se prodaju u velikim tiražima, a tribine na kojima oni nastupaju širom Srbije i Republike Srpske su veoma posećene. Uz to, nisu retki gosti na pojedinim, mahom lokalnim televizijama. Sa sociološkog i psihološkog stanovišta zanimljivo je da mit o "Srbima, narodu najstarijem" uživa veliku popularnost i prihvatanje u srpskoj dijaspori. Taj mit propagira jedna neozbiljna družina amatera-diletanata, podstaknuta jeftinim rodoljubljem (nikako ne bih potcenio ni trivijalno koristoljublje kao motiv!). Mit o "Srbima, narodu najstarijem" uvek dobija na snazi u kritičnim situacijama, u trenucima opšteg beznađa i nacionalne dezorijentacije. A, vreme u kojem živimo, sa svim svojim nedaćama i stranputicama, samo pogoduje održavanju i širenju tog mita. Ako je za utehu, slični mitovi postoje kod svih balkanskih naroda. Svi oni bi želeli da su barem jedan dan "stariji" od svojih suseda" (Radić 2015).

II. Në shtator 1998 u mbajt në Lubjanë një simpozium për gjenezën e sllovenëve, gjatë të cilit disa deshën t`i përkufizonin sllovenët si trashëgimtarë të *paleovenetëve*. Në mos, pa dyshim, të etruskëve.

III. *Nga ana e kroatëve*, regjimi mbështet lidhjet me *gotët*, që e kanë përshkuar Gadishullin Ballkanik në çerekun e fundit të shekullit IV – çka i jep mundësi të presë çdo lidhje me armikun serb.

IV. Tek *boshnjakët myslimanë*, pretendohet për një autoktoni që nuk shkuaka fort larg, por deri në epokën e bronzit: edhe një herë, qëllimi është mohimi i çdo lidhjeje me sllavët.

Maqedonasit e sotëm me koncept të identiteti të dyfishtë: antik dhe sllav

V. *Sllavët e Maqedonisë*, historikisht një element bullgar i këtij rajoni, sipas parapëlqimit të tyre, e ndajnë veten në dy kategori etnike: 1. Trashëgimtarë të maqedonasve antikë, pasardhës të Filipit dhe të Aleksandrit të Madh (kuptohet për pretendime të tyre territoriale), dhe 2. Sllavë të mirëfilltë. "*Koncepti i identitetit të dyfishtë, antik dhe sllav mund të zhvillohet vetëm në shoqëri ku mendimi kritik nuk funksionon*" – shprehet Arben Xhaferi. Përvetësimi i historisë së vjetër maqedonase të periudhës antike, kuptohet, bëhet vetëm për qëllime ekspansioniste, për ta përligjur edhe territorin e sotëm si pronë ekskluzivisht të tyre: "Maqedonia maqedonasve".

Lubço Georgievski (Љупчо Георгиевски), ish-kryeministër dhe lider i VMRO-DPMNE, tani kryetar nderi i ВМРО-НП, i deklaroi në intervistën e së dielës Radios Evropa e Lirë (04. 12. 2011), se: "*Atë që dëshirohet të imponohet sot si politikë shtetërore për Maqedoninë antike unë e quaj karikaturë, karikaturë e historisë, sepse nuk ka lidhje me të. Populli maqedonas për çdo ditë bombardohet me gënjeshtra, me dezinformata, me filma dokumentarë, ku shohim se si e përshkruajnë historinë greke dhe e modifikojnë. Për mua është shumë e qartë që ka një ndarje evidente në atë që quhet historia antike dhe historisë sllave të Maqedonisë. Ende mbroj tezën se ajo në të cilën mund të mbështetemi, e të mos gabojmë, është identiteti sllav, me themelvënësit në rrafshin shpirtëror, Shën Cirilin, Shën Klimentin, Shën Naumin. Kjo është ajo historia e vetme në të cilën mund të ecim seriozisht*". Ç`është e vërteta, sikundër pohon studiuesi Bernard Lory: "*Në mes të shekullit XIX identiteti maqedonas ishte vështirë të dallohej nga identiteti kombëtar bullgar, i cili ishte edhe vetë në formim. Një numër i caktuar ndryshimesh, në fillim ishin të vogla, që pastaj erdhën duke u thelluar, e bënin megjithatë dallimin. Zgjedhja e dialekteve Lindore për caktimin e normës letrare të bullgarishtes e bën këtë gjuhë më të vështirë për t`u përdorur nga maqedonasit, ndërkohë që normat e maqedonishtes letrare vendosen mbi bazën e dialekteve të qendrës (Prilep-Veles)...Formulimi i parë koherent i "maqedonizimit" daton më 1903 (K. Misirkov). Në vitin 1913 territori i Maqedonisë gjeografike ndahet ndërmjet Greqisë, Bullgarisë e Serbisë. Në pjesën e kësaj të fundit, popullsia autoktone sllave do të konsiderohet si serbe nga viti 1918 deri më 1941, pastaj si bullgare nga 1941 deri më 1944, kurse Konferenca e dytë e AVNOJ-it e Jugosllavisë (1943) njohu "identitetin maqedonas" në bashkësinë e re jugosllave...I shfaqur vonë ndërmjet nacionalizmave të tjerë ballkanikë, nacioni maqedonas mohohet dhe kritikohet në Greqi e në Bullgari, ngase ai ndërton një të kaluar historike sipas asaj që i pëlqen*" (Lory 2007: 196, 197).

Ballkanologu njohur Victor Friedman, pyetjes: *Si i shpjegoni pohimet që mbrojtësit e prejardhjes sllave e rrezikojnë identitetin e maqedonasve*?, i jepte këtë përgjigje: "*Unë jam linguist. Për mua gjuha maqedonase është gjuhë sllave, dhe kur është fjala për raportet e saj me gjuhët e tjera, ato i ka më të afërta me dialektet e bullgarishtes perëndimore dhe dialektet e serbishtes jugore* (Gazeta "Vreme" 8-9 gusht 2009).

Profesori i Historisë klasike dhe antike, në Universitetin e Australisë Perëndimore, Xhon Mellvin-Xhons, është shprehur se "*Maqedonasit janë njerëz që vjedhin historinë e huaj. Thuhet se shteti IRJM nuk mund të mbijetojë pa bazën historike për identitetin e tij nacional. Nëse ju jeni të zhveshur, nuk ua jep kjo të drejtën të vidhni veshjen e dikujt tjetër*", thotë profesori Mellvin Xhons.

VI. *Popullsia arumune (vllahe)* e Maqedonisë e konsideron praninë e barinjve vlleh në bjeshkët e Pindit, para se maqedonasit dhe ilirët të vijnë në këto treva – më qartë, para sllavëve të jugut dhe shqiptarëve (Cabanes 2001: 187, 188).

Grekët e sotëm pretendentë për prejardhjen e tyre nga grekët e lashtë, porse greqishtja e vjetër dhe greqishtja e re nuk kuptohen ndërmjet tyre

VII. *Grekët e sotëm* janë pretendentë të mëdhenj për prejardhjen e tyre nga grekët e lashtë, edhe pse mungojnë faktet historike e gjuhësore për këtë. Helenët e sotëm kinse harrojnë se deri para shek. 19 janë quajtur *Romei* (Fridman 2009: 20), e vendi *Rumeli* (Perandoria romake e lindjes). Në funksion të "autoktonisë" së tyre, në ndarjen e sotme administrative regjionale, ata kanë "ringjallur" dhe emërtimet e krahinave të vjetra antike si Epiri, Makedonia, Trakia, Thesalia, etj. duke pretenduar dhe aneksimin e tokave të vendeve fqinje (Shqipërisë Jugore, Maqedonisë, etj.).

Shënim. Grekët e sotëm, pra banorët e Greqisë, paraqesin një kontinuitet etnik jo të lidhur dhe aq të drejtpërdrejtë me helenët e lashtë.

Në fund të shekullit XIX megjithatë nacionalistët ia dolën mbanë, dhe mbajtën pretendimin e madh: Ne jemi trashëgimtarët e vetëm legjitimë të Greqisë së lashtë dhe si rrjedhojë në territorin grek duhet të jetojnë vetëm grekët etnikë – shprehet Christian Vos, sllavist, atëkohë në Universitetit të Freiburg-ut (Intervistë në Lobi, 20. 10. 2005, Shkup).

Nga pikëpamja filologjike, për rastin e greqishtes, linguisti i njohur Ranko Bugarski (2001: 18) shprehet kështu: "*Gjuha greke, në një kuptim të caktuar, vazhdon në kontinuitet nga greqishtja e vjetër, përmes greqishtes bizantine, te greqishtja e sotme, megjithëse greqishtja e vjetër dhe greqishtja e re nuk kuptohen ndërmjet tyre*".

Një fakt që ka rëndësi të përmendet për këtë çështje është dhe ky. Kur i pyet Arvanitasit e Greqisë se kë kanë pasur ata fqinj, merr këtë përgjigje: *shkletë*, kurse gjuhën e asaj popullsie e quajnë *shklertishte*. Pra, jo popullsinë e njohur me emrin e sotëm të mbivënë "greke". Ky argument është mjaft vetëfolës për ta kuptuar historinë, natyrisht për ata që duan ta kuptojnë.

Asgjë nuk është e qartë lidhur me origjinën e shqiptarëve, por sipas të gjitha gjasave, shqiptarët kanë prejardhje nga ilirët e lashtë

VIII. *Shqiptarët* e mbajnë veten për pasardhës direkt të ilirëve parakristianë dhe gjithashtu gjuhën e tyre - e cila nuk është e afërt as me sllavishten e as me greqishten - e trajtojnë si pasardhëse të ilirishtes. Por, për këtë nuk ka asnjë dokument të shkruar të përcjellë nga ilirishtja. Historiani i madh i Ballkanit, çeku Konstantin Jireček, në veprën e tij të famshme *Romanët në qytetet e Dalmacisë gjatë mesjetës*, me një objektivitet të konfirmuar shkencor e me autoritet të veçantë studimor, shprehet se:

"*Gjuha e shqiptarëve, paraardhësit e të cilëve janë ilirët e lashtë, ofron vetëm një material të paplotë për njohjen e ilirishtes, meqenëse është përshkuar krejtësisht vetëm nga elementë romakë*", dhe "*Marrëdhëniet etnografike ndryshuan nga përhapja e shpejtë e latinishtes dhe greqishtes dhe rënia e ilirishtes, prej së cilës rrjedh shqipja, dhe trakishtes, e cila nuk përmendet më pas shekullit të 6*" (Jireček 2010: 41, 63).

Prejardhja e shqiptarëve nga ilirët ka disa argumentime shkencore, por gjithnjë derisa nuk gjendet një tekst i ilirishtes që të krahasohej me shqipen, kjo mbetet vetëm një supozim. Ajo që dihet me siguri është kjo, që shqiptarët e sotëm janë pasardhës të një popullsie të vjetër antike të Ballkanit dhe të ankoruar në këto vise shumë kohë para ardhjes së sllavëve.

Shënim. Historiani anglez, Noel Malcolm, autor i librit "*Kosova – një histori e shkurtër*" (Prishtinë, 2001), shprehet:

"*Edhe pse asgjë nuk është e qartë lidhur me origjinën e shqiptarëve, sipas të gjitha gjasave, kanë prejardhje nga ilirët e lashtë. Mendoj se kjo është përgjigjja më e mirë historike që mund të jepet dhe ka evidencë për të*" (Koha, 15. 5. 2010, Prishtinë).

Historiani Konrad Clewing, eksperti për Ballkanin, konsideron që "*argumentimi shqiptar i Akademisë së Shkencave në Tiranë se gjuha shqipe dëshmon se shqiptarët kanë qenë gjithmonë aty, ku janë sot, kjo është nga ana shkencore absurditet. Gjuha një herë nuk dëshmon se ke qenë, ku ndodhesh sot*". Nuk është e vërtetë që shqiptarët ndodhen që prej antikitetit aty, ku janë sot dhe as që maqedonasit ishin aty, ku ndodhen sot që prej mesjetës së hershme - pohon Clewing (për Deutsche Welle).

Clewing na mëson, për shembull, se "*Nuk ka një të vërtetë shqiptare, një të vërtetë maqedonase për Maqedoninë dhe Kosovën. Mund të ketë perspektiva shqiptare, perspektiva maqedonase dhe këta duhet ta pranojnë kritikën e njëri-tjetrit me realizëm. Është fakt që të vërtetat gjenden me vështirësi dhe është e sigurt se jo të gjithë kanë jetuar atje, ku ndodhen sot. Kjo siç duket është e vështirë të pranohet*".

Në një shkrim eseistik me frymë kritike *Obsesioni ynë me origjinën* (Përpjekja 15-16, Tiranë, 1999), studiuesi Ardian Vehbiu për sa i përket lashtësisë së gjuhës shqipe shprehet me të drejtë: *Sigurisht, gjuha shqipe është e lashtë. Po aq e lashtë sa çdo gjuhë tjetër*...Emrat tanë nuk janë aspak të lashtë...Në kulturë asgjë nuk mund të jetë e lashtë dhe e gjallë në të njëjtën kohë. Ndërsa shoqëria riprodhon vetveten, e gjithë e vjetra shndërrohet në të re, ndonëse jo domosdoshmërisht në sensin progresiv.

Për mitomaninë e kombeve të sotme të Ballkanit, kishte të drejtë Ernest Renan kur thoshte: *"Kombi është shoqëria që prodhon iluzione të përbashkëta për paraardhësit e vet dhe urrejtje të përbashkëta për fqinjët"*.

Gadishulli Ballkanik ka histori shumë problematike. Dhjetë popuj të Ballkanit kanë dhjetë të vërteta në xhep për "autoktoninë e tyre antike" në këtë truall, me pretendimin se të qenit autokton të bën vetvetiu dhe trashëgimtar legjitim të truallit të sotëm që posedojnë popullsitë përkatëse, paçka se kjo nuk mund të jetë kështu. Në këtë kuptim, maqedonasit e sotëm shpallin pretendimin e madh: "Maqedonia maqedonasve", kurse të tjerët që nuk na qenkan "maqedonas" le të venë prapa diellit"! "Greqia e grekëve", "Shqipëria e shqiptarëve", e kështu me radhë.

Popujt ballkanas janë shumë të politizuar. E, rrjedhimisht, edhe gjuhët i politizojnë, e mistifikojnë historinë e tyre dhe e nihilojnë gjuhën e tjerit. Popujt e sotëm të këtij Gadishulli sa më parë që ta kuptojnë se historia e satanizuar që kanë krijuar ata është një histori imagjinare, pjellë e dëshirave të tyre të shkreta, aq më mirë do të jetë për të ardhmen e tyre evropiane.

BIBLIOGRAFIA

Ajeti 1998 = Ajeti 1998 = Ajeti, Idriz, *Vepra 3*, ASHAK, Prishtinë, 1998.

Ajeti 2001 = Ajeti, Idriz, *Vepra 4*, ASHAK, Prishtinë, 2001.

Bello 2009 = Bello 2009 = Seminari Ndërkombëtar për Gjuhën, Letërsinë dhe Kulturën Shqiptare, 28/1, Prishtinë, 2009.

Bugarski 2001 = Bugarski, Ranko, *Jazici*, Ein-Sof, Skopje, 2001.

Cabanes 2001 = Cabanes, Pierre, Cabanes, Bruno, *Afshe shqiptare nga Berisha te Kosova*, Onufri, Tiranë, 2001.

Friedman 2009 = Friedman, Victor, *Mekedonija i Evropa od lingvistička gledna točka*, Mekedonski jazik, 17, LX 2009, Skopje.

Jireček 2010 = Jireček, Konstandin, *Historia e serbëve*, Intelligenda, Shtëpia botuese "55", Tiranë, 2010.

Kepeski 1993 = Kepeski, Krume, *Prilepskiot govor*; priredil Vasil Drvošanov. Kultura, Skopje, 1993.

Kore 2010 = Kore, Mimoza, *Kërkime për njësi të përbashkëta ballkanike*, te "*Çështje të studimeve diakronike të shqipes*", Materiale të Konferencës shkencore, 6 korrik 2009, në Prishtinë, ASHK-ASHSH, Tiranë, 2010.

Lory 2007 = Lory, Bernard, *Europa Ballkanike nga 1945 në ditët tona*,

Shtëpia Botuese DITURIA, Tiranë, 2007.

Radić 2015 = Radić Radivoj, *Balkanci, narod od sebe stariji,* "VREME", 20. AVGUST 2015. Intervju).

HIDAJETE AZIZI

GJENDJA E STUDIMEVE ONOMASTIKE NË MAQEDONI

Onomastika është një degë e gjuhësisë tejet e rëndësishme dhe është e lidhur ngushtë jo vetëm me historinë e kulturës materiale, por edhe me atë të kulturës shpirtërore të një etnie, që nga kohët më të lashta e deri më sot. Rëndësia e lëndës së saj është dëshmuar jo vetëm në shkencën e gjuhës (në fonetikë e gramatikë, në leksikologji, semantikë, etimologji, dialektologji, në përkimet ndërgjuhësore e standardologji), por edhe në shumë disiplina jashtëgjuhësore a shkenca të tjera, siç janë historia, gjeografia e demografia, arkeologjia, etnografia, mitologjia, gjithashtu edhe psikologjia, sociologjia, por edhe letërsia e folklori etj. Mu për këtë, lënda e saj është bërë cak i studimeve në shumë lëmenj dhe studiohet si nga onomasticienët e linguistët ashtu edhe nga historianët, sociologët, juristët etj., të cilët këtë tematikë e shtjellojnë nga këndvështrimi i vet.

Fusha e onomastikës shqiptare, e sidomos e onomastikës së trevave shqiptare të Maqedonisë, është lëvruar pak. Edhe pse janë botuar mjaft studime shkencore nga kjo fushë, onomastika shqiptare në përgjithësi mund të llogaritet si shkencë relativisht e re, ndërsa ajo e shqiptarëve të Maqedonisë është në hapat e saj të parë. Po të shikohet i tërë korpusi i studimeve që lidhen me problematika të ndryshme të onomastikës shqiptare, të realizuara si nga studiues tanë, ashtu edhe nga studiues të huaj, rezulton se këto studime u takojnë më shumë trevave shqiptare përreth territorit të Maqedonisë, ndërkohë që deri më sot në studimet onomastike shqiptare në përgjithësi, akoma nuk është përfshirë materiali i plotë i tërësisë territoriale të trojeve etnike shqiptare, as në diakroni e as në sinkroni. Sa i takon studimit të onomastikës për viset shqiptare të Maqedonisë mund të thuhet se përveç disa studimeve për disa rajone të veçanta dhe disa vështrimeve të tjera më të shkurtra, akoma nuk është bërë ndonjë studim i gjerë dhe i thellë që do ta ndriçonte mirë këtë trevë nga kjo fushë shkencore, madje disa fusha të saj, sidomos antroponimia e patronimia, për dallim nga mikrotoponimia e cila megjithatë është trajtuar pak më shumë, kanë mbetur pothuajse të paprekshme nga dora e onomasticienit, për shumë zona të territorit të Maqedonisë. Aq më pak mund të flitet për studime të cilat do ta pasqyronin në tërësi lëndën onomastike të shqiptarëve të Maqedonisë. Edhe në këto prurje që kemi sot, lënda e onomastikës më tepër është trajtuar në kuadër të disiplinave të tjera brenda gjuhësisë, sidomos në atë të dialektologjisë, por edhe të fushave të tjera, si në atë të historisë, të demografisë, të arkeologjisë etj., të cilat vetëm ndërlidhen me onomastikën. Në këtë mënyrë, për shumë nga këto prurje, më drejt do të ishte të flitej për studime me karakter dialektologjik, historik etj., dhe sidomos për studime me karakter ballkanologjik brenda të cilave

pasuria materiale e shpirtërore e shqiptarëve të Maqedonisë shumë shpesh është bërë objekt studimi, sesa për studime të mirëfillta onomastike.

Përderisa studimet onomastike shqiptare në Maqedoni nuk shënojnë ndonjë nivel të lartë të zhvillimit dhe nga ana e studiuesve shqiptarë të këtushëm nuk është bërë apo nuk është mundur të bëhet sa duhet, mjaft trajtime, monografi e studime, sidomos të atilla të cilat flasin për identitetin e popullsisë dhe vendbanimeve në hapësirën shqiptare në Maqedoni kemi ndeshur tek autorët sllavë. Mirëpo siç dihet, në studimet e këtyre autorëve, kuptohet me ndonjë përjashtim, më tepër se sa për prurje të mirëfillta shkencore, mund të flitet për tekste propagandistike e të politizuara. Ky nivel jo i volitshëm i studimeve onomastike shqiptare në Maqedoni, para së gjithash lidhet me mungesën e institucioneve shkencore e organizimeve institucionale në gjuhën shqipe apo me funksionimin e tyre të vonë kundrejt ekzistimit të tyre të hershëm në Shqipëri e Kosovë. Aq më tepër, në asnjërin nga institucionet që funksionojnë sot në gjuhën shqipe këtu në Maqedoni, akoma nuk është themeluar një seksion i veçantë për onomastikë i cili do të ndihmonte në institucionalizimin e duhur të studimeve onomastike, ashtu siç ka ndodhur tek institucionet e ndryshme shkencore në Shqipëri e Kosovë apo edhe tek institucionet në gjuhën maqedonase këtu në Maqedoni brenda të cilave studiuesit maqedonas kanë arritur të botojnë një sërë veprash onomastike të cilat kërkojnë angazhim ekipor dhe jo vetëm individual, si: *Речник на презимињата кај Македонците,* i botuar në vitin 1994 në dy vëllime; *Стандардизација на географските имиња во Република Македонија*, 2004; *Речник на лични имиња во македонското народно творештво,* 2008 etj.

Megjithatë, përpjekjet individuale të hulumtuesve shqiptarë të Maqedonisë nuk janë për t'u nënvlerësuar dhe paraqesin një ndihmesë, mbase modeste dhe herë-herë vetëm një nismë e herë-herë edhe një hap para në kultivimin, zhvillimin dhe ngritjen e studimeve onomastike shqiptare dhe të kulturës albanologjike në përgjithësi në Maqedoni nga ky krah i kombit. Në kuadër të institucioneve ekzistuese, edhe pa ekzistimin e një sektori onomastik, onomastika është bërë objekt studimi edhe në shkallë magjistrature e doktorate[1], janë shkruar e botuar edhe monografi, artikuj e kumtesa të shumta si dhe janë organizuar tubime të ndryshme shkencore: diskutime, tryeza, simpoziume e konferenca shkencore dhe seminare ndërkombëtare të cilat kanë rezultuar edhe me botimin e përmbledhjeve të materialeve të tyre, si bie fjala, botimi i përmbledhjeve të materialeve të Seminarit Ndërkombëtar të Albanologjisë, botimet në Aktet e revistës shkencore Alb-shkenca, botimet në edicionet e veçanta të Scupi-t etj. Botimi i rregullt i materialeve të veprimtarive shkencore paraqet jo vetëm një ndihmesë të hulumtuesve shqiptarë nga Maqedonia, por flet edhe për një angazhim serioz në

[1] Kadriu, Sevdail. *Leksiku toponimik dhe patronimik i rajonit të Kumanovës.* Punim magjistrature. Universiteti Shtetëror i Tetovës, Tetovë 2001; Limani, Jakup. *Toponimet dhe mikrotoponimet në komunën e Zhelinës.* Punim magjistrature. Universiteti Shtetëror i Tetovës, Tetovë 2011; Azizi, Hidajete. *Sistemi antroponimimik dha patronimik i shqiptarëve të Maqedonisë.* Punim doktorate. Universiteti 'Shën CIrili e Metodi', Shkup 2015 etj.

veprimtarinë kërkimore edhe përkundër mundësive jo të volitshme në mungesë të institucioneve. Çështjet e onomastikës janë trajtuar si të tilla apo edhe si pjesë përbërëse e trajtimeve të larmishme gjuhësore, historike, dialektologjike etj., si dhe në kuadër të fushave të tjera edhe në shumë artikuj të botuar në revistat shkencore që botohen këtu në Maqedoni, si në *Studime Albanologjike*[2]*, Jehona*[3] apo herë pas here edhe në revista të tjera e në gazeta ditore. Nga këto organizime, si tregues të orientimit onomastik të shkencës albanologjike në Maqedoni do të veçojmë sesionin shkencor '*Toponimia shqiptare në Maqedoni'*, organizuar nga Instituti i Trashëgimisë Shpirtërore e Kulturore të Shqiptarëve në Shkup, materialet e të cilit janë botuar në numrin e 5-të të edicionit *Scupi*[4] në vitin 2014 dhe sesionin shkencor të etnokulturës '*Toponimia në trevat lindore, dëshmi e autoktonisë shqiptare*', i realizuar në kuadër të Seminarit Ndërkombëtar të Albanologjisë, organizuar nga Universiteti Shtetëror i Tetovës[5], si dhe simpoziumin shkencor '*Shqiptarët e Maqedonisë'*[6] në Shkup.

Në vazhdim do të jepet një pasqyrë e gjendjes dhe e zhvillimit të studimeve onomastike në Maqedoni përmes një bibliografie të studimeve onomastike dhe të fushave të tjera që prekin edhe çështje onomastike, të autoriteteve dhe personaliteteve shqiptare të cilët veprimtarinë e vet e kanë zhvilluar brenda kufijve të Maqedonisë dhe veprimtaria e të cilëve ka të bëjë me studime onomastike për Maqedoninë dhe me shqiptarët në të, pa e përfshirë edhe veprimtarinë e

[2] Revistë shkencore e Institutit për Trashëgimi Kulturore e Shpirtërore e Shqiptarëve në Shkup e cila botohet në Shkup që nga viti 2009 e deri më sot dhe e cila numëron 12 numra.

[3] Revistë shkencore e botuar në Shkup që nga viti 1962 në kuadër të së cilës janë botuar, ndër të tjera, edhe shumë studime nga fusha e onomastikës të studiuesve shqiptarë nga mbarë trevat shqiptare, si bie fjala nga Idriz Ajeti, *Kontribut për studimin e onomastikës mesjetare në territorin e Malit të Zi, Bosnës e Hercegovinës dhe të Kosovës,* 1976/9; Skënder Gashi, *Lidhjet gjuhësore etruro-shqipe,* 1970/1; Sqarimi i toponimeve antike përmes shqipes, 1970/5; Muhamet Tërnava, *Rëndësia e toponomastikës si shkencë ndihmëse e historisë*, 1973/1 e nga mjaft studiues të tjerë.

[4] SCUPI është edicion i veçantë i cili përmbledh e boton punimet e aktiviteteve shkencore: të konferencave, të simpoziumeve e tryezave shkencore që organizohen nga Instituti i Trashëgimisë Shpirtërore e Kulturore të Shqiptarëve në Shkup e i cili deri tani ka botuar 13 numra.

[5] Në kuadër të Seminarit Ndërkombëtar të Albanologjisë I-IX, që nga viti 2007 e deri më tani, janë trajtuar herë pas here mjaft çështje të onomastikës shqiptare në përgjithësi dhe për trojet shqiptare në Maqedoni në veçanti. Ndër to veçohet Seminari V ku u trajtuan gjerësisht tema të onomastikës shqiptare nga këndvështrime të ndryshme.

[6] Simpoziumi shkencor 'Shqiptarët e Maqedonisë' i organizuar në Shkup në vitin 1991 u thirr me nismën e Shoqatës së Arsimtarëve të Gjuhës dhe Letërsisë Shqipe, të Meshihatit të Bashkësisë Islame të Maqedonisë, si dhe të Medresesë 'Isa Beu' të Shkupit, ku përveç studiuesve shqiptarë nga Maqedonia, morën pjesë edhe studiues nga Shqipëria, Kosova e gjetkë dhe ku u trajtuan probleme të jetës shpirtërore e të kulturës materiale të popullsisë shqiptare të Maqedonisë, që nga kohët më të lashta. Një vend të rëndësishëm në këtë vëllim, përveç punimeve nga fushat e gjuhësisë, letërsisë e etnografisë, e arsimit, e folklorit etj., zënë edhe punimet nga fusha e onomastikës.

autoriteteve shqiptare e të huaj që kanë kontribuar për onomastikën shqiptarë të Maqedonisë nga jashtë, e që nuk është një kontribut i vogël, madje, mund të jetë edhe më i lartë se sa vetë kontributi i studiuesve nga Maqedonia.

Qëllimi i këtij artikulli është që, përveç të dhënave të ofruara për autorët dhe studimet e hulumtimet e tyre të bëra në fushën e onomastikës, por edhe në fusha të ndryshme studimore që ndërlidhen me onomastikën, të nxisë edhe idenë e nevojës për hulumtime të mëtejshme më të thella në këtë fushë, sepse materiali i pasur onomastik i kësaj ane, madje diku-diku edhe i pavënë re deri sot, regjistrimi i toponimeve, antroponimeve e patronimeve të ruajtura në gjendjen më të hershme të tyre si dhe studimi i tyre, besojmë se paraqet një interes të madh për gjuhësinë shqiptare në përgjithësi e për onomastikën, si disiplinë relativisht e re, në veçanti.

Studiuesit shqiptarë nga Maqedonia, krahas studiuesve nga Shqipëria e Kosova, me angazhimin e tyre shkencor në fushën e onomastikës dalin në sipërfaqe më vonë, vetëm në gjysmën e dytë të shekullit XX. Ndër ta do të përmendim Qemal Muratin, Xhemaludin Idrizin, Mustafa Ibrahimin dhe autorë të tjerë të cilët në kuadër të hulumtimeve të fushave të ndryshme linguistike, kanë kontribuar edhe në fushën e onomastikës, si: Fadil Sulejmani, Haki Ymeri, Asllan Hamiti, Izmit Durmishi etj. Kontributi i këtyre autorëve lidhet me fusha të ndryshme të onomastikës, si me toponiminë (mikrotoponiminë, ojkoniminë, hidroniminë, oroniminë), antroponiminë, patroniminë etj. të cilat janë trajtuar herë në rrafshin sinkronik e herë në atë diakronik. Materiali onomastik, i cili herë-herë përfshin edhe lëndë që nga antika e mesjeta, është studiuar jo vetëm si sistem vlerash historike e socio-linguistike duke e ndërlidhur kështu onomastikën edhe me shumë fusha të tjera, si me historinë, arkeologjinë, etnografinë, letërsinë, hartografinë etj., por mbi të gjitha si strukturë gjuhësore: fonetike, morfologjike, sintaksore, leksikore, etimologjike dhe semasiologjike. Në disa raste, ky material vetëm është vjelë në terren nga pjesë të ndryshme të territorit të Maqedonisë dhe është paraqitur si pjesë përbërëse e korpusit të përgjithshëm onomastik të këtyre viseve, material i cili pret ditën që të studiohet e të hulumtohet nga studiuesit në të ardhmen. Nga ana e studiuesve shqiptarë janë bërë përpjekje edhe për shqyrtimin e problemit të onomastikës së ndaluar shqiptare në Maqedoni dhe standardizimin e saj, një problematikë kjo mjaft e ndjeshme për shqiptarët e këtushëm.

Për fillim po japim një pasqyrë të veprave onomastike, të studimeve me karakter monografik brenda të cilave, në të shumtën e rasteve jepet përshkrim i vendbanimeve me popullsi shqiptare (i rajonit të Pollogut, të Pellagonisë, të Karshiakës, të Kumanovës etj.) por me theks të veçantë në toponiminë, përkatësisht mikrotoponiminë, patroniminë e antroponiminë sipas fshatrave. Në pjesën më të madhe të këtyre studimeve gjejmë të dhëna historike, etnogjeografike e demografike jo vetëm për fshatrat me popullsi të plotë shqiptare, por edhe për fshatrat ku mbijetojnë arketipe gjuhësore, folklorike e etnologjike në të cilat, falë korpusit onomastik të vjelë në këto anë dhe rezultateve që dalin nga analiza e këtij korpusi, akoma mund të gjenden shenja të ekzistencës së popullsisë shqiptare, në disa raste edhe të sllavizuar. Këto studime spikasin sidomos me analizat gjuhësore të njësive mikrotoponimike përmes klasifikimit sipas strukturës morfogramatikore e leksikore-semantike. Të tilla janë monografitë të cilat po i japim në vazhdim me

të dhënat e nevojshme bibliografike e të radhitura sipas rendit alfabetik të mbiemrave të autorëve e vitit të botimit:

Durmishi, Izmit. *Vështgime gjuhësore mbi toponiminë dhe antroponiminë e Pollogut të Epërm të Gostivarit.* Gostivar: Taulant, 2008.

Ibrahimi, Mustafa. *Mikrotoponimet në vendbanimet shqiptare të Prilepit, Krushevës dhe Velesit*. Shkup: Interlingua, 2010.

Idrizi, Xhemaludin. *Mikrotoponimia e Karshiakës së Shkupit.* Shkup: 2003.

Kadriu, Sevdail. *Leksiku toponimik dhe patronimik i rajonit të Kumanovës*. Kumanovë: Shqipe, 2004.

Një traditë të kërkimeve etimologjike në fushën e leksikut onomastik dhe sidomos në marrëdhëniet shqiptaro-sllave-maqedonase krijojnë sidomos veprat e studiuesit Qemal Murati. Në këto vepra, më shumë se në studimet e përmendura më parë, materiali onomastik (toponomastik, patronimik e antroponimik) studiohet në rrafshin diakronik përmes gjurmimeve e shpjegimeve të karakterit gjuhësor, historik, dialektor e krahasues. Karakteri etimologjizues i këtyre studimeve, por edhe ai polemizues me studiuesit serbë dhe maqedonas, një traditë kjo e cila nuk ishte edhe aq e pranishme më parë në hulumtimet nga ana e shqiptarëve të Maqedonisë, nxjerrin në pah dëshmime për autoktoninë e shqiptarëve në trojet e Maqedonisë. Të këtij karakteri i kemi veçuar sidomos veprat në vijim:

Murati, Qemal. *Dëshmime onomastike për autoktoninë e shqiptarëve në trojet etnike të tyre në Maqedoni.* Tiranë: Fan Noli, 1993.

Murati, Qemal. *Probleme të gjuhës së sotme dhe historike të shqipes.* Shkup: Asdreni, 1994.

Murati, Qemal. *Shqiptarët dhe Ballkani ilirik në dritën e emrave të vendeve dhe të familjeve.* Tetovë: 1999.

Përveç tjerash, edhe çështja e diktaturës në toponimi dhe jo vetëm, përmes ndryshimeve arbitrare në toponiminë shqiptare nga institucionet shtetërore dhe e censurimit të një sërë emrash vetjakë me karakter kombëtar, megjithëse është prekur edhe në veprat e përmendura më parë, trajtohet sidomos në veprën e radhës së po të njëjtit autor:

Murati, Qemal. *Shqiptarët dhe shqipja në një botë emrash të përveçëm.* Prishtinë: Instituti Albanologjik, 2015.

Nga korpusi i veprave të po të njëjtit studiues domosdo duhen përmendur këtu edhe fjalorët, nga të cilët mbizotërojnë ata dialektorë të trojeve shqiptare në Maqedoni. Në këta fjalorë, krahas pasurisë leksikore të fushave të ndryshme materiale e mendore e frazeologjisë së pasur të ligjërimeve shqiptare të truallit të Maqedonisë, trajtohet edhe leksiku toponomastik e antroponomastik. Leksiku i përzgjedhur onomastik që përfshin toponime përkatësisht topoleksema, antroponime e patronime, trajtohet në aspektin sinkronik e herë-herë edhe në rrafshin diakronik duke dhënë edhe shpjegime etimologjike e duke i trajtuar edhe nga aspekti i kontakteve ndërgjuhësore. Për hapësirën shqiptare në Maqedoni mund të thuhet se këto studime janë të vetmet vepra të kësaj natyre që ndjekin traditën e mbledhjes së thesarit të trashëgimisë materiale e shpirtërore të popullit shqiptar në fushë të gjuhës a folklorit e që përfshijnë edhe material onomastik. Ndonëse këta fjalorë nuk e përfshijnë gjithë pasurinë leksikore dhe sidomos pasurinë leksikore

onomastike të trojeve shqiptare në Maqedoni, siç është rasti për shembull me fjalorët e maqedonishtes,[7] nga lënda onomastike që trajtohet në këta fjalorë autori nxjerr në pah mjaft dëshmi për autoktoninë e shqiptarëve në këto troje përmes shpjegimit gjuhësor me anë të rregullave fonetike dhe gramatikore të gjuhës shqipe tek shumë onoma. Duke trajtuar materialin onomastik të shqiptarëve të Maqedonisë që nga periudhat më të hershme historike, përmes mesjetës e deri te koha më e re, autori dëshmon edhe për bashkëmarrëdhëniet e shqiptarëve me popullsitë sllavojugore maqedonase, turke, arumune etj., e me këtë edhe për faktin se shqipja gjatë periudhave të ndryshme historike në fushë të onomastikës jo vetëm ka marrë, sidomos nga leksiku i fqinjëve me të cilët ka bashkëjetuar, po edhe ka dhënë mjaft. Të kësaj natyre janë fjalorët në vijim:

Murati, Qemal. *Fjalor i shqipes truallsore të Maqedonisë.* Tetovë: 1998.

Murati, Qemal. *Fjalor i fjalëve të rralla të përdorura në viset shqiptare të Maqedonisë.* Shkup: Logos-A, 2003.

Murati, Qemal. *Fjalor toponomastik i tërthoreve shqiptare të Maqedonisë.* Tetovë: Universiteti Shtetëror i Tetovës, 2008.

Murati, Qemal. *Fjalor i fjalëve dhe shprehjeve nga trojet e shqipes në Maqedoni.* Shkup, Instituti i Trashëgimisë Shpirtërore e Kulturore të Shqiptarëve – Shkup, 2015.

Korpusit të veprave që kanë kontribuar në fushë të onomastikës i shtohet edhe vepra tjetër e të njëjtit autor: *Hetime e vjelje për gjuhën shqipe.* Prishtinë: Instituti Albanologjik, 2012*,* e cila para së gjithash trajton probleme në fushë të historisë së albanologjisë, përkatësisht të historisë së gjuhës shqipe dhe në fushë të ballkanologjisë e të marrëdhënieve të shqipes me gjuhët fqinje. Krahas trajtimeve të segmenteve të ndryshme, në këtë vepër një vend të mirë zënë edhe trajtimet etimologjizuese, përveç tjerash edhe në fushë të onomastikës.

Vargut të veprave në të cilat, ku më shumë e ku më pak, e herë edhe në mënyrë simbolike, preken çështje nga onomastika i shtohen edhe veprat me shënime e vëzhgime kulturore-historike, sociologjike, linguistike, etnografike e folklorike, si në vijim:

Murati, Qemal. *Kërçova në traditat e saj të vjetra.* Shkup: Asdreni, 1996.

Murati, Qemal. *Kërçova. Hulumtime gjuhësore, etnografike dhe folklorike.* Shkup: 2008.

Murati Qemal. *Hulumtime linguistike dhe kulturë-historike në etnoregjionin e Rekës së Epërme.* Shkup: Instituti i Trashëgimisë Shpirtërore e Kulturore të Shqiptarëve – Shkup, 2016.

Rustemi, Vebi. *Studime gjuhësore në Dërven të Shkupit.* Shkup: Albesa Vizion, 2012. Xhaferi, Hamit-Bexheti, Vebi-Ibrahimi, Mustafa. *Studime etnolinguistike, folklorike dhe sociolinguistike për kulturën shqiptare në Maqedoni.* Tetovë. 2008.

Në vazhdim do të përmenden edhe disa vepra të tjera me karakter dialektologjik, të shoqëruara me të dhëna të përgjithshme për banorët e vendit e të cilat, edhe pse nuk janë vepra me karakter onomastik, përfshijnë edhe të dhëna

[7] Shih fjalorët e përmendur më parë në tekst.

onomastike, herë me karakter informativ e me të dhëna statistikore, e herë edhe me të dhëna etimologjike të njësive onomastike e me të dhëna rreth formimit të tyre.

Haruni, Sefedin. *E folmja shqipe e Rekës së Epërme të Gostivarit.* Shkup, 1994.

Ibrahimi, Mustafa. *E folmja shqipe e rrethit të Prilepit dhe Krushevës.* Shkup: Interlingua, 2005.

Osmani, Zihni. *E folmja shqipe e Prespës*.Shkup: Flaka e vëllazërimit, 1996.

Osmani, Zihni. *E folmja shqipe e Manastirit dhe e qarkut të tij.* Shkup: Logos-A, 1997.

Poloska, Agim. *Leksiku dialektor në regjionin e Prespës.* Shkup: Asdreni, 2003.

Ymeri, Haki. *E foljma shqipe e Karshiakës*. Shkup: Shkupi, 1997.

Është e natyrshme që angazhimi i studiuesve shqiptarë nga Maqedonia rreth hulumtimit për onomastikën të përmbledh një numër më të madh të artikujve sesa të monografive. Në vazhdim do të japim një pasqyrë të botimit të këtyre artikujve duke u munduar t'i klasifikojmë sipas këndvështrimeve të ndryshme të studimit, por duhet theksuar faktin se është mjaft e vështirë të bëhet një ndarje e prerë sepse shumë prej tyre trajtojnë tema nga më shumë këndvështrime të cilat shpeshherë edhe janë të ndërlidhura ngushtë me njëra tjetrën.

Meqenëse janë më të shumtë në numër, për fillim po japim një pasqyrë të artikujve me vëzhgime historike e linguistike në të cilët materiali onomastik trajtohet si në rrafshin diakronik ashtu edhe në atë sinkronik. Në këta artikuj trajtohet sidomos struktura historike-gjuhësore, etno-historike dhe konfesionale e lëndës onomastike. Çështjet e toponomastikës historike që nga antika, mesjeta e sidomos lënda onomastike e nxjerrë nga të dhënat e defterëve turq, por edhe lënda onomastike që gjallon akoma në arealin e Maqedonisë së sotme, shfrytëzohen sidomos për të argumentuar autoktoninë e shqiptarëve në trojet shqiptare të Maqedonisë. Në këto trajtime, e gjejmë të përfshirë herë arealin e përgjithshëm të Maqedonisë, si në artikujt në vijim:

Abdyli, Ramiz. *Shqiptarët e Maqedonisë sipas të dhënave të defterëve të shek. XV-XVI.* Shqiptarët e Maqedonisë. Shkup: Meshihati i BI në RM, 1994.

Dervishi, Nebi. *Toponimet në trevat lindore shqiptare, dëshmi e padiskutueshme e autoktonisë.* Seminari V Ndërkombëtar i Albanologjisë, USHT, 2011.

Hamiti, Asllan. *Toponimia dhe mikrotoponimia shqiptare në Maqedoni – dëshmi e autoktonisë*. Scupi 5 (2014):101.

Murati, Qemal. *Kërkime të reja etimologjike në fushë të shqipes*. Jehona II/1 (1989):38.

Murati, Qemal. *Kërkime të reja etimologjike në fushë të shqipes* Jehona III/4 (1989):48.

Murati, Qemal. *Emrat vetjakë mesjetarë te shqiptarët e Maqedonisë në dritën e defterëve turke të shekullit XV*. Jehona 2-3 (1992):15.

Murati, Qemal. *Probleme të leksikut toponomastik mesjetar të truallit shqiptar të Maqedonisë.* Shqiptarët e Maqedonisë. Shkup: Meshihati i BI në RM, 1994.

Murati, Qemal. *Etimologji ndryshe për disa toponime dhe patronime.* Gjurmime Albanologjike 36 (2006):133.

Murati, Qemal. *Albanësia e 'provincave onomastike' në arealin e Maqedonisë – dëshmi e autoktonisë së shqiptarëve në këto vise që nga perioda antike e deri sot.* Studime Albanologjike 5 (2012):49.

Murati, Qemal. *Sprovë për një fjalor etimologjik onomastik shqiptar.* Studime Albanologjike 6 (2012):13.

Murati, Qemal. *Sprovë për një fjalor etimologjik onomastik shqiptar*. Studime Albanologjike 7 (2013):7.

Murati, Qemal. *Rreth disa emrave të vendeve në vështrimin e tyre etimologjik.* Studime Albanologjike 9 (2014):13;

e herë rajone a territore të veçanta të saj, si rajonin e Pollogut:

Sulejmani, Fadil. *Toponimia e Malësisë së Tetovës*. Onomastika e Kosovës, Prishtinë: Instituti Albanologjik, 1979;

dhe sidomos rajonin e Rekës së Epërme për të cilin përmes lëndës onomastike dëshmohet edhe asimilimi gradual i popullatës shqiptare atje:

Durmishi, Izmit. *Vështrim i përgjithshëm për ojkonimet e Pollogut dhe të Rekës së Epërme.* Seminari V Ndërkombëtar i Albanologjisë, USHT, 2011.

Murati, Qemal. *Mbi disa patronimika shqiptare të Rekës së Epërme të Dibrës.* Shqyrtime Albanologjike 2 (1996):45.

Murati, Qemal. *Gjuha e humbur.* Studime Albanologjike 3 (2011):87;

pastaj rajonin e Pellagonisë:

Ibrahimi, Mustafa. *Mikrotoponimet e fshatrave të Pellagonisë*. 'Zëri i Pellagonisë' në 10 vazhdime (nga viti 2004-2009).

Ibrahimi, Mustafa. *Shënime diakronike dhe sinkronike të toponimeve shqiptare në rajonin e Pelagonisë.* Alb Shkenca, Aktet IV/4 (2011):694.

Ibrahimi, Mustafa. *Toponomastika shqiptare ndër shekuj në rajonin e Pellagonisë.* Seminari V Ndërkombëtar i Albanologjisë, USHT, 2011;

rajonin e Kërçovës:

Murati, Qemal. *Toponimia e katundit Tuhinë-Kërçovë*. Përparimi 3(1971): 251;

dhe rajonin e Shkupit:

Asani, Skender. *Mbi disa emërtime të lagjeve të Shkupit të shek. XIX-XX.* Scupi 5 (2014):171.

Idrizi, Xhemaludin. *Mbi disa ojkonime të Karshiakës së Shkupit.* Seminari V Ndërkombëtar i Albanologjisë, USHT, 2011.

Idrizi, Xhemalidin. *Për etimologjinë e disa toponimeve të fshatrave të rrethit të Shkupit.* Scupi 5 (2014):43.

Murati, Qemal. *Emri i Shkupit në gojën e shqiptarëve rron prej dy mijë vjetësh.* Studime Albanologjike 8 (2013):35.

Ymeri, Haki. *Mikrotoponimia e Markova-Rekës*. Studime filologjike 1-4 (1993).

Lënda onomastike e arealit të Maqedonisë nga studiuesit shqiptarë të Maqedonisë studiohet jo vetëm si sistem vlerash historike e socio-linguistike po edhe si strukturë gjuhësore. Nuk janë të paktë në numër artikujt që për bazë kanë vëzhgimet gjuhësore e të cilat përfshijnë analiza fonetike, morfologjike e

sintaksore, semantike e leksikore, fjalëformuese etj. Të këtij karakteri i kemi veçuar artikujt në vijim:

Azizi, Hidajete. *Leksiku antroponimik në arealin e Maqedonisë.* Seminari IX Ndërkombëtar i Albanologjisë, USHT, 2015.

Durmishi, Izmit. *Vështrime fonetike mbi toponiminë e Pollogut të Epërm.* Scupi 5 (2014):125

Ibrahimi, Mustafa. *Veçoritë fonetike dhe morfologjike në mikrotoponiminë e vendbanimeve shqiptare të rrethit të Prilepit dhe Krushevës*. Seminari IV Ndërkombëtar i Albanologjisë, USHT, 2011.

Ibrahimi, Mustafa. *Huazimet leksikore në mikrotoponiminë në vendbanimet shqiptare të Pellagonisë.* Malësia (Revistë për kulturë, shkencë dhe çështje shoqërore), 8(2013):367.

Maksuti, Izer. *Mbi hulumtimin e emrave familjarë – disa veçori të krijimit dhe prejardhjes së tyre (me shembuj nga gjermanishtja dhe shqipja).* Seminari IX Ndërkombëtar i Albanologjisë, USHT, 2015.

Murati, Qemal. *Apelativat toponimike në toponiminë e Kërçovës*. Onomastika e Kosovës, Prishtinë: Instituti Albanologjik, 1979.

Murati, Qemal. *Emrat pluralia tantum në leksik e në toponimi.* Gjuha Shqipe 2(1988):23.

Osmani, Ismet. *Toponimia e Dervenit të Shkupit.* Scupi 5 (2014):137.

Në vazhdim kemi veçuar disa trajtime që shtjellojnë tema të përgjithshme nga onomastika, si:

Azizi, Hidajete. *Antroponimia e shqiptarëve të Maqedonisë.* Studime Albanologjike 12 (2015):99.

Hamiti, Asllan. *Antroponimet e shqiptarëve të Maqedonisë.* Seminari I Ndërkombëtar i Albanologjisë, USHT, 2007.

Vinca, Nuhi. *Venerime të përgjithshme onomastike në regjionin e Strugës*. Onomastika e Kosovës, Prishtinë: Instituti Albanologjik, 1979;

dhe tema që trajtohen nga aspekti sociolinguistik që për bazë kanë klasifikimin e antroponimeve sidomos sipas motivimit në bazë konfesionale e etnike të popullatës në Maqedoni:

Azizi, Hidajete. *Identiteti kombëtar dhe fetar në procesin e emërvënies.* Scupi 9 (2015):94.

Pjesë e studimeve onomastike janë bërë edhe krahasimet ndërgjuhësore ku lënda onomastike trajtohet në kuadër të kontakteve të gjuhës shqipe me gjuhët e tjera. Nga ky këndvështrim lënda e onomastikës është prekur jo rrallë edhe në mjaft artikuj të tjerë ku kjo lëndë trajtohet nga këndvështrime të ndryshme, por të këtij karakteri janë sidomos artikujt në vijim:

Murati, Qemal. *Mbi disa elemente të shqipes në nomenklaturën onomastike maqedonase.* Gjuha Shqipe 2 (1989):22.

Murati, Qemal. *Shqipja dhe maqedoarumanishtja nga aspekti i kontakteve midis tyre.* Studime Albanologjike 4 (2001):5.

Murati, Qemal. *Ballkani në nofka e llagape.* Studime Albanologjike 12 (2015):73.

Një pjesë e mirë e artikujve kanë më tepër karakter informativ a përshkrues. Këta artikuj kanë për qëllim evidentimin e materialit onomastik, si atë të vjelë në terren nga goja e popullit, ashtu edhe atë në formën zyrtare. Lënda onomastike në këto prurje përcillet me shënime mbi popullatën e mbi lokalitetet e ndryshme, duke i pasuruar të dhënat nga fusha e onomastikës edhe me të dhëna gjeografike, demografike e dialektologjike. Të këtij karakteri janë artikujt në vijim të cilët evidentojnë lëndë onomastike nga pjesë të ndryshme urbane e rurale të territorit të Maqedonisë, si për Tetovën me rrethinë:

Emini, Besnik. *Disa aspekte të mikrotoponimeve në hapësirën e fshatit Çellopek të Tetovës*. Scupi 5 (2014):185.

Islami, Zulfi. *Material leksikor dhe onomastik nga krahinëza e Malit të Thatë të Tetovës*. Studime Albanologjike 1 (2009): 201.

Salihi, Agron. *Toponimia e fshatit Sllatinë të Tetovës.* Scupi 5 (2014):191;

për Kumanovën me rrethinë:

Halimi, Naim. *Toponimet në rajonin e Kumanovës – dëshmi për autoktoninë e shqiptarëve.* Scupi 5 (2014):157.

Raimi, Sunaj. *Toponimia e qytetit të Kumanovës dhe e disa fshatrave shqiptare përreth.* Seminari V Ndërkombëtar i Albanologjisë, USHT, 2011.

Ymeri, Haki. *Patronimet dhe mikrotoponimet e regjionit të Lipkovës.* Jehona 3 (1985);

për rajonin e Pellagonisë:

Ibrahimi, Mustafa. *Ojkonimet zyrtare dhe ato burimore të shqiptarëve në rajonin e Pellagonisë (Prilep, Dollnen, Resnjë dhe Krushovë).* Scupi 5 (2014):145;

për rajonin e Rekës së Epërme:

Mustafa, Avzi. *Toponimia dhe mikrotoponimia e Rekës së Epërme.* Scupi 5 (2014):9;

e për rrethinën e Strugës:

Sela-Kastarti, Flora. *Toponimet e fshatrave në rrethinën e Strugës.* Seminari V Ndërkombëtar i Albanologjisë, USHT, 2011.

Toponimia dhe antroponimia e ndaluar shqiptare në Maqedoni, përkatësisht ndryshimi me dhunë i toponimisë shqiptare nga ana e institucioneve shtetërore këtu e rrjedhimisht edhe nevoja për standardizimin e toponimisë shqiptare në Maqedoni si dhe censurimi i një numri të madh i emrave vetjakë shqiptarë me karakter kombëtar është një temë për të cilën domosdo është dashur të reagohet e të trajtohet, si në artikujt e radhës:

Dauti, Daut. *Një betejë madhore e fituar në monizëm dhe dështimi në pluralizëm*. Scupi 10 (2015):117.

Ibrahimi, Mustafa. *Toponimet e dyfishtë si shkas i moskuptimeve ndërshtetërore në botën e globalizuar.* Alb Shkenca, Aktet III/ 4 (2009):531.

Ibrahimi, Zeqirija. *Standardizimi i toponimisë shqiptare në Maqedoni.* Scupi 5 (2014):177.

Lita, Qerim. *Pozita e shqiptarëve në RS të Maqedonisë gjatë viteve 1986-1988.* Studime Albanologjike 3 (2011):71.

Murati, Qemal. *E drejta për gjuhën.* Seminari I Ndërkombëtar i Albanologjisë, USHT, 2007.

Murati, Qemal. *Diktatura në toponimi.* Scupi 5 (2014):27.

Selmani, Asllan. *Toponimet sërish po sulmohen nga nacionalizmi shtetëror.* Lobi 27.8.2004.

Sulejmani, Berton. *Përdorimi i toponimeve shqiptare në tekstet shkollore shqipe (1981-1989) të botuar në Maqedoni.* Scupi 5 (2014):165.

Materiali onomastik shpeshherë është trajtuar duke u ndërlidhur edhe me shumë fusha të tjera, si me dialektologji:

Ibrahimi, Mustafa. *Frazema dialektore shqipe me gjymtyrë emra njerëzish.* Seminari VI Ndërkombëtar i Albanologjisë, USHT, 2012;

ashtu edhe me letërsi, ku lënda onomastike trajtohet në kuadër të veprave të ndryshme letrare, si:

Ibrahimi, Mustafa. *Onomat në "Bletën shqiptare" të Thimi Mitkos*. Konferencë Shkencore Ndërkombëtare -195 vjetori i lindjes të Thimi Mitkos. Universiteti "Fan Noli", Korçë (2015):292.

Ibrahimi, Mustafa. *Antroponimet dhe toponimet në strukturën e lirikës shqipe në rajonin e Pellagonisë.* Konferenca shkencore "Java e Albanologjisë", I/4 (2014):231;

me arkeologji:

Pollozhani, Mixhait. *Mbishkrimi me toponimin ALBANOPOLIS i gjetur në Shkup*. Instituti Alb shkenca (2012):144;

me gjeografi, por ku vetëm pjesërisht preken çështjet onomastike, si:

F. Skenderi-H. Meleqi. *Disa veçori fiziko-gjeografike të malit Sharr.* Scupi 3 (2012):101.

Korpusit të veprave onomastike duhet shtuar edhe një fjalor me emra njerëzish, i vetmi i këtij lloji nga studiuesit shqiptarë të Maqedonisë, si:

Agai, Adnan. *Fjalor i emrave vetjakë.* Shkup: Tribuna – Sh, 1995.

dhe një tjetër fjalor, por i botuar në gjuhën maqedonase, si:

Poloska, Agim & Grozdanovska, Zora. *Речник на албанските лични имиња.* Shkup: Tri, 2004.

Krejt në fund do të paraqiten edhe disa nga monografitë e shumta të shkruara për vendbanime të ndryshme të territorit të Maqedonisë në të cilat takohen edhe të dhëna nga fusha e onomastikës të cilat herë-herë janë edhe mjaft sipërfaqësore. Në fakt, nga këto studime në të cilat, përveç tjerash përmenden edhe emrat e vendeve, të lagjeve, të lumenjve, maleve etj., si dhe emrat e njerëzve, të familjeve e të fiseve, mund të mblidhet një lëndë mjaft e pasur onomastike për rajone të ndryshme të Maqedonisë dhe të vlerësohet pasuria e laramania që gjallon në toponiminë me të gjitha nëndegët e saj, dhe në antroponimnë e patroniminë e arealit të përgjithshëm të Maqedonisë. Në vazhdim po i paraqesim vetëm disa prej tyre, si:

Arnori – Kurtishi, Qazim. *Sellca ndër shekuj.* Tetovë, Brezi 9, 2005.

Arnori – Kurtishi, Qazim. *Llaca në rrjedhën e moteve.* Tetovë: 2012.

Bakiu, Baki. *Derveni i Shkupit ndër shekuj.* Shkup, Furkan, 2011.

Dervishi, Nebi. *Livadhia e Strugës.* Tetovë: Tringa, 2008.

Emini, Refet. *Çellopeku gjatë shekujve.* Tetovë, Çabej, 2004.
Etemi, Syrja. *Sllatina (monografi).* Tetovë, Çabej, 2005.
Jakupi, Enis. *Reka vendi im.* Gostivar: Illko, 2007.
Jonuzi-Krosi, Ismet. *Jeta dje dhe sot në Luginën e Pollogut.* Tetovë: 2006.
Qyra, Zejnulla. *Veleshta në histori.* Strugë: 2000.
Sulejmani, Shaip. *Debreshi nëpër shekuj (dëshmi dhe rrëfime).* Shkup: 2004.
Shabani, Fejzulla-Dervishi, Nebi. *Reçani i Pollogut të Epërm.* Strugë: IRIS, 2015.

Dhe për fund po theksojmë se qëllimi ynë për të dhënë një pasqyrë të përmbledhur për angazhimin dhe prurjet e studiuesve shqiptarë nga Maqedonia për fushën e onomastikës mund të mos jetë realizuar plotësisht. Kjo nga fakti se mund të jenë bërë lëshime e të mos jetë përfshirë i tërë korpusi i punimeve të kësaj natyre, sado që jemi munduar që në këtë përmbledhje të përfshijmë të gjitha ato punime të cilat, qoftë edhe në mënyrë simbolike, kanë prekur çështje nga fusha e onomastikës shqiptare e arealit të Maqedonisë. Sidoqoftë, shpresojmë që pasqyra e njësive bibliografike e paraqitur në këtë përmbledhje të jetë një ndihmë, qoftë edhe modeste, sidomos për ata të cilët në të ardhmen do të merren me studime onomastike për të cilat shkenca albanologjike, sidomos në Maqedoni, ka nevojë të madhe.

HAREDIN XHAFERI

LOKUCIONET ME VLERË PËREMRI NË GJUHËN SHQIPE

Në gjuhë grupet e qëndrueshme të fjalëve përdoren me vlerën e një fjale. Ato kanë vlerën e një pjese të caktuar të ligjëratës. Një grup i tyre ka vlerë përemri. Ky grup lokucionesh nuk është pasqyruar në literaturën tonë gjuhësore.

I. D. Sheperi te përemrat lidhorë ka dalluar lokucionet aý që (atij që etj. ajò që etj.), kushdò që, cilidò që etj.[1] Këto lokucione i ka pasqyruar edhe O. Myderrizi.[2]

M. Domi ka tërhequr vëmendjen për t'u parë edhe çështja e lokucioneve përemërore. "Ndonjëherë, - ka shkruar ai, - bashkimi i dy përemrave (përemër i pakufishëm, përemër lidhor) ka shpënë ose po shpie në formimin e një përemri të vetëm, që mund të merret fare mirë si lokucion përemëror, si p. sh. në raste si: gjithë sa (qenë aty u çuditën)", "çfarëdo që t'i shkruash, ai s'turbullohet", "çdo që t'i thuash, ai e bën." Janë për t'u parë edhe rastet si: "kush e di sa", "kush e di (se) kush," që përdoren për të shënuar sasi, vehtje, sende etj. me një farë përcaktuarësie."[3] Më parë ky studiues grupe të tilla i ka quajtur togje përemërore, të cilat mund të merren si përemra lidhorë të përbërë me kuptim përgjithësues. Listës së mësipërme i shtohen: tërë sa, tërë ç', gjithë ç.'[4] Këto grupe janë pasqyruar si shembuj në gramatika, pa i trajtuar gjerësisht. Këtë pohim e ka mbështetur edhe A. Spahiu. Ai u ka shtuar shembujve të mësipërm edhe: gjë që, ai që, kushdo që, cilido që.[5] K. Cipo strukturat kushdo që dhe cilido që i ka shkruar bashkë dhe i ka quajtur përemra të pacaktuar me forcën e përemrit lidhor, [6] ndërsa përemrat i cili, e cila i ka quajtur lokucione përemërore.[7]

Në Gramatikën e gjuhës shqipe, II janë marrë si lokucion: gjithë sa, gjithë ç' (f. 506), gjë që (f. 532); si përemra lidhorë të pacaktuar: kushdo që, cilido që, çfarëdo që (f. 598) dhe si përemra të pacaktuar: kushdo, cilido, çfarëdo, të ndjekur ose jo nga një që ekspletive (f. 600). Siç shihet, edhe brenda një teksti nuk është mbajtur i njëjti qëndrim.

---

[1] I. D. Sheperi, *Gramatika dhe sindaksa e gjuhës shqipe,"* 1927, f. 68

[2] O. Myderrizi, *Gramatika e ré e shqipes,* Për shkollat e mesme, Vëllimi I (Fonologji e morfologji), Tiranë, 1944, f. 114

[3] M. Domi, *Disa çështje të lokucioneve*, SF, 1, 1985, f. 216

[4] Po ai, *Mbi një tip strukturor të fjalive të varura,* Studime filologjike, 4, 1970, f. 22, shën. 2

[5] A. Spahiu, *A përbëjnë lokucionet një mënyrë të veçantë fjalëformimi*? Gjuha jonë, 1 - 4, 2005,
f. 164

[6] K. Cipo, *Sintaksa,* 1952, f. 35

[7] Po aty, f. 93

I pari që nuk i ka pranuar disa nga këto struktura si lokucione, ka qenë M. Totoni. Për togun gjë që (emër + përemër) ai mendon se emri gjë e ruan kuptimin e tij dhe kryen funksionin e ndajshtimit në fjalinë kryesore ose në një pjesë të saj.[8] Te togjet kushdo që, çfarëdo që, cilido që ky studiues veçon përemrat si gjymtyrë (kryefjalë, kundrinorë a përcaktorë) në fjalinë e nënrenditur dhe pjesëzën që me vlerë aktualizuese.[9] Këtë qëndrim e ka mbështetur gjetkë edhe autori i këtij artikulli.[10]

Lokucionet përemërore zakonisht kanë shkallë të ulët qëndrueshmërie të elementeve përbërëse. Ato janë grupe të pakta, të formuara nga përsëritja e një fjale ose nga lidhja e dy fjalëve të ndryshme.[11] Këto lokucione kanë strukturë jotogfjalëshe ose togfjalëshe.

I. Lokucionet me strukturë jotogfjalëshe

Janë grup më i pasur. Ato janë formime me fjalë të ndryshueshme dhe të pandryshueshme. Këto të fundit mund të jenë një lidhëz ose një parafjalë.

1. Lokucione të formuara nga dy fjalë shënuese dhe një fjalë shërbyese. Janë më të shumta. Këto lokucione janë formuar nga përsëritja e një fjale ose nga dy fjalë të ndryshme, të lidhura me lidhëzën e.

1. 1. Lokucionet e formuara me përsëritjen e një fjale shënuese janë më të shumta. Fjala që përsëritet është një përemër ose një emër.

a. Lokucionet e formuara me përsëritjen e një përemri kanë në strukturë dy forma të njëjta të një përemri të pacaktuar, i cili tregon frymor a send të pacaktuar ose sasi të pacaktuar frymorësh a sendesh. Më rrallë mund të përsëritet edhe një përemër pyetës.

- Lokucioni kush e kush është formuar nga përsëritja e përemrit të pacaktuar kush. Të dy format lidhen me lidhëzën këpujore e. Forma e dytë përdoret me kuptim përforcues. Lokucioni tregon frymor a send të veçantë. P. sh. Njerëz që më përpara në bisedat me mua kishin nxjerrë nga goja sharjet dhe shpifjet më të ndyra për Zogun, tani konkurronin **kush e kush** t'i lëpihej më shumë e të fitonte dashamirësinë e tij.
- Lokucioni ca e ca është formuar nga përsëritja e përemrit ca dhe tregon sasi të kufizuar frymorësh a sendesh. Forma e dytë përdoret me kuptim përforcues. P. sh. Krahina ishte e varfër, po **ca e ca** jetonin mirë, se kishin fëmijët në kurbet. Gjatë përdorimit te kjo strukturë ndryshon vetëm forma e dytë: **Ca e cave** nuk u vinte mirë nga fjalët e teknikut të turnit. Me këtë formë përdorimi del edhe

[8] M. Totoni, *Zhvillim i brendshëm dhe ndërtim i huaj,* Gjuha jonë, 1, 1988, f. 56 - 58

[9] Po ai, *Fraza me nënrenditje*, 2000, f. 24 - 25

[10] *Sintaksë e gjuhës shqipe*, 2009, f. 299 - 300

[11] Për strukturat me elemente të lidhura me vizë pajtohemi me qëndrimin e mbajtur në Gramatikën e gjuhës shqipe, I, 1995 (f. 255, 257) ose në fjalorët e ndryshëm.

lokucioni sa e sa, i formuar nga përsëritja e përemrit sa. P. sh. **Sa e save** nga këto pjesë të bukura simfonike e vokale nuk u është dhënë mundësia të luhen vetëm një herë. Ndryshimi i këtyre strukturave tek elementi i dytë u jep atyre tiparet e një fjale të vetme.

- Lokucionet kaq e kaq, aq e aq, shumë e shumë etj. janë formuar me përsëritjen e një përemri. Forma e dytë përdoret për përforcim. Janë struktura me shkallë qëndrueshmërie të ulët dhe përdoren për të treguar sasi të madhe frymorësh, sendesh etj. P. sh. Aktorin e talentuar Timo Flloko shikuesit tanë e kanë parë në **shumë e shumë** role. Kanë kaluar **kaq e kaq** vite dhe ajo ngjarje është e freskët në mendjet e njerëzve të këtyre anëve. Po kështu, këtu e ka pasur vatrën edhe qëndresa më e madhe kundër reformave të Tanzimatit, e dëshmuar në **aq e aq** këngë popullore. - Ka ardhur edhe **shumë e shumë** herë të tjera, po mendjen nuk ma ka mbushur, - tha ai.
- Lokucioni ç'... e ç' është formuar nga përsëritja në distancë e përemrit pyetës ç. Dy format e përemrit formojnë togje me të njëjtën folje, të cilat janë të lidhura me lidhëzën këpujore e. Forma e dytë përdoret në kuptim mohor. Gjithë lokucioni tregon tërësi të pacaktuar frymorësh a sendesh. P. sh. Ti na zhveshe nga **ç**'kishim e **ç**'nuk kishim.

b. Lokucionet e formuara me përsëritjen e një emri, kanë në strukturë dy forma të njëjta të një emri me orgjinë numërori a me përmbajtje të tillë, si: dhjetëra e dhjetëra, qindra e qindra, mijëra e mijëra etj. Forma e parë tregon sasi të pacaktuar frymorësh a sendesh, ndërsa forma e përsëritur shpreh rritjen e sasisë në mënyrë të pacaktuar. P. sh. Nuk e di pse i erdhi në mend ajo Përralla e pyllit, që ia kishte treguar gjyshja **dhjetëra e dhjetëra** herë netëve të dimrit, para se ta zinte gjumi. Por zakoni i rrënjosur në **qindra e qindra** vjet nuk mund të hiqej me një dekret. Flakët fërfëllonin dhe më dukej sikur ato murmuronin **mijëra e mijëra** fjalë misterioze të kuqe, të ngjashme me njëra - tjetrën.

1. 2. Lokucionet e formuara nga dy fjalë shënuese të ndryshme, kanë në strukturë dy emra ose dy përemra. Fjalët shënuese mund të kenë lidhje semantike ose mund të jenë pa një lidhje të tillë.

a. Lokucionet e formuara nga dy fjalë shënuese me lidhje semantike nuk përbëjnë shumicë.

- Lokucionet çikën e pikën, nam e nishan janë formuar nga dy emra të ndryshëm me ose pa lidhje semantike. P. sh. Ta hedhim atje poshtë në greminë. Nuk i mbetet **nam e nishan.** Lokucioni i dytë përdoret vetëm në fjali mohore.
- Lokucioni çmos e çnuk është formuar nga dy përemra të ndryshëm. Ai shpreh tërësi të pacaktuar. Janë ndërtime mjaft të rralla. P. sh. Pastaj do të thoshin diçka edhe ata dhe ai **do të bënte çmos e çnuk** të merrte vesh se cilët ishin dhe përse i kishin mbyllur këtu.

b. Lokucionet e formuara nga fjalë shënuese që nuk kanë lidhje semantike me njëra - tjetrën kanë fjalë kuptimplota një përemër dhe një emër. Përemri përbën temën semantike të lokucionit. Emri me parafjalë ka kuptim përforcues. Të tilla janë: asnjë për be, asnjë për farë, asnjë për shenjë etj. P. sh. - Ore! Po ti e paske dredhur të gjthë gorricën dhe s'paske lënë **asnjë për shenjë!** - tha Nushi i pikëlluar. - Jo, jo. Kam lënë ca degë në majë, se aty s'ma mbante të hipja.

2. Lokucionet e formuara nga dy fjalë shërbyese dhe një fjalë shënuese. Janë më të pakta. Këto lokucione kanë element të parë pjesëzën kushedi, të ndjekur nga lidhëza se dhe një përemër, i cili mban peshën kryesore kuptimore të lokucionit. Të tilla janë strukturat kushedi se sa, kushedi se kush, kushedi se çfarë, kushedi se ç' etj. Në fillim kjo njësi ka funksionuar si fjali e përbërë. Duke i humbur tiparet e saj, funksionon si një njësi e vetme me vlerën e një përemri me kuptim të pacaktuar. P. sh. Përmendte edhe emra që ata s'i kishin dëgjuar dhe përsëriti **kushedi sa** herë se në këtë orë aty nuk gjen njeri. - **Kushedi se kush** i ka pëshpëritur në vesh dhe na hedh vizgla, - tha Qemali i zemëruar. Në jetë u ndesha me shumë njerëz, ngjarje e u lidha me marrëdhënie të ndryshme, që e zvogëluan peshën e një ngjarjeje, e cila në rini më ishte dukur **kushedi se çfarë** (diçka). Lidhëza në gjuhën e folur edhe mund të mos përdoret. P. sh. Ata sy s'thoshin dot asgjë dhe fshiheshin si të trembur nën qerpikët e gjatë ose gjurmonin ndonjë gjë përdhe, të thuash **kushedi ç**' kishte humbur.

3. Lokucione të formuara nga tri fjalë shërbyese dhe dy fjalë shënuese. Këto lokucione kanë në strukturë një parafjalë të përsëritur dhe një lidhëz. Të tillë janë lokucionet me laçkë e me plaçkë, me kuç e me maç, me bakra e me çakra, me cull e me mull etj., që janë formuar nga dy emra të ndryshëm të paraprirë nga parafjala me dhe të lidhur me lidhëzën e. Çdo element i kësaj strukture është i domosdoshëm dhe e gjithë njësia tregon tërësi të pacaktuar frymorësh a sendesh. P. sh. Atëherë ai niset për udhë **me kuç e me maç,** madje edhe me një pjesë të shërbëtorëve. I mori **me laçkë e me plaçkë** dhe u largua nga shtëpia.

II. Lokucionet me strukturë togfjalëshe

Përbëjnë grup të vogël. Lidhjet e elementeve përbërëse janë nënrenditëse të pandërmjetme ose të ndërmjetme. Struktura e tyre është e ndryshme.

1. Lokucionet e formuara nga fjalë shënuese + fjalë shënuese janë të pakta. Fjalët përbërëse mund të jenë të së njëjtës kategorie leksiko - gramatikore ose të kategorive të ndryshme.

a. Lokucionet e formuara nga dy fjalë të së njëjtës kategorie leksiko - gramatikore janë të pakta.

- Lokucionet gjithë sa, gjithë ç', tërë sa etj. janë formuar nga bashkimi i dy përemrave të pacaktuar. Raportet brenda këtyre strukturave janë varësie. Shkalla e qëndrueshmërisë së elementeve është e ulët. Këto lokucione janë barazvlerëse me përemrat të gjithë, gjithçka. P. sh. Pas bombës që hodhi Zeqoja në oborr, u dorëzuan menjëherë **gjithë sa** vërtiteshin brenda në kullë e rreth veturës. Po ja, fundja, edhe për t'u treguar partizanëve **gjithë ç'** kemi parë më sy këto ditë. **Tërë sa** ishin, kur morën vesh atë të papritur, u mblodhën përqark kullës së komandimit.

- Lokucionet e bija e botës, gruaja e botës i biri i botës, burri i botës etj. kanë në strukturë një emër që i përket sferës familjare dhe emrin botë, i cili i jep lokucionit kuptim të pacaktuar. P. sh. Këto ka shkolla, ka të mira plot, po ka dhe të këqia. Hidhet **burri i botës** dhe të rrëmben macen.

b. Lokucionet e formuara nga dy fjalë të kategorive të ndryshme leksiko - gramatikore janë të rralla. Lokucionet sinonime: një pjesë, një takëm, një sërë, një palë[12] etj., janë formuar nga lidhja e numërorit një me një emër që emërton një grup frymorësh a sendesh. Emrat kanë lidhje semantike midis tyre. Numërori e ka humbur kuptimin, ndërsa emri zakonisht e ruan atë. Gjithë shprehja e merr kuptimin nga emri dhe tregon sasi të pacaktuar, por të kufizuar frymorësh a sendesh. Këtë e shpreh gramatikisht edhe përdorimi i kallëzuesit në numrin shumës. P. sh. **Një pjesë** nuk donin të qëndronin edhe një natë në atë fshat. Për **një takëm** si unë, që kanë motra në shtëpi dhe nuk pyesin për llafet e Korçës, një ilaç ka: të sevdalliset ndonjë djalë për të qenë, t'u japim uratën e të shkojnë në punën e tyre. Sidoqoftë, në radhët e shqiptarëve të Greqisë shquhen **një sërë** patriotësh të flaktë. Turqit vetë ndaheshin në dy kategori: **një palë** ishte e zemëruar, që shpiptarët muslimanë tani papritur kërkonin të drejta të veçanta, **një palë** tjetër qeshnin me përtallje dhe mishërim me shqiptarët, të cilëve, prej kohësh, "u kishte ngrënë lopa librin" ...

- Lokucionet një çikë, një grimë, një fije etj. janë formuar nga numërori një[13] dhe një emër me përdorim të drejtpërdrejtë. P. sh. - Po do t'ia ujdisim qejfin sonte këtij kuqaloshi me **një çikë** raki kumbulle të zier dy herë, se gjelin më të majmë e rakinë më të mirë për miq të rrallë e mbaj, - tha Zeqiri.
- Lokucionet aq gjë, kaq gjë, pak gjë, ndonjë gjë (send), çdo gjë etj. janë formuar nga një përemër i pacaktuar dhe emri gjë, me kuptim të përgjithësuar. Brenda lokucionit emri nuk mund të lidhet me përcaktues të tjerë. Lokucionet tregojnë sasi të pacaktuar frymorësh a sendesh. P. sh. - Ndryshe mund të ishte sikur mos t'i kishin sjellë në errësirë. Makar të kishte një fije drite. Të shihja se ç'fytyra

[12] Struktura *një palë* në veprën "Fonetika dhe gramatika e gjuhës së sotme letrare shqipe," II, 1976
është trajtuar si përemër i pacaktuar dhe është shkruar si tog dhe si një fjalë e vetme (f. 219). Në fjalorët shpjegues nuk është pasqyruar.

[13] Në Fjalorin e gjuhës së sotme shqipe për këto struktura janë dhënë kuptime të ndryshme. Struktura *një çikë* del si ilustrim pas kuptimeve 2 dhe 3 të emrit *çikë*, si "Një sasi ose një pjesë fare e vogël nga diçka, një pakicë, një grimë" dhe si "Pjesë kohe shumë e vogël, kohë e shkurtër që zgjat shumë pak." Për fjalën *një* nuk jepet sqarim (f. 260). Për strukturën *një fije* te kuptimi 5 i emrit *fije* jepet shpjegimi "Sasi shumë e pakët e diçkaje, një pakicë, një çikë (me nyjen joshquese *një*.) *Një fije bukë. Një fije ujë. Kam një fije dyshim (shpresë*)" (f. 468). Fjala *një* është quajtur nyjë joshquese. Struktura *një grimë* është përdorur për ilustrim te kuptimi 3 i emrit *grimë* (përdorim ndajfoljor), si "Shumë pak, një thërrime, një fije (përdoret së bashku me numërorin *një*). *Një grimë. Për një grimë* a) për shumë pak kohë; b) për pak gjë. *Në një grimë* në çast. *Një grimë herë. Një grimë shpresë. Prit një grimë!*" (f. 574) Këto lokucione kanë vlerën e një përemri kur përdoren në bashkëvajtje me një emër.

kanë. Ja, **kaq gjë**, - mendoi Asafi. - Ka **ndonjë gjë**? - pyeti Bilbili. - Këtu është një kope me lakuriqë nate. Njëri prej tyre, që ecte sikur të kishte susta te thembrat e këmbëve, trupmadh, pyeste dendur për **çdo gjë** që i nevojitej.

- Këtu përfshihen edhe lokucionet gjithë bota, gjithë fshati, gjithë fisi etj., të formuar nga përemri (i, e) gjithë dhe një emër që ka edhe kuptim përmbledhës. Të dy elementet kanë kuptimin e tërësisë së pacaktuar. P. sh. - Po këtë e paska marrë vesh **gjithë bota!** - shprehu habinë ai.

2. Lokucione që kanë në strukturë fjalë shënuese + fjalë shërbyese + fjalë shënuese. Janë të rralla. Fjalët shënuese janë përemra, ndërsa fjala shërbyese është parafjalë. Të tilla janë lokucionet sinonime gjë prej gjëje, asgjë prej gjëje, që janë formuar nga një përemër i pacaktuar që përdoret në fjalitë mohuese ose ka kuptim mohues dhe emri gjë në rrjedhore me parafjalë. Strukturat kanë kuptimin e përemrit të pacaktuar asgjë. Forma e dytë përdoret në trajtë të ngurosur, duke e humbur kuptimin e së tërës. Forma e parë mund të përdoret edhe jashtë lokucionit me atë kuptim që ka lokucioni. P. sh. - Ju jini humbësira, - tha, - kurse xhaxhai ka dy barrë mend më shumë se ne të gjithë, po, ngaqë jini aguridhe, s' kuptoni dot **gjë prej gjëje**. Sa herë që hynte në dhomën e bukur, me krevat të gjerë, me qilim e plot kolltukë, sytë i visheshin e pothuaj nuk shquante **asgjë prej gjëje**.

Lokucionet me vlerë përemri nuk përbëjnë shumicë, megjithatë, ato janë një grup i veçantë i lokucioneve në gjuhën shqipe. Megjithëse janë jo të shumta, këto lokucione shfaqin interes për studim në aspektin strukturor dhe semantik. Hulumtimet e ardhshme do ta pasurojë më tepër këtë grup lokucionesh.

NJERIU QË DINTE GJITHÇKA



Shkrimtari i njohur italian jetoi i ndarë mes botës akademike dhe asaj letrare, ndërsa u përpoq të krijonte një ndërthurje tërheqëse të të dyjave, pavarësisht kritikave. Ai shiti miliona kopje të librave të tij, duke i bërë lexuesit të mos lëshonin nga duart romanet e tij, me misterin që përcillte pavarësisht ngarkesës shpjeguese të simboleve, shenjave dhe kulturave

Umberto Eko, një shkollar në fushën e errët të semiotikës, që u bë autor i suksesshëm romanesh, mbi të gjitha me veprën "*Emri i Trëndafilit*", vdiq më 19 shkurt në Itali. Ai ishte 84 vjeç.

Si një semiotikan, Eko kërkoi të interpretonte kulturat përmes shenjave dhe simboleve të tyre – fjalëve, ikonave fetare, banerave, veshjeve, notave muzikore dhe madje edhe filmave vizatimorë. Ai ka publikuar mbi 20 libra mbi këto çështje ndërsa jepte mësim në Universitetin e Bolonjës, më i vjetri në Europë. Por në vend që të veçonte jetën e tij akademike nga krijimtaria e tij popullore, Eko përfshiu në shtatë romanet e tij shumë prej shqetësimeve të veta akademike.

Në bashkimin e këtyre dy botëve, ai nuk ka qenë kurrë më i suksesshëm sesa tek "*Emri i Trëndafilit*", romani i tij i parë, që u publikua në Europë në vitin 1980.

Suksesi qe i madh dhe ai shiti më tepër se 10 milionë kopje në rreth 30 gjuhë dhe pati edhe një adaptim kinematografik në Hollivood. Libri tregon për ngjarjet që ndodhin në një manastir italian në shekullin 14, kur murgjit vriten nga besimtarë të tjerë duke risjellë bukur një qasje filozofike të Aristotelit, harruar kohë më parë. Në një intervistë për "Vogue" në vitin 1995, Eko pranoi se ai nuk ishte i lehtë për t'u lexuar. "Njerëzit gjithnjë më pyesin, 'si është e mundur që romanet tuaja, që janë kaq të vështira, kanë një lloj suksesi?'", tha ai.

"Më ofendon kjo pyetje. Është si të pyesësh një grua 'si është e mundur që burrat tërhiqen prej teje?'", sqaroi Eko, i cili e përfundoi përgjigjen me një dozë ironie: "Unë vetë i kam qejf librat e thjeshtë, sepse ata më vënë në gjumë". Ndërsa Eko pati shumë ithtarë në botën akademike dhe në letërsi, kritikë nga të dyja sferat ndonjëherë e shpërfillnin atë për mungesë të seriozitetit akademik ose të talentit rrëfimtar.

"Asnjë artefakt kulturor nuk është shumë i ulët apo i parëndësishëm për analizën e Ekos", shkroi për "The Guardian", Ian Thomson, një biograf letrar, duke komentuar për esetë e Ekos për mënyrën sesi besëtytnitë kanë ndryshuar historinë. Ndërkohë, kritikës therëse të shkrimtarit iranian, Salman Rushdie, për romanin "lavjerrësi i Focault-it", ai iu përgjigj me stil. Në një diskutim letrar në Nju Jork, ku ishin të ftuar dy autorët, italiani zgjodhi që të lexonte pikërisht disa paragrafë të veprës së tij "Lavjerrësi i Focault-it"

Ai i ka mirëpritur kritikat ndaj tij duke thënë se nuk ishte një fundamentalist dhe se çdo gjë ishte perfekte në kontekstin e saj. Eko mund të jepte leksione në pesë gjuhë moderne, si dhe në latinisht dhe greqishten klasike. Ai i ra kryq e tërthor Atlantikut për konferenca akademike, promovime e diskutime librash dhe festa koktejesh të personave të njohur. Por nga ana tjetër, atij i pëlqente edhe të pinte verë të lirë dhe të shkëmbente batuta me studentët e tij natën vonë në tavernat e Bolonjës.

Ai dhe gruaja e tij gjermane, Renate Ramge, një profesoreshë arkitekture dhe e artit, kishin apartamente në Paris, Milano dhe një çiflig të shekullit 17 në Rimini, mbi detin Adriatik. Ata patën dy fëmijë, Stefanon, një producent televizioni në Romë dhe Karlotën, një arkitekte në Milano. Umberto Eko lindi më 5 janar 1932, në Aleksandri, një qytet industrial në veriperëndim të Italisë. Babai i tij, Xhulio, ishte një llogaritar në një firmë metalesh ndërsa e ëma, Xhovana ishte nëpunëse atje. Në fëmijëri, ai kalonte orë të tëra në qilarin e gjyshit, duke lexuar koleksionin e librave të tij. Gjatë diktaturës së Benito Musolinit, ai mban mend të ketë veshur një uniformë fashiste dhe të ketë fituar çmimin e parë në një konkurs shkrimi për fashistët e rinj. Eko pati një lidhje të fortë me fenë, për të cilën mbrojti edhe tezën e doktoraturës në 1956, por ishte gjithashtu i lidhur me filozofinë dhe semiotikën, për të cilat dha mësim në Universitetin e Bolonjës. Ai fitoi famë në Itali për kolonat e përjavshme për politikën dhe kulturën në revistën më të famshme "L'Espresso".

Por ishte botimi "Emri i Trëndafilit" ai që i dha Ekos njohje botërore. Pas romanit të parë, të tjerët që pasuan nuk u pritën me të njëjtën dëshirë.

Ato u kritikuan, e megjithatë, romanet e Ekos vazhduan të shiten me miliona pas krijimit të lexuesve të devotshëm. Janarin e shkuar, u botua dhe romani më i ri i Ekos, "Numri Zero", historia e të cilit zhvillohet në vitin 1992 dhe trajton një

shkrimtar fantazmë që përfshihet në botën e politikave të medias dhe konspiracioneve për vrasje në lidhje me ish-diktatorin Benito Musolini. Ky i fundit u përfol se nuk vdiq në 1945, por jetoi në hije për dekada me radhë. Eko ka marrë çmimin më të lartë letrar të Italisë, "Premio Strega", është nderuar si Kalorës i Legjionit të Nderit nga Franca dhe është një anëtar nderi në Akademinë Amerikane të Arteve dhe Letrave. Ndërsa ai vazhdoi t'i habiste kolegët e tij akademikë me famën e tij të kulturës pop, Eko nuk shihte kontradiktë në statusin e tij të dyfishtë. "E shoh veten si një profesor serioz, i cili gjatë fundjavës, shkruan romane", ka thënë ai.

http://www.nytimes.com/
Shkurt, 2016

SHPËTIM ÇUÇKA

UMBERTO EKO – VËSHTRIM PËRMES PËRKTHIMESH E LEXIMESH

Shqetësimet e Umberto Ekos janë shqetësime jo thjesht ekzistenciale, por kulturore, qytetërimore, janë shqetësime të mbartura nga shekujt dhe jo thjesht çështje të jetesës e të përditshmërisë, janë shqetësime, të cilave ai nuk rreket t'u gjejë një shpjegim e – aq më pak – t'u parashohë ecurinë në të ardhmen, por synon t'i shtrojë në trajtë pikëpyetjesh para gjithë shoqërisë së vendeve të Evropës Perëndimore

Ndarja nga jeta e shkrimtarit dhe studiuesit italian Umberto Eko u shoqërua me shkrime dhe komente të shumta në shtypin e huaj. Spikasnin në to mënyrat e ndryshme të vështrimit të krijimtarisë së tij, përgjithësimet e ndryshme të nxjerra prej saj, vlerësimet – në tërësi pozitive – të bëra me nuancime të ndryshme. Ky fakt do të thotë, ndër të tjera, se edhe ne në Shqipëri kemi mundësinë – dhe jo vetëm të drejtën – për ta parë dhe për ta vlerësuar këtë figurë të kulturës italiane e më gjerë sipas këndvështrimit tonë.

Nuk do të kishte qenë nevoja për këtë hyrje të shkurtër, pra, për mundësinë, të drejtën dhe nevojën për ta parë Umberto Ekon me sytë tanë, sikur jeta e përditshme të mos na dëshmonte se sa pak shfrytëzohet te ne kjo e drejtë, mundësi dhe nevojë për të dhënë opinione të mbështetura në këndvështrimin tonë kulturor, se sa dendur te ne qëllon që thjesht të përtypen dhe ripërtypen teza të huazuara jo vetëm brendapërbrenda por edhe – e kryesisht – nga jashtë. E veçanta, sipas meje, e këndvështrimit tonë kulturor – në rastin konkret në lidhje me Umberto Ekon – qëndron në faktin që Shqipëria ndodhet në lindje dhe në jug të atij vendi dhe asaj hapësire politiko-gjeografike, ku u formua, jetoi dhe krijoi Umberto Ekoja, qëndron në faktin që Shqipëria ka një histori politike, ekonomike dhe kulturore aq të ndryshme nga ajo pjesë e gadishullit evropian, ku e bëri jetën dhe e zhvilloi veprimtarinë Umberto Ekoja.

Gjëja e parë që meriton të thuhet është se Umberto Ekoja zë një vend të veçantë në kulturën e Italisë, përkatësisht në letërsinë italiane. Ky vend i tij i veçantë në botën kulturore dhe letrare të Italisë ka lidhje me mesazhet e shumta dhe të shumanshme, që ai ka shpërndarë nëpër veprat e tij. Dhe thelbi i kësaj veçantie do të mund të përmblidhej fare mirë në karakterizimin: Umberto Ekoja është evropianoperëndimor si shkrimtar dhe si studiues, është evropianoperëndimor për nga bindjet e qëndrimet qytetare e politike.

Elementet themelore të kulturës evropianoperëndimore janë: Racionalizmi; pragmatizmi; universalizmi; misticizmi. Renditja e këtyre elementeve në radhë

parësie ka qenë e ndryshme në epoka dhe vende të ndryshme. Dikush mund të pyesë: "A nuk duket se ka kundërthënie ndërmjet këtyre elementeve?" Po, është e vërtetë! E gjithë historia e Evropës Perëndimore është dëshmi e qartë e veprimeve dhe e doktrinave të mbrujtura me kundërthënie të brendshme. Epoka e sotme është gjithashtu një dëshmi e qartë e kësaj natyre kundërthënëse të kulturës dhe qytetërimit evropianoperëndimor.

Në veprën e Umberto Ekos çdo lexues sadopak i vëmendshëm do të dallojë një gërshetim të linjave të racionalizmit, pragmatizmit dhe misticizmit, të gjitha të vendosura në një shtrat universalizmi. Vlen të kujtojmë këtu për plotësim të tablosë se termi "universalizëm" vjen nga latinishtja "universalis" (i gjithëmbarshëm, i përgjithshëm, gjithëpërfshirës, ose – me një fjalë të modës – global), kuptim që e vëllazëron atë term me termin tjetër "katolik", i cili rrjedh nga greqishtja "katholikos" (i gjithëmbarshëm, gjithëpërfshirës).

Në veprën e Ekos ndeshen edhe elemente të liberalizmit dhe të majtizmit të moderuar, të modernizmit dhe postmodernizmit, të estetizmit, enciklopedizmit dhe sinkretizmit shkencor e parashkencor (alkimizmit, magjisë), shkurt, një koktej i të gjithë përbërësve kryesorë të kulturës evropianoperëndimore në shekuj. Nuk mungojnë as elemente të tjera që kanë të bëjnë sidomos me kulturën politike dhe që këtu po lihen pa u përmendur. Vlen gjithsesi të përsëritet: Syrit të një lexuesi të vëmendshëm të gjitha këto shenja, elemente e gjurmë – të përmendura apo të lëna këtu pa u përmendur – nuk i shpëtojnë.

Pikërisht rreth këtyre elementeve, linjave, mesazheve, që nuk janë tipike për pjesën më të madhe – dhe, të themi, klasike – të letërsisë dhe kulturës italiane, pikërisht rreth këtij tipari të përgjithshëm të veprës së Umberto Ekos u përmblodhën vlerësimet që u bënë këto ditë me rastin e ndarjes së tij nga jeta.

Në veprat e Umberto Ekos vihet re edhe një tipar, të cilin vetë ai e ka përmbledhur diku me fjalët: "*Unë nuk e kam më lirinë e të pasurit një pikëpamje*." Prirja për të mos bërë vlerësime, për të mos shfaqur pikëpamje, për të mos mbajtur anë lidhur me një çështje të caktuar, objektivizmi përbën një tjetër tipar dallues të kulturës evropianoperëndimore. Këtu nuk është aq fjala për lirinë e të pasurit një pikëpamje, sa për lirinë e të shprehurit të asaj pikëpamjeje, veçanërisht kur një pikëpamje e caktuar mund të tingëllojë si paradoksale, domethënë kur ajo vjen ndesh me atë që përgjithësisht njihet si opinion publik ose – që është në thelb e njëjta gjë – kur vjen ndesh me të ashtuquajturin gjykim i shëndoshë.

Ka edhe diçka tjetër që ia vlen të theksohet lidhur me veçantinë e veprës së Umberto Ekos: Veprimi në krijimet e tij, ndryshe nga ç'ndodh me pjesën më të madhe të letërsisë italiane, nuk qëndron brenda kufijve të Italisë. Kjo dalje e veprimit përtej kufijve shtetërorë në veprat e U. Ekos na paraqitet si dukuri e brendshme e tyre, si diçka e natyrshme, e vetëkuptueshme. Shkurt, mjedisi dhe veprimi në veprat e tij fare pak tingëllon si italian, fare pak ka ngjyresë dhe shije italiane, fare pak ka identitet italian.

Dhe, së fundi, vepra letrare, por edhe ajo studimore e U. Ekos, në harmoni dhe vijimësi me sa më lart, karakterizohet nga një procedim gjuhësor dhe nocional, që praktikisht ka karakter mbikombëtar. Italishtja e shkrimtarit dhe studiuesit U. Eko përbën një sprovë të vështirë jo vetëm për njohuritë gjuhësore e kulturore rreth

italishtes të lexuesit të huaj, por edhe për vetë lexuesin mesatar italian. Në veprat e tij janë vënë në provë vetë normat e gjuhës italiane.

Në mënyrë të përmbledhur mund të pohohet se nga ana kulturore, letrare dhe studimore Umberto Ekoja i përket më tepër hapësirës evropianoperëndimore sesa asaj italiane. Ai shtron probleme që nuk prekin e shqetësojnë para së gjithash dhe kryesisht italianin, por në tërësi qytetarin evropianoperëndimor. Shqetësimet e Umberto Ekos janë shqetësime jo thjesht ekzistenciale, por kulturore, qytetërimore, janë shqetësime të mbartura nga shekujt dhe jo thjesht çështje të jetesës e të përditshmërisë, janë shqetësime, të cilave ai nuk rreket t'u gjejë një shpjegim e – aq më pak – t'u parashohë ecurinë në të ardhmen, por synon t'i shtrojë në trajtë pikëpyetjesh para gjithë shoqërisë së vendeve të Evropës Perëndimore.

Dhe nga sa del prej veprave të tij, tabloja e shoqërisë evropianoperëndimore është e zymtë, pothuaj pa dritë në horizont.

* * *

Lexuesi shqiptar – këtu nuk kam parasysh lexues të veçantë për nga formimi dhe cilësi të tjera – e ka natyrisht të vështirë ta rrokë tërësinë e mesazheve kryesore, që janë vendosur në tërë shtrirjen e veprave të Ekos, sikurse edhe të pjesës kryesore të prodhimit kulturor evropianoperëndimor. Bota jonë kulturore, e lidhur detyrimisht me mënyrën e të jetuarit, të vepruarit dhe të menduarit jo vetëm të individëve të veçantë, por sidomos të gjithë shoqërisë, është mbushur me tjetër problematikë thelbësore, është pajisur me të tjera sisteme nocionesh dhe njohurish, me tjetër aparat logjik, është mbështetur mbi një tjetër ngrehinë morale dhe edukative, vepron me tjetër sistem gjuhësor.

Këto ndryshime të thella, që ndajnë botën e Umberto Ekos nga bota jonë, kthehen në pengesë të madhe për cilindo që do të donte ta lexonte veprën e këtij italiani mendjemprehtë, dyshues e kërkues. Ato ngrihen si pengesë serioze përpara cilitdo, që matet, guxon dhe përpiqet ta përkthejë këtë botë në botën e gjuhës shqipe. Mundësitë e dështimit të këtyre përpjekjeve janë shumë të mëdha. Mundësitë e suksesit të tyre –shumë të vogla. Kjo është një e vërtetë e thjeshtë, që duhet të kuptohet nga të gjithë – botues, përkthyes dhe lexues. Dhe të gjithë duhet të jemi të përgatitur që humbjet – në gjuhë, por jo vetëm – mund të jenë të ndjeshme, ndërsa arritjet – modeste.

Ne përballemi me një kulturë problematike, kulturë të thënash e të pathënash, pohimesh e heshtjesh, ndërkohë që në këtë përballje shumë shpesh na mungon përgatitja e nevojshme, e gjithanshme, e hollësishme dhe sistemore. Për këtë arsye shoqëria te ne do të duhej të merrte masa që ky ballafaqim, kjo përballje, të sillte dëmtime sa më të vogla dhe përfitime sa më të mëdha.

Për fat të keq nuk vihet re që të ndërmerren të tilla masa, të cilat do të lehtësonin përthithjen e kulturës evropianoperëndimore në kulturën tonë duke parandaluar dëmtimet e mundshme të ndërgjegjes dhe psikologjisë sonë shoqërore – qoftë edhe në trajtën e alergjive kulturore – dhe duke forcuar imunitetin tonë kulturor.

Ndaj nuk më mbetet veçse ta mbyll këtë vështrim mbi Umberto Ekon, duke iu drejtuar lexuesit tonë të veprave të tij dhe të veprave të tjera të kulturës

evropianoperëndimore: “Kujdes, i dashur bashkatdhetar! Ti po hyn i vetëm e pa ndihmë në një rrjedhë me shumë rryma të nënsipërfaqshme! Hap sytë që të mësosh të notosh në të pa u mbytur!”

ISMAIL SYLA

VITI I GJENIUT KADARE (2016)

Kadare nuk do të mbahet mend për jetën private, për dobësitë universale njerëzore, për artikuj e komente për socializmin dhe diktaturën. Qarqe jo dashamirëse ti tij brendashqiptare vetëm mund të koriten. Cinizmi më i madh kulturor është kur disa qarqe në Tiranë dhe Prishtinë i lumturon mosmarrja e Çmimit Nobel. Ato vetëm sa koriten. Ato nuk i zbehin përmasat e gjeniut të tij.

Tetëdhjetë vjetori i lindje së Ismail Kadaresë (1936) bëri që viti 2016 të shpallet si vit i tij. Është ky një akt i lartë kulturor, që e nderon kombin në tërësi, sepse bëhet fjalë për shkrimtarin dhe krijuesin më të rëndësishëm të letërsisë shqiptare, për veprën e tij të gjerë në të cilën e shtriu gjeniun e tij. Pse Ismail Kadare është një gjeni?

Në pyetjen se cila vepër letrare meriton të përkthehet në gjuhët kryesore të botës, që në moshë të hershme Ismail Kadare, para se për ndonjë autor të caktuar shqiptar, kishte thënë se në radhë të parë duhet të përktheheshin baladat dhe legjendat e lashta shqiptare.

Në pyetjen rutinë të intervistave stereotip se po të jesh i detyruar të jetoje në një planet tjetër, cilat libra shqip do t'i merrje me vete, atëherë personalisht do të merrja veprat letrare të Ismail Kadaresë, dhe nga to do të merrja ato pjesë më të mira, 200 deri 300 faqe, në të cilat është koncentruar gjeniu i tij krijues.

Nuk ka dyshim se i përkas atij krahu të mendimit që konsideron se krijesa më e lartë kulturore e shqiptarëve është vetë gjuha shqipe. Gjuha e kombit tonë është më e lartë se krijesat shpirtërore të autorëve në fushën e krijimtarisë letrare, duke përjashtuar autorin Ismail Kadare që e sublimoi në nivelin më të lartë të saj. Autorë që kanë shkruar dhe shkruajnë shqip në asnjë fushë të dijes dhe shpirtit nuk kanë të arritura të larta filozofike, sisteme teorike etj. autoriale që ta ngrinin atë në nivel botëror. Ndërkaq, Ismail Kadare, me artin e tij, gjuhën shqipe dhe kultivimin e saj e ka ngritur në nivelin më të lartë të përdorimit.

Edhe një libër tjetër në planetin X, që do t'i bashkoja krijimtarisë së Kadaresë është libri i albanologut Eqrem Çabej, gjegjësisht tekstet për Shqipërinë midis Lindjes dhe Perëndimit dhe një studim për romantizmin evropian dhe atë shqiptar. Sa herë që më duket se shqipja ka një gjendje të zhguftë në aftësinë e saj shprehëse, i lexoj këto dy shkrime të një gjuhe aq të sigurt, sa vërtet po të mos kishte shtypshkronjë, meritojnë të botohen edhe në pllaka argjile si "Epi i Gilgameshit" dikur, ku saktësisë sintaksore, logjikës dhe kulturës së shkrimit nuk mund t'ua shtosh ose t'ua heqësh as dhe një fjalë. Por le të kthehemi te Kadare.

Fuqia shprehëse e fjalës shqipe

Me disa shembuj do të përpiqem të argumentoj pse Ismail Kadare është gjeniu i vetëm deri me tash i letrave shqipe. Jo me analizë veprash veç e veç, po në radhë të parë me përdorimin e gjuhës shqipe, kryeveprës së vetme të shqiptarëve. Në prozën e tij të gjatë "Shkaba" (sipas botimi të Parisi f. 325, vëllimi 6) Ismail Kadare ndërton këtë fjali:

"*Një buzëqeshje, më tepër e brendshme e saj, e grimcuar dhe ripërtërirë prej pengesës qelqore, arriti gjer te Maksi*." Te poetë shqiptarë, prozatorë, romancierë e kultivues zhanresh të ndryshme mund të gjesh përdorim të fjalive shqipe kur përshkruajnë diçka, por këtë nivel të përdorimit maksimal të fjalëve shqipe për të treguar aftësinë shprehëse të gjuhës shqipe, nuk mund të gjesh askund në letërsinë shqipe pos te Ismail Kadare. Prozatorët e letërsisë shqipe nuk e kanë të vështirë formulimin e tipit: Një buzëqeshje e brendshme arriti gjer te Maksi, por atë, fjalinë e ndërshtënë: *e grimcuar dhe ripërtërirë prej pengesës qelqore*, tek askush nuk mund ta gjesh. Ajo është aq shumë e pasuruar me ngarkesë stilistike dhe përdorim imagjinativ dhe për fat të gjuhës shqipe shembuj të tillë në ato 300 faqet e veçuara nga tërë vepra e Kadaresë janë të shumtë.

Pra, fjalia e ndërshtënë "*...e grimcuar dhe ripërtërirë prej pengesës qelqore...*" është pjesa e fjalisë të cilën e vë në jetë mendja e gjeniut. Thënë më konkretisht me gjuhën sportive të kampionit që kërcen së larti, të gjithë atletët kërcejnë lart, por kampioni dhe thyerësi i rekordeve e ka atë 5 centimetërshin që vetëm ai e arrin. Prandaj është kampion. Kjo fjali e ndërshtënë botën letrare shqiptare e ndan në dysh, në lartësinë e saj unike, në rekordin kadarean dhe në pjesë tjetër gjithmonë nën atë 5 centimetërsh.

Për dallim nga soji tjetër, veprat e gjeniut mbahen mend gjatë dhe me detaje. Temat, motivet dhe idetë e gjeniut mbahen mend për gjithçka shkruan. E, i tillë në letërsinë shqipe është vetëm I. Kadareja.

Dy pamje të Shqipërisë artistike

Historikisht nuk e dimë të saktë datën e pushtimit kulturor të shqiptarëve nga Perandoria Osmane, por në prozën e Kadaresë e dimë kur Mark Kasneci bëhet Mark Haberi (*Ura me tri harqe*) kur baroni i Kashnjetit bëhet dyemërsh Mark Shkreli - Aqif Pasha. E ajo e cila bën të vihet kuja është zëvendësimi i fjalës së parë shqipe me fjalën turke te proza "*Shënime nga kapitaneria e portit*":

"*Kishte fluturuar një zog, një farë laureshe, nga ato me rrypth të gjelbër në qafë, dhe një nga fëmijët i kishte thirrur shokut të vet që larg : "kqyre Pal, kqyre zogun dervish!"*.

"Ç'zog dervish, mor qyq?" kishte klithur tjetri me zë të thekshëm. Po ajo është çafkëlore. Çafkëlore kaçirubë (kështu i thënkëshin në gjuhën shqipe këtij lloji të laureshave).

Siç e mora vesh më pas, ajo fjalë, apo më mirë ai emërtim shpendi, paskësh qenë, mesadukej, fjala e parë shqipe që qënkëshis zëvendësuar me të folmet e

përditshme, me një fjalë turke dhe mësuesi i vjetër, e paskish marrë këtë si shenjë të gjëmës së ardhme, që e priste gjuhën e tyre, që ata e quakan hyjnore."

Në veprën e Kadaresë si askund tjetër ka dalë e gjallë fytyra e Shqipërisë. Duke lënë anash shumë profile të tjera, mjafton të shpërfaqen dy: Shqipëria e Vasiliqisë në romanin "*Kamarja e turpit*" (*Pashallëqet e mëdha*, f. 502, botimi i Parisit) dhe ajo e Ali Pashë Tepelenës.

Për Vasiliqinë Shqipëria ishte e rrokshme lehtë, ashtu me pllaja dhe vathina të mardhura nga thëllimi, me kumbimin midis gjumit të mëngjesit të tundësit ku rrihej qumështi, me qëndisjen e prikës në orët e padurimt, dhe një copë diellishtë te kisha, dhe qyqen që në këto anë i thoshin herëkeqe.

Ky është përkufizimi më artistik, më subjektiv, më individual, më poetik i mundshëm, që ka krijuar imagjinata artistike e letrare shqiptare. Është përkufizim antologjik, i stisur me mjeshtërinë e penës së nobelueshme. Le të marrim parasysh vetëm pamjen artistike të perceptimit femëror të elementeve natyrore dhe kulturore të Shqipërisë vasiliqiane: vathina dhe pllaja të mardhura, një gjeografi e egër, e rrudhur nga pushtimet e ngushtimet. Shqipëria femërore e qëndisjes së prikës në orët e padurimit, është bota e gruas, e nënës, e burimit të jetës, e punës, ripërtëritjes së kombit, e dashurisë rinore paramartesore, e pragut të bërjes grua, nënë, mbajtëse shtëpie (tundësi që rrah qumështin). Është Shqipëria e krishterë, një qytetërim gati i perënduar, i asimiluar pothuajse nën sundimin e gjatë të Perandorisë Osmane, një copë diellishtë te kisha. Kjo copë diellishtë sikur është kujtesa, anamneza e kohës së sundimit paraturk, hapësira e tjetërsuar, e zvetënuar, kur rrjedha e qytetërimit në brigjet e këndej Adriatikut, ishte po aq kulturore dhe oksidentale sa vetë bota e krishterë perëndimore. Dhe si pozicion historiko-politiko-kulturor, i Shqipërisë vailiqiane, është e *rrokshmja qyqe*, herëkeqja, që simbolizon pozicionin e Shqipërisë së robëruar, pa identitet, pa liri, pa shenja të kumtit të mirë.

Ndërkaq, sipas përfytyrimit të Vasiliqisë (që dihet, nuk është veçse përfytyrimi i Kadaresë), për Ali Pashë Tepelenën, Shqipëria ishte ndryshe: ajo ishte ndryshe: një vend i ngrirë si në kllapi, sipër të cilit hëna e yjet s'ishin gjë tjetër, veçse lloje emblemash e stemash shtetërore, një gjë shterpë gjer në llahtarë (*Kamarja e turpit* , 502, vëllimi 2).

Elementet mashkullore të përfytyrimit të Shqipërisë Alipashiane janë elementet e shpirtit dhe karakterit të tij, që si produkt i kohës, nuk tejkalon rrethin e orbitës, në të cilin është i përcaktuar fati i sjelljes së Shqipërisë, një vend i ngrirë nga shtrëngesa e unazës së robërisë, që në vend të një ëndrre të qartë, realisht gjendet në kllapi mbytëse, ndërkaq, përpjekja për krijim origjinal të shtetit, në një vend me hapësirë të pushtuar, të ngrirë, e tregon edhe më mirë përmasën e shterpësisë, llahtarit, thatësirën shpirtërore dhe thërrmimin e ëndrrës së lirisë.

I nobelueshëm

Ismail Kadare do të mbahet mend dhe është i nobelueshëm për zbërthimin artistik të dukurive nga më të thellat të botës shqiptare, për djegën (pasionin shtetformues, "*Viti i Mbrapshtë*"), për brejën (luftën speciale te "*Kështjella*"), për

fuqinë metaforike të gjuhës shqipe (Hurshid Pashai duke menduar se edhe koka e tij mund të prehet një ditë nga Tunxh Hatai: Tani gërshëra e fatit e kishte zgjedhur frytin e vet dhe ajo ishte aty mbi tryezë, lakër e bardhë e kopshteve të ferrit ("*Kamarja e turpit*" , f. 424 Vëllimi 2), për dukurinë e frikës nga kontrolli diktatorial "... madje kishin prerë flokët gjer në rrëzë, nga frika se mos grimca të dyshimeve kishin mbetur në to ("*Tregimi i ditës që po vjen*", vëllimi 2, f.336) dhe mijëra gjetje tjera artistike, secila më perlë se tjetra, për të cilat duhen faqe të tëra...

Kadare nuk do të mbahet mend për jetën private, për dobësitë universale njerëzore, për artikuj e komente për socializmin dhe diktaturën. Qarqe jo dashamirëse ti tij brenda shqiptare vetëm mund të koriten. Cinizmi më i madh kulturor është kur disa qarqe në Tiranë dhe Prishtinë i lumturon mosmarrja e Çmimit Nobel. Ato vetëm sa koriten. Ato nuk i zbehin përmasat e gjeniut të tij.

MIMOZA CIKA-KELMENDI

NJË KADARE PAS LETRAVE

Në prag të 80-vjetorit të lindjes së shkrimtarit Ismail Kadare

Si gazetare e Deutsche Welle-s, përmes intervistave e bisedave të zhvilluara përgjatë dy dekadave me shkrimtarin Ismail Kadare, pata fatin ta njoh jo vetëm si intelektual, shkrimtar, por edhe si njëri që, krahas veprimtarisë publike, ka edhe jetën e tij private.

Këtë privilegj ia dedikoj multimedias gjermane, Deutsche Welle/Bon, e cila ka qenë vijueshmërisht e interesuar për mendimin e I. Kadaresë rreth zhvillimeve në Shqipëri, në Kosovë e në rajonin e Europës Juglindore; Deutsche Welle e ka ndjekur me simpati punën e tij si shkrimtar, si mendimtar, si personalitet me ndikim në botën shqiptare në kuptimin më të gjerë; po edhe në mjediset intelektuale dhe politike europiane, atje ku janë marrë dhe vazhdojnë të merren vendime me rëndësi historike, madje edhe epokale, për shqiptarët.

Sa i takon "besojmës", Kadare është i njëjti si në ligjërimin e shkruar dhe në atë të folur, si në Francë dhe në Shqipëri, si në periudhën totalitare dhe në atë të lirisë së mendimit, si me mikrofonin e "Deutsche Welles", përpara dhe me atë të "France International". Sepse, siç shprehet Kadare: "Letërsia është realiteti më i pavarur prej të gjithë realiteteve: prej rendeve shoqërorë dhe ideologjive të tyre, prej historisë së vërtetë dhe asaj të legjendarizuar, prej vijës dhe projekteve qeveritare, përveç rastit kur ajo nuk është letërsi e vërtetë".

Sepse vetë shkrimtari është një tiran, por një tiran për të mirë, që robëron vetveten dhe jo të tjerët; që sundon tiranisht dhe në vetmi totalitare kohën e vet subjektive, perandorinë e vet të letrave; që kthehet në një "outsider" edhe brenda familjes së vet; që arratiset në kohë e nëpër globin e ngushtë të njerëzimit; që meritën e tij mund ta ndajë – më së shumti – me gjuhën që ka trashëguar prej të vetëve.

Sipas Kadaresë gjuha letrare kombëtare është kryeshenja e identitetit shqiptar, arritje e një procesi shumë të gjatë historik, faktori më homogjenizues; ajo duhet të hapet për pasurinë leksikore ndërdialektore, por jo të rindërtohet sipas trilleve të pafundme të qeverisësve. "Gjuha shqipe është një makinë e mrekullueshme e të shprehurit, një nga makinat më të përsosura të Europës, nga ana e mundësive të shprehjes. Prandaj, ne s'kemi pse ta prishim këtë makinë për t'u dukur që dimë anglisht, italisht frëngjisht. Ruajtja e pastërtisë së gjuhës që shoqërohet me procesin e pasurimit tregon mjeshtërinë e lartë dhe moralitetin e një kulture".

Është për t'u ritheksuar se I. Kadare mund të ketë ndryshuar mendim për individë që kanë dominuar jetën shtetërore në Shqipëri e në Kosovë më herët e në kohët e reja, për I. Rugovën dhe A. Demaçin, për A. Pipën dhe S. Berishën. Por ai

nuk ka ndryshuar qëndrim dhe nuk ka gabuar në asnjë rast në çështje që kanë të bëjnë me fatin historik të një kombi: në çështjen e Kosovës; në çështjen e gjuhës, letërsisë, historisë dhe identitetit kombëtar; në mbrojtjen e interesave të popullit shqiptar kundrejt çfarëdo faktori që është shfaqur si rrezik ndaj tyre.

"Besoj që shumica e shqiptarëve janë dakord që identiteti shqiptar është homogjen, është i njëjtë, është pjesë e identitetit europian. Nuk mund të ketë identitet shqiptar të përgjysmuar, të gjymtuar ose të modifikuar për shkak të një robërie të gjatë. Identiteti është edhe historia e përbashkët, është të ndjerit e përbashkët, janë emocionet e përbashkëta si komb, të cilat janë të krijuara gjatë shekujve, të mijëvjeçarëve".

Identiteti i shqiptarëve është prej burimit me karakter europian dhe cenimi i shenjave themelore të këtij identiteti (Gjergj Kastrioti, Nënë Tereza, gjuha dhe letërsia kombëtare) përbën një regres historik, po aq sa dhe "farkimi" i identiteteve të rremë mbi bazën e dallimit rajonal, fetar, apo qoftë dhe shtetëror.

"Skënderbeu është figura më imediate e sotme për Shqipërinë. Është figura që tregon se si shqiptarët janë ndjerë europianë nëpër shekuj. Gjergj Kastrioti është argumenti i parë, flamuri i parë që plotësisht e hedh poshtë çdo etiketim kundëreuropian ndaj shqiptarëve. Do ta kishin zili shumë popuj në Ballkan ta kishin këtë figurë".

Jeta vetjake e I. Kadaresë dhe e familjes së tij, sikurse ndodh shpesh në shoqëritë e paqytetëruara, është lënduar barbarisht prej njerëzve shqiptarë. Por Kadare në mikrofonin e DË është ndryshe dhe për faktin që shpërfill realitetin e thashethemeve shqiptare dhe kumton me kursim për aq sa është e fisme për një shkrimtar të përdorë jetën e vet në publik.

"Unë kam kryer gjënë themelore në jetën time. Kam mbetur shkrimtar, kur atëherë ishte shumë vështirë të ishe shkrimtar, në periudhën më të zezë për letërsinë. Unë kam kryer gjënë themelore që kam dashur në jetën time, e kam realizuar atë".

Ne folëm ashpër për gjëra serioze, ne folëm qetë për zgjidhje paqësore, ne folëm shtruar për perspektiven e shqiptarëve, ne buzëqeshëm për dashuritë e përhershme, për femrat dhe meshkujt, por, kur e përmendëm vdekjen… subjektin më të trishtuar, madhështia e krijuesit e shndërroi në një kategori aq të rëndomtë e lehtësisht të kalueshme. "Një krijues, zakonisht normal, duhet të mos i trembet vdekjes. Sepse vepra e mëson të mësohet me vdekjen. Vetë krijimi e mëson që të mësohet me atë. Ai shkruan për kohën që është gjallë do ose s'do. Ai shkruan edhe për kohën që nuk do të jetë. Do ose nuk do. Vetë mjeshtëria e letërsisë është e tillë. Letërsia e mirë jeton, jeton gjatë".

Dhe ashtu si bënte Tomas Mani, edhe Kadare shkruan në mëngjes dy ose tri orë, duke nisur të përditshmen e tij krijuese pa u ndalur kurrë edhe sot në prag të 80 vjetorit të tij duke shoshitur vazhdimisht midis imagjinares dhe reales…

(*Nga libri* "Kadare ndryshe", *botimet "Naimi", Tiranë 2014*)

LIRAK KARJAGDIU

NOLI PËRKTHYES I LETËRSISË ANGLEZE DHE AMERIKANE

Përmbledhje: S'ka pikë dyshimi se, ndonëse janë shkruar mjaft vështrime, kritika dhe studime për veprimtarinë e Nolit si publicist, historian, orator, diplomat, kritik letrar, kompozitor, dramaturg dhe poet, për Nolin si përkthyes gjer tani nuk janë shkruar kritika dhe studime të mirëfillta. Kjo duket pothuajse si një anomali, po të kihet parasysh se Noli është marrë me përkthime fetare dhe letrare më shumë se me asnjë veprimtari tjetër, ka përkthyer me mija faqe. Prandaj, në punimin tonë ne do ta përqendrojmë vëmendjen tonë rreth Nolit si përkthyes i letërsisë angleze dhe amerikane, në të cilën dallohen tri periudha: 1. Periudha e hershme, 2. Periudha e pjekurisë dhe 3. Periudha e fundit. Është me rëndësi që të vihet në dukje shumë qartë se në këtë punim do të bëjmë fjalë dhe do të diskutojmë vetëm për veprat më të spikatura dhe kryeveprat më të popullarizuara të letërsisë angleze dhe amerikane të përkthyera nga Noli në gjuhën shqipe.

Fjalët kyçe: Noli përkthyes, letërsia angleze dhe amerikane, begatimi i letërsisë shqipe, modernizimi dhe perëndimorizimi i letërisë shqipe

Periudha e hershme (1906-1920)

Në periudhën e hershme (1906-1920), Noli ka përkthyer disa tregime të shkurtra nga letërsia gjermane, frënge, norvegjeze, greke. Ndërsa, nga letërsia angleze dhe amerikane ka përkthyer tregimin e Uashington Irvingut "Dhurata e arabit" nga cikli "Përrallat e Alhambrës" (1909), tregimin e E. A. Poes "Maska e vdekjes së kuqe" (1909), pastaj poezinë e Llongfelloit "Skënderbeu" (1915), mandej tragjedinë e Shekspirit "Othellon" (1916) dhe poemën e njohur të E.A. Poes "Korbi" dhe elegjinë "Anabel Li" (1918).

Fazës së parë të shqipërimeve të Nolit i përket poema e poetit amerikan Llongfellout. Titulli i plotë i broshurës së përkthyer është: "Henry Wadsworth Longfellow, "Skënderbeu". E shqipëroi At Fan S. Noli, Boston., Mass., 1916". Në ballinën e broshurës është ky shënim: "Libraria popullore", ndërsa në faqen e dytë është përkushtimi. Noli ia dedikon përkthimin F. Konicës.[1] Në vijim, në faqen e tretë, është një parathënie, në të cilën thuhet: "Mungimi i librave në gjuhën tonë më shtyri të themelonj Librarin Popullore", me qëllim që t'u jap bashkatdhetarëve të

[1] Fan. S. Noli, Vëllimi I, "Skendërbeu", Libraria Popullore, Boston, Mass 1916, fq. 4

mi ca vepra të zgjedhura nga literatyra e përbotshme. Nisa duke filluar "Skendërbenë" e vjershëtorit amerikan të dëgjuar H.W. Longfellow. Kjo vjershë është nofta më e bukura që është shkruar në një gjuhë të huaj për trimin tonë kombëtar dhe meritonte vendin e parë në mes të vëllimeve që kam ndër mënt të nxjerrë në shesh për këndonjësit shqiptarë". Mandej, në faqen e pestë është "hyrja" ku ka ca shënime kryesore mbi autorin, veprën dhe një shpjegim mjaft interesant për lexuesin. "Vjershëtori amerikan", sqaron Noli, "zgjodhi episodin më dramatik të jetës së Skendërbeut si subjekt edhe na dha një vjershë, e cila bashkon të gjitha cilësitë që i duhen një kryevepre. Ikja e Skendërbeut pas luftës, vrasja e Qatipit, zaptimi i fortesës me fermanin e rremë që i mori me pahir Qatipit, ngritja e flamurit kombëtar dhe gëzimi i popullit për çlirimin e atdheut nga zgjedha e huaj, përshkruhen me një mjeshtëri, me një gjallëri, me një sulmë, me një zjarr dhe me një brohori me një brohori që ta rrëmbejnë zemrën dhe mendjen".

Lidhur me përkthimin e kësaj poeme, Noli thekson se përkthimi i një poezie nga një gjuhë në tjetrën është një gjë e vështirë, "në mos e pamundshme", vëren ai. Por, megjithatë, ai cek se ka një shpresë që: "Lulja që mora nga kopshti i Longfelloit, nuk e humbi fare as erën, as ngjyrën, as freskinë, duke u mbjellë në gardinën e Shqipërisë. Këndonjësit do të gjykojnë më mirë". [2]

Nëse bëjmë disa krahasime spontane do të konstatojmë se, ndërsa poema e Skënderbeut në origjinal ka 16 strofa, në përkthimin e Nolit ka 19 strofa me numër të njëjtë të vargjeve. Kështu, strofa e dytë në origjinal ka 12 vargje, ndërsa në përkthim është e ndarë në dy strofa me nga 6 vargje. Strofa e 13 në anglisht ka 14 vargje, ndërsa në përkthim ka dy strofa nga 7 vargje. Përveç kësaj, Llongfellou në poemën e tij përdorë vargun shtatërrokësh, ndërsa edhe në përkthimin e Nolit mbisundon shtatërrokëshi. Duket qartazi se ky lloj i vargut përputhet me tonin luftarak të poemës, meqë ritmi i saj ta kujton luftën.[3]

Pos kësaj, edhe skema e rimave përkon me skemën e origjinalit: AA-BB-CDDC: The battle is fought and won, A, Lufton luftën dhe fiton, A/ By King Ladislav the thin, A, Mbreti Ladislav gjëmon, A/ In fire of hell and death's frost, B, Djek si vdekje pret, B/ On the day of Pentecost, B, Ditën e Rushajave, B/ And in rout before his path, C, Dhe nga fush e kuqe gjak, D, From the field of battle red, D/ Ikën rent përpara tij, D, Flee all that are not dead, D/ E Muratit ushtëri, D, Of all the army of Amurath, C/ Që shpëtoi e s'ra në lak.

Mirëpo, ndryshe nga origjinali Noli ka gjetur një solucion tjetër dhe ka ndryshuar ritmin dhe theksat në varg. Ndërsa, Longfellou, në përgjithësi, i ka tri theksa në varg, Noli, duke u mbështetur në traditën e poezisë shqipe, përdorë dy thekse. Kështu, në poemën në original theksi është vendosur në fillim ose edhe te rrokja e dytë: The battle is fought and won, ndërsa në poemën në shqipe theksi i

[2] Fan S. Noli poet në: Fan S. Noli, Vepra 1. Botohet nën kujdesin e ASH të RPSSH, Tiranë, 1987, fq. 346- 347

[3] Pojani, V., Lubonja, B. dhe Bonja, E.. Poema "Skendërbeu" e H.W. Longfellow përmes shqipërimit të F. S. Nolit, në: "Fan S. Noli me 130 vjetorin e lindjes 1882-2012". Konferenca shkencore ndërkombëtare. Fakulteti i Edukimit dhe Filologjisë, Korçë, 2012, fq. 388

parë gjendet te rrokja e tretë: Lufton luftën dhe fiton, pra te fjala "luftën". Kihet përshtypja se Noli përdorë në përkthimet e tij një numër të madh të aliteracionave dhe asonancave për të rikrijuar bukurzani dhe eufoni në këtë shqipërim, p.sh. This city and all its lands/ Should be given të me again. (Qyteti me të gjitha tokat/ Do të më kthehen përsëri (aliteracioni në shkronjën t), ose: Who we are that shall withstand/ The wind of his lifted hand? (Kur ngre dorën kundër nesh/ Dhena grykën si rrebesh? (aliteracioni në shkronjën t dhe asonacë në shkronjën e) apo edhe ky shembull: And the Scribe said What misdeed/ Have I done, that without need/ Thou dost to me this thing? (Dhe Qatipi tha: Po ç'faj/ Paskam bërë që Pashaj/ Më bën mua këtë gjë? (asonanca në shkronjën a).

Është fakt se Llongfellou ka përdorur disa arkaizma, si p.sh. Wearing his signet ring (Me mehyrin e Dorletit)/ To King Amurath's Pasha (Për Mytesarifin e mbretit)/ And the Scribe low in dread (Dhe Qatipi u krrus prej tmerrit). Poeti amerikan përdor edhe disa arkaizma të tjera, përemra dhe emra, për të cilat Noli gjen pothuajse përherë edhe fjalën ekuivalente në gjuhën shqipe.[4]

Afër mendsh, përkthimet dëshmojnë aftësinë, dijen dhe mjeshtërinë e përkthyesit, i cili zakonisht së pari e interpreton poezinë e huaj në gjuhën tjetër, e pastaj e rikrijon substancën e origjinalit në mënyrë që të jetë sa më i qartë për lexuesin. Me fjalë të tjera, si detyrë parësore, Noli e kishte në të shumtën e rasteve përpara sysh lexuesin me të cilin komunikonte përmes versionit të tij të shqipëruar. Në këtë mënyrë, suksesi apo dështimi i një përkthimi varet nga reagimi i lexuesit. Afër mendsh, nuk ka vetëm një mënyrë, formë apo lloj për përkthimin poetik. Këtë e dëshmon edhe shqipërimi i kësaj poeme të Longfellout nga Noli me ç'rast, shqipëruesi ynë, përkundër sfidave dhe vështirësive që ka hasur gjatë procesit të përkthimit ia doli mbanë t'i tejkalojë të gjitha sfidat dhe na dhuroi një poemë që, me sa dihet, lexuesi shqiptar rrallëherë e ka dalluar atë si përkthim, po e ka trajtuar më të shpeshtën e herës si të ishte shkruar nga një autor shqiptar.

Ndërkaq sprovat e tij kritike, gjithsej tetë introdukte e disa artikuj, një pjesë të madhe Noli ia kushton universit shekspirian, me të cilin gjithnjë e më shumë ndihej i lidhur emocionalisht. Temat e trajtuara në veprat e Shekspirit, janë universale dhe kanë pika të shumta referimi me realitetin shqiptar, por mbi të gjitha Noli admiron ato pasi përbëjnë paralele interesante me botën e zymtë shqiptare dhe me përpjekjet ekzistenciale të saj për të dalë nga terri i historisë. Kjo aftësi e referimit me realitetin shqiptar duket thuajse në të gjitha introduktat, ku përmes universalitetit të artit dhe aluzionit shprehen raportet e individit me shoqërinë, lufta për drejtësi, barazi e demokraci sociale, kundër dallimeve, klasore, etj. Noli nuk hyn në shumë analiza të aspekteve artistike dhe etike të veprës. Në të gjitha introduktat ai përdorë një skemë të qartë trajtimi, në fillim bën fjalë shkurtimisht për autorin, pastaj për mjedisin shoqëror e historik ku zhvillohen ngjarjet, ndërsa në fund e bën një analizë të thelbit ideor e filozofik të veprës.

Kështu "Othelloja", e mbështetur në disa detaje të ndryshuara të një tregimi të Çintit, është një tragjedi e xhelozisë, e shkaktuar nga shpifjet. Është një xhelozi, e cila rrjedh nga vetëmashtrimi. Marrë nga pikëpamje të ndryshme, "Othello" është

[4] Pojani, V., vep. e cituar, fq. 389

një tragjedi e shumëfishtë: tragjedi e pafajësisë, viktimë e së cilës është Desdemona, tragjedi e naivitetit dhe e sinqeritetit, që ka si viktimë Othellon dhe tragjedi e vullnetit djallëzor, e dinakërisë dhe poshtërsisë, simbol i të cilës është Jago. Sikur Desdemona të mos ishte e padjallëzuar, ajo nuk do të pësonte; sikur Othello mos të ishte zemërbardhë dhe i çiltër, nuk do ta vriste Desdemonën; sikur Jago mos ta kishte karakterin satanik nuk do të përgatiste një krim aq të llahtarshëm.

Padyshim, "Othello" është një ndër katër tragjeditë më të famshme të Shekspirit. Ngjarjet në këtë tragjedi janë shumë të furishme, si për lexim ashtu edhe për shikim. Ato zhvillohen me rrëmbim, skenat janë të ngjashme me ato të jetës dhe uniteti i ngjarjeve është pa episode, por ekziston një harmoni e plotë artistike. Jago është mishërim i dyftyrësisë, kështu që tërë hipokrizinë e tij e vë në funksion të hakmarrjes. Nga jashtë Jago duket i këndshëm dhe i sjellshëm ndaj çdokujt. Vetëm kohë pas kohe cinizmi i tij tregonte se ai ka një shpirt katran. Atë që bën Jago duket si rezultat i mirësisë, miqësisë, bujarisë ndaj komandantit të vet. Ai për vete thotë se: "Nuk është ai që duket", d.m.th nuk është ai që shtiret. Ç'është edhe më interesant të gjithë kanë mendim të mirë për Jagon dhe i besojnë atij, ndonëse është shkaktari kryesor i të gjitha intrigave dhe të këqijave të kësaj tragjedie.[5]

Në "Parathënien" apo "Hyrjen" e përkthimit, Noli e njofton lexuesin se "Othellon" e ka përkthyer brenda pesë muajve "dhe për dy muaj të tjerë" është marrë me përmirësimin e veprës pas një periudhe nëntëvjeçare të qëndrimit në Shtetet e Bashkuara, ku arriti më 1906 dhe u diplomua në Harvard më 1912. Në të vërtetë "Othellon" e përkthen më 1915, shtatë vjet pas Kongresit të Manastirit, tri vjet pas shpalljes së Pavarësisë së Shqipërisë dhe rreth dy vjet para Komisisë Letrare të Shkodrës. Përsa i përket grafisë Noli e përdor alfabetin e Manastirit.[6] Përveç kësaj, në "parathënien" e përkthimit të botuar të datës 1916, Noli thekson se Shekspiri "është dramatisti më i madh i botës", i cili kishte shkruar vjersha, komedira, dramëra historike dhe tragjedira". Veprat më të shquara të Shekspirit, sipas Nolit janë: "Hamleti", "Makbethi", "Romeo dhe Gjulieta", "Mberi Lir", "Jul Qesari" dhe "Othello". Po kështu, në "Parathënien" e "Othellos" Noli pasi jep ca të dhëna kryesore mbi jetën e Shekspirit, vijon të shkruajë mbi subjektin e veprës, në përgjithësi, ndërsa mbarështrimit, sqarimit dhe analizës së karateristikave të personazhave i kushton një vëmendje më të madhe.[7]

Kështu në introduktin kushtuar "Othellos" ai do të japë përcaktime të vyera në lidhje me natyrën e përgjithshme dramaturgjike të veprës, duke e përcaktuar si "tragjedi e lidhur më mjeshtërisht se të gjitha veprat e tjera shekspiriane" si dhe do të bëjë karakterizime për personazhet dhe psikologjinë e tyre. Lidhur me karakterin e ngatërruar e djallëzor të Jagos dhe mjeshtërinë e Shekspirit në skalitjen e figurës së tij shprehet: "Ligësia e tij do të ishte me të vërtetë e paduruar, po të mos ishte bashkuar me një hollësi mendjeje, thellësi psikologjike dhe mjeshtëri intrige të

[5] Po aty, fq. 390
[6] Vep. e cituar, fq. 9-12
[7] Kastrati, J., Përkthyesit tanë të veprave dramaturgjike. Fan S. Noli si përkthyes, në Fan S. Noli ndër bashkëkohanikët, Rilindja, Prishtinë, 1968, fq. 204-205

rrallë e të çudiçme". Ndërsa në fund, jep me tone përgjithësuese, dramën e protagonistit, Othellos, pasi ka zbuluar të vërtetën tragjike: "Për nderin e tij vrau Desdemonën, të cilën nuk do ta kish këmbyer për një botë të artë- për nderin e Republikës lëftoi tërë jetën e tij, për nderin e tij tani vret veten".

Do vënë në dukje se kohë më parë dy studiues, Gjovani Bellusho dhe Flora Koleci, në punimin e tyre: "Veçori leksiko- gramatikore dhe strategji origjinale në përkthimin e "Othellos" të F. Nolit nga anglishtja", bëjnë një analizë të thukët të veçorive të përkthimit të kësaj vepre, të cilët i përqasën jo vetëm pesëdhjetë e dy fusnota të sjella nga Noli, me rasti e përkthimit të "Othellos", po e krahasojnë, shpjegojnë dhe analizojnë edhe leksikun, trajtat e lajthitjeve gramatikore, strukturave sintaksore dhe nivelin e përkthimit, por pa i nënçmuar vlerat dhe mjeshtërinë e shqipërimit të Nolit.[8]

Mirëpo, një ndër poezitë më të spikatura dhe më të popullarizuara të përkthyera nga Noli në gjuhën është poezia e poetit famëmadh amerikan E.A. Poe "Korbi". Do thënë se, sapo u botua, në vitin 1849, në të përkohshmen "New York Evening", kjo poezi u ribotua në një mori gazetash dhe revistash të tjera. Kjo dëshmon se poezia e tij u prit më interesim dhe u pëlqye nga lexuesit. Pikërisht kjo poezi ia rriti famën Poes si poet. Sipas, E.H. Davidsonit idenë për shpendin që flet Poe e kishte gjetur në romanin e Dikensit "Barbani Raxhit". Po kështu, krijimi i kësaj poezie zgjati më se tre vjet, meqë më parë autori ose poeti e recitonte atë shpeshherë para miqve dhe shokëve të tij. Sipas S. Stovalit, në "Filozofinë e kompozicionit" Poeja kishte pasur ndërmend të shkruante një tregim të shkurtër, por pastaj vendosi ta shkruante poezinë "Korbi".[9] Në esenë e përmendur të tij, Poe vë në dukje se idetë kryesore për shkrimin e një poezie janë bukuria dhe pikëllimi, toni dhe ritmi. Me këtë rast, Poe i jep edhe disa sqarime për nevojën e përdorimit të refrenit në strukturën e poezisë së tij. Kjo poezi ka gjithsej 108 vargje, ndërsa pika kulminante arrihet në vargun 54. Ndërsa, T.S. Elioti nga ana e tij beson se famën e kësaj poezie e ngriti në kupë të qiellit përkthimi në frengjishte i saj nga Sharl Bodleri, i cili sipas mendimit të tij, tejkalon pothujase edhe orligjinalin.[10]

Megjithëse kjo poezi ekziston në disa variante, ajo është botuar së pari në "Rivistën Adriatik" në Boston, në shtator të vitit 1918. Në parathënien e shqipërimit, Noli shkruan: "Korbi" është vjersha më e mallëngjyer dhe më artistike e vjershëtorit amerikan Edgar Allan Poe. Mund të thuhet lehtë që s'ka shoqë letrëtyrë të botës. Është përkthyer në tërë gjuhët evropiane. Shqip e ky kthyer editori i kësaj riviste këtu e shtatë vjet (1911), po tani shtypet për herën e parë. Dy fjalë për jetëshkrimin e vjershëroit janë të nevojshme, se hedhin dritë për kuptimin e vjershës". Noli cek se Poeja e kishte shkruar këtë poezi më 1845, kur e shoqja e

[8] Belluscio, Gj., Koleci, F.: "Veçori gramatikore dhe strategji origjinale në përkthimin e "Othellos" së Fan Nolit nga anglishtja" në: "Fan S. Noli me 130 vjetorin e lindjes 1882-2012". Konferenca shkencore ndërkombëtare. Fakulteti i Edukimit dhe Filologjisë, Korçë, 2012, fq. 232-244

[9] Korbi, Fan S. Noli, "Korbi i Poes", Revista Adriatike, Vol. 1, Boston, Mass., Shtator, 1918, fq. 38-41

[10] Ibrani (Gjinali), Z.; Fan S. Noli përkthyesi i parë i poezisë amerikane në gjuhën shqipe. Universiteti i Kosovës në Prishtinë, Fakulteti Filozofik, Prishtinë, fq. 67-68.

tij ishte sëmurë dhe nuk kishte më kurrfarë shprese për shërim. Pas vdekjes së saj, ai ka shkruar edhe një poezi me titullin "Anabel Li", në të cilën, vë në dukje Noli: "Pikturon gjithë me forcë dëshprimin që ndjente për humbjen e saj. Vjersha më të mallëngjyera se këtë dyja" përfundon Noli, "nuk gjenden fare a rrallë në leteratyrën e përbotshme. Kemi shpresë që shqiptarët do t'i shijojnë që të dyja në gjuhë të tyre, pa vënë re mungimet e pashpëtuarshme të përkthimit".

Si dihet, "Korbi" në origjinal ka 18 strofa me nga 6 vargje, ndërsa në përkthimin e Nolit i ka 18 strofa me nga 11 vargje. Kohë më parë studiuesi E. Dodona kishte gjetur se ekzistojnë dy versione të përkthimit të kësaj poezie ne shqip të Nolit, një e vitit 1911 dhe versioni i dytë, i përpunuar, i vitit 1918. Në origjinalin e kësaj poezie mbisundon gjashtëmbëdhjetë rrokshi dhe një pesë rrokësh, si refren, ndërsa në shqipërimin e kësaj poezie është përdorur tetë rrokshi, shtatë rrokshi dhe dy rrokshi, në refren. Në vazhdim do të japim disa shembuj të strategjisë shqipëruese të Nolit në këtë poezi. Gjatë shqipërimit të kësaj poezie, Noli ka përdorur qasje të veçantë dhe unike, prandaj për hir të tërësisë dhe të interpretimit sa më të suksesshëm të origjinalit, kur është konfrontuar me gjuhën burimore, sipas rastit, ka marrë qëndrime të ndryshme. Në të shumtën e rasteve ia ka dalë mbanë, por ka pasur edhe raste kur është dashur të bëjë ndonjë sakrificë të vogël të origjinalit. P.sh. në strofën e dytë, në vend të fjalës bleak, që d.m.th i zymtë ai e përdorë fjalën i ngrirë. Pastaj, në vend fjalës sorrow, që d.m.th dhimbje, ai përdorë fjalën ngushëllim. Po kështu, në vend të shprehjes lost Lenore, që do të thotë, e tretura Lenorë, ai e përkthen e humbura Lenorë. Mirëpo, aliteracionin e vargut të pestë rare and radiant ai e përkthen rrallë dhe rezore, duke i ruajtur kështu dy epitetet dhe aliteracionin. Po ashtu, e ruan edhe figurën e epiforës, që e krijojnë vargjet katër dhe pesë. Në strofën e katërt, kemi të bëjmë me një përkthim mjaft të suksesshëm dhe elokuent. Është përkthyer me sukses tërësia e strofës dhe përkthimi ka dalë mjaft i bukur. Janë ruajtur edhe figurat stilistike si dhe anafora, në vargjet gjashtë dhe shtatë, ndërsa njëkohësisht rimat e qëlluara dhe të harmonizuara i japin një bukurzani të posaçme kësaj strofe. Strofa e nëntë me gjithë faktin se përkthyesit i është dashur të cungojë dhe anashkalojë disa vargje dhe njësi leksiko-semantike. Prej elementeve që iu shmanget janë: so plainly (aq rrjedhshëm), agreeing (duke u pajtuar), blessed (i bekuar) dhe sculptured (i gdhendur). Megjithëse, i humbë fjalët e origjinalit, strofa e përkthyer del e strukturuar, mjaft e qartë dhe kumbon për bukuri. Me këtë rast, bie në sy aliteracioni i vargut të pestë "bird or beast", të cilën Noli e reprodukon në këtë mënyrë "shpend a shtazë", duke e rikrijuar një strofë të shqipëruar me domethënien, tonin dhe atmosferën.[11] Poezia "Korbi" në gjuhën shqipe, është pritur me entuziazëm nga kritika letrare shqipe. Studiuesi Vehbi Bala, në studimin e tij mbi Nolin e vlerëson lartë këtë shqipërim të tij, duke thënë se: "Popullaritetin që fitoi "Korbi" i E.A. Poes, përshkohet nga fryma e dëshprimit të skajshëm, lidhet me vlerën e veçantë të mjeshtërisë poetike të shqipëruesit, sidomos në efektet melodike, harmonike dhe ritmike që shkaktoi te këndonjësit". [12]

[11] Ibrani (Gjinali), vep. e cituar, 68-69
[12] Noli, F. S., vep. e cituar, fq. 43

Do thënë se shqipëruesi ynë ka ditur të shpalosë suksesshëm efektet e veçanta melodike, harmonike dhe ritmike të poemës, efekte që përcillen tek lexuesi shqiptar me një lexim të parë të veprës. "Korbi" nën shqipërimin mjeshtëror të Nolit, na shfaqet me tipare të poezisë shqipe, duke u konsideruar si vlerë e (kësaj poezie) në fondin e letrave shqipe. Në një përfundim të ngjashëm arrin edhe studiuesi Kolë Ashta lidhur me poemën "Korbi": "Në këtë poezi që gati mund të guxojmë me e quejtë shqiptare, edhe jo e përkthyeme, dëgjohet jehona e një tingulli të marrë, kërcitja e një kumbone vdekjeje".[13] "S'është çudi që lexuesi shqiptar preket nga leximi i poemës" vëren Ashta, "sepse në të jeton një shenjë e dallueshme e shpirtit shqiptar".

Kështu, Noli jo vetëm që ka mundur të perceptojë, por edhe ta përcjellë me elegancë, një nga veçoritë e mjeshtërisë së Poes, aftësinë për të lënë mbresë të thellë dhe për të magjepsur dhe për të hipnotizuar lexuesin. Refreni i përsëritur "Never more", që Noli na e sjell në trajtën "Kurrë më", i ngjan një vajtimi shqiptar, që përcjell tek lexuesi jo vetëm intensitet dramatik, por edhe dhimbje e dëshpërim. Është e dukshme në shqipërimin e kësaj poeme, përpjekja e jashtëzakonshme e Nolit për të hetuar dhe hulumtuar me resurset e gjuhës shqipe, në thesaret e saj, jo vetëm që të mos t'i mbetet borxh origjinalit, por as lexuesit të tij.

Noli pra, me përkthimin e "Korbit", ka mundur të krijojë një realitet të ri artistik, duke u shmangur shpesh nga origjinali, por duke e përforcuar vlerën e përkthimit të tij. Lidhur me këtë K. Ashta arrin në përfundimin se: "Në përkthimin e Nolit, lexuesit gjenden para një vepre shqiptare, para një elegjie që populli arbuer di ta shprehë e ta kuptojë. Noli përktheu frymën e poezive në tetërrokëshin popullor, me natyrën e gjuhës shqipe, këtë trajtë të re andeje estetike që na ndrydh e na nalton".[14]

Ndërsa në poezinë elegjiake "Anabel Li" të po të njëjtit autor amerikan, të cilën Noli e përktheu në vitin 1918, kemi të bëjmë me mallin, pikëllimin dhe dhembjen e thellë shpirtërore të një dashnori, i cili është i pushtuar nga mallëngjimi dhe ngashërimi për vajzën e re Anabel Li, të cilën e kishte dashur së tepërmi, po edhe ajo njësoj e kishte dashuruar vajtuesin fatkeq. Ai beson se dashurinë e tyre e kishin zili edhe enjgjujt. Por, pasi ajo kishte ndërruar jetë shokut të saj, i cili vuan nga malli i duket se "motrat e saj ëngjëllusha e kishin rrëmbyer dhe mbyllur në varr, në një vend, afër në det. Të dashurit të gjorë, i bëhet se engjujt, s'kishin aq dashuri dhe e kishin mëri Anabelën, që e kishte ngrirë veriu. Duke vajtuar me trishtim, me zemër të sëmbuar dhe shpirt të therur, vajton dhe rënkon se një dashuri e tillë, ishte më e fortë se çdo dashuri tjetër, që s'ishte parë nga asnjeri, as nga engjëjt dhe sa nga demonët. Megjithatë, dashnori i dëshpëruar me zemër të zhuritur ndjen dhimbje të thellë për Anabel Linë e bukur, madje nga malli i pashuar e përkujton atë dhe me trishtim ndjen se hëna që ndriçon, syri i të mjerit ndriçon për Anabel

[13] Ashta, K., Revista "Shkëndija", Tiranë, nr. 4, 1940, fq. 50

[14] Zhuri, N., Noli: Përkthyesi dhe kritiku, në: "Fan S. Noli me 130 vjetorin e lindjes 1882-2012". Konferenca shkencore ndërkombëtare. Fakulteti i Edukimit dhe Filologjisë, Korçë, 2012, fq. 384

Linë se yjtë që shkëlqejnë, tregojnë bukurinë e saj, ndaj ai e kujto dhe përfytyron ditë e natë dhe kështu i ngrohet zemra për, si thotë në fund të poezisë, "Shoq e dashura ime, e mjera jetime/ Përmi varrin ku deti buçet/ I rri pranë mi varrin në det." Në këtë elegji të përkryer, poeti e përdor dendur hiperbolën, metaforën, similin, gradacionin dhe antitezën dhe disa epitete. Rimat e riprodukuara, japin një lloj euforie tonit të zymtë, lamentues dhe ogurzi të atmosferës dhe tonit elegjiak.[15]

Periudha e pjekurisë (1920-1961)

Ndërsa në periudhën e dytë, apo të pjekurisë (1920- 1961), ka përkthyer dhe ka botuar nga letërsia angleze tre tregjeditë më të shquara "Makbethi", "Hamleti" dhe "Jul Çezari" (1926).

Noli e botoi "Othellon" me 1916, ndërsa pas 10 vjetësh i përktheu edhe veprat e tjera, njëra pas tjetrës: "Hamletin", "Jul Cezarin", dhe "Makbethin". Noli në fillim ngurronte për suksesin që mund të arrinte. Gjuha shqipe në të cilën nuk ishte shkolluar asnjëherë, ishte gjuha e një djaloshi të lindur jashtë atdheut në Ibrik Tepen e largët nga Shqipëria, ndërsa gjuha angleze si gjuhë të huaj, por e përvetësuar shumë mirë, nuk e tradhtoi Nolin. Përkthimi i "Othellos" doli i suksesshëm. Këtë sukses mund të arrijë vetëm një intelektual si Noli. Ai, Shekspirin nisi ta lexojë në moshë shumë të re, kur ishte vetëm 15 vjeç, duke e njohur atë dhe veprën e tij, edhe në cilësinë e suflerit në një teatër grek të Athinës. Takimin e këtillë me Shekspirin, ai e ka konsideruar si një nga ngjarjet më të rëndësishme të jetës së tij, për të kuptuar jo vetëm artin por edhe historinë e njerëzimit. Kështu, Shekspiri hyri i pari nga shkrimtarët e mëdhenj botërorë, në gjirin e kulturës e të botës shqiptare. Noli, përveç që ia ofroi lexuesit shqiptar tragjedinë e Shekspirit, ai me kritikat apo introduktat, siç i quan, i ndihmoi për ta kuptuar më mirë porosinë e veprës, ndërsa kritikës letrare shqiptare ia çeli rrugën e mbarë për të vazhduar më vonë me të tjerët. Introduktat e Nolit që i paraprinë çdo vepre të përkthyer ose më mirë të themi të shqipëruar, e bënin analizën e përgjithshme të veprës duke zbërthyer problemet historike, filozofike, sociale, politike, etj. Fjalët hyrëse për çdo vepër të përkthyer, janë studime të shkurtra, por shumë të ngjeshura, nëpërmjet të cilave në mënyrë të gjithanshme, nëpërmjet gjuhës shqipe që e përdorte aq bukur dhe me përgjegjësi, i zbuloi dhe i dënoi veset e një kategorie shoqërore, siç ishin: lakmitë e shfrenuara, të pjesës hipokrite, dinakërinë, karrierizmin dhe vëllavrasjen me pabesi dhe misterioze.[16]

Kështu, në tre tragjeditë e famshme të Shekspirit "Hamleti", "Makbethi" dhe "Jul Qezari", të përkthyera në gjuhën shqipe dhe të pajisura me shënime dhe analiza nga Noli, mund të themi se përmblidhet i gjithë thelbi i teatrit shekspirian,

[15] Aliu, L., Me përkthimet e Nolit, në 100 vjetorin e lindjes 1882-1982. Instituti Albanologjik i Prishtinës, Prishtinë, fq. 227-228

[16] Bexheti, V., Fan Noli dhe Shekspiri, në: "Fan S. Noli me 130 vjetorin e lindjes 1882-2012". Konferenca shkencore ndërkombëtare. Fakulteti i Edukimit dhe Filologjisë, Korçë, 2012, fq. 395

universaliteti i mendimit të tij, fati dhe psikologjia njerëzore. Por, aty mbi të gjitha, nga ana e Nolit jepet një mesazh për botën shqiptare, grupet politiko-shoqërore, sfidat e pritshme për njeriun dhe kombin shqiptar. Paralelizmi me kontekstin historiko-shoqëror shqiptar është mjaft i pranishëm e madje ndonjëherë ndihet një lloj prirje teprimi.[17]

Veç kësaj, tek "Jul Cezari" dhe "Makbethi" Noli përmes një njohjeje të thellë të problematikës dhe vlerave të këtyre tragjedive synon ta çojë lexuesin në përfundime e domethënie të qarta në lidhje me situatën politike të kohës, ndoshta edhe duke kaluar në teprime të disa analizave politike. Sidoqoftë, në këto vepra, ai përpiqet të nxjerrë thelbin e vërtetë filozofik që ato mishërojnë në raportet e forcave politike, por edhe në lidhje me dhunën e ngjarjet që përfshihen në subjektin e veprës shprehet: "Shekspiri nuk bëri tjetër veçse t'i dramatizojë, po i ka lidhur aq bukur sa ka krijuar veprën theatrale më të fortë të botës dhe e ka sintetizuar këtë periudhë të historisë romane aq mjeshtërisht, sa "Jul Qesari" i tij i shkurtër vlen më tepër se duzina vëllimesh mi këtë themë prej historianësh të specializuar.

Ndërkaq, në hyrjen e Makbethit Noli shkruan: "Asnjë vepër teatrale nuk përmbledh në një vënt aq të ngushtë një gjëmë aq të madhe prej ngjarjesh tronditëse dhe ngjethëse sa "Makbethi", tragjedia më e tmerruar që ka dalë nga penda demoniake e Shekspirit" dhe më tej përmes një analize të shkurtër, por të ngjeshur me mendimin, e karakterizon atë saktësisht si "pasqyrë e tërë historisë së Skotlandës", kritikë të "sistemit terrorist", "tragjedi e ambicies kriminale".[18] "Makbethi" është një vepër e përsosur e artit dramatik, e cila mbështetet në njërin prej parimeve më të rëndësishme të etikës, prandaj është edhe e natyrshme se ndonjëherë theksohet se është drama më e mirë e letërsisë botërore. Ideja etike, në të cilën mbështetet "Makbethi", e cila është disi e pllakosur me një pesimizëm të errët se e keqja që i bën tjetrit, i bën vetes. Kjo është esenca e mendimit, të cilin e shprehë Makbethi, kur në errësirë mendon a ta vrasë Dankanin apo jo. Që nga momenti, kur nën ndikimin e gruas së tij e vret Dankanin dhe bëhet mbret, e deri te çasti kur i del shpirti nga shpata hakmarrëse, Makbethi e dëmton veten, duke i shkatërruar të tjerët. Me pak fjalë, çfarë vepre është "Makbethi"? Ajo është një tragjedi, që ka personazhe, të cilët janë më të gjallë se njerëzit, me një psikologji të thellë, me mendime të rëndësishme poetike dhe me imazhe, të cilat përputhen me karaktetin e rrethanave. Kjo është një tragjedi e mbështetur në njërën prej parimeve më relevante të jetës, d.m.th porosia e kësaj tragjedie është se jeta e njerëzve është e lidhur në një mënyrë misterioze asisoji që, ku një njeri e vret dhe e shkatërron një tjetër, në të njëtën kohë e vret edhe veten. Së këndejmi, kjo tragjedi është shfaqur edhe ende shfaet në skenat teatrore anekënd botës.

Shpirti i "Makbethit" është fushëbetejë e fuqive të liga dhe të mira. Burimet e fuqive të liga gjenden në lakmitë dhe ambiciet e tij të tepruara, në dashakeqësinë e

[17] Rredhi, G., "Mendimi kritiko letrar i Fan Nolit në lidhje me artin klasik botëror", në: "Fan S. Noli me 130 vjetorin e lindjes 1882-2012". Konferenca shkencore ndërkombëtare. Fakulteti i Edukimit dhe Filologjisë, Korçë, 2012, fq. 357-358

[18] Noli, F.S. Introdukta, në Fan S. Noli. Vepra 6, Rilindja, Prishtinë, 1988, fq. 21-66

shtrigave dhe në lakminë për pushtet të lejdi Makbethit. Fuqitë e të mirës janë më misterioze dhe paraqiten në fillim vetëm në disa mendime të Makbethit si dhe në qëndrimet dhe aktet e njerëzve të ndershëm. Më parë korrin fitore fuqitë e së keqes, por kur konflikti dhe lufta përhapet në turmat popullore, atëherë forcat e së keqes pësojnë disfatë. Sikur përplasja të mos merrte fund, atëherë ajo do të përhapej në mbarë rruzullin tokësor, meqë Shekspiri ishte i bindur se drejtësia duhej ta provonte fuqinë e saj superiore, në mënyrë që të ngadhënjente e vërteta.

Në tragjedinë "Makbethi" e natyrshmja dhe e panatyrshmja janë të pleksura dhe të ndërthurura në atë mënyrë saqë shthurja e ngjarjeve të dalë në shesh dhe të kuptohej nga urtia popullore. Sipas Shekspirit, njeriu mund të dëshirojë dhe të lakmojë çdo gjë, po jo shfarosjen e njerëzve të zakonshëm, të rëndomtë dhe të drejtë. Fuqitë e gjithësisë të së keqes nuk mbrojnë atë njeri, i cili duke ju nënshtruar këtyre forcave, e vrasin një njeri të padjallëzuar dhe të ndershëm. Prandaj, Makbethi, pasi e vrau Dankanin në besë nuk mund të flejë nga brejtja e ndërgjegjes. Forcat e mira të gjithësisë e marrin nën mbrojtje atë njeri, i cili duke u shërbyer atyre, e shkatërron jetën e një të keqi dhe të padrejti. Prandaj, Makdafi, kur e vret Makbethin, si të merrte një hije dhe aureolë të një të shenjti.

Ndërkaq, në tragjedinë "Hamleti" Noli mundohet të zbulojë thelbin e hamletizimit të kësaj drame, siç shprehet që në hyrje të introduktit "të çvilluar e të zbukuruar me një mjeshtëri aq të çuditshme, saqë mund të quhet vepra theatrale edhe më popullore edhe më e thellë që luhet mi shkenë". Siç dihet tek Shekspiri aftësia hipnotizuese, imagjinata tejkalojnë çdo lloj kufiri njerëzor. Për Nolin, lexues të thellë, tërë tragjedia e shpirtit të Hamletit përmblidhet në vargjet: Kjo botë u çthur o prapësi, o dreq,/ Që unë paskam lindur të të ndreq.

Kësaj radhe ai i bënë një përshkrim të denjë e sugjestiv andrallave dhe vujatjeve pa fund të Hamletit, këtij shpirti delikat që befas "i përmbyset bota mbi kokë; S'është as i gjallë as i vdekur, as i marrë as nër mënt; ndodhet buzë vdekjes, buzë vetëvrasjes, buzë marrëzisë, buzë greminës, ku e di që shpejton a vonë do të përmbyest e do të copëtohet. Mendja e tij banon në varrezat, midis fantazmave, skeleteve dhe kafkave...; Gjakmarrja e tij është një vepër arti...; Hamleti është piktura më e pasur dhe e thellë që ka dalë nga penda e Shekspirit... ; Hamleti është dushku më i lartë dhe më i bukur i pyllit shekspirian", etj.[19] Tragjedia mbi princin e ri danez, Hamletin, mbase nuk është vepra e tij më e përsosur, por është gjithsesi vepra më e famshme dhe më madhështore në dramaturgji. Mendimet që përmban kjo vepër janë të thella, por megjithatë janë edhe të kuptueshme për shikuesin dhe lexuesin e kësaj drame. Mos të harrojmë se personazhi i Hamletit shpreh shumë gjëra apo ide, që duhet ta kenë shqetësuar edhe vetë Shekspirin. Ajo që është individuale është njëkohësisht me aq rëndësi gjithënjerëzore saqë shumë krikikë, duke e sqaruar dhe interpretuar karakterin e Hamletit, në mënyrë të tërthortë interpretojnë qëndrimin e tyre ndaj jetës.

Ja se pse shumë kritkë të njohur janë përpjekur që ta interpretojnë dhe kuptojnë karakterin e Hamletit, por edhe përkundër gjithë përpjekjeve të tyre ai mbetet personazhi më enigmatik në botën e dramës. Teni në këtë personazh e gjente vetë

[19] Rredhi, G. Vepër e cituar fq. 359

Shekpsirin. Gervinusi e konsideronte Hamletin idealist. Bodelshteti konsideronte se Hamleti është një personazh, i cili nuk mund të përputhet me ambientin dhe rrethin e tij. Kurse, Ygo mendonte se ai është mizantrop. Në të vërtetë, Hamleti mund të jetë ai për të cilin mendojnë dhe besojnë kritikët e tij. Por, në të vërtetë, çdo lexues i zgjuar ndien se Shekspiri përmes Hamletit ka shprehur kryesisht veten e tij në vitet e para të shekullit XVII.[20]

Së këndejmi, Shekspiri në shpirtin e vet duhet të ketë qenë njëherësh jo vetëm Hamlet, por edhe Brut, Makbeth, Jago dhe Çezar. Të gjitha këto personazhe rrjedhin (dalin) nga bota e brendshme dhe misterioze e Shekspirit. Madhështia e Shekspirit konsiston në atë se ai në të njëjtën kohë ka qenë çdo gjë në botën e imagjinatës. Kur e lexojmë "Hamletin" me një vëmendje më të përqendruar, atëherë do të na shpalohet tërë laryshia e personaliteti të Shekspirit, si poet, mendimtar, aktor dhe dramatrurg, vëzhgues i hollë dhe i zgjuar i vetvetes dhe i shoqërisë.

Për shkak të cilësive poetike dhe meditative, për shkak të dhimbje dhe pikëllimit të misterit të jetës, për shkak të formës së përsosur artistike, të cilën e merr ajo dhimbje dhe ai pikëllim dhe për shkak të ndjenjës së madhështisë, që e kaplon atë, Hamleti mbetet, që nga fillimi e deri më sot si në Angli ashtu edhe në tërë botën, gjithmonë i ri, joshës dhe magjepës, përherë i afërt dhe i qartë për çdo shikues dhe lexues, një ushqim shpirtëror si për njerëzit më kompleks dhe intelektual ashtu edhe për njerëzit e rëndomtë.

"Jul Çezari" duket në shikim të parë si një tragjedi e lakmisë për pushtet, e cila në pa vetëdije lakmon ta ketë pushtetin hyjnor. Por, në një vështrim më të thellë do të del në shesh se kjo vepër është një tragjedi e frymës së Republikës romake, që nuk e ka kuptuar se i ka kaluar koha dhe se ka arritur epoka e re e frymës perandorake. Fryma e re perandorake i ka përfaqësuesit e vet te Jul Çezari, Antoni dhe Oktaviani; fryma e vjetër republikane mbështetet, mbrohet dhe lakmohet nga Kasi dhe Bruti. Shekspiri na rrëfen konfliktin midis këtyre dy frymave dhe sistemeve dhe triumfin e frymës së re mbi frymën e vjetër.[21]

Pas kësaj, tragjedia e "Jul Çezarit" me skena dhe akte të përkryera, kur paraqitet botërisht Çezari, apo kur komplotistët e vrasin Çezarin, apo kur Bruti dhe Antoni me oratorinë e tyre perfide e mashtrojnë turmën popullore, apo kur Bruti dhe Kasi bien në konflikt e pastaj pajtohen. Kjo tragjedi ka një mori të madhe të mendimeve të rëndësishme që paraqiten në mënyrë të natyrshme, në çastet dhe skenat e duhura. Megjithatë, me personazhet e fuqishëm, me ngjarjet që shpalohen vazhdimisht, gjithmonë ka mbetur një tragjedi tejet aktuale për publikun që nga koha e Shekpsirit e deri më sot.

Në këtë mënyrë, Shekspiri i frymëzuar nga vepra e Plutarkut "Jetët paralele" e dramatizoi aq bukur këtë vepër saqë krijoi, vëren ose thekson Noli: "Veprën teatrale më të fortë të botës, duke sintetizuar këtë periudhë të historisë romane aq mjeshtërisht, sa "Jul Qesari" i tij i shkurtër, vlen më tepër se duzina vëllimesh mbi

[20] Qosja, R. Gjurmëve të një kritiku letrar, në: Fan S. Noli ndër bashkëkohanikët, Rilindja, Prishtinë, 1968, fq. 130-145
[21] Noli, S.F. Vepër e cituar, fq. 29-32

këtë themë prej historianësh të specializuar". Në vijim, Noli cek se ka kritikë modern, të cilët vënë në dukje se vrasja e Jul Qesarit ishte një krim dhe një gjakderdhje e kotë. Këta kritikë, vëren Noli: "Nuk i gjykonin vrasjet politike sipas standardeve të sotmes, sepse sipas standardeve të botës republikane dhe antike të Greqisë dhe Romës, vrasësit e tiranëve lavdëroheshin si kryetrima liberatorë, kurse vrasja e tiranit quhej vepër e lartë dhe detyrë patriotike e çdo qytetari të lirë". Noli nuk pajtohet me argumentin sipas të cilit gjakderdhja kishte qenë e kotë, meqë "qesarizma" triumfoi edhe pas vrasjes së Jul Qesarit, ndërsa përgjigjen më të mirë na japin me gojën e tyre Bruti e Kasi kur thonë se: "Vepra e tyre do të mbetet në histori dhe se emrat e tyre si çlirimtarë të atdheut do të përmenden jetë pas jete prej brezave të ardhshëm".

Ç'është e vërteta, Bruti dhe Kasi, sipas bindjes së thellë të Nolit, i ngjasojnë shumë njëri- tjetrit, ndonëse përfaqësojnë dy shkolla politike. Ata, sipas Nolit, përfaqësojnë dy sisteme të ndryshme dhe janë të një mendjeje se përmbysja e regjimit tiranik, "duhet bërë pa mëshirë dhe pa skrupulla morale". Mirëpo, si shkruan Noli, pas hapit kryesor, pas vrasjes së Qesarit, Bruti dhe Kasi ndahen. Kasi ishte i mendjes se duhet shkuar shpejtë me çdo mjet duhen qëruar hesapet me armiq dhe nuk duhet treguar mëshirë ndaj kundërshtarëve, kurse Bruti mendonte se për ta fituar lirinë duhet marrë një rrugë me syçelësi, me shokë të zgjedhur, me mjete fisnike dhe pa gjakderdhje të mëtejme, por si populli i Romës ashtu edhe parësia, thekson Noli, nuk janë fajtorë që ndejtën me një anë të ftohur e të terrorizuar dhe i lanë të vetmuar, në baltë Brutin dhe Kasin. Ndërkaq, në fund Noli thekson: "Këtë qëndrim fatal e paguan shtrenjtë pastaj, duke hyrë nën zgjedhje tiranie, të cilin e mbajtën brezat e pastajmë në zverk shekuj me radhë, gjersa u shkatërrua dhe u zhduk perandoria Romake". Aludimi dhe anologjia janë më se të qarta. Tërë Introdukta e autorit dhe e përkthyesit kushtuar "Jul Qesarit" duket sheshit se është shkruar me aluzione, krahasime dhe paralelizma historike ndërmjet fatit të Romës antike dhe Shqipërisë pas vitit të vështirë dhe fatal për Nolin, në vitin 1924.[22]

Kështu, këto shqipërime të veprave të Shekspirit dhe të tjerëve në kohën kur nuk kishte ndonjë përvojë të madhe në traditën e letërsisë shqipe, ishin rezultat i një pune serioze dhe me përgjegjësi të një intelektuali që habiti jo vetëm gjuhëtarët tanë, por edhe personalitete të kulturës botërore. Në vargun e shumë përkthimeve që po ashtu qëndrojnë në kulmet e vlerave të përkthimologjisë në gjuhën shqipe, shqipërimet e tragjedive të Shekspirit, edhe sot llogariten më të mirat nga të gjitha përkthimet që janë bërë nga shumë gjuhë të botës. I tërë ky gjenialitet qëndron para së gjithash, në respektin intelektual që kishte ndaj gjuhës së tjetrit, vlerave letrare që dëshironte t-i sillte të palënduara në gjuhën tonë, dhe me njohjen e mrekullueshme të kësaj gjuhe në tërë shtrirjen e saj. Ky mister i Nolit qëndron edhe në aftësinë e tij për aktivizimin e fjalëve të reja që ndoshta nuk ishin dëgjuar e as lexuar deri atëherë.

U mor vesh fjalën e fuqishme estetike dhe etike të Shekspirit, si element themelor për ndërtimin e veprës së tij të madhe, Noli e modifikoi duke i dhënë

[22] Raifi, M. "Misioni i Fan S. Nolit", në: Fan S. Noli, Vepra 7. Rilindja, Prishtinë, 1988, fq. 311-312

ngjyrim, kuptim dhe muzikalitet shqip, pa rrezikuar se mund ta deformojë idenë e Shekspirit, pa rrezikuar se mund t'i japë kahe tjetër. Përkundrazi, Noli ishte shumë i sigurt se largimi nga një përkthim besnik e fjalë për fjale që mund të kishte ndonjë peshë gjuhësore, do të varfëronte veprën e Shekspirit në gjuhën shqipe. Me veprimin e tij, drejt shqipërimit e jo përkthimit, e afronte lexuesin shqiptar kah thelbi i veprës shekspiriane dhe kështu ajo vepër e ruan madhështinë artistike pa e lënduar fare idenë poetike dhe mesazhet e saj. Trajtën e fjalës së huaj, në këtë rast të gjuhës angleze, e përpunon deri në masë, kur bindet se ka fituar një trajtë të kapshme në gjuhën e vet, por nga e njëjta materie.[23]

Periudha e fundit (1961-1965)

Në fund, në periudhën e fundit (1961-1965), apo të qetësisë dhe pleqërisë, ka përkthyer një sërë poezishë nga letërsia angleze dhe amerikane. Nga letërisa angleze ka përkthyer poezinë "Në munç" të R. Kipllingut (1962), poezinë "Atdheu im" të U. Skotit (1962), poezinë "Në vëngjillen e vdekjes" të Ç. Tiçbornit (1963) dhe poezinë e W. Noksit "Kotësia njerëzore" (1963). Kurse nga letërisa amerikane ka përkthyer poezinë e H. Mellvillit "Dëshmori" (1963) dhe poezinë E. Mekhenit "Njeriu dhe shatën" (1963).

Ndërkohë, poezinë e Radiar Kiplingut, prozatorit të shquar dhe poetit anglez të periudhës viktoriane, me titullin "Në munç", Noli e botoi në "Diellin" e 1 nëntorit të vitit 1961. Fjala është për një poezi meditative, me ca elemente dhe dilema në formë antitezash filozofike, morale dhe etike. Tema e kësaj poezie (në mënyrë kushtore: "Në munç") është qëndresa e njeriut të ndershëm përballë sfidave, sprovave, tundimeve, ngasjeve, goditjeve dhe të papriturave të hidhura e të pamëshirshme të jetës. Një njeri i tillë, sipas poetit, duhet ta ruajë gjakftohtësinë edhe përballë damkosjeve së shokëve; të ketë vetëbesim në qëllimet dhe idealet e tij, edhe kur të tjerët s'i besojnë; të ketë durim, nerva e karakter të sinqertë, edhe kur të tjerët e gënjejnë, shpifin dhe e përbuzin; të ketë mendimin dhe qëndrimin e vet, po të mos bëhet rob i tyre; të presë njësojë shkëlqimin dhe rëniet, triumfin dhe disfatën; të ketë tolerancë ndaj kapadaillëkut; të çajë përpara, edhe pse e ka goditur e liga; të mos përfillë as para, as pasuri dhe të mos zhytet në pesimizëm; të jetojë me mbretin, po ta respektojë vegjëlinë; të jetojë me turmën e skamnorët, por të mos bëhet mendjemadh; të mos jetë i keq as me miq, po as të mos bëjë armiq; ta kalojë jetën në punë me vepra të zellshme, por mos të jetë si sehirxhi e badihavxhi. Pra, një burrë me karakter, të çiltër, parime dhe virtyte të tilla, do ta meritojë admirimin e poetit, i cili një të këtillë, do t'i brohorisë me nderime: Zaptove dhenë me çdo mall dhe hir/ Dhe ca më mirë, qenke trim mor bir!"[24]

Ndërsa, poezinë elegjiake "Atdheu im" të Uolter Skotit, themeluesit të romanit historik anglez të periudhës romantike (si dhe poetit të talentuar), Noli e shqipëroi dhe e botoi në gazetën "Dielli", më 4 shkurt 1962. Kjo poezi ka dy pjesë, ndërsa

[23] Bexheti, V. Vepër e cituar, fq. 396

[24] Bihiku, K., Periudha e fundit e krijimtarisë poetike të Nolit, në: Fan S. Noli, Vepra 7. Rilindja, Prishtinë, 1988, fq. 647-650

tema e saj është dashuria, malli dhe vuajtjet e të mërguarit fatlig e të tretur për atdheun. Në vargjet e para të kësaj poezie, autori ankohet: A rron njeri në botë me shpirt të vdekur/ Cili kurrë veten s'e ka pyetur:/ Është ky vent për mua, mëmëdheu im?/ E cili fare s'i është djegur zemra/ Që kur la shtëpinë pa iu kthyer këmba/ Duke bredhur në vend të huaj pa qëllim?/ Shënoje mirë, një njeri i tillë rron...

Në këtë mënyrë, "I treturi" ose "I syrgjynosuri" i kësaj poezie, e ruan të gjallë dashurinë ndaj atdheut jo duke shikuar hartën, po duke admiruar atë në zemër. Kihet përshtypja se ky i syrgjynosur ka dalë jashtë atdheut, me kusht që ta duaj atë edhe më tepër. Ai bredh, punon, arrin suksese në jetë, por asnjëherë nuk është i lumtur, ngaqë e djeg malli i pashuar për trojet e të parëve. Një të syrgjynosur të këtillë, jo vetëm që s'e çmojnë sa duhet të huajt, por ai, në vendin e huaj, është i dënuar me mospërfillje, indiferencë, injorim dhe harresë. Në pjesën e dytë të kësaj poezie, i syrgjynosuri i drejtohet përmes një apostrofe Skotlandës, atdheut të vet, truallit të dokeve, traditave dhe zakoneve fisnike, kreshnike të syrgjynosurit fatlig.[25]

Pastaj, poezinë "Kotësia njerëzore" të poetit të panjohur Uiliam Noks, të periudhës së romantizmit anglez, Noli e botoi në "Diellin" e 14 gushtit 1963. Në një shënim të shkurtër, Noli, vëren: "Këtë vjershë e deshti shumë presidenti martir Abraham Linkoln dhe thuhet që e këndoi në mbrëmjen e funtme, përpara ditës kur u shtri i vrarë prej plumbit të asasinit (vrasësit)". Në këtë poezi meditative, didaktike dhe filozofike, autori e vë në shënjestër kotësinë, kryelartësinë e tepruar dhe kryeneçësinë, të cilat e shpijnë njeriun drejt greminës, izolimit dhe mëkatit. Një njeri i kapluar nga kotësia, çfarëdo që të bëjë, të arrijë, të realizojë, sipas poetit, të gjitha "do të përmbysen tok e hidhen në gërmadha", ose do të "dërrmohen posi vala nëpër zall", ngaqë pdo gjë është relative, sepse fundi i jetës, vdekja do t'i barazojë të gjitha krijesat, prandaj poeti e rikujton kotësinë njerëzore: Përse njeriu është kryelartë?/ Si dritë vetëtin, si valë na vëngon/ Nga jeta në pushim, në varr kalon.

Më tej, poezinë e autorit të panjohur dhe fatprerë, Çidiok Tiçbornit, nga periudha e Renesancës angleze (shek.XVI), me titullin "Në vëngjillen e vdekjes", Noli e botoi më 4 shtator të vitit 1963. Tema e kësaj poezie të trishtuar elegjiake është gjendja shpirtërore e një djaloshi, para dënimit me vdekje. Pothuajse e tërë poezia është e përshkuar me një atmosferë e dhembshuri të zymtë. Në rrëfimin e tij të sinqertë, i dënuari me vdekje, ankohet se që në lulen e rinisë, e katandisën hallet, e mira iu kthye me të keqe, brengat s'ia kuptoi asnjëri dhe megjithëse i shkoi rinia, ai s'u plak, por po vdes i zhgënjyer, pa shpresë, larg miqve dhe ngushëllimit. Rrëfimi prekës, e arrin kulmin në strofën e tretë, ku theksohet fatkeqësia e tij: Kërkova vdekjen dhe në zemër e gjeta,/ Kam dashur jetën dhe kufomë mbeta,/ Barita tokën, varrin tim e miha,/ Tani po vdes, kur jetën time e nisa,/Kupa m'u mbush, tani m'u zbraz, u vrashë,/Tani po rrojnë, tani jetën e lashë." [26]

[25] Cicko, A., Një studim përqasës i "My Native Land" i V. Skotit në përkthimin e Nolit, në: "Fan S. Noli në 130 vjetorin e lindjes 1882-2012". Konferenca shkencore ndërkombëtare. Fakulteti i Edukimit dhe Filologjisë, Korçë, 2012, fq. 321-322

[26] Fan S. Noli, Kotësia njerëzore, në Albumi, Rilindja, Prishtinë, fq. 149

Mandej, poezia e E. Mekhemit "Njeriu me shatën" është botuar në korrik të vitit 1963. Në këtë poezi Makhëmi bëhet fjalë për punën, jetën, vuajtjet në jetën e vështirë e të rëndë, shfrytëzimin dhe shtypjen e fshatarit, i cili në këtë jetë kalon si në ferr, për shkak të dallimeve klasore dhe paralajmërohet kryengritja kundër shfrytëzuesve të tij. Në strofën e fundit, shqipëruesi e lokalizon me disa vargje porosinë e kësaj poezie edhe për lexuesin shqiptar, duke pyetur: Ç'do të pësonjë kralet e Dovletit/ Ata që katandisnë siç u bë/ Kur ky terror do t'i buçasë Zotit/ Xhevap me nam pas heshtjes shekullore?

Dhe, në poezinë e H. Mellvillit "Dëshmori", e botuar në mars të vitit 1963, tema është vrasja e një udhëheqësi popullor të shquar dhe liridashës në kurth dhe në mënyrë tinëzare, duke e vrarë edhe mirësinë dhe lirinë në mënyrë të pabesë dhe paralajmërohet përsëri ngritja e popullit, që vajton dhe rënkon, por edhe mendon të hakmerret për krimin e kryer nga "të fuqishmit".[27]

Një ndër karakteristikat e dalluara të këtyre poezive të shqipëruara nga Noli, është se autorët e tyre, ose janë të njohur si prozatorë të shquar, si Skoti e Kiplingu, ose janë autorë jo aq të njohur. Nolin, sipas të gjitha gjasave, e kanë joshur, frymëzuar e nxitur që t'i hyjë shqipërimit të këtyre poezive, para së gjithash mesazhi, ndjenjat dhe vlera e tyre etike, humane dhe poetike, pastaj me siguri dhe vlerat tjera, ngjashmëritë dhe situatat që aludojnë në përvojën, idetë, tonin, vuajtjet dhe shkëlqimet e rëniet e jetës së shqipëruesit.

Konkluzioni

Është me rëndësi të theksohet se Noli bëri shqipërime jo vetëm të afta për të mbijetuar dhe për t'u lexuar, por në të njëjtën kohë na dhuroi vepra të përkthyera me aq zotësi e mjeshtri çfarë nuk ia doli askush t'na ofrojë gjer tani. Përkthimet e Nolit janë bërë pjesë përbërëse e kulturës sonë, kështu që, Hamleti jeton në të vërtetë në ambientin tonë vetëm në saje të përkthimit artistik të Nolit, ndërsa "Rubairat" lexohen, stërlexohen dhe citohen vetëm ashtu dhe asistoji si i shqipëroi dhe rikrijoi Noli. Së këndejmi, sot mund të themi me gojën plotë, se Noli pati diçka edhe shekspiriane, fitcxheraldiane, poiane, khajamjane dhe ibzeniane në veten e tij.

S'do mend se, Përkthyesi i ynë më i shquar, tregoi dhe faktoi me vepër, se të përkthesh do të thotë të krijosh artistikisht, me durim, urtësi dhe pasion të pashtershëm fisnik. Ai shkriu një pjesë të madhe të prirjes së tij poetike në përkthim dhe prandaj ia doli mbanë që të bëjë përkthime që të rrëmbejnë e të magjepsin edhe dhjetëra vite pas përkthimit. Mjafton të themi se vetëm "Rubairat" janë një kryevepër e tillë përkthimi, ku spikatet dhe del në pah tërë delli i rrallë poetik i përkthyesit, zhdërvjelltësia dhe afiniteti i shqipëruesit të talentuar e të rysur. Me të këtilla përkthime, Noli në njëfarë mënyre qysh atëherë qe në gjendje të marrë për dore lexuesin shqiptar, ta shpien dhe ta shetisë atë nëpër viset ku ai s'do të mund të shkilte aso kohe.

Prandaj, s'është çudi se sa herë që i lexojmë poezitë e përkthyera nga Noli, kemi përshtypjen se asnjë poet i përkthyer nga ai nuk e humbi hijeshinë dhe

[27] Fan S. Noli, Vepër e cituar, fq. 151

bukurinë e poezisë së vet dhe as që u dëmtua apo "u zbehë" nga ai. Kjo ngase Noli qe edhe vetë poet i madh dhe artist i rrallë. Sepse ai në përkthim e sipër, hove-hove, si një artist i vërtetë i frymëzuar gjatë krijimtarisë artistike, diti të identifikohet me metaforën, figurën, fjalën poetike e madje edhe me botën poetike të poetit, të cilin e përktheu. Ai, në rast nevoje, diti të imitojë e të transponojë për mrekulli autorin të cilin e përktheu, po nganjëherë u rropat të gjejë fjalën, vargun, idenë dhe botëkuptimin adekuat e te qëlluar në gjuhën që përktheu. Ai diti të depërtojë në shpirtin e autorit të cilin e përktheu dhe të krijojë e ta transponojë atmosferën e pothuaj të çdo vepre që përktheu e shqipëroi.

Lypset të kihet parasysh se shpeshherë mundësia më e mirë për pasurimin e një letërsie kombëtare arrihet edhe përmes përkthimit të zhanreve, gjinive apo kategorive që s'janë zhvilluar sa duhet në letërsinë kombëtare. Në këtë mënyrë, vepra e përkthyer shpeshherë i nxit apo i cyt gjinitë e pazhvilluara gjithaq të letërsisë kombëtare në atë sektor apo në atë fushë ku i mungon tradita. Me fjalë të tjera, vepra e përkthyer jo vetëm që hapë shanse dhe mundësi për zhvillimin e letërsisë kombëtare, por edhe e zhvillon, begaton dhe avancon letërsinë kombëtare. Përveç kësaj, Noli përktheu kur tradita e krijuar në letërsinë shqipe nuk ishte shtritë akoma sa duhej në gjini të tilla letrare si proza dhe dramaturgjia, meqë letërsia shqipe në atë kohë ishte duke kaluar nga Romantizmi i Rilindjes në periudhën e Realizmit. Së këndejmi, Noli kishte edhe kriterin e të zgjedhurit të veprave të huaja që i përkthente në gjuhën shqipe. Me këtë rast, duhet thënë se, në kohën kur Noli merrej me përkthime, numri i veprave dhe kreyveprave të letërsisë botërore nuk ishte i madh, prandaj ai zgjodhi, përktheu dhe dha shqip, në përgjithësi, ato vepra që i nevojiteshin shoqërisë, kulturës dhe lexuesit shqiptarë.

Ca nga këto konstatime janë në harmoni të plotë dhe në frymën e vlerësimeve të shumicës së studiuesve të veprave të Nolit. Shumica syresh janë të mendimit se shqipërimet e Nolit janë rikrijime të vërteta artistike. Me fjalë të tjera, Noli nga një anë tregoi se e njihte thellë gjuhën amëtare, po njëkohësisht e njihte shumë mirë edhe një mori gjuhësh të huaja dhe kishte talent për të rikrijuar veprat ose kryeveprat e letërsisë artistike botërore.

Për zotësinë e Nolit si shqipërues, një vlerësim mjaft të qëlluar ka dhënë edhe M. Kuteli, i cili ka shkruar: "*Pa fjalë se këtu lënda e parë, thema, është e huajtur, po këtë lëndë shqipëronjësi e ka tretur krejt në flakën e gjeniut të vet, duke na dhënë një ekuivalent shqipëtarë të një vepre absolute. Të tilla janë shqipërimet nga Poe "Korbi" dhe "Anabel Li", nga Longfellow "Skendërbeu" i shqipëruar në rithmin dhe masën e këngëve tona popullore, disa fragmente nga veprat e Shakespeare-it, si dhe një pjesë e madhe e "Rubairave" të Omar Khajamit*". Duket sheshit se, duke zgjedhur e përkthyer vepra dhe kryevepra të letërsisë evropiane dhe amerikane, Noli faktoi se ka një shije të hollë, se i njeh shumë mirë arritjet apo rezultatet artistike të shkrimtarëve të shquar botëror, nga një anë, dhe, nga ana tjetër, ai dëshmoi se ka edhe pirje dhe afinitet për përkthime.

Në këtë kontekst, duhet theksuar se Noli është përkthyesi i parë i letërsisë angleze dhe amerikane në gjuhën shqipe dhe gjithashtu edhe përkthyesi i parë i veprave të Shekspirit në një kohë kur askush nuk mund të besonte se kishte mundësi për përkthimin e veprave të gjeniut botëror. Ndërkaq, motivet e Nolit për

përkthimin në fazën e parë të përkthimit kanë pasur për qëllim zgjimin dhe thellimin e ndjenjës kombëtare, ndërsa më pas, në fazën e pjekurisë, motivet e tij kanë qenë kryesisht rrënjosja e idesë së lirisë, barazisë dhe vlerave demokratike dhe eliminimi i ideologjive reaksionare, obskurantiste dhe diktatoriale. Por kësaj, në pleqëri ai përktheu edhe për qëllime edukative, zbavitëse, meditative dhe filozofike. Përkthimi i kryeveprave të letërsisë botërore, në përgjithësi, dhe letërsisë angleze dhe amerikane, në veçanti, kishin për qëllim pasurimin dhe letërsisë kombëtare, nga një anë, dhe, nga ana tjetër, thellimin apo zgjerimin e ideve dhe botëkuptimeve artistike, estetike, etike dhe letrare të lexuesit.

Duhet përmendur po ashtu se, meqë gjuha i paraprinë letërsisë dhe është lënda kryesore e letërsisë, leksiku, pasuria leksikore dhe semantike janë anët e veçanta në shqipërimet dhe veprat origjinale të tij. Fjalori që përdorë Noli është vërtetë i pasur dhe i ka dhënë një ndihmesë të madhe formimit të gjuhës letrare shqipe. Ndërsa, shqipërimet e tij, veçanërisht të letërsisë angelze dhe amerikane zënë vend nderi në begatimin e kulturës sonë kombëtare, jo vetëm si dëshmi artistike e asaj kohe, por më parë si vlerë e dalluar dhe permanete gjuhësore dhe estetike.

Ndërkaq, në fund do thënë se Noli përmes shqipërimeve të veprave dhe kryeveprave të letërsisë botërore, në përgjithësi, dhe të letërsisë angleze dhe amerikane, në veçanti, ka bërë kthesë në letërsinë shqipe, duke i vënë themelet e modernizimit dhe përendimorizimit të letërsisë shqipe.

LITERATURA

1. Aliu, L., "Me përkthimet e Nolit, në 100 vjetorin e lindjes 1882-1982". Instituti Albanologjik i Prishtinës, Prishtinë, fq. 227-228.
2. Ashta, K., Revista "Shkëndija", Tiranë, nr. 4, 1940, fq. 50.
3. Belluscio, Gj., Koleci, F.: "Veçori gramatikore dhe strategji origjinale në përkthimin e "Othellos" së Fan Nolit nga anglishtja" në: "Fan S. Noli me 130 vjetorin e lindjes 1882-2012". Konferenca shkencore ndërkombëtare. Fakulteti i Edukimit dhe Filologjisë, Korçë, 2012, fq. 232-244.
4. Bexheti, V., Fan Noli dhe Shekspiri, në: "Fan S. Noli me 130 vjetorin e lindjes 1882-2012". Konferenca shkencore ndërkombëtare. Fakulteti i Edukimit dhe Filologjisë, Korçë, 2012, fq. 395.
5. Bihiku, K., "Periudha e fundit e krijimtarisë poetike të Nolit", në: Fan S. Noli, Vepra 7. Rilindja, Prishtinë, 1988, fq. 647-650.
6. Cicko, A., "Një studim përqasës i "My Native Land" i V. Skotit në përkthimin e Nolit", në: "Fan S. Noli në 130 vjetorin e lindjes 1882-2012". Konferenca shkencore ndërkombëtare. Fakulteti i Edukimit dhe Filologjisë, Korçë, 2012, fq. 321-322.
7. Ibrani (Gjinali), Z.,: Fan S. "Noli përkthyesi i parë i poezisë amerikane në gjuhën shqipe". Universiteti i Kosovës në Prishtinë, Fakulteti Filozofik, Prishtinë, fq. 67-68.
8. Kastrati, J., "Përkthyesit tanë të veprave dramaturgjike. Fan S. Noli si përkthyes", në Fan S. Noli ndër bashkëkohanikët, Rilindja, Prishtinë, 1968, fq. 204-205.

9. Konferenca shkencore ndërkombëtare. Fakulteti i Edukimit dhe Filologjisë, Korçë, 2012, fq. 388.
10. Noli, F.S., Vëllimi I, "Skendërbeu", Libraria Populllore, Boston, Mass 1916, fq. 4.
11. Noli, F.S., "Introdukta", në Fan S. Noli. Vepra 6, Rilindja, Prishtinë, 1988, fq. 21-66.
12. Noli, F.S. poet në: Fan S. Noli, Vepra 1. Botohet nën kujdesin e ASH të RPSSH, Tiranë, 1987, fq. 346- 347.
13. Noli, F.S., "Korbi i Poes", Revista Adriatike, Vol. 1, Boston, Mass., Shtator, 1918, fq. 38-41.
14. Noli, F.S., "Kotësia njerëzore", në Albumi, Rilindja, Prishtinë, fq. 149.
15. Pojani, V., Lubonja, B. dhe Bonja, E. "Poema "Skendërbeu" e H.W. Longfellow përmes shqipërimit të F. S. Nolit", në: "Fan S. Noli me 130 vjetorin e lindjes 1882-2012".
16. Qosja, R., "Gjurmëve të një kritiku letrar", në: Fan S. Noli ndër bashkëkohanikët, Rilindja, Prishtinë, 1968, fq. 130-145.
17. Raifi, M., "Misioni i Fan S. Nolit", në: Fan S. Noli, Vepra 7. Rilindja, Prishtinë, 1988, fq. 311-312.
18. Rredhi, G., "Mendimi kritiko letrar i Fan Nolit në lidhje me artin klasik botëror", në: "Fan S. Noli me 130 vjetorin e lindjes 1882-2012". Konferenca shkencore ndërkombëtare. Fakulteti i Edukimit dhe Filologjisë, Korçë, 2012, fq. 357-358.
19. Zhuri, N., Noli: "Përkthyesi dhe kritiku", në: "Fan S. Noli me 130 vjetorin e lindjes 1882-2012". Konferenca shkencore ndërkombëtare. Fakulteti i Edukimit dhe Filologjisë, Korçë, 2012, fq. 384.

JOLANDA LILA

IRONIA SI PJESË E STRUKTURËS POETIKE TEK ALI PODRIMJA

Procesi i ironifikimit në poezinë bashkëkohore shqipe nuk mund të themi se është një tipar zotërues, i kudogjendur, por megjithatë është i pranishëm në doza të ndryshme tek shumë autorë, të cilët e kanë ngritur shprehjen poetike në nivelet e poezisë moderne evropiane, falë ekonomizimit të gjuhës dhe forcimit të objektivitetit artistik. Këto tipare krijojnë mundësinë e ndërtimit të ironisë dhe rritjes së larmisë interpretative të poezisë. "Zbatimi i ironisë ka të bëjë në rend të parë me kundërvënien parimore të subjektit lirik ndaj çështjeve, objekteve dhe fenomeneve ekzistuese, e po ashtu, mund të zhvillohet edhe brenda vetë procesit poetik si kundërvënie e brendshme e materialit poetik, fjalëve, të folurit, e të ligjërimit në përgjithësi, apo të figurave të ndryshme poetike, të cilat vendosin edhe kundërvënie kuptimore që është finaliteti i ironisë".[1]

Vetë procesi i krijimit të ironisë kërkon një talent krijues dhe po ashtu, zbërthimi i kësaj figure mund të realizohet nga lexues të kultivuar, por duke pasur parasysh rrethanat socio-kulturore në vendin tonë, as niveli krijues dhe as ai receptues nuk ka qenë në lartësinë e duhur, të paktën në mënyrë masive, për ta bërë pjesë të sistemit të gjerë poetik këtë figurë. Nëse bëjmë një përqasje me poezinë moderne evropiane, konstatojmë dy fakte që nxjerrin në pah raportin joharmonik zhvillimor mes dy realiteteve: së pari, përdorimi i ironisë me trajta moderne në poezinë shqipe ka nisur rreth një shekull më vonë (diku nga vitet '70) krahasuar me poezinë evropiane dhe gjithashtu, niveli i shtrirjes ndër krijues është i rrallë. Pavarësisht vonshmërisë në të dyja këto drejtime, poetët shqiptarë e kanë pasur si model reference ironinë e përdorur nga poetë të njohur të poezisë moderne evropiane. Sigurisht, përvoja ndikuese është veshur me tiparet origjinale krijuese dhe me specifika të përftimit të ironisë në poezinë shqipe.

Gjuha e ironisë është përdorur me sukses në një sërë krijimesh poetike të Zef Zorbës, Ali Podrimjes, Azem Shkrelit, Sabri Hamitit, Eqrem Bashës, Rrahman Dedajt dhe Beqir Musliut, si dhe gjendet në një masë më të vogël në poezitë e Natasha Lakos, Luljeta Lleshanakut, Xhevahir Spahiut, Agron Tufës etj. Ndërsa poeti i ri Ervin Hatibi është ndër krijuesit më të rëndësishëm bashkëkohor të gjuhës ironike në poezi, e cila kryesisht del në trajta parodizuese ndaj absurditeteve të kohës dhe ndaj të kaluarës uniformizuese dhe të rreme.

Në mjedisin kulturor të Kosovës, poeti Ali Podrimja ishte ndër të parët që revoltën e vet poetike ndaj realitetit dhe padrejtësive të kohës e shprehu përmes

[1] Rugova, Ibrahim "Strategjia e kuptimit", Rilindja, Prishtinë, 1980, f. 185.

figurës së ironisë, konkretisht në disa poezi të vëllimit "Sampo" (1969) dhe në librin "Torzo" (1971). Me anë të kësaj figure përshkohen, gjithashtu, edhe poezitë e vëllimeve të fundit poetike "Ishulli Albania" dhe "Pikë e zezë në blu". Vlen të theksojmë se ky trop stilistikor shpërfaqet në shumë prej poezive të këtij autori, duke u përdorur me sasi e nivele të ndryshme: herë në strukturën bazë të poezisë, e herë si element përplotësues i koncepteve dhe i ideve poetike.

Përdorimi i ironisë në poezi shquhet për intonacionin e veçantë, i cili e plotëson kuptimin e figurës.[2]* Kështu, edhe në poezinë e Ali Podrimjes ironia është ngritur mbi tjetërsimin e përmbajtjeve të dukurive dhe në raste të rralla krijohet me figurat e fjalëve. Pra, më tepër sesa ironinë verbale, ndeshim ironinë e situatës, në të cilën fenomenet paraqiten përmes logjikës së paradoksales, ku ka një mospërputhje mes asaj që pritet dhe asaj që ndodh në të vërtetë. Ndryshe kjo quhet edhe "ironi dramatike, sepse përmbys të gjitha pritshmëritë normale dhe rendin e zakonshëm të

[2]* Termi "ironi" e ka zanafillën nga karakteri komik grek Eironi, ose "shtirësi", një person që shfaqej si injorant, ndërkohë që kuptonte gjithçka dhe që bënte sikur mashtrohej apo goditej nga e vërteta trashanike dhe pompoze e Alazonit. Në ironinë e situatës, eironi është zëvendësuar nga lexuesit, të cilët janë njohur me situatën reale të karakterit apo të subjektit lirik përpara se ai ta njohë vetveten dhe për pasojë, mund të parashikojnë dhe shijojnë dështimin e ideales nga aktualja. Ironia sokratike rrjedh nga kjo origjinë komike dhe ka në thelb të pyeturit naiv të njerëzve të llojeve të ndryshme mbi tema të ndryshme, vetëm e vetëm për të nxjerrë në pah padituринë e thellë të tyre. Sipas Sokratit, njeriu është i paaftë të njohë esencën e qenies dhe të natyrës dhe sa më i ditur të jetë, aq më shumë të panjohura hapen përpara dijes së tij. Kështu, krijoi dhe thënien paradoksale "E di që nuk di". Kjo lloj ironie përfshin kontrastin mes asaj që është thënë dhe, pak a shumë, asaj që nënkuptohet si e kundërta. Përdorimi joletrar i ironisë zakonisht konsiderohet si sarkazmë.

Ironia konsiderohet një mënyrë bisede apo të shkruari që përçon kuptime të ndryshme dhe zakonisht të kundërta me ato që shpallen dhe thuhen. Studiuesit kanë dalluar shumë tipa të ironisë si: ironia verbale, ironia strukturale, ironia e ndryshueshme, sarkazma, ironia sokratike dhe ironia dramatike, tragjike, kozmike, e romantike. Këto tipa mund të reduktohen në dy kategori të mëdha: ironia verbale dhe ironia e situatës, ku njëra operon me logjikën e përkundërt të fjalëve të paraqitura në tekst dhe tjetra me kundërvënien e situatave të nënkuptuara përmes tekstit.

Për nga mënyra e ndërtimit strukturor, ironia e poezisë moderne klasifikohet në katër lloje kryesore: 1. Fabulare, ku huazohen elemente të fabulave (përrallave) që zbërthehen semantikisht dhe funksionalizohen nëpër situata të reja poetike që varen nga qëllimi i ironizimit. 2. Figurative, ku bëhet kombinimi figurativ i objekteve me qëllimin e ironisë dhe thyhet figura normale poetike. 3. Kuptimore, ku shfaqet mospajtimi artistik i poetit mbi kuptimin e ideve dhe gjërave që pajtohen e njihen. 4. Konkrete, ku metaforizohen objektet dhe idetë ekzistuese.

Kjo figurë letrare është konsideruar si arti i së tërthortës dhe i pranëvënies, duke e mbështetur suksesin e saj në teknika të tilla si, mosshprehjen haptas, paradoksin, lojën e fjalëve dhe forma të tjera të mençura të shprehjes dhe të mospërputhjeve.
Ashtu si simbolizmi, alegoria dhe metafora, ironia përbën një mjet për unifikimin e kontradiktave të dukshme të përvojës, por gjithashtu është e aftë që në mënyrë unikale të vlerësojë diversitetin e botës. Shih për më gjerë: “A rethoric of irony”, The University of Chicago Press, Chicago, 1974.

fenomeneve, duke marrë forma të shumta"[3]. Konteksti i ironisë së poezisë podrimjane mund të kërkohet në sferën psikologjike, morale, sociale, metafizike etj. Paradoksi dhe situatat e kontrasteve mprehin pandalshmërisht tehun e ironisë. Për shkak të kësaj përftese krijuese, gjetja dhe zbërthimi i thelbit poetik bëhet shpesh i vështirë, sepse kjo nuk është një figurë lehtësisht e dallueshme. Më shumë sesa në fjalët dhe në shenjat gjuhësore, ironia gjendet në strukturën tërësore të tekstit. "Më tepër se brendi, shprehje dhe strukturë zotëruese/ dominante, ajo është një bashkëbanuese dysi-dyfishësi (*dualité-duplicité*, term i marrë nga teoria e ironisë), që përshkon ligjëratën lirike, herë më shumë e herë më pak, duke ndërfutur në të shtresa të tjera domethëniesh dhe trajtash, ngjashëm me poezinë moderne e pasmoderne të gjuhëve të tjera."[4]

Në poezinë e Ali Podrimjes, ironia shfaqet me tipare të veçanta, tërësisht origjinale, ajo është një ironi e hollë, me tipare moderne dhe që gjendet në thellësi të strukturës poetike, ashtu siç ngjet edhe në poezinë moderne bashkëkohore, ku kjo figurë qëndron gjithnjë në rrafshin kontekstual. Për të kuptuar më qartësisht përftesën e ironisë në vargjet e Ali Podrimjes do të analizojmë poezinë "Torzo", si një prej gjedheve tipike të ironisë, jo vetëm në krijimtarinë e këtij autori, por në përgjithësi në poezinë shqipe.

Torzo, trajta ironike moderne

Me simbolin e torzos shënjohet titulli i njërit prej vëllimeve poetike të Ali Podrimjes, botuar në vitin 1971 (ribotuar në vitin 1979), që përmban dyzet e gjashtë poezi, mes të cilave edhe poezinë me titullin "Torzo". "Kjo figurë i përket fushës së skulpturës dhe arkitekturës, por kuptimi burimor i saj rrjedh prej qenies njerëzore. Torzo është figurë njerëzore e dëmtuar, e gjymtuar, e cunguar, madje e deformuar. Ajo nuk ka as kokë, as gjymtyrë (krahë e këmbë), është vetëm tors, gjoks".[5]

Huazimi i figurave prej arteve të tjera (skulptura, piktura, kinematografia etj.) është një tipar i poezisë së këtij autori, që përdoret për të kondensuar më tepër mendimin poetik. Një qasje më të detajuar studimore, në lidhje me këtë tipar, ka realizuar studiuesi Bashkim Kuçuku, i cili ka përftuar një lloj teksture, duke ballafaquar elementet e arteve të tjera me mishërimin që gjejnë në poezinë podrimjane. Veçanërisht ai e sheh ironinë dhe simbolin në dritën e marrëdhënieve mes pikturës, skulpturës dhe letërsisë.

Barasvlerës kuptimor i Torzos është deformimi maksimal i figurës njerëzore dhe shëmtimi. Atë ngrehinë të torzionit që paraqitet në skulpturë dhe prej saj transplantohet në mitologji, Podrimja e ndërton në poezi:

[3] W. Empson, Seven Types of Ambiguity, (1947), Publish by Pimliko 2004, Great Britain, fq. 38-47.

[4] Bashkim Kuçuku, Një lidhje parabolike mes vëllimin "Lulet e së keqes" dhe "Torzos", gazeta Nacional, Tiranë, korrik 2012, fq. 5-6.

[5] Mercatante, Anthony S. "Dizionario universale dei miti e delle leggende", Edizione Mondolibri S.p.A., Milano su licenza Neëton & Compton editori s.r.l., 2001, f.604.

Gjithkund kaloj e kurrkund s'jam
në ndonjë kohë po më takuat ndonjëherë
ju lutem mos më lini pa emër

(Poezia "Torzo", f.332)

"Kur studiuesi i letërsisë, e veçanërisht i poezisë, mëton të bëjë një qasje studimore përballet me dy alternativa vlerësimesh: së pari, vlerësimi i lëndës poetike që niset nga ideja dhe e japin idenë në mosrealizimin e saj, që duket gjithnjë interesante, vizionare dhe e pafundme dhe së dyti, vlerësimi që niset nga realja, e cila shpesh nuk kënaq shijet emocionale dhe sjell zymtësi e brenga të tjera".[6] Në rastin e vlerësimit të poezisë "Torzo" këto alternativa nuk mund të ndahen, por paraqiten si përplotësuese të njëra-tjetrës. Koncepcioni poetik i këtyre vargjeve ngrihet mbi një skicim të njeriut dhe të botës, që rendin pandalshëm në kohë dhe në hapësirë. Këtë lëvizje të përhershme të Torzos, studiuesi Ibrahim Rugova e përkufizon me sintagmën latine "perpetum mobile"[7], që nënkupton një ndryshueshmëri të përhershme në pafundësi. Subjekti lirik paraqitet në lëvizje dhe në ndryshim, ku herë shfaqet gjithkund, e herë mbetet vegimi dhe hija e tij e zbrazët, sepse ekzistenca e vet nuk lë gjurmë të njëmendta. Torzo vjen si imazh dhe mirazh në të njëjtën kohë, që ndodhet kudo dhe askund njëkohësisht. Referencat kohore dhe vendore shprehen në formë të papërcaktuar, gjë që i jep tipare përgjithësuese kësaj figure në kohë dhe në hapësirë. "Poeti duke analizuar torzionin e gjithhershëm të ekzistimit të botës dhe të njeriut, arrin në konstatime të hidhura, që i metamorifikon me emërtimin Torzo".[8]

Në thelb të lëvizjes së Torzos është ironia dhe vepron kundërlogjika, sepse "perpetum mobile" ndodh nga një qenie që i ka të shkëputura të gjitha gjymtyrët lëvizëse të trupit, ndodh nga një bust që kurrsesi nuk mund të bëjë as grimcën më të vogël të zhvendosjes.

Kjo është ndërtuar mbi një oksimor, ku bashkohen jo dy fjalë kundërthënëse, por dy situata të kundërta, të cilat vënë përballë njëra-tjetrës dy kuptime paradoksale. Në studimet semiotike kjo dukuri shënjohet me emrin *antifrazë*, duke nënkuptuar përdorimin e një fjale ose një vargu në sens të kundërt me kuptimin e vet të zakonshëm apo të drejtpërdrejtë. Për pasojë, prodhohet efekti i ironisë.[9] Kundëvënia dhe paradoksalja këtu përftohet mes titullit dhe vargjeve, të cilat shenjojnë dy situata të kundërta me njëra-tjetrën. Njëra situatë (titulli i simbolizuar "Torzo") është tregues i staniacionit, qëndrimit në një vend, pamundësisë për të lëvizur, ndërsa situata tjetër (vargjet e poezisë) nënkuptojnë lëvizjen e pandërprerë, ku kalohet gjithkund, por që gjurmë nuk lihen askund. Poetizimi i kësaj kundërvënieje është motori gjenerues i ironisë dhe i paradoksit.

---

[6] "*I mettodi attuali della critica in Italia",* A cura di Maria Corti, Cesare Segre, Italy, 1980, f.17.

[7] Rugova, Ibrahim "Strategjia e kuptimit", Rilindja, Prishtinë, 1980, f. 83.

[8] Rugova, Ibrahim "Strategjia e kuptimit", Rilindja, Prishtinë, 1980, f. 87.

[9] Dictionary of semiotics, Bronëen Martin and Felizitas Ringham, Casell, Neë York, (first published 2000), 2000, f. 25.

Letrarisht, këtu kemi të bëjmë me ironi kuptimore, e cila përqendrohet në ironizimin e kuptimeve dhe të botëkuptimeve ekzistuese, përmes së cilës poeti kërkon të deklarojë mospajtimin e tij artistik mbi kuptimin e ideve dhe gjërave që pranohen e njihen. Kuptimi i përgjithshëm pasurohet me një model të botëkuptimit të krijuesit, i cili shpalos një vizion poetik, që përmbushet me elementin artistik e humanizues.[10] Këtë mënyrë të ndërtimit të figurës së ironisë e ndeshim edhe në shumë krijime të tjera të Ali Podrimjes.

Ironia është si një armë shumëfunksionale dhe një lloj strategjie poetike, e cila mund të gjenerojë përdorime me shumë efekte"[11]. Në poezinë "Torzo" nuk ekzistojnë gjurmë në tekst që të na çojnë tek burimi i torzionit, shkaku thjesht hamendësohet duke parë natyrën dhe përmasat e pasojave, të cilat reflektohen që në titull dhe zgjerohen më tej në tre vargjet eliptike të poezisë, vargje që kanë më shumë natyrën e aforizmës.

Gjuha kundërvënëse dhe ironike e ndërtimit të kësaj poezie shëmbëllen një sistem semantik shumëfaqësh, që përvijon përbërësit thelbësor të ekzistencës njerëzore. Thirrja përmbyllëse e poezisë "ju lutem mos më lini pa emër" nxjerr në pah brengën e subjektit lirik, për të mos mbetur pa identitet. Emri është një nga të dhënat kryesore të identitetit të njeriut, që e shoqëron gjatë gjithë jetës. Ndonjëherë emri dallon sipas krahinës dhe kombit. Në këtë gjendje transi, në këtë situatë të pezullt dhe në këtë kaotizëm ekzistencial, subjekti lirik ka vetëm një dëshirë, qëllim dhe kërkesë njëkohësisht: të mos mbetet pa emër.

Rifunksionalizimi i Torzos zhvillohet në dy dimensione: në gjymtimin fizik dhe në atë psikologjik të tij. Gjymtimi i Torzos nuk është vetëm në aspektin fizik, ku i mungojnë krahët, këmbët dhe gjymtyrët lëvizëse, por në risemantizimin poetik të kësaj figure, atij i mungon liria për të menduar e vepruar, i mungon përkatësia e një hapësire qëndrimi, i mungon identiteti dhe gjithçka përreth tij është mungesore. Ka një skenë mangësie absolute, braktisjeje emocionale, të dëbimit dhe të vetmisë së plotë tmerruese.

Gjendja e Torzos është shëmbëlltyrë e situatës emocionale e psikologjike, në të cilën gjendet njeriu nën një regjim shtypës. Politika kundëretnike përkthehet në politikë kundëridentiteti. Për pasojë, njeriu pa identitet vetjak dhe kombëtar është askushi dhe ekzistenca e tij shenjon gjithnjë kohën zero në hapësirën që mbetet edhe ajo në kufirin e zeros. Mungesa e përkatësisë së identitetit është e barasvlershme me asgjësimin e qenies dhe ky asgjësim prodhon pakohësinë.

Përveç kësaj logjike ekzistenciale, simboli i Torzos bart edhe një shpjegim tjetër në një nivel më të gjerë. Gjymtimi fizik i kësaj figure krijon analogji me gjymtimin e etnisë shqiptare. Ky përngjasim bazohet në ballafaqimin midis dy realiteteve kontradiktore: gjithkund jam e kurrkund s'jam, ku hapësirat e kombit shqiptar dhe vetë shqiptarët ekzistojnë kudo, por gjendja reale e Shqipërisë ka përmasa fatale, sepse në të vërtetë këto nuk janë më pjesë e saj. Edhe këtu mbizotëron një ndjesi e humbjes dhe e mungesës së atdheut të vërtetë. Kjo është

[10] Abrams, M.H. *A glossary of literary terms,* Cornell University, Canada, 1999, 875.

[11] Kumar, Shiv K., Interview with Shiv K. Kumar, ed.Shyam Asnand, Literature Criticism,1:1.2,1991-92, p.151.

frymë sugjestive për diasporën, për shpërndarjen e popullit shqiptar nëpër botë, për humbjen e identitetit kombëtar nga të konsideruarit si të huaj prej të tjerëve. Subjekti lirik shpreh ankthin dhe frikën se përkatësia etnike e këtyre hapësirave të shkëputura, mund të mos vlerësohet, madje mund të harrohet dhe për këtë arsye, këmbëngul që të mos mbetet pa emër.

Ashtu si pamja skulpturale e Torzos, është edhe harta fizike e Shqipërisë së sotme, të cilës i ka mbetur vetëm trungu, sepse degët e gjymtyrët e saj janë prerë. Në këto kontekste, Torzo paraqet rrafshin individual të jetës së deformuar si pasojë e shtypjes, rrafshin kombëtar të etnisë shqiptare të gjymtuar dhe njëkohësisht, rrafshin universal të qënies njerëzore të thyer.

Edhe vetë paraqitja grafike e tekstit dhe struktura formale e kësaj poezie përmbajnë botëkuptimin e torzionit, sepse është mbizotërues konciziteti nëpërmjet elipsës. Vetëm tre vargje strukturojnë një opus semantik shumëdimensional. Mungojnë shenjat e pikësimit, mungojnë pjesë të ligjëratës, mungojnë referencat e kronotoposit, mungon emocioni, mungon çdo gjurmë që të shpie te përmasa njëkuptimore, por kurrsesi nuk mungon mendimi, i cili gjeneron kuptime të pafundme.

Sipas studiuesit Ibrahim Rugova, Torzo ka në qendër relacionin njeriu-bota, që është ndër relacionet më dominante në gjithë poezinë e Podrimjes. Tek Torzoja realizohet qëllimi që të kërkohen elementet qenësore të qenies njerëzore në dy fusha ku ajo ekziston: njeriu si ide, si mundësi dhe njeriu si realizim, si produkt shoqëror e njerëzor. Duke dhënë diagnozën e njeriut të realizuar, përmes një analize mjaft të fuqishme poetike, në mënyrë fare të qartë dhe bindëse del ideja mbi njeriun dhe fushën e qeniesimit të tij, pikërisht botës. Ideja e tij është brengë për mosrealizim, e që këtë mosrealizim e sinjalizon përmes shkatërrimit, fundosjes ironike të elementeve ekzistuese.[12]

Relacioni njeriu-bota merr të tjera dimensione sipas këtij studiuesi, sepse etimologjikisht fjala botë korrespondon me shoqërinë, me bashkësinë njerëzore; është një qenësi, realizimin e së cilës e bart qenia njerëzore. Në këtë poezi kjo merr kuptimin shenjëzues-simbolik dhe shpesh del si objekt-simbol. Kështu, bota si hapësirë kohore-ekzistenciale e ekzistimit shpirtëror lidhet ngushtë me faktorin që e krijon kuptimin e saj, me njeriun. Pra, semantikisht, bota është fushë e realizimit të njeriut dhe njëkohësisht rezultat i relacioneve njerëzore. Nëpërmjet figurës minimale të Torzos, shpaloset pamja maksimale dhe plotënia e botës njerëzore.

Situatën ekzistenciale të Torzos dhe nëpërmjet tij, krizën e qënies në kushte ekstremisht të vështira, studiuesi Mensur Raifi, e konsideron si simbol të protestës dhe njëkohësisht, simbol të guximit që çdo dukuri të quhet me emrin e vet. Torzo është një mallkim i shprehur me zërin artistik dhe pa e përmendur, pa e përsëritur atë fjalë.[13]

Ngritja e strukturës së poezisë mbi parimin e ironisë dhe simbolit lë shteg për shumësi interpretimesh dhe pasuron rrafshin kontekstual, njëlloj si parimi i

[12] Rugova, Ibrahim " Stategjia e kuptimit", Rilindja, Prishtinë, 1980, f. 84.
[13] Raifi, Mensur. Simbolikë e protestës. Në "Mbi poezinë shqipe bashkëkohëse shqiptare", Rilindja, Prishtinë, 1977, f. 37

ajsbergut, ku vetëm një pjesë minimale sipërfaqësore qëndron zbuluar, ndërsa pjesa tjetër është e mbuluar.

"Gjuha e poezisë ka nevojë jo vetëm për stolisje e mesazhe të drejtpërdrejta, por edhe për elemente e figura që nënkuptojnë përmbajtje të ndryshme. Bukuria e një poezie i përngjan bimës së lulëzuar, së cilës për të qenë e tillë i nevojitet kërcelli, gjethet dhe rrënjët e fshehura". [14] Kur flitet për strukturën ironike të poezisë merret edhe një tjetër analogji me fushën e artit, ku poezia konsiderohet e ngjashme me dramën. Efekti i përgjithshëm përftohet nga të gjitha elementet e dramës dhe ashtu si drama, edhe një poezi e mirë nuk ka pjesë të tepërta e të panevojshme, por vetëm elemente në funksion të efektit të përgjithshëm poetik. "Në funksion të ikjes nga gjuha e drejtpërdrejtë përdoret metoda ironike e thënies së një gjëje për të shenjuar diçka tjetër"[15]. Struktura poetike është ironike ngaqë ajo që thuhet ndryshon gjithmonë për nga shkalla dhe për nga lloji nga ajo që nënkuptohet. Në rastin e "Torzos" shfaqet universi alogjik përkundër deklarimit logjik.

Shënjimi i simbolit vetëm në titullin e poezisë dhe zbërthimi i figurës në pak vargje, nxjerrin në pah aftësitë krijuese të Ali Podrimjes. Ai risemantizon jo vetëm Torzon si simbol, por faktorizon përmes tij një dukuri të pranishme kudo, pikërisht torzionin, ose gjymtimin, i cili është përherë ekzistent, mbi të gjitha në gjendjen emocionale e psikologjike të qenies.

Literatura e shfrytëzuar:

1. *A rethoric of irony,* The University of Chicago Press, Chicago, 1974.

2. Abrams, M.H. *A glossary of literary terms,* Cornell University, Canada, 1999.

3. Brooks, Cleanth, "Irony as a principle of strukture", *Modern poetry and the tradition*, The University of North Carolina Press, Chapel Hill, 1967.

4. Dictionary of semiotics, Bronwen Martin and Felizitas Ringham, Casell, New York, (first published 2000), 2000.

5. *I mettodi attuali della critica in Italia",* A cura di Maria Corti, Cesare Segre, Italy, 1980.

6. Kuçuku, Bashkim. "Një lidhje parabolike mes vëllimin *Lulet e së keqes* dhe *Torzos*", gazeta Nacional, Tiranë, korrik 2012, fq. 5-6.

[14] Brooks, Cleanth, "Irony as a principle of strukture", *Modern poetry and the tradition*, The University of North Carolina Press, Chapel Hill, 1967, f. 4.
[15] Northrop Fray, Anatomi of criticism, Princeton University Press, Princeton, 1967, f. 105.

7. Kumar, Shiv K., Interview with Shiv K. Kumar, ed.Shyam Asnand, Literature Criticism,1:1.2,1991-92.

8. Mercatante, Anthony S. "Dizionario universale dei miti e delle leggende", Edizione Mondolibri S.p.A., Milano su licenza Neëton & Compton editori s.r.l., 2001.

9. Northrop Fray, Anatomi of criticism, Princeton University Press, Princeton, 1967.

10. Raifi, Mensur. Simbolikë e protestës. Në "Mbi poezinë shqipe bashkëkohëse shqiptare", Rilindja, Prishtinë, 1977.

11. Rugova, Ibrahim "Strategjia e kuptimit", Rilindja, Prishtinë, 1980, f. 185.

12. W. Empson, Seven Types of Ambiguity, (1947), Publish by Pimliko 2004, Great Britain.

ROGER COHEN

LUFTA E TRETË

Si ia shpjegon mamaja fëmijës fillimin e Luftës së Parë Botërore, problemin e tashëm sirian dhe Luftën e Tretë Botërore

"Mami, të lutem, ma thuaj sërish, si nisi Lufta e Parë Botërore?"

"Zemër, ta thashë një herë, ka ndodhur shumë kohë më parë. Një shekull është kohë shumë e gjatë".

"Por mami, të lutem".

'Epo, është e ndërlikuar. A do vërtetë që ta dish?"

"Po, mami".

"Është një histori e trishtë. Bota ishte organizuar në një mënyrë, dhe ajo mënyrë pësoi kolaps, dhe në proces u vranë miliona njerëz".

"Ua. Si ishte organizuar më parë?"

"Kishte gjëra që quheshin perandori. Ato kontrollonin hapësira të mëdha territori, plot me popuj të ndryshëm, dhe disa prej këtyre popujve donin që të vetëqeveriseshin, në vend që të qeveriseshin nga një perandor i largët".

"Ok".

"Perandoria Austro-Hungareze ishte një prej tyre. Kishte shumë pallate të mëdhenj në kryeqytetin e saj, Vienën, ku njerëzit vallëzonin në ballo të mrekullueshme. Ajo qeveriste pjesë të një qosheje të varfër të Europës, të quajtur Ballkan, ku sundimin e saj nuk e pëlqenin. Një ditë në vitin 1914, trashëgmitari i perandorisë Austro-hungareze dhe bashkëshortja e tij u vranë në një qytet ballkanik që quhet Sarajevë, nga një djalë i ri, serbo-boshnjak, i cili donte të çlironte sllavët e jugut nga sundimi perandorak".

"Kjo është e trishtë, mami. Muzika u ndal, ma merr mendja. Po pastaj?"

"Perandoria u zemërua vërtetë shumë. Ajo i kërkoi Serbisë të bënte disa gjëra, ose do të përballej me luftën. Sundimtari në Vienë kishte besim sepse kishte një shok të ngushtë, një fuqi në ngjitje e cila quhej Gjermani. Serbia kishte edhe ajo një shok të mirë, një vend që quhej Rusi, dhe që është i madh. Serbia u spërdrodh disi, siç bën ti me detyrat e shtëpisë, kështu që Austro-Hungaria nisi luftën kundër saj".

"Po pastaj?"

"Pastaj Gjermania i shpalli luftë Rusisë, e cila kishte mike Francën, të cilës nuk i pëlqente Gjermania, për shumë arsye. Shumë shpejt, Gjermania sulmoi Francën përmes Belgjikës. Kjo gjë zemëroi Britaninë. Ajo hyri në luftë kundër Gjermanisë. Një tjetër perandori – e sëmurë – që quhej Perandoria Otomane u bashkua me Gjermaninë dhe Austro-Hungarinë. Më vonë SHBA, një fuqi në ngjitje, iu bashkua ekipit franko-britanik. Pas pak vitesh, më shumë se 16 milionë njerëz kishin vdekur. Perandoritë austro-hungareze, otomane, gjermane dhe ruse ishin shembur".

"E gjithë kjo, vetëm se u vra një çift? E çuditshme".

"Ndonjëherë, gjërat e vogla rriten, njerëzit humbasin durimin dhe perspektivën, ka një shkëndijë dhe pastaj, një rrëmujë e madhe".

"Mami, mund të ndodhë përsëri, apo jo?"

"Jo".

"A ka mbetur ndonjë perandori sot?"

"Disa e quajnë Amerikën perandori, edhe pse ajo nuk ka perandor. Eshtë vendi më i fuqishëm mbi tokë, me ushtarë kudo përreth botës dhe popuj të ndryshëm që mbështeten tek ajo, për drejtim dhe mbrojtje. Por Amerika po dobësohet".

"Pra, mami, mos ka të bëjë me atë që më the, që bota organizohet në një mënyrë, dhe pastaj organizohet në një tjetër mënyrë, dhe në ndërkohë vdesin shumë njerëz?"

"Jo tamam, zemër. Vdesin ku?"

"Në Siri, mami. Çfarë është Siria".

"Eshtë një vend i vogël, me popuj dhe fe të ndryshme, që u krijua pas shembjes së Perandorisë otomane".

"Përse luftojnë njerëzit atje?"

"Eshtë e ndërlikuar. A do vërtetë që ta dish?"

"Po, mami".

"Ishte një tiran brutal, i largët, që vepronte si perandor, dhe disa prej popujve të Sirisë u ngritën kundër tij. Tirani filloi të qëllojë ndaj tyre. Amerika dhe Britania dhe Franca, mes të tjerëve, nuk e pëlqyen këtë, dhe thanë që do të mbështesnin rebelët, por nuk është se i ndihmuan ashtu si duhej".

"Pse?"

"Sepse siç të thashë, Amerika është e sëmurë. Po dobësohet".

"Ok, po pastaj?"

"Tirani kishte një shok të madh që quhet Rusi. Kishte dhe një tjetër shok të madh që quhej Iran. Ata të dy donin ta ndihmonin".

"Atëherë ai fitoi?"

"Jo tamam. Shumë prej atyre që donin ta hiqnin qafe tiranin ishin myslimanë sunitë. Ata kishin mbështetjen e Arabisë Saudite, e cila ka shumicë sunite dhe e urren Iranin dhe ka mbështetur fanatikët sunitë. Turqia, që ishte pasardhësja e Perandorisë Otomane dhe e urren tiranin sirian, u bashkua gjithashtu me rebelët. Por Turqia urren një tjetër popull në Siri, që quhen kurdët, më shumë se sa tiranin – kaq shumë, sa që në fshehtësi ka qenë gati të mbështesë një grup sunitësh të çmendur që presin fytet e njerëzve, vrasin kurdët dhe qëllojnë njerëzit në qytetet në Perëndim".

"Mami, u ngatërrova".

"Siria është ndarë, ashtu si Perandoria otomane. Rusia po bombardon disa armiq të tiranit sirian. Amerika po bombardon ata që presin fyte. Edhe Franca. Turqia rrëzoi një avion rus. Rusia është e zemëruar. Kurdët duan shtetin që nuk morën 100 vjet më parë. Arabia Saudite po lufton një luftë mbarërajonale kundër Iranit. Ajo luftë është më e fortë në Siri, ku qindra-mijëra kanë vdekur".

"E gjitha sepse disa njerëz donin të hiqnin qafe një tiran?"

"Ndonjëherë gjërat e vogla rriten, ka një shkëndijë dhe bëhet rrëmujë e madhe".

“Mami, si do të jetë Lufta e Tretë Botërore?”

“Mos u shqetëso, zemër, çdo gjë është ndryshe tani”.

“Tërësisht?”

“Tërësisht. Ne kemi jetën, lirinë dhe kërkimin e lumturisë. Gëzuar Ditën e Falënderimeve, e dashur”.

/The New York Times
/Në shqip nga Bota.al

JAMES PETTIFER

SI U MANIPULUA HISTORIA E BALLISTËVE NË MAQEDONINË PERËNDIMORE

Në Çamëri / Threspoti në Greqinë veri-perëndimore popullsia e mbetur shqipfolëse u dëbua ose u vra në vitin 1944 mbi bazën e bashkëpunimit të pretenduar me forcat e Boshtit nga milicia e djathtë e Napoleon Zervës, ndërsa në Kosovë dhe në Maqedoninë Perëndimore vetëm shumë pak shqiptarë etnikë kishin qenë aktivë me partizanët titistë. Shumica kishin qenë të lidhur me lëvizjen nacionaliste të pavarur të Ballit Kombëtar e cila u mund dhe u arratis.

Historia është se si ne e shohim veten në të kaluarën. Në periudhën post-komuniste në tranzicion në Shqipëri dhe gjetiu në Ballkan, ajo ka qenë një temë e diskutueshme dhe e rëndësishme jo më pak se sa ajo ishte nën komunizëm, apo në sistemet e mëparshme politike. Institucionet ndërkombëtare perëndimore, si Bashkimi Europian, kanë bërë financime dhe janë angazhuar për atë që ka qenë konsideruar si 'modernizim' i historisë komuniste të 'rreme' ose të 'shtrembëruar'. Arsyeja pse unë i hyra këtij studimi ishte se në realitet është shënuar një ndryshim shumë i kufizuar në drejtim të shkrimit ndërnacional të historisë që nga viti 1990, dhe se shumë shkrime historike post-komuniste shqiptare qëndrojnë në kornizat intelektuale në lidhje me identitetin kombëtar, kryesisht në gjuhësi dhe arkeologji, që u zhvilluan në periudhën komuniste. Për më tepër, disa aspekte të të shkruarit pas viteve1990 kanë mishëruar në të vërtetë fuqishëm konceptimet mbarëshqiptare, për shkak të 'ndreqjes' së historive të Ballit Kombëtar në Kosovë dhe ish-Maqedoninë jugosllave Perëndimore / Republika e Maqedonisë, të ndrydhura nga sistemet arsimore titiste dhe enveriste. Rëndësia e Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës në arritjen e pavarësisë së Kosovës në vitin 2008 ka të ngjarë të përforcojë analizën e traditave partizane dhe jozyrtare ushtarake në historiografinë shqiptare të Kosovës.

Është e rëndësishme që të sjellim ndër mend se historia shqiptare politike, ekonomike dhe ushtarake gjithmonë ka qenë pak e njohur jashtë vendit, në të vërtetë mund të thuhet se për periudha të gjata vështirë se mund të thuhet se kanë ekzistuar këto njohuri. Studimet e huaja janë përqendruar gjithmonë në historinë kulturore, gjuhën dhe letërsinë, nga përkthimet dhe tekstet letrare të botës veneciane të Buzaut dhe pasardhësve të tij ndaj hulumtimeve shkencore të helenizmit austriak nga Johannes von Hahn në shekullin XIX. Lexuesit anglezë në gjysmën e dytë të shekullit XIX mund të kenë mësuar për Skënderbeun nga poezia e Henri Uadsuorth Longfellout (Henry Wadsworth Longfelloë), ashtu si pesëdhjetë vjet më parë Bajroni kish përcaktuar një imazh të Shqipërisë në veprën e tij. Nuk do të kishte qenë e mundur për ta që, në të njëjtën kohë, të shkonin në ndonjë

librari në Londër apo Nju Jork dhe të blinin një histori të Shqipërisë, të çdo lloji, qoftë ky një libër i mirë apo i keq.

Në shumicën e kësaj tradite kulturore, figura e Skënderbeut, ikona kombëtare e shekullit të pesëmbëdhjetë ka qenë gjithmonë qendrore, duke mishëruar imazhin heroik të rezistencës më të spikatur popullore shqiptare kundër pushtimit osman. Para tij në gojëdhëna kishte vetëm shtypje, disfata, mister dhe pasiguri. Këta faktorë negativë u rishfaqën pas vdekjes së tij, me vendosjen e qindra vjetëve të sundimit osman. Pas Skënderbeut, shqiptarët u 'zhdukën' në Perandorinë Osmane, për t'u rishfaqur në traditën letrare angleze në periudhën romantike nëpërmjet Bajronit dhe përshkrimeve në poezitë e tij në oborrin e Ali Pashë Tepelenës. Në Francë, një autor si Pukëvili (Pouqueville) kreu të njëjtin rol. Pas rënies së Ali Pashës ndodhi një tjetër eklips i shkurtër, dhe pastaj historia shqiptare 'filloi përsëri' të flasë, në këtë perceptim, në periudhën e Rilindjes të mesit të shekullit të nëntëmbëdhjetë që përkon me ripërtëritjen e ndjenjave kombëtare me formimin e Lidhjeve të Prizrenit dhe të Pejës, pas vitit 1878. Kongresi i Berlinit pa mbërritjen e çështjes shqiptare në stadin diplomatik europian. Një brez pas saj erdhi shfaqja e ngadaltë dhe e pasigurt e shtetit të ri kombëtar shqiptar pas rënies së sistemit otomaniii.

Pas pavarësisë në vitin 1912 dhe dështimit të aspiratës për bashkimin kombëtar të shqiptarëve në konferencat e mbajtura para Luftës së Parë Botërore, historia shqiptare u përfshi në krizën rajonale që gllabëroi Ballkanin gjatë dhe pas konfliktit botëror. Mbijetesa e kombit ishte problematike dhe pa angazhimin e Shteteve të Bashkuara për një shtet të pavarur shqiptar në periudhën e negociatave të Traktatit të Versajës, kishte të ngjarë që ky territor të ishte ndarë midis Greqisë dhe Serbisë. Historia e periudhës midis luftërave është e njohur mirë, me monarkinë e brishtë zogiste që po gëlltitej nga Italia fashiste e Musolinit në vitet 1930.iv Çfarëdo interpretimesh që janë bërë për atë periudhë, në kuptimin e atmosferës së përgjithshme të historiografisë, duhet thënë se imazhet heroike ishin të pakta. Vetëm në historinë e Kosovës kanë zenë vend episode të tilla dhe këtu flitet për martirizimin, me figura të tilla si Bajram Curri dhe Hasan Prishtina, të cilët luftuan për nacionalizmin shqiptar parimor, duke humbur jetën e tyre në rrethana poshtëruese dhe të vështira.

Por me Luftën e Dytë Botërore, pushtimi nga forcat e Boshtit i Shqipërisë dhe Kosovës siguruan një terren ku diskutimi tradicional i rezistencës heroike ndaj pushtimit kombëtar mund të rifillonte. Ushtria komuniste partizane u përshtat me sukses ndaj instinkteve natyrore të pjesës më të madhe të shqiptarëve kundër forcave të Boshtit, duke zhdukur forcat e tjera të rezistencës, dhe bëri një rezistencë të shquar ushtarake në vitet 1943-1944 për çlirimin e kombit. Duke vepruar kështu, natyrshëm kryen edhe një luftë civile kundër nacionalistëve jo komunistë të bazuar kryesisht në veri të vendit, disa nga të cilët, si familja Kryeziu kishin qenë patriotë dhe që nuk kishin bashkëpunuar me forcat e Boshtit.

Ushtari partizan si individ u bë hero universal, ndërsa nga ana tjetër vetë Partia Komuniste përvetësoi heroiken, pasqyrimin e një kombi të vogël dhe të shtypur që gjeti sërish forcën, për të luftuar kundër pengesave të mëdha të forcave të huaja, dhe për t'i kapërcyer ato. Por ndërsa partizanët padyshim që dominuan forcat e

rezistencës në Shqipëri, dhe triumfuan, në Kosovë dhe Çamëri dhe në trevat me shumicë shqiptare në atë që u bë Republika Socialiste e Maqedonisë në kuadër të Jugosllavisë së dytë, historitë në këto vende të ndryshme ishin shumë të ndryshme. Në Çamëri / Threspoti në Greqinë veri-perëndimore popullsia e mbetur shqipfolëse u dëbua ose u vra në vitin 1944 mbi bazën e bashkëpunimit të pretenduar me forcat e Boshtit nga milicia e djathtë e Napoleon Zervës, ndërsa në Kosovë dhe në Maqedoninë Perëndimore vetëm shumë pak shqiptarë etnikë kishin qenë aktivë me partizanët titistë. Shumica kishin qenë të lidhur me lëvizjen nacionaliste të pavarur të Ballit Kombëtar e cila u mund dhe u arratis. Kishte partizanë çamë, siç thekson Enver Hoxha në librin e tij mbi marrëdhëniet shqiptaro-greke "Dy popuj miq", por ata ishin të paktë në numër dhe në situatën kaotike ushtarake në Epir ndërsa fuqia e Boshtit mori fund, çamë të tjerë luftuan në ushtrinë e rezistencës komuniste ELAS dhe disa me Ushtrinë Komuniste Demokratike në fazat e mëvonshme të Luftës Civile greke. Numri i vogël i luftëtarëve partizanë shqiptarë të Kosovës, më i shquari ndër të cilët, Fadil Hoxha u bë më vonë udhëheqës i Lidhjes së Komunistëve në Kosovë, kishte për të kapërcyer trashëgiminë e vështirë të pjesëmarrjes shqiptare në Kosovë në Divizionin SS nazist 'Skënderbeg', i cili ishte përdorur kundër partizanëve malazezë në fazën e fundit të Luftës së Dytë Botërore. Në Kosovë lideri më i aftë ushtarak i partizanëve shqiptarë etnikë, Kolonel Qemal Brovina u radhit në vitin 1948 me ata që ishin në favor të linjës ruse dhe ai u arrestua nga policia sekrete e Titos dhe u burgos në kampin e punës Goli Otok në Adriatik.v

Në vitin 1945, komunistët shqiptarë trashëguan këtë histori të vështirë.vi Kjo ishte një histori e pranisë kulturore dhe letrare në Perëndim, si dhe një prani antropologjike e hulumtimeve të udhëtarëve të hershëm si Mary Edith Durham, ashtu si historia mbizotëruese e Serbisë në botën anglisht-folëse ishte (dhe mbetet) ushtarake, 'roje te porta' siç tregon titulli i librit të midis luftërave të R.G. Laffan.vii Ajo kishte qenë paraprirë nga vepra të shumta, pak a shumë libra propagandistikë mbi marrëdhëniet britaniko-serbe në periudhën e Luftës së Parë Botërore. Një titull domethënës është ai "Serbia – Parajsa e të varfërit" i Herbert Vivian.viii Vështirësitë e periudhës së Zogut dhe rënia e kombit nën shtypjen e Italisë fashiste të Musolinit i shtuan vështirësitë për historianët. Kishte pak histori të 'mirë' për t'u rrëfyer në shekullin e njëzetë pas Shpalljes së Pavarësisë në Vlorë në vitin 1912. Në kuptimin e ndarjes me periudha, kemi një shekull të nëntëmbëdhjetë të shtrirë dhe shumë 'të gjatë' në historinë shqiptare, duke filluar nga rreth 1810-a dhe përhapja e njohjes së Ali Pashës, deri në shpalljen e pavarësisë në Vlorë, e cila u fitua vetëm në shekullin e njëzetë më 1912. Për studiuesit britanikë të fokusuar mbi origjinën dhe zhvillimin e idealit kombëtar jugosllav, periudha e ringjalljes kombëtare shqiptare, Rilindja dhe Pavarësia, nuk dha një figurë të vetme heroike të 'babait themelues' për t'u krahasuar me Vuk Karaxhiçin në historinë kulturore serbe. Heronjtë shqiptarë të Kosovës ishin luftëtarë, aktivistë, si Isa Boletini dhe Hasan Prishtina, sikurse kishte qenë në të vërtetë edhe Skënderbeu. Shkrimet e historianit të madh prusian Leopold von Ranke krijoi një model të ngjashëm të perceptimeve në botën gjermanike, ku studimi i tij për shfaqejn serbe dhe malazeze nga botët otomane dhe veneciane në

gjysmën e dytë të shekullit të 18-të, krijuan kredencialet 'heroike' të këtyre kombësive si faktorë kryesorë në Ballkanin pas Napoleonit.ix

Në vitet e pas Traktatit të Versajës dhe marrjes së pushtetit nga Ahmet Zogu (i cili më vonë u bë Mbret), pak shkrime të konsiderueshme historike u prodhuan në Shqipëri. Tradita historike ishte ende kryesisht gojore, kjo ndodhte më së shumti edhe ne Jugosllavinë e sapo-krijuar. Ishte koha e veprës me krijime të zgjedhura të folklorit epik të Lordit Albert, Milman Parry-i e të tjerëve, ndërkohë që veprat epike i tejkalonin kufijtë kufijtë bashkëkohorë të kombit, sikurse tregon përzgjedhja e Parry-t për kufijtë aktualë shqiptaro-malazezë dhe serbë. Këto krijime epike ishin në një kuptim real, historia e etnosit në këndvështrimin Rankeian. Shtysë themelore e qeverisë së re komuniste pas vitit 1945 ishte për ta vënë historinë, ashtu si dhe pjesët e tjera të shoqërisë, në baza "shkencore". Kjo bëhej për të kombinuar me fushatat kundër analfabetizmit masiv – para vitit 1939 vetëm një pjesë e vogël e popullsisë mund të lexonin dhe shkruanin, ndërsa arsimi i mesëm dhe i lartë nuk mund të imagjinoheshin jashtë disa qyteteve më të zhvilluara si Korça dhe Shkodra, madje në një farë mase edhe në kryeqytetin Tiranë. Në zonat rurale dhe malore, analfabetizmi ishte thuajse masiv. Kjo fushatë kundër analfabetizmit bëri që të dukeshin disa përparime të ndjeshme drejt modernitetit në disa fusha. Në zhvillimin e arsimit të lartë, pas vitit 1955, në disiplinën kryesore të historisë së lashtë të arkeologjisë ishin shënuar përparime. Ata u ngritën mbi përpjekjet e paraluftës të arkeologëve të huaj si Ugolini në Butrint dhe Leon Rey në Apolloni, të cilat u morën përsipër nga një brez i ri i studiuesish vendas, si Hasan Ceka. Ky hulumtim u përqendrua në objektivin e përforcimit të origjinës ilire të popullit shqiptar, si dhe të fillesës së tyre.x Pra, në shumë mënyra, kjo shënoi sjelljen e çështjeve bashkëkohore kombëtare në traditën intelektuale shqiptare. Puna ndoshta mund të krahasohet me vendosjen e gurëve të themelit për një ndërtesë të madhe, që kishte të bënte me ndërtimin e një historie në vazhdimësi të aktivitetit dhe arritjeve shqiptare. Ilirët ishin kooptuar në 'idealin heroik' të komunizmit në të tashmen shqiptare, me gjithë implikimet e zakonshme të një etnosi që luftonte kolonizimin e jashtëm nga Greqia dhe Roma. Por sigurisht, dihet pak për shumë aspekte të shoqërisë ilire, pasi ata fare pak gjëra të shkruara kanë lënë pas. Kështu ata kanë kontribuar ndjeshëm në bërjen heroike, por pjesërisht mitike – të imazhit të së kaluarës shqiptare, ndërsa disa figura të shquara të botës klasike dhe atë para-klasike, si mbreti Pirro i Epirit, ishin quajtur proto-shqiptarë. Pirro është simbolikisht i rëndësishëm, pasi e kaluara e tij ishte e lidhur me rezistencën ndaj pushtimit të huaj dhe mbrojtjen e territorit të vendit, një temë kryesore politike kjo për komunistët shqiptarë gjatë gjithë periudhës së sundimit të tyre nga viti 1945 deri në 1990. Regjimi komunist mund të thuhet se ka pasur disa suksese të vërteta në këtë drejtim, ndërsa arsimi shqiptar deri në ditët e sotme i ka pranuar këto 'zbulime', si pjesë e urtësisë së pranuar kombëtare dhe që është tërësisht e pakundërshtueshme. Rrëfimi i komunistëve ka vazhduar të mbetet një rrëfim kombëtar edhe gjatë viteve të gjata të qeverisë së djathtë të Dr. Sali Berishës në periudhën post-komuniste. Është ndoshta domethënëse se statuja e madhe e Partizanit heroik që simbolizon çlirimin e qytetit ka mbijetuar në qendër të Tiranës gjatë periudhës së Berishës, pa shqetësim, ndërkohë që pothuajse të gjitha

monumentet e krijuara gjithandej në kohën e Partisë së Punës janë shkatërruar, duke përfshirë edhe të gjitha statujat e vetë Enver Hoxhës. Partizanët me imazhin e tyre heroik vendor kanë mbetur të ngulitur në një mënyrë të ndershme në shkrimet historike si dhe në artin publik historik dhe praktikën ikonografike. Polemikat e forta mbi përpjekjet e qeverisë së parë Berisha ndërmjet viteve 1992 dhe 1996 për të modernizuar mozaikun në pjesën ballore të Muzeut Kombëtar në Tiranë kushtuar Luftës së Dytë Botërore e ilustrojnë më së miri këtë situatë. Kjo sigurisht nuk është e vërtetë për periudha të tjera të historisë kombëtare, siç demonstrohet me një pamje nënçmuese nga autori i shquar Ismail Kadare për të gjithë periudhën osmane të historisë shqiptare. Kur në vitin 1996 qeveria turke pagoi për ngritjen e një statuje në qendër të Tiranës, për një Pasha të shquar që kishte kontribuar në themelimin e qytetit osman, kështilli i qytetit u kritikua gjerësisht pse e lejoi atë.

Në Kosovë dhe në ish-Republikën Jugosllave të Maqedonisë situata me shkrimet historike ka qenë mjaft e ndryshme. Në këto hapësira që nga viti 1990, historia e periudhës së Luftës së Dytë Botërore ka ndryshuar tërësisht, kështu që në një qytet të rëndësishëm si Tetova, ekziston vetëm ai rrëfim që mund të quhet 'ballist' dhe në mësimdhënie nëpër shkolla dhe në tekstet e reja, si dhe në studimet vendore të bëra kohët e fundit nga historianët shqiptarë të Maqedonisë, pothuajse pa përjashtim mishërojnë tregimin ballist. Në Gostivar dhe në treva të tjera perëndimore të FYROM-it/Republikës së Maqedonisë statujat partizane janë dhunuar dhe shkatërruar shpesh gjerësisht. Tradita partizane këtu, ashtu si në pjesën më të madhe të Kosovës, është parë nga shqiptarët si 'sllavokomuniste', ku raca, etnia dhe një opinion marksist janë shkrirë në një. Në përdorimin e këtij termi, nacionalistët shqiptarë mbi të Djathtën politike duken të pavetëdijshëm pasi ata janë duke përdorur një term që është shpikur në Greqinë nacional-shoviniste të Metaxasë; transferimi i kuptimit nga zbulimet arkeologjike rreth Ilirisë së lashtë te shkrimet historike ka qenë i vështirë.

Në qendër të praktikës komuniste ishte kërkimi për histori të 'mirë' kombëtare, siç tregohet më lart. 'Mirë' domethënë 'heroike'. Historia e lashtë ishin transformuar nga arkeologët nga 'keq' – imperializmi i lashtë grek dhe pushtimi romak – në 'mirë' ku kishte tani një shfaqje të botës indigjene 'ilire' – edhe pse lidhja e saktë me shqiptarët moderne është e mezidukshme për disa. Por antikiteti i vonë dhe periudha mesjetare ishin shpesh të panjohura, me vetëm përcaktimin e një populli shqiptar në njëfarë mënyre. Periudha e Skënderbeut u pasua nga e ashtuquajtura 'zgjedha osmane'. Arkeologjia shkencore ishte ndoshta trashëgimia më e qëndrueshme e periudhës së hershme komuniste. Ajo ndryshoi ekuilibrin e gjithë rrëfimit, siç është provuar bota klasike në Shqipëri, ku lavdia greke dhe romake në një qendër si Butrinti është ndërtuar në fakt fizikisht mbi muret e lashta ilire. Kjo i kujtonte Enver Hoxhës dhe bashkëpunëtorëve të tij se Shqipëria ishte e rrethuar nga fqinjë armiqësorë, sidomos Greqia, e cila shpesh kërkon të denigrojë trashëgiminë e lashtë ilire dhe kjo ishte dhe ende është e lidhur me disa mendje ekstremiste greke për ambiciet irredentiste për të aneksuar pjesë të Shqipërisë jugore. Nëse e kaluara e lashtë ishte edhe ilire, si edhe greke dhe romake, Shqipëria ishte më e sigurt si një shtet. Kështu, kur historia nacionaliste e kombeve të tjera të Ballkanit si Kroacia ishte ngritur gjithashtu mbi 'Ilirianizmin', diku tjetër ai ishte

pjesë e një narrative të shekullit të nëntëmbëdhjetë, që më vonë u modifikua ndjeshëm dhe aspektet ilire ose u zbehën, ose u braktisën krejtësisht nga periudha e Traktatit të Versajës, në Shqipëri nuk ishte ndërtuar ashtu siç duhej mbi baza racionale deri pas vitit 1945. Ndërsa arkeologjia, ndryshe nga gjuhësia, është gjithashtu një temë gjerësisht popullore studimi nga akademitë dhe universitetet e huaja, ndërsa lidhjet me diskutimet popullore mbi ndërtimin e identitetit kombëtar në rrugë gjuhësore nuk janë bërë. Ka me qindra programe në televizionet europiane dhe amerikane çdo vit të frymëzuara nga zbulimet arkeologjike, por pak ose asnjë nuk ka që të lidhet me shkencat gjuhësore.

Si u kapërcyen këto boshllëqe dhe pengesa? Historia që jepej në shkolla dhe tekstet mësimore ishin një problem parësor. Në mungesë të një universiteti funksional në Tiranë për disa vjet pas 1945-s, çështjet e mësimdhënies së historisë në arsimin e lartë ishte urgjente. Pas shkëputjes me Titon në vitin 1948, imazhet pozitive të jugosllavizmit, në kuptimin më të gjerë, u hoqën nga programet mësimore. Gjithsesi, një dimension 'grek', ishte ruajtur. Zbulimet arkeologjike tregonin se ishte e pamundur të lije pas dore rolin e kolonizimit klasik grek në sjelljen e urbanizmit dhe 'qytetërimit' në trevat jugore shqiptare. Por ndoshta më i rëndësishëm ishte roli i shqiptarëve në Luftën greke të Pavarësisë. Kjo prodhoi imazhe heroike për të rinjtë e pjesëmarrjes shqiptare (udhëheqja shqiptare në disa vende, si në ishujt Hidra dhe Spetses, ose pjesë të Epirit jugor) në luftën për pavarësinë greke si edhe në luftën e gjatë antiosmane. Imazhet ishin gjithashtu tradicionalisht të përshtatshme si, fjala vjen, për luftën e burrave (apo grave, siç ishte rasti i Bubulinës, heroinë detare arvanitase në ishullin e Spetses në Gjirin e Saronikut) që me armë në dorë luftuan kundër një okupatori të huaj. Për Hoxhën dhe komunistët kjo ishte një histori shumë e dobishme. Heroikja kishte hyrë në tregimin modern nacionalist. Megjithatë, edhe në këtë periudhë ka pasur vështirësi. Figura e tmerrshme e Ali Pashës paraqet probleme për historiografinë shqiptare. Ai ishte padyshim 'shqiptar' në kulturën e tij të përgjithshme, por ai ishte gjithashtu një epirot që fliste mirë greqisht dhe ishte një tiran autoritar dhe shtypës i popullit. Edhe në vitet 1990 ishte e mundur të shihje vendbanimet e braktisura në Shqipërinë jugore që kurrë nuk qenë rindërtuar pas luftërave midis bejlerëve në periudhën e sundimit të tij dhe zhvillimet e mëvonshme kaotike.

Në pedagogjinë hoxhiste u përshtat një metodë shumë autoritare, nga 'lart poshtë' e 'ndriçmit' kombëtar. Një format me 'pyetje dhe përgjigje' ishte miratuar në mësimdhënien e historisë në shkolla, të cilat nxënësit i mësonin përmendsh. Kishte përgjigje 'e drejtë' dhe 'gabim' në të gjitha problemet historike, ndërsa nuk ishte inkurajuar debati i bazuar në dëshmi. Debati në arsimin e lartë ishte gjithashtu i rrallë, edhe në Universitetin e Tiranës, pasi ai u krijua, ndërsa hulumtimet objektive historike, përveçse në arkeologji, nuk ekzistonin. Përgjigjet ishin shpesh të kufizuara sa dhe pyetjet, ndërsa disa aspekte të teksteve shkollore të historisë në fillim të periudhës komuniste kanë një cilësi fetare që mund të shihet më shumë si një kundërmim i mësimit fetar se sa mësimdhënie normale e historisë. Kjo, sigurisht, mund të vërehet se nuk ishte e re në kulturën shqiptare, apo një produkt i prioriteteve marksiste-leniniste apo politikës enveriste. Thënia e famshme e nacionalistëve të shekullit të nëntëmbëdhjetë se 'Feja e shqiptarit është Shqiptaria'

e përmbledh këtë mjeshtërisht. Të kuptuarit e studimit historik është kështu në njëfarë kuptimi hegelian, me shpalosjen e një shpirti kombëtar shqiptar, i cili ka ngjyrime të ndryshme fetare. Arkeologjia u bë teologjia praktike e historisë kombëtare. Me gjuhësinë, ishte vendimtar krijimi shkencërisht i themeleve ilire të tablosë kombëtare.

Ajo është gjithashtu një perspektivë thellësisht elitiste, sepse fryma kombëtare mund të jetë në zemrën e të gjithëve, por jo edhe në aftësitë e tyre intelektuale. Ndërmjetësit e arsimuar ishin të domosdoshëm. Para vitit 1945 ata thuajse nuk ekzistonin. Në periudhën zogiste, edukimi shkollor kishte qenë i kufizuar për elitën vogël urbane, kryesisht në Tiranë, Shkodër, Korçë dhe Elbasan. Nën regjimin e Hoxhës, u ndërmor një fushatë masive arsimimi e përhapur në të gjithë vendin, duke ndjekur në shumë mënyra atë që kish ndodhur në Rusi pas revolucionit bolshevik, apo në Kinë pas vitit 1949. Në aspektin e të kuptuarit popullor të historisë, tradita gojore mbeti shumë e rëndësishme, si kudo në Ballkan, kështu që fëmijët e vegjël në shkollë mësonin se si të shkruanin fjalët e këngëve që kishin mësuar tashmë në prehrin e gjysheve të tyre. Një rrëfim i unifikuar dhe i zhvilluar i historisë kulturore dhe gjuhësore ishte një thirrje më shumë për të përforcuar ndërgjegjen kombëtare dhe për të mbuluar problemet e të kaluarës politike dhe ushtarake. Por sigurisht kjo traditë gojore ishte ajo e 'shqiptarëve', jo e 'Shqipërisë' së pas vitit 1912 . Partia e Punës e Shqipërisë u bë ndërmjetësja që interpretoi frymën historike kombëtare pas vitit 1945, dhe që nuk do të duronte dot kundërshtime për interpretimet që bënte, por mbijetesa e traditës së madhe historike gojore do të zbuste kuptimin e rolit të tyre, për, fjala vjen, figura të tilla si Skënderbeu dhe Isa Boletini që ishin heronj të gjithë shqiptarëve, sikurse tregon statuja madhështore e këtij të fundit, që u ngrit në periudhën komuniste në qytetin përgjithësisht anti-komunist verior të Shkodrës.

Kështu mendimi i intelektualëve komunistë pas vitit 1945 në shumë çështje historike dhe kulturore ishte i padallueshëm nga ai i shumicës së njerëzve, ndonëse shumë njerëz nuk e pëlqyen instalimin e komunizmit. Kjo mund të ndihmojë për të shpjeguar se atë që kanë shprehur shumë vëzhgues të huaj për mbijetesën e diktaturës Hoxha më shumë se sa pritej, në periudhën e krizës së përgjithshme të regjimeve komuniste të Europës Lindore në vitet 1980, që kulmoi me rënien dramatike të viteve 1989-1990. Ajo gjithashtu ndihmon për të shpjeguar vështirësitë që ekzistojnë ende në historiografinë kombëtare. Komunistët nuk kishin asnjë problem me historinë kulturore; në fakt ata e kanë përdorur atë me zgjuarsi për qëllimet e tyre. Ajo u plotësua shpejt nga historia ushtarake e cila pas viteve 1950 shpejt u bë shumë e rëndësishme. Kjo gjithashtu reflektoi një ngushtim të pikëpamjeve, një refuzim të mbarëshqiptarizmit në përkufizimin e çështjes kombëtare. Për Partinë e Punës, historia ushtarake, thuajse ekskluzivisht ajo e partizanëve në Luftën e Dytë Botërore ngushtoi fokusin mbi Shqipërinë dhe përjashtoi përfundimisht Kosovën dhe shqiptarët e tjerë fqinjë në një masë të jashtëzakonshme, kështu që në botimet e mëvonshme të historisë zyrtare të Partisë së Punës së Shqipërisë nuk përmendej Kosova. Historia e shqiptarëve në Ballkan në përgjithësi u ngushtua dhe u zhvendos në historinë e vetëm Shqipërisë. Rrëfimi ishte dominuar gjithmonë nga luftërat vendore dhe rezistenca ndaj sundimit të huaj,

sidomos atij osman, natyrisht. Rezistenca komuniste partizane ndaj pushtimit të Boshtit në Luftën e Dytë Botërore ishte parë si trashëgimtarja e vetme legjitime e kësaj tradite. Megjithatë, ajo nuk mund të jetë një zëvendësim për një histori koherente kombëtare që mbulon periudhat shumë më të hershme dhe, mbi të gjitha, përvojën historike të shqiptarëve gjatë shekullit të njëzetë, të cilët deri në Luftërat Ballkanike (1912-1913) kishin jetuar së bashku në sistemin osman pa ndarje nga kufijtë e rinj shtetërorë. Në tekstet komuniste, ka pasur shumë, shumë mangësi.

Çfarë ishte lënë jashtë qëllimisht, si periudha me disa nga aspektet jo 'heroike'? Kjo ishte një periudhë madhore. Kjo është periudha e antikitetit të vonë dhe Bizantit. Hoxha dhe bashkëpunëtorët e tij ndiheshin komodë me botën arkaike dhe antikitetin klasik, siç u tregua më lart, ndërsa origjina 'ilire' e disa perandorëve të vonë romakë ishte gjithashtu e dobishme. Por pastaj dolën vështirësitë. Bizanti ishte një entitet i pakëndshëm për nacionalistët shqiptarë dhe intelektualët marksistë. Kjo ishte një perandori transnacionale me greqishten si gjuhë e saj kryesore, kristianizmi ortodoks jo vetëm ishte fe kryesore, por edhe që mishëronte në thelbin e vet strukturat shtetërore si dhe aparatin ideologjik të shtetit. Në Bizant, pasardhësit e ilirëve në antikitetin e vonë dhe në periudhën e hershme mesjetare, proto-shqiptarët, janë praktikisht të padukshëm. Njohuritë moderne bizantine që shpesh theksojnë kontradiktat dhe diversitetin brenda Bizantit dhe më pak përqendrohen në rolin e gjuhës greke nuk janë ende evidente. Edhe pse fjala "shqiptar" shfaqet për herë të parë në një kronikë bizantine, ne dimë pak për këta njerëz të cilët me të vërtetë ishin. Vepra prej dijetari e Alain Ducellier në Francë dhe historianë të shumtë në Shqipëri e kanë ndryshuar tani këtë, por zbulimet e tij nuk ishin në dispozicion të historianëve shqiptarë deri pas viteve 1960. Është gjithashtu e vërtetë se Ducellier ishte një nga themeluesit e historisë së Adriatikut, po aq sa dhe historisë së Shqipërisë. Shqipëria e tij dhe shqiptarët janë një popull bregdetar, më shumë se një popull malësor, dhe kjo është e rëndësishme në diskutimin e disa çështjeve që përfshijnë formimin dhe ndërtimin e identitetit kombëtar modern. Çështja qendrore me Bizantin pas vitit 1945 për intelektualët shqiptarë ishte ajo "greke" në një kuptim shumë të veçantë, kur roli i trashëgimisë ortodokse të besimtarëve kryesisht jugorë ishte e vështirë për t'u trajtuar për Hoxhën dhe Partinë e Punës. Shumë besimtarë ortodoksë kishin luftuar si shqiptarë patriotë kundër pushtuesve të Boshtit dhe disa kishin qenë heronj dhe heroina partizane. Shumë familje jugore përfshinin si anëtarë të familjes që ishin praktikues të besimit ortodoks dhe gjithashtu anëtarë të Partisë së Punës. Ata erdhën nga pjesa e vetme e Shqipërisë, në jug, ku kishte mbështetje aktive dhe të rëndësishme popullore për komunizmin, ndryshe sidomos nga katolikët të përqendruar në qytetin e Shkodrës dhe në veri-perëndim të vendit. Disa anëtarë të minoritetit grek ishin bërë edhe komunistë aktivë, si në nivel lokal në zonën e minoritetit në jug-perëndim, ndërsa disa edhe në organet më të larta të Partisë së Punës. Por vetë Greqia nën qeverinë e saj monarkiste pas përfundimit të Luftës Civile në vitin 1949 ishte një armik kryesor i Shqipërisë, ndërsa teknikisht ekzistonte një gjendje lufte midis dy vendeve (dhe vazhdon ende në kohën e këtij shkrimi). Shqipëria kishte strehuar refugjatët grekë pas disfatës së Ushtrisë Demokratike në vitin 1949, si dhe kishte dhënë në forma të ndryshme ndihmash praktike, ndërkohë që konflikti i

Luftës Civile ishte në zhvillim e sipër. Refugjatët çamë kishin vërshuar në jug të Shqipërisë pas vitit 1944 dhe në popullatën e përgjithshme ata kanë mbetur në kujtesë si një nga aktet më të këqija të nacionalizmit dhe irredentizmit grek.xi

Periudhat e tjera prodhuan pak histori të dobishme, nga pikëpamja e enveristëve, por kjo nuk ndali prodhimin e koncepteve historike, vlera e të cilave është e dyshimtë. Mbretëritë feudale (në qoftë se kjo nuk është një fjalë e dalë mode) të Arbërit sigurisht kanë ekzistuar, por në atë kuptim që ata ishin shqiptarë (ose 'Mbretëri', ose 'Feudale') shpesh është e paqartë. Koncepti rrjedh nga statusi kanonik i shkrimeve të George Ostrogorskit (dhe shumë të tjera europiano-lindore) në historinë shqiptare të kësaj periudhe.xii Historianët zyrtarë të periudhës së Hoxhës, Arben Puto dhe Stefanaq Pollo i bazojnë pikëpamjet e tyre të periudhës në ato të Ostrogorskit dhe në një mënyrë të veçantë jokritike. Në periudhën osmane historia e elitës shqiptare nën Perandori, me asimilimin e tyre efektiv dhe përdorimin e gjuhës turke, do të thotë se historia e tyre është pjesë e asaj bote osmane, ndërkohë që në trojet shqiptare pjesa më e madhe e prodhimit letrar mbështetet jashtëzakonisht në traditën gojore dhe praktike.

Kështu historiografia shqiptare në periudhën aktuale është përballur me shumë çështje të pazgjidhura, ndoshta më e rëndësishmja qëndron në paqartësinë rreth asaj se sa larg historia e shqiptarëve brenda kufijve të shtetit aktual me të vërtetë është e pavarur nga ajo e shqiptarëve farefisnorë në shtetet fqinje dhe me historinë më të gjerë të shteteve fqinje në përgjithësi.xiii Vendet ballkanike janë marrë shumë më gjatë se qeveritë komuniste për të zgjidhur këto çështje komplekse nga sa mund të pritej, ashtu siç është harxhuar më shumë se sa mund të pritej në vitet 1990 për rajonin në ecjen drejt demokracive të qëndrueshme e të pavarura.

E shqipëroi: Xhevdet SHEHU

FAIK KONICA

VESET E PANDREQSHME TË SHQIPTARËVE

Në 74-vjetorin e vdekjes/ Faik Konica, rrëfimet e mbetura në letër mbi karakterin e shqiptarëve

Shënimet e grekëve, italianëve, turqve apo francezëve mbi shqiptarët

Dhjetori i vitit 1942 do të ishte dhjetori i fundit për Faik Konicën. I zhgënjyer nga raporti me mbretin Zog dhe duke parë atë çfarë po ndodhte në Shqipëri me luftën, ai u mbyll në shtëpinë e tij në Uashington duke iu dorëzuar shkrimit. Si ish-diplomat, pyetja me të cilën ndeshej shpesh sa herë thoshte emrin e vendit që përfaqësonte ishte "çfarë janë shqiptarët?" Në SHBA-në e pas viteve '40, Shqipëria ishte thjesht një vend i vogël në një cep të Ballkanit, me një histori po aq të trazuar sa rajoni në ato vite. Ky vend mund të hasej rrallë në libra udhëtarësh të rastësishëm, apo studiuesish të gjuhës, por asnjë libër në ato vite nuk mund të tregonte një histori të vërtetë të shqiptarëve. I shtyrë dhe nga një botues amerikan, Konica ulet të shkruajë një histori të Shqipërisë, në formën e eseve, të cilin nuk mundi ta përfundonte kurrë. Në Uashingtonin që rrihej nga një erë e ftohtë atë fillim dhjetori të 1940-s, ai vazhdonte të hidhte në letër historinë e shqiptarëve, frymëzuar nga gjithë librat që kishte lexuar, por dhe nga përvoja personale. Fati nuk deshi që Konica t'i përfundonte këto shënime, por ato janë sot si dëshmi jo vetëm e një kohe dhe një mendjeje që ka kontribuar aq shumë për çështjen shqiptare, por dhe një mënyrë për të parë një tablo të jetës sonë në ato vite. Këto shënime do të botoheshin shumë më vonë në një libër "*Shqipëria, Kopshti Shkëmbor i Europës Juglindore*", një libër që ia vlen t'i rikthehesh shpesh për të takuar idetë përparimtare të Konicës. Dje ishte 73-vjetori i ndarjes nga jeta të Konicës. Në këtë përvjetor të heshtur ne po bëjmë një udhëtim në mendimet e tij, shkëputur nga ky libër, i cili shënon dhe fillesat e prozës moderne shqiptare. Për të nisur hulumtimin në karakterin e shqiptarëve, Konica ndalet tek një nga gjestet që mund të quhet i rëndë për një shqiptar, dhe ai është ta quash "*i pabesë*". "Më së pari duhet ditur se fyerja më e rëndë në Shqipëri është ta quash tjetrin '*i pabesë'*. Shumë gjaqe kanë pasur si pikënisje akuzën për pabesi. Kjo s'do të thotë se në Shqipëri nuk ka njerëz të pabesë, por tregon nivelin e sjelljes dhe idealin që parapëlqehet më shumë. Është interesante të vihet në dukje se në Greqinë moderne fyerja më e rëndë është ta quash tjetrin "*analfabet*" ose "*të trashë*" a "*të plogët*": ideali i fqinjëve jugorë të Shqipërisë nuk është karakteri, por zgjuarsia, shkathtësia. Një fjalë e urtë e përhapur në të gjithë Shqipërinë thotë: "*Shqiptari për një plesht*

djeg jorganin". Kjo tregon padurimin dhe rrëmbimin, vrullin e shqiptarit. Ndoshta proverbi e ka zanafillën tek këshilla e ndonjë udhëheqësi për të mos nisur luftime të kushtueshme për punë të kota. Një sjellje edhe më fisnike shpreh fjala e urtë "*Kokë e falur nuk pritet*", që do të thotë se armiku i nënshtruar ose i zënë rob nuk vritet", shkruan Konica. Historiani bizantin, Nikiforos Gregoras, i cili nuk mund të dyshohet për simpati ndaj shqiptarëve, e përforcon faktin se shqiptarët nuk i vrasin, as nuk i shndërrojnë në skllevër, armiqtë e mundur. Është e vërtetë se Gregorasi përmend edhe emrat e disa kombësive të tjera të Perandorisë Bizantine që ndjekin po atë etikë luftarake, por edhe shembuj të ndryshëm, që dëshmojnë të kundërtën, mund të gjenden në kronikat e Bizantit. "Sidoqoftë në kohët e reja, në mes të kombeve të Europës Juglindore, vetëm shqiptarët i kanë qëndruar besnikë traditës kalorësiake që ta falin armikun e mundur", shkruan Konica. Duke folur për femrën, ai shkruan se "është diçka e ditur dhe e vërtetuar që në Shqipëri 'gruaja gëzon paprekshmërinë'". "Edhe në luftimet e gjaqet më të egra, gruan s'e trazon njeri. Kur dikush ka një armik, i cili ruan rastin t'i marrë hak, kur i duhet të udhëtojë, e ndien veten më të sigurt po të jetë i shoqëruar nga ndonjë grua; megjithëse kjo mënyrë veprimi quhet si jo burrërore. Edhe hajdutët e rrugëve i përmbahen këtij qëndrimi ndaj grave", shkruan Konica. Ai sjell në kujtesë një ngjarje që duhet të ketë ndodhur në vitet 1900 ku në shtypin botëror shkruhej për një ngjarje: treni ndërkombëtar "Orient Ekspres", që udhëtonte nga Parisi në Stamboll, u sulmua nga kusarët e Thrakisë. Udhëtarët meshkuj u detyruan të linin trenin me gjithë plaçkat e veta. Ndërkaq kryetari i bandës u tha grave të zinin vendet ku ishin më parë në tren dhe disa herë me radhë u kërkoi të falur për shqetësimin. Nga urdhrat që u jepte shokëve të vet në gjuhën shqipe, u mor vesh kombësia e hajdutëve. "Shqiptarët, kur flasin për veten e tyre, krenohen duke thënë se kanë shumë cilësi të mira e virtyte. Kjo është një pikë e dobët që e ka çdo komb dhe opinione të tilla nuk kanë ndonjë vlerë. Përkundrazi thëniet dhe shprehjet popullore janë gjykime spontane; ndër to, si të thuash, një komb zihet në befasi. Ne do ta vazhdojmë gjurmimin tonë po në atë vijë dhe do të përpiqemi të japim mendimin e popujve të tjerë për shqiptarët", shkruan Konica. Ai veçon mendimin e turqve, për shkak të afërsisë së tyre pesëqindvjeçare me shqiptarët. "Të gjithë historianët turq bëjnë fjalë për kokëfortësinë shqiptare: *'Arnaud iunud'* do të thotë 'shqiptari kokëfortë (i papërkulshëm)'" dhe është një shprehje e zakonshme në kronikat e vjetra turke. Turqit mendojnë gjithashtu se shqiptarët janë gjaknxehtë. "*E ka një dell shqiptari*", është një shprehje turke mjaft e përhapur. Sir James Sedhouse, që e ka përfshirë këtë shprehje në fjalorin e vet monumental turqisht-anglisht, jep këtë përkufizim në botimin e ri të vitit 1921: "*Arnautligi tuttu*" – filloi t'i lëvizë gjaku, flet a vepron, siç bën zakonisht një shqiptar, me vrull. Sipas mendimit të komandantëve të vjetër turq, është me të vërtetë trim dhe shumë i zoti për të sulmuar, për të pushtuar ndonjë vend me mësymje, por qëndron indiferent kur kushtet kërkojnë taktikë mbrojtëse. Shqiptari vlerësohet nga turqit si tip i zgjuar, por një historian turk i shekullit XVII, Ibrahim Peçevi, thotë se "Ajaz Pasha i përkiste racës shqiptare, e megjithatë ishte shumë i zgjuar", shkruan ai. Sipas mendimit të turqve, interesi për para është një karakteristikë tjetër e shqiptarit, i cili është gati të futet në aventurat më të rrezikshme, mjaft që të nxjerrë ndonjë përfitim. E kishin zakon të tregonin

një anekdotë në kohën e Perandorisë së vjetër turke: E pyetën shqiptarin një herë "a do të shkosh në ferr?" dhe ai u përgjigj "Sa është rroga atje?". Ndërsa grekët kanë një tjetër mendim për shqiptarët. Në gjuhën popullore greke takojmë dy shprehje për shqiptarët. "*Një kokë shqiptari*" thuhet për një njeri të papërkulshëm e kryeneç. Kur dikush vuan nga hallet që i kanë rënë përsipër, miqtë e ngushëllojnë duke i thënë "*hajt se Zoti nuk është shqiptar*", që do të thotë se Zoti është i mëshirshëm. "Kjo akuzë për mizori kuptohet fare mirë po të shikohet në dritën e historisë: grekët për qindra vjet me radhë i kanë njohur shqiptarët vetëm si pushtues, si kusarë që u plaçkitnin qytetet bregdetare, si ushtarë të dërguar ndër ekspedita ndëshkimore, si xhandarë ose si mbledhës taksash. Grekët nuk patën rast të njohin anën njerëzore të shqiptarëve", shkruan Konica. Ajo çfarë e çudit atë janë italianët. "Italianët – dhe kjo të çudit shumë – megjithëse kanë pasur vazhdimisht marrëdhënie të ngushta dhe të afërme me shqiptarët, kanë vetëm një shprehje në lidhje me këtë popull. Edhe kjo nuk është diçka në favor të shqiptarëve. Shprehja "*far l'albanese*" mund të gjendet në të gjithë fjalorët e mirë të italishtes, si për shembull, në atë të Nikola Zingarelit (Nicola Zingarelli). Përkthimi fjalë për fjalë i shprehjes është "të hiqesh si shqiptar", kurse kuptimi është tjetër "bëj sikur s'kuptoj; hiqem sikur nuk di gjë", shkruan Konica. Ndërsa francezët gjithnjë kanë pasur marrëdhënie të ngushta me shqiptarët, princat e familjes së Kapetëve kanë mbretëruar në Shqipëri për afro njëqind vjet. Një shprehje që mund të takohet në kronikat e vjetra është kjo: "*fier comme un albanais*" – krenar si shqiptar. Edhe banorët e Ishujve Britanikë do ta kenë vizituar shpesh Shqipërinë në kohën e kryqëzatave, gjatë rrugës së tyre për në Tokat e Shenjta. Këtë itinerar ndiqnin edhe popujt e tjerë, mbasi rruga që kalonte nëpër Shqipëri ishte më e sigurta në atë kohë, kur udhëtimi për det, me anije të vogla, paraqiste rrezik. Por këto vizita, në kalim e sipër, nuk kanë lënë gjurmë në histori. Për një grup anglezësh në Shqipëri bëhet fjalë vetëm në vitin 1457. Në këtë vit, një fisnik anglez me një kompani detarësh, erdhi në Shqipëri për të ndihmuar Skënderbeun në luftën kundër turqve. Nga këta ushtarë të guximshëm anglezë një pjesë e mirë u kthyen të gjallë në atdhe, i cili në atë kohë ishte i trazuar nga Lufta e dy Trëndafilave dhe nuk dihet çfarë përshtypjesh u la Shqipëria. Por, tre a katërqind vjet më vonë, anglezët, pasi pushtuan ishujt e Detit Jon, hynë në marrëdhënie të mira për një kohë të gjatë me Shqipërinë. "Ata na kanë lënë disa vëzhgime të mprehta dhe të shkëlqyeshme mbi karakterin e shqiptarëve. Këto përshtypje, herë janë, herë nuk janë në favor të shqiptarëve, por vlejnë për sinqeritetin e tyre, mbasi shqiptarët për të cilët bëhej fjalë në ato studime ishin analfabetë e prandaj të paaftë të falënderonin ose të protestonin për sa thuhej rreth tyre", shkruan Konica. Villiam Martin Lik, i cili e filloi karrierën e vet si inxhinier ushtarak dhe e mbylli si arkeolog klasik, studimet e të cilit edhe pas një shekulli studiohen me nderim nga dijetarët, flet më se një herë në librat e vet për karakteristikat e shqiptarëve. "Plutarku na vë në dijeni – thotë Lik, – se Pirroja ishte një oborrtar i shkathët dhe që në rini përpiqej të fitonte miqësinë e njerëzve të fuqishëm. Ky është në përgjithësi karakteri i shqiptarëve. Ata përpiqen me çdo mënyrë të sigurojnë mbrojtjen e eprorëve të tyre dhe u qëndrojnë besnikë, kur paguhen rregullisht. Kryengritjet e tyre të shpeshta zakonisht shkaktohen nga sjellja e pabesë e zyrtarëve, të cilët ndërmarrin disa punë pa siguruar më parë mjetet e

duhura financiare. Shqiptarët, duke qenë zakonisht më të varfër se turqit, janë të kufizuar në kërkesat e veta, janë më të qëndrueshëm e të durueshëm, janë më të regjur me vështirësitë që në moshë të njomë". Në një vend tjetër, koloneli Lik shpreh këtë mendim: "Ndërsa turku krenar dhe përtac dhe fshatari i varfër grek paraqiten shpeshherë pa pikë energjie, si pasojë e shtypjes dhe e varfërisë së vazhdueshme, këta shqiptarët dallohen për veprimtarinë e tyre të palodhur. Ata i zinin të parët pikat më të larta anës udhës, sikur ishin në garë cili do të ngjitej i pari. Të gjitha pyetjeve në lidhje me topografinë u përgjigjeshin me zgjuarsi, lejen për të shikuar me teleskopin tim e quajnë si një shpërblim të madh. Nuk ka dy gjëra në këtë botë që ndryshojnë më tepër në mes tyre se sa zakonet, (sjelljet) e shqiptarëve me ato të osmanllnëve. Këta të fundit janë qeniet më flegmatike dhe të plogëta të njerëzimit, përveç rasteve kur i nxit diçka e jashtëzakonshme. Por për Konicën një ndër karakteristikat kryesore të shqiptarëve dhe që asnjë studiues i huaj nuk e ka vënë re, është individualizmi. Një dijetar gjerman, dr. Herbert Louis, i cili, siç e kemi thënë edhe më parë, ishte ngarkuar nga qeveria shqiptare të studionte topografinë e vendit, deklaron se në Shqipëri nuk ekziston kuptimi i fjalës turmë. "Një nga përshtypjet më të forta, – deklaron dr. Louisi – që më ka mbetur nga shqiptarët, është ajo që te secili prej tyre vihet re një njeri me besim të madh në vetvete. Çdo individ, qoftë i zgjuar ose budalla, ka një aftësi të dukshme për të vendosur vetë dhe është mësuar të trajtojë pasurinë dhe jetën e vet në mënyrë praktike. Në një situatë të paqartë, secili jep një gjykim dhe është i gatshëm për nisma të guximshme. Me fjalë të tjera, në Shqipëri nuk ekzistojnë masa indiferente". "Kjo mungesë e frymës së turmës ka pasur pasoja fatale për unitetin e Shqipërisë, pasi secili përpiqej të merrte pjesë drejtpërsëdrejti personalisht, pa ndërmjetës ose të deleguar, në diskutimin e punëve publike. Ideja e shtetit për shqiptarin nuk kalonte përtej caqeve të qytetit ose përtej maleve ku banonte. Ashtu si për grekët e vjetër dhe për italianët e mesjetës, ideali i shqiptarit ishte ai i një qyteti shtet. Në rastet kur çështja kombëtare kërkonte unitet veprimi, vetëm mbas diskutimesh pa fund arrihej të merreshin masa të përbashkëta, por edhe këto shumë herë tepër me vonesë. Nëse Shqipëria u nënshtrua nga të huajt në të kaluarën, gjithmonë ndodhte për fajin e një qëndrese të pakombinuar", shkruan Konica. Ajo çfarë është interesante sipas tij, është dhe fakti se shqiptari, megjithëse shumë i pavarur dhe individualist, për të mos iu nënshtruar ndikimit të huaj kundër vullnetit të vet, prapëseprapë ka besim të madh në përparësinë që i takon atij që ka lindur në një familje të fisme. Ai sjell si shembull një ngjarje nga historia e kryengritjeve shqiptare, kur trazirat shkaktoheshin vetëm për shkak se caktohej si sundimtar ndonjë njeri nga familje e panjohur (pa emër). "Jo shumë kohë më parë (për të qenë të saktë, në vitin 1896) Sulltani kishte emëruar një sundimtar të përgjithshëm në Shqipërinë e Veriut, por popullsia ngriti krye, rroku armët dhe shprehu pakënaqësinë që do të sundohej nga një njeri me prejardhje familjare të rëndomtë. Një gazetar frëng i kohës vuri në dukje se "këta shqiptarët kanë një mënyrë të menduari si Montomorensia" (Duka i Montmorency, të cilit ia prenë kokën më 1632). Por qëndrimi shqiptar e ka burimin gjetiu: mbështetet në përvojën që "njeriu i ri", njeriu i pafis (homo novus), shpesh nuk di ta përmbajë veten. Në Shqipëri dëgjohet ky proverb popullor "*Kur bëhet jevgu pasha, më parë vret të atin*". Kjo

shprehje popullore e shqipes është varianti i proverbit të anglishtes "*Po i hipi kalit një lypës, do t'i grahë sa t'i nxjerrë shpirtin*", shkruan Konica. Urrejtja është një tjetër. Prandaj përzierja e një autoriteti qendror në liritë lokale dhe individuale shikohet si një dhunë, ligjet që nxjerr ai autoritet qendror quhen në esencë si të padrejta dhe shkelja e tyre, sado e rëndë që të jetë, konsiderohet vetëm si një sjellje e pahijshme. Për më tepër, prej njëfarë qëndrimi patriarkal ndaj jetës, ngurron të marrë masa të rënda ndëshkimore. Dënimi me vdekje shikohet kudo si diçka e urryer, dhe është për t'u vënë në dukje se edhe në ditët tona, ashtu si në të kaluarën, nuk gjen dot njeri në Shqipëri që të bëjë punën e xhelatit. Për të zbatuar dënimet me vdekje të gjykatave, policia detyrohet të pajtojë ndonjë jevg, i cili, pas shumë protestash, e kryen detyrën, natyrisht jo si profesionist, por si diletant, gjë kjo që ia zgjat vuajtjet viktimës", shkruan Konica. Ndërsa një nga karakteristikat fatkeqe të shqiptarëve dhe që zë vend të dukshëm, është mungesa e plotë e idealizmit tek ata. Në një vend ku njeriu vdes aq me lehtësi në grindje të ndryshme, nuk është dëgjuar të vdesë kush për një ideal a për një çështje (kauzë). Kjo ndihmon të shpjegohet fakti përse Shqipëria nuk e fitoi lirinë më parë dhe ka një numër kaq të paktë dëshmorësh të rënë për pavarësinë kombëtare. Aktet e devotshmërisë dhe të guximit, që kanë shkaktuar vdekjen e mijëra njerëzve, mund të përdoren si argument për të përgënjeshtruar thënien time. Por, devotshmëria e egër ndaj traditave të vendosura dhe ndaj kanunit shekullor të nderit, janë më tepër veprime mekanike dhe për t'i kryer nuk nevojitet të vihet në rrezik jeta në mënyrë të vullnetshme për një ideal të zgjedhur lirisht. Ndërsa mikpritja është një virtyt tashmë i pranuar nga të gjithë. Konica thotë se "*shqiptarët nuk kanë prirje të flasin shumë*". Këtë gjë e vë re dhe shkrimtari frëng Hiasent Hekar (Hyacynthe Hecquard), i cili, si konsull i Francës në Shkodër për shumë vjet me radhë, arriti ta njihte mirë Shqipërinë e Veriut, e vë në dukje shkurtësinë plot dinjitet të fjalimeve në kuvendet popullore.

Jeta seksuale e shqiptarëve

Për jetën seksuale të shqiptarëve mund të thuhet fare pak në një libër të destinuar për publikun e gjerë. Disa vese nuk janë të panjohura ndër qytete, megjithëse janë fryti i ndikimeve të huaja; porse vështirë të gjendet në botë një popullsi me zakone më të pastra se ajo e fshatarëve dhe malësive të Shqipërisë. Pafajësia e popullit të thjeshtë dëshmohet edhe nga një zakon i çuditshëm që ka mbetur deri vonë e nuk është zhdukur ende plotësisht. Përpara martesës (dhe nusja është zakonisht pesëmbëdhjetë deri më shtatëmbëdhjetë vjeçe, kurse dhëndri nëntëmbëdhjetë deri njëzetenjë) një burrë i moshuar, pjesëtar i familjes, do t'i shpjegonte bashkëshortit të ardhshëm anën fizike të martesës, ku do të shënonte me shkumës, me qymyr ose me ndonjë lëndë tjetër ngjyruese një rreth të vogël përqark "depilata virginis pudenda, ut iuvenis inexpers introitum facilius inveniat". Në disa krahina të Shqipërisë ekziston një besëtytni në lidhje me seksin e ujërave. Disa ujëra quhen "mashkullore" dhe besohet se kanë veti afrodiziake për burrat; disa ujëra të tjera janë "femërore" dhe mendohet se ushtrojnë të njëjtin efekt te femrat; kurse një lloj uji tjetër është "asnjanës". Një burrë, me arsim, më tregoi se një herë

kishte shkuar për punë nga qyteti i lindjes Gjirokastër në një fshat gjashtë orë larg. Sapo arriti aty piu një gotë ujë nga një burim dhe menjëherë pas kësaj diçka e shtyu të kthehej në shtëpi dhe të takohej me të shoqen. Ai ua tregoi shokëve këtë ndjenjë të çuditshme dhe ata e pyetën, duke qeshur, nëse kishte pirë ujë nga një farë burimi. Unë e ndërpreva bashkëbiseduesin, duke e pyetur a e dinte më parë çfarë mendohej për ato ujëra. "E mora vesh çfarë doni të nxirrni me këtë pyetje, ma ktheu ai – doni të dini se mos isha ndikuar nga sa kisha dëgjuar për ato ujëra; jo, deri atë ditë nuk kisha dëgjuar asgjë për efektin e tyre". Ai shtoi se, meqë e kishte kthyer kalin në Gjirokastër dhe i kishte urdhëruar shërbyesit të vinin e ta merrnin pas tri ditësh, u kthye më këmbë në qytet sa më shpejt që mundi.

FERID MUHIQ

APOLOGJIA E BALLKANIT

Sokrati është i mundur vetëm në Ballkan. Nëse kërkoni argumente, përfytyrojeni Sokratin në Angli, ose në Gjermani, ose në Suedi. Sokrati është saktësisht fenomen ballkanik; një instancë endemike, siç është edhe Ballkani një rast endemik. Të të akuzojnë për krim ata që u ke bërë të mirën më të madhe; të të dënojnë me vdekje ata që u ke hapur dhe u ke ndriçuar mendjen, kjo mund të ndodhë vetëm në Ballkan. Sokrati, sipas profetes nga Delfi, e cila nuk kish gabuar asnjëherë, ishte "më i mençur ndër njerëz". Mendjen e tij plot bujari ua dhuronte të gjithëve. Dijen e tij e këmbente me miqtë dhe me armiqtë. Ai mbeti i varfër, edhe pse e donin më të pasurit. Ai nuk arriti asnjëherë fuqi, ndonëse ishte i rrethuar nga më të fortët. Dinte më shumë se të arsimuarit, ndërkohë që e akuzonin se ishte i paarsimuar. Të rinjtë i udhëzonte në rrugën e virtytit, ndërkohë që u dënua me vdekje me akuzën se po prishte rininë. Predikonte ekzistencën e një Zoti të vetëm me shumë pasion, ndërkohë që e dënuan me vdekje për herezi dhe blasfemi. Mbrojtja e tij para gjykatës, e njohur si "Apologjia e Sokratit", nuk e ndihmoi që t'i shmangej dënimit me vdekje, por, nga ana tjetër, e bëri të pavdekshëm! Shtrohet pyetja se kush e kishte akuzuar Sokratin? Bashkëqytetarët e tij, banorët e qytetit ku kishte lindur, të cilit i dha vulën e urtësisë dhe aurën e virtytit! Një njeri i tillë mund të lindte vetëm në Ballkan dhe vetëm në Ballkan mund të kishte këtë fat.

Më shumë se dymijë vjet më vonë, mbase për shkak të ndonjë drejtësie më të lartë ose për shkak të rezistencës së virusit të padrejtësisë, mallkimi i Sokratit goditi Ballkanin. Tashmë ka kaluar një kohë e gjatë që është ngritur akuza kundër Ballkanit: e pështyjnë për shkak të primitivizmit, mungesës së kulturës dhe qytetërimit; e akuzojnë se po prish të rinjtë dhe pleqtë; se është një "strehë për heretikët" (refugium haereticorum); e ngarkojnë me blasfemi; e gjykojnë për krimet më të rënda. Ballkani, i cili në fillim të erës së re quhej "Kopsa e botëve" (Catena mundi) – sepse vërtet që ka qenë qendra e botës, ku janë bashkuar tre kontinentet e njohura, Afrika, Azia dhe Europa, duke bashkuar dijet e tyre më të larta, jo në aspektin epigjenik, por drejt një sinteze origjinale dhe kreative – sot është shpallur si guacë dhe WC e Europës! Nga kush akuzohet sot Ballkani? Pikërisht prej asaj Europe për të cilën Ballkani është jo vetëm burim, por edhe deltë; jo vetëm alfa, por edhe omega, dhe i cili i ka dhënë edhe emrin, përveç urtësisë, drejtësisë, artit dhe virtytit, që ajo i ka marrë po nga Ballkani!

Kanë kaluar shumë kohë që Ballkani po shkruan "Apologjinë" e tij, që sipas logjikës së padrejtësisë historike dhe precedentit të Sokratit, nuk do gjykohet me liri. Por, sipas drejtësisë historike dhe rrëfimit për Sokratin, Ballkani do ta sigurojë

pavdekësinë. Pikat kryesore të "Apologjisë së Ballkanit" janë fokusuar mbi akuzat më të rënda.

Në raport me akuzën e parë, që Ballkani përbën një çerdhe tradicionale primitivizmi dhe një zorrë qorre të qytetërimit, le të kujtohemi se e ashtuquajtura filozofi perëndimore, shkencë perëndimore, kulturë perëndimore, demokraci perëndimore, me një fjalë i gjithë qytetërimi perëndimor buron drejtpërdrejt nga Ballkani! Edhe Sokrati, edhe Platoni, edhe Aristoteli, edhe Soloni, edhe Perikliu, edhe Herodoti, edhe Tuqididi, edhe Sofokliu, edhe Fidia, edhe Euripidi, edhe Aleksandri bashkë me babanë e tij, Filipin, si dhe nënën, Olimpian, që të gjithë me radhë kanë lindur në Ballkan, dhe nuk kanë shkelur kurrë në Londër, në Paris, në Berlin apo në Bruksel. Në fakt, këto qytete, në atë kohë as që kanë ekzistuar, as si mëhallë fshati nuk u është përmendur emri. Pa këto emra dhe pa dy-treqind ballkanas të tjerë, as që do ekzistonte filozofia perëndimore, shkenca perëndimore, kultura perëndimore, demokracia perëndimore dhe qytetërimi perëndimor, ndërsa bota nuk do ishte kështu siç është. Madje edhe Zeusi, si dhe të gjithë hyjnitë e tjera, në atë kohë kanë jetuar në malin Olimp, në zemër të Ballkanit, e jo në Europën Perëndimore. Gjithçka që ata dinë sot e kanë mësuar nga Ballkani. Ndërsa tani kanë gjetur rastin të akuzojnë Ballkanin për primitivizëm, për mungesë kulture dhe qytetërimi, duke përvetësuar pa pikë turpi veprat e ballkanasve si realizime të tyre. Vallë, askush nuk do i dënojë për shpifje dhe si plagjiatorë të paskrupullt!?

Akuza e dytë kapitale kundër Ballkanit ka të bëjë me dhunën fetare dhe etnike, mungesën e tolerancës, me brutalitetin, përndjekjet dhe krimet masive. Megjithatë, eksodi më i madh dhe përndjekja tërësore në historinë e njohur, e realizuar vetëm për shkak të përkatësisë etnike dhe fetare, ka ndodhur në vitin 1492 shumë larg nga Ballkani, në Spanjën e atëhershme, kur të gjithë myslimanët dhe hebrenjtë ishin përzënë. Ata që nuk kishin nga të shkonin, ose u vranë, ose u kryqëzuan. Myslimanët e kryqëzuar me dhunë, të quajtur në mënyrë pezhorative moriskosë, si dhe hebrenjtë e kryqëzuar me dhunë, të quajtur maranosë, qenë përndjekur edhe 120 vite të tëra më pas: të akuzuar për herezi dhe blasfemi; të dënuar pa asnjë faj; të masakruar përçudshëm e kështu me radhë. Përfundimisht ishte lëshuar urdhri që deri në mars të vitit 1612, ose do vriteshin, ose duheshin përzënë nga Mbretëria e Spanjës. Dhe, ndërkohë që luftërat më të përgjakshme në Europën Perëndimore janë zhvilluar për motive religjioze/doktrinare, në Ballkan mbizotëronte një atmosferë e qëndrueshme dhe paqësore, rrjedhojë e tolerancës multifetare dhe multikulturore, e paprecedent në të gjithë historinë botërore. Pikërisht për këtë arsye, numri më i madh i myslimanëve dhe hebrenjve të përndjekur, të përzënë nga Spanja dhe nga vendet e tjera euro-perëndimore, gjetën shpëtim dhe strehë bash në Ballkan. Kishat, xhamitë, katedralet dhe sinagogat, ndryshe nga e gjithë pjesa tjetër e Europës, në Ballkan qëndronin pranë njëra-tjetrës, që edhe sot dëshmojnë në favor të mbrojtjes së Ballkanit. Krimi më i tmerrshëm kolektiv, holokausti, nuk ka ndodhur në Ballkan; as nuk është planifikuar dhe as është kryer nga ballkanasit. Të vrasësh miliona njerëz në kuadër të një projekti ideologjik, në emër të arsyes dhe qëllimeve të larta, për ballkanasin kjo është shumë monstruoze! Vërtet çnjerëzore! Për ballkanasin vrasja njerëzve është çështje ndjenjash, emocionesh – nuk është një çështje e arsyes. Vrasja është një formë çmendurie: vetëm një i çmendur i

përkohshëm (nga urrejtja, nga hidhërimi!), një njeri pa arsye, që ka dalë nga vetja, mund të bëjë një vepër të tillë të tmerrshme, siç është vrasja e njeriut. Në Ballkan, njeriu i arsyeshëm, njeriu që është në vete, nuk do vriste kurrë një njeri. Llogoret e përqendrimit nuk janë menduar nga ballkanasit, por nga anglezët. Bombën atomike nuk e kanë hedhur ballkanasit.

Që nga themelimi i tij, duke filluar me Torkvemadën dhe me pasuesin e tij Lojola, e deri ne fund të tij, inkuizicioni ka gjykuar me vdekje dhe djegie me zjarr më shumë se dhjetëmijë njerëz, dhe kjo vetëm për motive doktrinare, teorike. Siç thuhet, nisur nga parimi! Në listën e të djegurve janë gjetur mijëra njerëz kundër të cilëve nuk ishte bërë asgjë, dhe të cilët nuk i kishin bërë kujt asnjë të keqe – përveçse ishin të mashtruar nga djalli! Prandaj, në atë listë kishte edhe njerëz të thjeshtë, shkencëtarë të mëdhenj, pleq, gra, madje edhe fëmijë. Në Ballkan nuk ka ekzistuar asnjëherë inkuizicioni; as që ka qenë e mundur. Torkvemado dhe Lojola nuk kanë urryer askënd. Gjykimet e tyre nuk përmbanin diçka të ngjashme. Vdekja në Ballkan është një temë për të cilën me patjetër duhet të keni diçka shumë personale. Asnjë ballkanas i vërtetë nuk mund të pranojë të vrisni një njeri ndaj të cilit nuk ndjeni asgjë personale! Nëse nuk e urreni, si mund ta vrisni!? Njeriu nuk vritet thjesht, ashtu siç theret delja ose pula! Kur njeriu vritet për kot, kur ekzekutohet për kot, ai përçmohet, i mohohet e gjithë njerëzorja! Të paktën i vrari meriton pak respekt nga vrasësi, që të mos ekzekutohet si dele apo si pulë! Vdekja e tij është e pakuptimtë, ndërkohë që ai degradohet si njeri, nëse vrasësi nuk ka ndjerë asgjë ndaj tij – as urrejtje, as hidhërim, as pikëllim, as lehtësim, as vuajtje, as pendim! Thjesht asgjë. Vetëm ai që urren ka një shtysë mjaft të fortë – për të mos thënë edhe të arsyeshme – për të vrarë. Vetëm urrejtja është motivi i pranuar i ballkanasve për të vrarë një njeri ose me dhjetëra.

Është mirë të kujtohemi... Por, edhe Ballkani ka historinë e tij të përgjakshme, dhe në Ballkan lulëzon e harlisur lulja e krimit, nëse na kujtohen fjalët e Baudelaire-t. Në atë pjesë të Europës që e akuzon Ballkanin për brutalitet, për krime masive dhe luftëra të rrepta, vrasja e njerëzve është një aksion aseptik, deratizim, një lloj përdorimi sistematik i herbicideve, ku në vend të minjve dhe barit, vuajnë qeniet njerëzore, të degraduara në minj dhe bar! Aksione të tilla vrasjesh, në thelbin e tyre më të thellë janë të organizuara në mënyrë racionale; janë të planifikuara në aspektin logjistik; të motivuara ideologjikisht; janë të justifikuara nga aspekti doktrinar – e thënë shkurt, janë çnjerëzore. "Asgjë personale" thonë planifikuesit, por edhe ekzekutuesit, dhe këtë e thonë pa emocione, nuk u dridhen duart; zemra nuk rreh e çakërdisur. Ata flenë të qetë, pa ankthe dhe pa brejtje ndërgjegjeje. Ky është lloji më i lig i krimit: krimi pa urrejtje! Ekzekutimi versus vrasja. Në të kundërtën, në Ballkan dhe për ballkanasin, çdo gjest është vetjak, me emocion. Mbase Ballkani është vendi i fundit në të cilin ekziston akoma apejroni i fundit autentik antropologjik, ajo protoplazmë, ai brumë primordial (i kryehershëm) në të cilin ruhet akoma bashkësia burimore e të gjitha elementeve nga të cilat është gatuar njeriu.

Prandaj dhe ballkanasi është i afërt me Sokratin, sepse ai nuk ishte gjykuar me vdekje për motive ideologjike, as për shkak të ndonjë mospajtimi intelektual ndërmjet tij dhe akuzuesve, siç pohohet aq shpesh dhe gabimisht! Pikërisht për

arsyen se një pjesë e qytetarëve të Athinës, ballkanas në eshtra e në shpirt, thjesht nisën ta urrenin Sokratin. Prej vitesh u kishte llomotitur të njëjtën gjë: me vendosmëri dhe këmbëngulje gjakonte t'u dëshmonte se sa të pavlerë janë dhe çfarë jete të padenjë e të zbrazët jetojnë. Sepse ua kishte sjellë në maje të hundës! Prandaj kishin zënë të pëshpëritnin: "Aman, edhe ai Sokrati! Kur do shpëtojmë prej tij!?" Ndërkaq, prej Sokratit nuk kishte shpëtim, edhe në moshën 70-vjeçare, duke qenë shëndosh si lisi, një asket i vërtetë, rezistues karshi diellit dhe acarit, i pavarur nga të gjithë dhe i kënaqur me atë pak që kishte, ai përbënte një kërcënim që mund të zgjaste: nuk i shihej fundi, mund të hante inat edhe për 100 vjet me radhë! Ndërkaq, përgjatë gjithë jetës, 50 vite rrumbullak, Sokrati vërtet hante inat: nuk donte t'i linte të qetë njerëzit, u kishte ardhur në maje të hundës. Gjysma e athinasve filluan të mos dilnin në Agorë, në sheshin e qytetit – i rrinin larg si djalli temjanit. Nuk u interesonte as e vërteta, as mirësia, as shpirti, por vetëm paratë, ndërkohë që ai, pikërisht për para nuk i linte të hapnin gojë. Iu lutën, i tërhoqën vëmendjen, u përpoqën që ta korruptonin dhe në fund e kërcënuan. Por çdo gjë qe e kotë. Madje edhe kur u dënua me vdekje, i dhanë 30 ditë afat, derisa të kthehej anija nga ishulli i shenjtë – të ikte, t'i mbyllnin sytë, të shkonte vullnetar në syrgjyn; ata do kujdeseshin që ai të jetonte si mbret. Por, jo dhe jo! A e donte me patjetër gjykimin me vdekje prej tyre? Sigurisht që e donte! Në Ballkan nuk kishte shteg tjetër. Aniti, Meleti dhe prokurorët e tjerë ndjenin urrejtje personale ndaj tij dhe ky ishte një rast ideal që ta kurorëzonin në mënyrë ballkanike: me vdekje. Meqë nuk bënte asnjë dëm serioz dhe nuk i rebelonte njerëzit, në çdo vend tjetër Sokrati do e kalonte me ndonjë qortim dhe me një dënim në të holla. Por, në Ballkan, edhe kundërvajtja më e rëndë falet nëse nuk ekziston urrejtja personale. Kurse në pjesën tjetër të botës dënohet kundërvajtja, jo personaliteti. Madje edhe kundërvajtjet më të rënda mund të kalojnë me qortime ose me ndonjë dënim në para, deri edhe çrregullimet relativisht beninje të rendit dhe qetësisë publike, si në rastin e Sokratit, mund të përfundojnë me dënim me vdekje. Në Ballkan gjykohet personi, jo kundërvajtja. Edhe dënimi në Ballkan nuk është dënim, por hakmarrje. Ndërsa amnistia nuk është amnisti, por falje!

Dhe këtu mund ta ndërpresim këtë apologji për Ballkanin, edhe pse potencialisht nuk ka fund. Në këtë rast vetëm sa përmendëm anën më të ligë të njerëzve, pra edhe të ballkanasve – vrasjen e njerëzve. Sa e gjatë dhe e madhe do ishte kjo apologji për Ballkanin nëse do bëhej fjalë për gjërat e bukura: për dashurinë, butësinë, miqësinë! – fenomene që në Ballkan arrijnë proporcione dhe intensitet të lartë dhe nuk mund të krahasohen me asnjë vend tjetër në botë! Por, edhe Apologjia e Madhe e Ballkanit, kur të ulet në bankë për të dhënë llogari para prokurorëve dhe gjykatësve, nuk do ndryshojë shumë; sepse as kjo apologji e vogël, as Apologjia e Madhe nuk do jenë të mjaftueshme që të tërhiqen akuzat kundër Ballkanit, sikundër nuk ka mjaftuar as "Apologjia e Sokratit" për tërheqjen e akuzave kundër tij. Sado që të jenë të pabaza, të sforcuara, të pabesueshme, këto akuza kanë qenë të vërteta, nga njerëz të gjallë, realë, në adresë të një njeriu real, të gjallë! Edhe akuzat kundër Ballkanit janë të njëjta: ato janë akuza plot ndjenjë. Baza e tyre e përbashkët është përzierja e urrejtjes dhe zilisë, e superioritetit të rremë dhe inferioritetit të vërtetë. Dhe, pikërisht për shkak të kësaj, këto akuza, me

argumentimin e tyre të papranueshëm racional, por me qëllimin e keq irracional dhe të sinqertë, sa më shumë të përsëriten e të shtohen, aq më të pavdekshëm do e bëjnë Ballkanin, njësoj si akuzat kundër Sokratit, që nga ana racionale janë të paargumentuara, por të motivuara nga mëria dhe smira. Ato e bënë të pavdekshëm Sokratin.

ARDIAN EMINI - ALFRED MARLEKU

PRESHEVA PAS SHPËRBËRJES SË REPUBLIKËS FEDERATIVE TË JUGOSLLAVISË

Abstrakt: *Qëllimi i këtij punimi është që të analizojë rrjedhën dhe procesin e shpërbërjes së Jugosllavisë e specifikisht fatin e Preshevës respektivisht popullsisë shqiptare e cila e popullon këtë trevë. Janë katër pjesë kryesore në të cilat shtrihet analiza e punimit. Fillimisht shtrohet korniza historike teorike e cila fokusohet në definimin e vetë konceptit të shpërbërjes konstitucionale dhe fillimet plurale në rajon e specifikisht në trevën e Preshevës. Mandej, studimi trajton një vistër sjelljesh të strukturave shtetërore me komponentët e saj politikë e administrativë. Me qëllim të kontekstualizimit të subjektit, punimi fokusohet në rastin e Preshevës si pjesë e pandashme e trungut shqiptar e cila pa drejtësisht sot gjendet në kuadër të Republikës së Serbisë.*

Pluralizmi në Preshevë

Fushata e egër shtetërore serbe e ndërmarrë ndaj shqiptarëve në Jugosllavi, përkatësisht fushata e gjerë e diferencimeve ideo-politike, kulturore e arsimore, preku të gjithë strukturat shoqërore shqiptare. Me këtë rast u përjashtuan dhe u larguan nga puna shumë intelektualë, punonjës shqiptarë, të cilët nuk e pranuan platformën politike serbe, e as diferencimin ideo- politik. Kjo masë e politikës shtetërore serbe kishte arritur përmasa të mëdha gjatë vitit 1988. Përveç Kosovës ku ndodhej syri i ciklonit, represioni u shtri në të gjitha trevat shqiptare në Jugosllavi, duke përfshirë edhe Luginën e Preshevës. Në këtë drejtim strukturat shtetërore serbe intensifikuan sulmet ndaj shqiptarëve. Në muajin shtator të vitit 1988 në Bujanovc dhe Preshevë qëndroi një delegacion i Republikës së Serbisë, që ishte i lidhur drejtpërdrejt me diferencimet ideopolitike lokale që zhvilloheshin në Luginë të Preshevës. Delegacioni përgatiti strukturat komunale e politike lokale për vizitën që do të bënte në këto anë Sllobodan Millosheviqi.

Para ardhjes së Millosheviqit, më 28 shtator 1988 në qendër të qytetit të Bujanovcit u organizua një tubim nga simpatizantët e pushtetit të tij. Antishqiptarët e përbetuar kërkuan në këtë tubim rregullimin e padrejtësive që ishin bërë ndaj popullit serb e malazez. Në këtë protestë serbët e tubuar kërkuan edhe mbrojtje, siç deklaroheshin, nga e ashtuquajtura dhunë shqiptare që ushtrohej ndaj tyre. Tubimi në fjalë u organizua për t'u solidarizuar me serbët në Kosovë. Tubime të serbëve

pati edhe në Preshevë[1]. Këto ngjarje kuptohet se ishin të dirigjuara nga strukturat shtetërore serbe në kuadër të revanshit që qarqet radikale e shovene të Serbisë filluan pas daljes në krye të Serbisë të Sllobodan Millosheviçit.

Gjatë shtatorit të vitit 1998 Preshevën e Bujanovcin e vizituan Sekretari Ekzekutiv i Komitetit Qendror të Lidhjes së Komunistëve të Serbisë, Danillo Markoviq, kryetar i komitetit për arsim etj[2]. Fushata serbe ndaj shqiptarëve, apo më mirë të themi ndaj çdo gjë që ishte shqiptare, vetëm sa ishte shpallur. Të shtyrë nga qarqet politike serbe, popullata civile serbe kishte nisur të protestonte duke bojkotuar mësimin në Shkollën e Mesme "Skënderbeu" në Preshevë ngjarje që u zhvilluan më 10 dhe 11 dhjetor të vitit 1988. Fillimisht nga nxënësit serbë u kërkua përjashtimi i profesorëve shqiptarë dhe ndryshimi i emrit të shkollës[3]. Pasoi më 11 nëntor vizita e Sllobodan Millosheviçit në qytetin e Bujanovcit. Pas bisedës me funksionarët lokalë në ndërtesën e Kuvendit Komunal, ku përkrahu pushtetarët serbë në organet udhëheqëse dhe i siguroi për mbështetjen në punën e tyre dhe veprimtarinë sociale që zhvillonin.

Disa muaj më pas, në fillim të vitit 1989, politika serbomadhe përfshiu gjithë institucionet politike, kulturore arsimore të komunës së Preshevës por edhe të Luginës në përgjithësi. Më 1 shkurt të vitit 1989, nga Kuvendi Komunal i Preshevës u futën në Qendrën Arsimore "Skënderbeu" masat e përkohshme të dhunshme. Ky veprim, sipas institucioneve, u ndërmor për shkak se në këtë qendër ishin dëmtuar marrëdhëniet shoqërore[4]. Po këtë vit edhe emri i Shkollës së Mesme "Skënderbeu" u ndryshua në "25 Maji". Ky vendim u mor në përputhshmëri me vendimet e Kuvendit Komunal të Preshevës për futjen e masave të dhunshme në Qendrën Arsimore. Në këtë kohë një sërë kuadrosh arsimore u përjashtuan nga procesi mësimor. Përveç ndryshimit të emrit të Shkollës së Mesme në Preshevë, në këtë kohë, ishte sjellë edhe vendimi mbi heqjen dhe ndalimin e flamurit dhe simboleve kombëtare shqiptare. E njëjta gjë kishte ndodhur më herët edhe në Bujanovc. Presheva ishte vendi i fundit në trevën e Luginës së Preshevës, ku ende kishte mbetur në përdorim simboli kombëtar –Flamuri.

Ngjarjet e vitit 1989 në Kosovë si greva e minatorëve të Trepçës, arrestimet e elitës politike në Kosovë, izolimi i intelektualëve shqiptarë, vendosja e masave të dhunshme në institucionet arsimore shqiptare, protestat gjithëpopullore në Prishtinë e në gjithë Kosovën, si dhe suprimimi i Autonomisë së Kosovës, reflektuan edhe në Luginën e Preshevës. Më 1 shkurt të vitit 1990, një grup të rinjsh protestuan rrugëve të qytetit të Preshevës në përkrahje dhe në mbështetje të shqiptarëve të Kosovës dhe të protestave që zhvilloheshin atje duke brohoritur "Jetën e Japim Kosovën s'e japim"[5]. Protestat vazhduan edhe gjatë 2 shkurtit të vitit 1990 kur banorët e fshatrave Rahovicë e Miratoc ishin nisur në Komunën e Preshevës për

[1] Atanasije Jevtić, *Stradanja Srba na Kosovu I Metohiji od 1941.do 1990 godine,* Jedinstvo Priština, 1990, fq.323.
[2] S. Latifi, *Rrugëtimi nëpër Luginë të Preshevës ...,* fq.131.
[3] N.A.B.Ф. Скупштина општина Прешево- Прешево, Д. 007, 16.10.1988.
[4] *Po aty*, d.nr.011, 01.02.1989.
[5] S.Latifi, *Rrugëtimi nëpër Luginë të Preshevës ...,* fq.134.

t'iu bashkangjitur protestuesve të tjerë. Por më 2 shkurt në Preshevë ishin sjellë forca shtesë policore nga Vranja dhe nga qytetet e tjera të Serbisë. Pas depërtimit të protestuesve në qendër të qytetit, forcat e rendit me anë të dhunës fizike i shpërndanë protestuesit. Menjëherë pas shpërndarjes dhe shuarjes së protestës në Preshevë, organet e rendit, më 2 dhe 3 shkurtit të vitit 1990, ndërmorën masa për kapjen dhe burgosjen e pjesëmarrësve në protesta. Me këtë rast u arrestuan: Hasan Hyseni, Zeqirja Jakupi, Xheladin Hajdini, Nazmi Kamberi, Enver Saqipi, Avni Jakupi, Haki Nuhiu, Mustafë Doda, Orhan Ibrahimi, Shpëtim Aliu, Qamil Mustafa, Naser Rrahmani, Tefik Fejzullahu. Gjithë këta u dënuan nga Gjykata Komunale për Kundravajtje në Preshevë si pjesëmarrës në protestat e 1 shkurtit të vitit 1990 dhe si përgjegjës për brohoritje dhe prishje të rendit dhe qetësisë publike në protestat e 2 shkurt të vitit 1990. Me një procedurë të shpejtë gjyqësore gjithë të burgosurit u dënuan me nga 60 ditë heqje lire dhe u dërguan në Burgun e Vranjës për ta vuajtur dënimin[6].

Pas gjithë këtyre ngjarjeve që përjetuan, shqiptarët e Preshevës panë se përfaqësimi i tyre politik e qytetar ishte i mangët apo nuk ekzistonte fare, strukturat lokale politike e administrative nuk ishin për të shërbyer në interes të qytetarëve por vepronin në bazë të interesave të politikës ditore, që udhëhiqte Serbia. Interesat e tyre politiko-juridike nuk përfaqësoheshin, madje nuk përfilleshin fare. Në këtë situatë popullsia e Preshevës u bind se kishte ardhur koha për të kërkuar një alternativë tjetër politike.

Të shtyrë nga këto arsye që i cekëm më lart, më 5 gusht të vitit 1990 në Preshevë u themelua Shoqata e Pavarur Demokratike, që më vonë u shndërrua në parti politike. Ajo kishte ardhur si kërkesë e anëtarësisë dhe në konsultime me faktorë të brendshëm e të jashtëm. Kryetar të kësaj Partie, e cila e mori emrin Partia Demokratike Shqiptare, u zgjodh profesori i Biologjisë, Ali Ahmeti. Ndërsa më 19 gusht të vitit 1990 u formua Partia për Veprim Demokratik. Kryetar i saj u zgjodh Riza Halimi, profesor i fizikës. Është për t'u theksuar se në udhëheqje të dy alternativave politike në Preshevë, erdhën dy mësimdhënës që ishin të përjashtuar nga procesi mësimor pas masave të dhunshme të vendosura në qendrën arsimore. Karakteristikë e Partisë për Veprim Demokratik ishte që, në dallim nga Partia Demokratike Shqiptare, kjo parti arriti të shtrijë aktivitetin e saj politik në Komunën e Bujanovcit dhe në atë të Medvegjës, në gjithë Luginën e Preshevës. Këto dy parti të Luginës së Preshevës deri në vitin 1992, çdo aktivitet politik e partiak e kishin bërë në koordinim, si dhe në konsulta me partitë politike shqiptare që vepronin në Kosovë dhe në Maqedoni.

Është për t'u theksuar se krijimi i partive politike në vitet 1990, në Luginën e Preshevës ndodhi kur pluralizmi politik kishte përfshirë gjithë trevat shqiptare. Deri në këtë kohë përfaqësimi i interesave politike të qytetarëve të Luginës së Preshevës nuk kishte struktura komunale të vetat. Institucionet komunale udhëhiqeshin nga serbët, edhe pse këta ishin një pakicë e vogël në këtë komunë. Themelimi i partive politike shqiptare në Luginën e Preshevës pati efektin e vet. Ato u bënë zëdhënëse të ideve dhe mendimeve të shqiptarëve dhe përfaqësuese të interesave të tyre.

[6] *Po aty*.

Megjithatë këto dy parti të para në Luginën e Preshevës kishin divergjenca. Partia për Veprim Demokratik synonte që veprimet e veta t'i kanalizonte dhe t'i zhvillonte si veprime institucionale, çka nënkuptonte që të gjitha kërkesat t'i realizonte nëpërmes institucioneve shtetërore, ndërsa Partia Demokratike Shqiptare ishte për distancim nga politika institucionale, e cila kishte të bënte me Republikën e Serbisë. Në këtë aspekt, në fillimet e veta, ajo nuk e fshihte që përfaqësuesit shqiptarë në Luginë të Preshevës të ishin pjesë e pushtetit paralel të Kosovës. Pra kjo parti kërkonte për shqiptarët e Preshevës një qasje identike si të shqiptarëve të Kosovës.

Këto dy qëndrime të dy partitë i mbajtën edhe në dhjetor të vitit 1990, kur u organizuan zgjedhjet parlamentare në Republikën e Serbisë. Pjesëmarrës në këto zgjedhje ishte Partia për Veprim Demokratik, njëherësh partia e vetme shqiptare e kësaj ane që merrte pjesë në këto zgjedhje, e cila fitoi një mandat përfaqësimi në Parlamentin e Republikës së Serbisë. Deputet dhe njëherësh përfaqësues i këtyre trevave u caktua Behlul Nasufi[7]. Partia Demokratike Shqiptare i bojkotoi këto zgjedhje për arsye se çështjen e Preshevës e shihte në kuadër të asaj të Kosovës. Kjo bindje ishte përforcuar sidomos pas takimit të Prishtinës, të ndërmarrë nga Forumi Intelektualëve Shqiptarë në vitin 1991. Në këtë forum nga përfaqësuesit e Luginës së Preshevës ishte kërkuar që në qeverinë e ardhshme të Kosovës të përfshiheshin edhe përfaqësuesit e tri komunave të Luginës së Preshevës, si dhe të gjitha trojeve shqiptare në Jugosllavi.

Nga sa shihet, Luginën e Preshevës fillimet e pluralizmit e kishin gjetur me dy linja të përfaqësimit politik, pra në dy rryma politike. Në një farë mënyre kjo bëri begatimin e skenës politike. Qytetarëve të kësaj treve u jepej kështu mundësi zgjedhjeje mes këtyre dy subjekteve politike ndërkohë që, deri në vitet 90-të, popullsia shqiptare nuk kishte ndonjë përfaqësues të dëshirueshëm dhe nuk kishte mundësinë e zgjedhjes. Dihet se më herët funksiononte vetëm sistemi njëpartiak, pra ende nuk ishte lejuar sistemi pluralist. Krijimi i partive politike u prit mirë dhe me entuziazëm nga popullsia shqiptare e Luginë së Preshevës.

Qëndrimi i shqiptarëve të Preshevës për Referendumin e Kosovës

Zhvillimet politike që kishin përfshirë trevat shqiptare në përgjithësi, ngjarjet që zhvilloheshin në Kosovë, sidomos ato me shpalljen e Deklaratës Kushtetuese më 2 korrik 1990, Kuvendi i Kaçanikut dhe Referendumi për pavarësi, që përcaktoi mbajtjen e zgjedhjeve të lira parlamentare në Kosovë brenda gjashtë muajsh, prej të cilave do të dilte Qeveria e parë e Republikës së Kosovës, të gjitha këto domosdo reflektonin në Luginën e Preshevës dhe mobilizonin intelektualët e saj, si dhe të gjithë popullsinë. Në këtë drejtim në vitin 1991 në Kosovë u formua Këshilli Koordinues i Partive Politike Shqiptare në Jugosllavi. Ky këshill kishte të bënte me hartimin e një platforme të përbashkët me të cilën subjektet politike shqiptare shfaqeshin ndaj krizës dhe zhvillimeve politike. Kryesues i Këshillit ishte Dr. Ibrahim Rugova dhe pjesë përbërëse të këtij këshilli ishin njëmbëdhjetë subjekte

[7] S. Latifi, *Rrugëtimi nëpër Luginë të Preshevës ...,*fq. 140.

politike shqiptare si: "Lidhja Demokratike Shqiptare", "Partia për Prosperitet Demokratik", "Lidhja Demokratike në Mal të Zi", "Partia për Veprim Demokratik", "Partia Fshatare e Kosovës", "Partia Shqiptare Demokristiane", "Partia Parlamentare e Kosovës", "Partia Social Demokrate e Kosovës", "Partia e Unitetit Kombëtar Shqiptar", "Partia Popullore Shqiptare" dhe "Partia Demokratike Shqiptare"[8].

Po ashtu në këtë këshill ishte vendosur që edhe shqiptarët e trevave të tjera në Jugosllavi të artikulonin vullnetin e tyre politik nëpërmes Referendumit, sikurse shqiptarët e Kosovës[9]. Në këtë kuadër nga data 26 deri në 30 shtator të vitit 1991 në Kosovë u organizua Referendumi për Pavarësi. Mbi 87% e popullsisë së Kosovës, ishte me të drejtë vote. Prej pjesëmarrësve u deklaruan për Kosovën shtet sovran dhe të pavarur, 99.8%. Më 11 tetor të vitit 1991, menjëherë pas Referendumit, Këshilli Koordinues i Partive Politike Shqiptare në Jugosllavi, me një deklaratë politike, duke respektuar Referendumin, shprehu vullnetin politik të popullit shqiptar për zgjidhjen e çështjes shqiptare në Jugosllavi me tri opsione të hapura:

"Sipas variantit të parë: Nëse nuk ndryshohen kufijtë e jashtëm e as ata të brendshëm të Jugosllavisë, duhet të ekzistojë Republika e Kosovës si shtet sovran dhe i pavarur, me të drejtën e bashkimit në lidhjen e shteteve sovrane në Jugosllavi. Pjesa e popullit shqiptar që mbesin të jetojnë në Maqedoni, Mal të Zi dhe në Luginë të Preshevës do ta kenë statusin e popullit shtetformues dhe të gjitha të drejtat që dalin nga kjo.

Sipas variantit të dytë: Nëse kufijtë e jashtëm të Jugosllavisë nuk ndryshojnë, por ndryshojnë kufijtë e brendshëm ndërmjet Republikave, atëherë kërkesë është Republika Shqiptare në Jugosllavi, e ndërtuar mbi bazën e parimit etnik dhe të parimeve të tjera, që vlejnë për serbët, sllovenët dhe popujt e tjerë të Jugosllavisë.

Sipas variantit të tretë: nëse ndryshojnë kufijtë e jashtëm të Jugosllavisë, atëherë populli shqiptar në Jugosllavi, përmes deklarimit të përgjithshëm me plebishit do të vendosë për bashkimin e territoreve në të cilat jetojnë shqiptarë dhe kështu do të krijohet shteti integral shqiptar në Ballkan në kufijtë e tij etnik"[10].

Deklarata e Këshillit Koordinues të Partive Politike Shqiptare në Jugosllavi është e një rëndësie historike sepse kjo deklaratë nuk përkufizohet vetëm te problematika e Kosovës dhe zgjidhja e saj, por ajo përfshin gjithë kompleksitetin e popullit shqiptar në Ballkan, duke e ngritur si një problem të një çështjeje të pazgjidhur. Në këtë linjë ishte vendosur që edhe në Maqedoni, në Kosovën Lindore-Luginën e Preshevës, të artikulohej vullneti politik nëpërmjet një Referendumi. Kështu në Maqedoni ishte vendosur që të organizohej e mbahej Referendumi për Republikën e Iliridës në shkurt të vitit 1992, ndërsa në Luginë të Preshevës në mars të vitit 1992[11]. Në këtë rrjedhë më 26 shkurt 1992 në Preshevë u

[8] J. Buxhovi, *Kosova - Nga Konferenca e Londrës deri te protektorati…,*fq. 488.
[9] Intervistë me Ibrahim Kadriun profesor i Sociologjisë, Kryetar i Kuvendit të referendumit në Luginë të Preshevës gjatë 1-2 marsit 1992, 20.07.2012, Preshevë.
[10] J. Buxhovi, *Kosova - Nga Konferenca e Londrës deri te protektorati…,* fq.489.
[11] Intervistë me zotin Ibrahim Kadriu, dt. 20.07.2012.

themelua Kuvendi i Referendumit me 96 këshilltarë nga tri strukturat e popullsisë si subjektet politike, këshilltarët e dy partive Partisë për Veprim Demokratik dhe të Partisë Demokratike Shqiptare, si dhe të shoqatave jo qeveritare si "Nënë Tereza" etj. Në këtë Kuvend u vendos që Referendumi të organizohej e të mbahej me 1 dhe 2 mars të vitit 1992[12]. Kuvendi i Referendumit kishte edhe Kryesinë që përbëhej nga përfaqësuesit politik dhe anëtarët e organizatave jo qeveritare dhe nga anëtarë të pavarur.

Në këtë mënyrë më 26 shkurt 1992, Kryetar i Kuvendit të Referendumit u zgjodh Ibrahim Kadriu, prof. i Sociologjisë nga Presheva, i cili ishte anëtar i pavarur sepse nuk i përkiste asnjë partie politike, ndërsa për nënkryetar ishin dy liderët e Partive politike, Riza Halimi i Partisë për Veprim Demokratik dhe Ali Ahmeti i Partisë Demokratike Shqiptare. Ndërsa, sekretar i Kuvendit ishte Shaip Duraku nga Bujanovci, i cili njëherësh ishte edhe kryetar i Këshillit për Liri dhe të Drejtat e Njeriut. Për shkaqe praktike të largësisë dhe të sigurisë, vendi i përcaktuar për përfaqësuesin nga Medvegja kishte mbetur vakant[13]. Në mbledhjen e 26 shkurtit 1992 në Kuvendin e Referendumit përveç zgjedhjes së kryesisë dhe bartësve të referendumit ishte vendosur edhe për opsionet e Referendumit, pasi që në fillim subjektet politike hezitonin për opsionin e propozuar fillimisht Bashkim-Ribashkim me Kosovën. Kështu para anëtarëve të kuvendit u propozuan tri opsione: "Autonomi Politike Territoriale", "Bashkim me Kosovë" dhe "Autonomi Kulturore". Këto propozime u nxorën në votim në Kuvendin e Referendumit ku përcaktohej njëri opsion me të cilin do dilnin qytetarët në Referendum. Me shumicë votash fitoi opsioni për "Autonomi Territoriale Politike". Opsioni i Bashkimit me Kosovën siguroi 14 vota kurse opsioni për "Autonomi Kulturore" nuk mori asnjë votë[14].

Në një farë mënyre opsioni për "Autonomi Territoriale" me të drejtë Bashkëngjitje me Kosovën që u miratua përfundimisht, ishte edhe opsion kompromisi dhe shprese. Sipas kryetarit të Kuvendit z. Ibrahim Kadriut, opsioni i "Autonomisë Politike Territoriale" në rrethana aktuale në këto tri Komuna nuk mund të zbatohej. Sipas tij, mes Komunës së Bujanovcit dhe asaj të Medvegjës shtrihej një hapësirë e gjerë gjeografike me popullsi serbe, prandaj ky opsion ishte i pa realizueshëm, kështu që i vetmi opsion real dhe i mundshëm ishte ai i "Bashkimit-Ribashkim me Kosovë", e cila do të ishte një vazhdimësi e kontinuitetit territorial shqiptar. Pas shumë përgatitjeve, më 1 dhe 2 mars 1992, shqiptarët e komunave Preshevë, Bujanovc, Medvegjë votuan në 71 vendvotime, duke u deklaruar për një "Autonomi Politike e Territoriale" me të drejtë "Bashkëngjitje me Kosovë" të shqiptarëve në Preshevë, Bujanovc e Medvegjë. Gjatë organizimit, si dhe gjatë zhvillimit të Referendumit, te shqiptarët e Preshevës pati një entuziazëm të madh, pasi për herë të parë në histori u krijua mundësia të dalin në Referendum dhe të përcaktohen për fatin e tyre. Më kryesorja ishte se edhe pse ishte i ndaluar rreptësisht flamuri kombëtar shqiptar, gjatë gjithë kohës që

[12] Po aty.
[13] Po aty.
[14] Po aty.

zhvillohej Referendumi nëpër vendvotime e sidomos jashtë vendvotimeve ishin të vendosur flamujt kombëtarë shqiptarë. Po ashtu vlen të theksohet se fletëvotimet ishin në dy gjuhë: në gjuhën shqipe dhe në atë serbe, dhe për kohën e mbajtjes së referendumit ishin njoftuar organet e pushtetit lokal dhe atij qendror republikan të Serbisë. Po ashtu ishin njoftuar organizmat ndërkombëtarë, por edhe ishte kërkuar mbikëqyrja e tyre.

Gjatë zhvillimit të Referendumit në këto tri komuna nuk pati ndonjë rast dhune nga organet e rendit të pushtetit serb, përveç në fshatin Sfirc dhe në Tupallë të Komunës së Medvegjës, ku komisionerët ishin ftuar në polici në bisedë informative për veprimet që kishin ndërmarrë, duke i kërcënuar me burgim. Në vendet e tjera nuk pati ndonjë problem dhe në përgjithësi rrjedha e referendumit ishte e qetë[15]. E gjithë kjo arsyetohet pasi, përveç që kjo trevë ishte nën kontroll nga Republika e Serbisë, nuk pritej ndonjë eskalim situate nga popullsia shqiptare apo nxitje e liderëve politikë. Mbi të gjitha ishte se Republika e Serbisë ishte në atë kohë në vlugun e luftës në Kroaci dhe sapo kishte filluar luftën në Bosnje e Hercegovinë dhe tërë vëmendjen e kishte përqendruar në këto zona.

Në tri komunat Preshevë, Bujanovc, Medvegjë votuan 37.179 qytetarë me të drejtë vote, që në përqindje nënkupton 96.34%, ndërsa rreth 6 423 qytetarë të këtyre trevave votuan nëpër vendvotime jashtë vendit, si në Zvicër, Gjermani, Suedi, Danimarkë, Norvegji, Austri etj. E gjithë kjo nënkupton se nga 100% të votuesve me të drejtë vote në këto treva, në votime dolën 96,98% e votuesve dhe nga pjesëmarrësit për "Autonomi Politike Territoriale me të drejtë Bashkëngjitje me Kosovën" u deklaruan 99,94% e qytetarëve të këtyre tri komunave[16]. Mbarëvajtja e procesit, entuziazmi i popullsisë që votonte për herë të parë në histori për vullnetin e vet, tregonte rëndësinë dhe simbolikën e gjithë këtij procesi në masën e gjerë të popullsisë shqiptare. Siç vërehet popullsia e Luginës së Preshevës në shumicë absolute iu përgjigj ftesës për të dalë në referendum për të shprehur vullnetin e vet.

Më 22 mars të vitit 1992 u mbajt mbledhja e Kuvendit të Referendumi në të cilën u iniciua realizimi i rezultatit, që nënkuptonte zbatimin e opsionit të dalë nga referendumi, pra atë të "Autonomisë Territoriale me të drejtë bashkëngjitje me Kosovë". Po në këtë mbledhje ishte propozuar një grup prej pesë anëtarësh, i përbërë nga : Kryetari Ibrahim Kadriu, Sekretari Shaip Duraku, deputeti në Kuvendin e Republikës së Serbisë Behlul Nasufi, njëherësh anëtar i Partisë për Veprim Demokratik, kryetari i Partisë Demokratike Shqiptare Zeqirja Fazliu, pasuesi i Ali Ahmeti, pasi që ky i fundit u detyrua të largohej nga Presheva e të emigronte në Gjermani për shkak se në këtë kohë nga strukturat ushtarake i kishte arritur ftesa për mobilizim ushtarak, si edhe kryetari i Partisë për Veprim Demokratik Riza Halimi.

Ky grup-delegacion kishte detyrë të sensibilizonte qarqet dhe institucionet ndërkombëtare, si dhe ato vendore, në këtë rast, Republikën e Serbisë, për

[15] Intervistë me zotin Ibrahim Kadriu, dt. 20.07.2012.

[16] Gazeta ditore, *Bujku,* 3 mars 1992, Prishtinë, Referendumi-Sintezë e Kërkesave Popullore, fq.2.

rezultatet e referendumit të 1 dhe 2 marsit 1992 dhe për kërkesat e shqiptarëve të këtyre trevave[17]. Përveç kësaj në këtë Kuvend u vendos edhe për bojkotimin e çdo lloj zgjedhje të organizuar nga Republika e Serbisë deri sa të realizoheshin kërkesat e dala nga referendumi i 1 dhe 2 marsit të vitit 1992[18]. Megjithatë realizimi i kërkesës së referendumit dështoi si rezultat i hezitimit të subjekteve politike. Gjithë iniciativa dhe gjithë veprimtaria që ishte ndërmarrë mbetën në gjysmë. Mbledhjet e Kuvendit filluan të bojkotoheshin nga subjektet politike, të kundërshtohen dhe të mos mbahen më. Dalëngadalë ky Kuvend si rezultat i mosmarrëveshjeve të partive politike u shndërrua në jo funksional e shkoi deri në shuarje[19]. Gjithsesi organizimi i referendumit në tri Komunat e Luginës së Preshevës, ishte dhe mbetet suksesi më i madh i partive politike të këtyre trevave, për faktin se për herë të parë këto parti hasen të unifikuara me një qëndrim dhe në bashkëpunim të mirë. Ndonëse Kuvendi i Referendumit u bllokua në realizimin e rezultatit të referendumit, dhe ndonëse partitë politike nuk arritën një marrëveshje mes tyre për jetësimin e rezultateve të tij, referendumi i vitit 1992 vlerësohet lart si proces që u zhvillua në këto treva. Ai la të kuptohet vullneti politik i shqiptarëve të tri komunave, Preshevës, Bujanovcit dhe Medvegjës.

Qeverisja lokale nga partitë shqiptare

Vitet 90-të, komunat e Luginës së Preshevës i gjetën me një situatë të rëndë politike, ekonomike e sociale. Këto treva shqiptare qysh nga koha e Jugosllavisë së Titos mbanin primatin e vendeve me një moszhvillim ekonomik të theksuar. Gjatë viteve 90-të, edhe ato pak fabrika e punishte që ekzistonin në këto qytete filluan të mbyllen. Trysnia e strukturave shtetërore politike e policore ndaj shqiptarëve të këtyre tri komunave filloi në këto vite të theksohej më tepër, në tentativë për të kontrolluar çdo pore të jetës. Gjatë vitit 1991 në Serbi u ndërmorën hapa për ndryshime administrative territoriale. Në këtë vit u hoqën bashkësitë regjionale ndërkomunale, që ishin deri atëherë, dhe si ndarje administrative territoriale e politike, u futën qarqet. Kështu në Serbi u formuan 29 qarqe, ndërsa në Serbinë Jugore u formua Qarku i Pçinjës me komunat: Vranjë, Surdulicë, Vlladiçin Han, Bosilegrad, Tërgovisht, Bujanoc dhe Preshevë. Selia e rrethit u caktua në Vranjë. Edhe pse në mënyrë permanente popullsia e këtyre trevave deklaronte se ishte për bashkëngjitje me Kosovën, kjo mbeti një kërkesë e pa realizuar.

Siç theksuam edhe më lart Presheva gjendet në Serbinë Jugore, ndërsa shqiptarët e shohin dhe e njohin si pjesë e Kosovës Lindore. Presheva si komunë ndahet në dy sfera, që ndryshe njihen si vendbanime, ku hynë: Vendbanimet e Moravicës së Preshevës dhe të Karadakut të Preshevës. Në vendbanimet e Moravicës së Preshevës hynë fshatrat: Çukarka, Strezoci, Bugarina, Laniku, Geraj, Lerani, Golemidolli, Zhunica, Bukuroci, Bushtrani; në vendbanimet e Karadakut të Preshevës fshatrat: Miratoci, Tërrnava, Norça, Presheva, Kurbalia, Staneci, Seferi,

[17] Intervistë me zotin Ibrahim Kadriu, dt. 20.07.2012.
[18] Po aty.
[19] Intervistë me zotin Ibrahim Kadriu, dt. 20.07.2012.

Caravajka, Depca, Peçena, Buhiçi, Ilinca, Bukoci, Gare, Maxhera, Ranatoci, Gosponica, Rahovica, Shoshaja, Corrotica, Rainca, Bërrçeci.

Për vendbanimet e Komunës së Preshevës, shih edhe fig.1

Harta e Komunës së Preshevës



Fig.1.

Gjatë një pjese të periudhës së komunizmit Presheva qeverisej nga strukturat serbe por kjo vazhdoi edhe në një pjesë të periudhës së pluralizmit, sidomos pas shpalljes së zgjedhjeve lokale nga Qeveria e Serbisë në maj të vitit 1992. Pas mbajtjes së Referendumit në Luginë të Preshevës dhe pas shpalljes së rezultateve të këtij Referendumi, Partia për Veprim Demokratik u deklarua për pjesëmarrje në zgjedhje lokale, gjë që inicioi përgatitjen për një fushatë elektorale për marrjen e Komunës së Preshevës. Ndërsa partia tjetër shqiptare, si Partia Demokratike Shqiptare këto zgjedhje i bojkotoi. Në zgjedhjet e 31 majit 1992, partia e vetme shqiptare që mori pjesë në këto zgjedhje ishte Partia për Veprim Demokratik, e cila edhe i fitoi këto zgjedhje. Nga viti 1988 deri në vitin 1992, Presheva u udhëhoq nga serbët. Është për t'u theksuar se në frymën pluraliste ishte hera e parë në këtë sistem, që Komuna e Preshevës udhëhiqej nga një Parti Shqiptare.

Nga viti 1992, pushteti lokal filloi të udhëhiqej nga subjektet politike shqiptare sidomos nga Partia për Veprim Demokratik, pasi këto zgjedhje lokale Partia Demokratike Shqiptare i kishte bojkotuar me synimin dhe mendimin se pas rezultateve të referendumit duhet të bojkotoheshin zgjedhjet në Serbi, deri në implementimin e kërkesës së referendumit dhe se referendumi i obligonte që të vepronin në përputhshmëri me partitë politike në Kosovë, duke krijuar edhe në këto

treva, sistem paralel karshi institucioneve komunale. Partia Demokratike Shqiptare ndoqi këtë linjë deri në vitin 1993, kohë pas së cilës edhe kjo parti mendonte se duhej të dalë në zgjedhje në mënyrë që të krijohej hapësirë dhe mundësi për veprim politik.

Kështu në zgjedhjet parlamentare në Serbi në muajin dhjetor të vitit 1993, subjektet politike shqiptare të Luginës së Preshevës ishin pjesëmarrëse në zgjedhje. Është për t'u theksuar se në këto zgjedhje parlamentare subjektet politike shqiptare në Luginën e Preshevës kishin formuar koalicion zgjedhor. Në këto zgjedhje subjektet politike shqiptare morën 29.342 vota[20] dhe arritën të siguronin dy vende në Parlamentin e Serbisë përkatësisht u përfaqësuan nga deputetët Behlul Nasufi, anëtar i Partisë për Veprim Demokratik dhe nga Tahir Dalipi, anëtar i Partisë Demokratike Shqiptare[21]. Është për t'u theksuar se edhe pse në zgjedhjet lokale të Serbisë, Presheva u fitua nga subjektet politike shqiptare dhe udhëhiqej nga ata, kjo nuk ndodhi për komunat e tjera, Bujanovcin dhe Medvegjën. Komuna e Bujanovcit, edhe pse ishte me shumicë shqiptare, me ndërhyrjet nga qendra, Serbia, nuk u lejua të qeverisej nga shqiptarët aq më pak mund të ndodhte kjo në Komunën e Medvegjës ku shqiptarët nuk përbënin shumicën e popullsisë.

Vetëm në Komunën e Preshevës, nga viti 1992, rregullisht, ishin subjektet politike shqiptare që drejtonin qeverisjen lokale. Në këtë periudhë situata e gjithëmbarshme në regjion ishte tej mase e rënduar nga kriza e madhe ekonomike e politike, që kishte kapluar gjithë Serbinë. Ishte periudha e luftërave në Kroaci, Bosnje e Hercegovinë, e sulmit të nacionalizmit serb për të shkatërruar çdo gjë që konsideronte si antiserbe, ishte koha e aplikimit të sanksioneve ndërkombëtare ndaj Serbisë. Në të gjitha sferat e jetës mbretëronte një gjendje e rëndë, sidomos për shqiptarët, çka detyroi që një pjesë e madhe e rinisë shqiptare u detyrua të emigrojë jashtë. Një arsye thelbësore e largimit ishte ikja nga mobilizimi ushtarak që praktikonte Serbia për të plotësuar radhët e forcave të saj që luftonin kundër kroatëve dhe boshnjakëve. Në gjithë këtë situatë të vështirë, subjektet politike shqiptare duhej të qeverisnin e t'i zgjidhnin problemet e popullsisë në përgjithësi. Edhe pse mungesa e të mirave materiale nuk e lejonte, veprimet e menduara ishin për një rregullim më të mirë dhe për një zhvillim të standardit jetësor apo për ndërmarrjen e ndonjë iniciative për të mirën e popullsisë. Në këtë kohë subjekteve politike shqiptare dhe qeverisjes lokale, i erdhi në ndihmë mërgata e kësaj treve, e cila ishte shumë e madhe dhe shtrihej në të gjitha vendet e Evropës. Ajo me ndihmat materiale dhe donacionet e vazhdueshme ndihmoi aktivitetet politike dhe administrative në Komunën e Preshevës, e cila u dallua në krahasim me trevat e tjera.

Në këtë kohë Luginës së Preshevës iu shtua edhe një subjekt politik. Një pjesë e politikanëve, anëtarë të Partisë për Veprim Demokratik dhe intelektualëve të tjerë të pavarur, në vitin 1995, formuan Partinë Parlamentare, çka e fragmentarizoi në tri pjesë elektoratin shqiptar. Për pasojë zgjedhjet lokale të vitit 1996, u kthyen në zgjedhjet më dramatike në këtë rajon. Dy subjektet politike, Partia për Veprim

[20] S. Latifi, *Rrugëtimi nëpër Luginë të Preshevës ...,*fq.142.
[21] *Po aty*.

Demokratik dhe Partia Demokratike Shqiptare u detyruan të hynë në koalicion në udhëheqjen e komunës. Por në zgjedhjet parlamentare, që organizoi Republika e Serbisë, subjektet e politike të Luginës së Preshevës arritën të fitojnë vetëm një vend në Parlamentin e Serbisë nga dy vende që patën më parë. Në periudhën prej vitit 1997 deri në vitin 2000, përfaqësuesi i vetëm i Luginës së Preshevës në Parlamentin e Serbisë, ishte Ramadan Ahmet Daci nga fshati Tërrnoc, komuna e Bujanovcit, anëtar i Partisë për Veprim Demokratik[22].

Po në këtë kohë nga subjektet politike shqiptare, po më së shumti nga vetë qytetarët e kësaj komune, sidomos nga shtresa e intelektualëve u organizuan shumë aktivitete kulturore artistike. Është për t'u theksuar se në këtë kohë për trevat shqiptare në Jugosllavi, Presheva ishte shndërruar në një qendër kulturore artistike. Kjo ishte arritur nga vetë organizimi i qytetarëve për të krijuar një klimë më të butë por edhe nga ndihma e subjekteve politike të qeverisjes lokale dhe angazhimi i madh i punëtorëve të institucioneve kulturore në këtë komunë. Në periudhën e viteve 90-të në Shtëpinë e Kulturës së Preshevës "Abdullah Krashnica" organizuan shumë aktivitete kulturore artistike, përkatësisht veprimtari teatrale, aktivitete letrare, festivale të recituesve, takime të Shoqërive kulturore artistike, festivale si "Ditët e Komedisë Shqiptare - Presheva 95" etj. Natyrisht në këtë periudhë e vetmja fushë ku shqiptarët e Preshevës mund të prosperonin, ishin aktivitetet kulturore artistike. Në fushat e tjera, të gjithë aktivitetet që ndërmerreshin sabotoheshin, ose pengoheshin, nga organet qendrore të Serbisë.

Komunat e tjera të Luginës së Preshevës, Bujanovci dhe Medvegja, kishin një gjendje shumë më të vështirë se Presheva. Komuna e Bujanovcit gjatë viteve 90-të, ishte nën vrojtimin dhe mbikëqyrjen direkte të politikës së Milosheviqit. Në këtë komunë popullsisë shqiptare, edhe pse ishte në shumicë, nuk do t'i lejohej të merrte pushtetin lokal. Nga 41 këshilltarë që kishte Kuvendi Komunal i Bujanovcit, vetëm 12 ishin shqiptarë, ndërkohë që shqiptarët përbënin 55% të popullsisë së Komunës. Në Bujanovc, strukturat politike e shtetërore serbe, kishin vënë në shënjestër edhe arsimin në gjuhën shqipe. Në vitin 1990 në shkollat shqiptare në Bujanoc u vendosën masat e dhunshme, të cilat më vonë çuan në mbylljen e shkollave në gjuhën shqipe. Medvegja në këtë aspekt qëndronte edhe më keq. Shkollat në gjuhën shqipe ishin mbyllur dhe kishte nisur fushata e diferencimit, etiketimit, e gjitha mjeteve tjera torturuese ndaj popullsisë shqiptare. Në Medvegjë autoritetet serbe e kishin edhe më të lehtë të vepronin sepse shqiptarët nuk ishin shumicë e popullsisë, gjë që reflektohej edhe në përfaqësimin e popullit në organet e qeverisjes lokale. Në Kuvendin Komunal të Medvegjës shqiptarët ishin të përfaqësuar me 6 këshilltarë komunalë. Ky numër i vogël i përfaqësuesve komunalë e kishte shumë të vështirë që në Kuvendin Komunal të zgjidhte edhe problemin më të vogël të popullsisë shqiptare të kësaj treve.

Gjatë gjithë viteve 90-të e shtyrë nga dhuna, presioni, maltretimi si dhe nën kërcënimin e forcave policore ushtarake, u shtuan shumë shpërnguljet e popullsisë shqiptare. Deri në vitin 1999 nga Medvegja, ishte shpërngulur rreth 90% të

[22] S. Latifi, *Rrugëtimi nëpër Luginë të Preshevës ...,* fq.144.

popullsisë shqiptare, përkatësisht ishin shpërngulur 740 familje me 3.846 anëtarë, kurse kishin mbetur vetëm 159 familje, me 560 anëtarë[23].

Solidarizimi dhe ndihma e shqiptarëve të Preshevës për Kosovën

Ngjarjet e viteve 90-të, nga Kuvendi i Kaçanikut i 7 shtatorit të vitit 1990, deri te referendumi i vitit 1991, nisën të japin shenja të qarta për krijimin e një shteti paralel të shqiptarëve në Kosovë. Ndonëse në këtë kohë pushteti serb me anë të aparatit të dhunës dhe masave të dhunshme kontrollonte çdo por të jetës, ai nuk arriti të ndikonte në organizimin e brendshëm të shqiptarëve. Në këtë periudhë nga pushteti qendror serb, si dhe ai i instaluar në Kosovë, u përpiluan plane e strategji si të veprohej kundër shqiptarëve. Pushteti serb krahas dhunës së deriatëhershme të praktikuar ndaj shqiptarëve, filloi të bëjë edhe trysni sociale, duke i larguar shqiptarët nga vendet e punës. Pasojë ishte shtimi i emigracionit. Në këtë mënyrë Serbia synonte spastrimin e qetë etnik të Kosovës. Trysnia sociale u vërejt sidomos pas grevës së përgjithshme të 3 shtatorit të vitit 1990, e cila paralizoi në tërësi jetën në Kosovë. Ky rast u shfrytëzua nga strukturat shtetërore në Serbi dhe nga pushteti i dhunshëm serb që ishte instaluar në Kosovë. Fillimisht nisën suspendimet e Kuvendeve Komunale në Kosovë, të bashkëstafeve udhëheqëse dhe strukturave përcjellëse, duke i zëvendësuar ato me zyrtarë serbë të vendit, apo të sjellë nga Serbia. Pasuan largimet masive të shqiptarëve nga puna në sektorin publik apo institucionet e ndryshme.

Pas tre shtatorit u shkarkuan nga vendet udhëheqëse të gjithë drejtuesve të ndërmarrjeve publike, që ishin të përkatësisë etnike shqiptare, mandej u pezulluan nga puna gjykatësit, prokurorët dhe drejtuesit e administratës publike. Në këtë formë do të veprohej edhe me drejtuesit e shkollave, institucioneve parashkollore dhe institucionet e kulturës[24]. Ndërsa në fazën e dytë të dëbimit të shqiptarëve nga puna, përfshiu të gjitha institucionet shoqërore e ekonomike, si ato të shëndetësisë, të kulturës e arsimit. Udhëheqësit e dhunshëm, për të punësuarit shqiptarë, që ende nuk ishin larguar nga puna kishin vendosur "masën e domosdoshme të lojalitetit ndaj shtetit të Serbisë", e cila bëhej me anë të një nënshkrimi të një dokumenti të veçantë. Ata që e refuzonin këtë nënshkrim, humbnin të drejtën e punës. Në këtë formë u veprua me gjykatësit, prokurorët, policët etj[25]. Po ashtu me dekretin e 2 janarit të vitit 1991 të Qeverisë së Serbisë, u vendos përdorimin e gjuhës serbe si gjuhë zyrtare, duke hequr përfundimisht gjuhën shqipe.

Masat e sipërpërmendura të ndërmarra nga qeveria e Serbisë ndaj shqiptarëve në Kosovë, e futën atë në një kaos social ekonomik. Shtresa e mesme të popullsisë shqiptare u kthye në një gjendje sociale pa kurrfarë të ardhurash. Të shtyrë nga kjo situatë, shqiptarët u detyruan të organizoheshin për një jetë institucionale paralele, me qëllim që t'i vinë në ndihmë masës së gjerë të popullsisë shqiptare. Në këtë

[23] I. Muharremi, *Shqiptarët e Medvegjës nëpër shekuj-Rrënjët e lëkundura*…, fq.618.
[24] J. Buxhovi, *Kosova - Nga Konferenca e Londrës deri te protektorati ndërkombëtar…,* fq. 500.
[25] *Po aty*, fq. 501.

frymë u ndërmor edhe iniciativa e përkujdesjes sociale, me të cilën tentohej t'u vihej në ndihmë me mjete materiale shtresave të popullsisë, të cilat në këtë kohë kishin mbetur pa të ardhura materiale. Në kuadër të kësaj nisme filloi edhe organizimi i shqiptarëve të trevave të Jugosllavisë dhe jashtë saj për të shprehur solidaritetin e tyre ndaj shqiptarëve të Kosovës. Shtrirja e solidaritetit filloi nga familja e ngushtë për t'u shtrirë në të gjitha trevat shqiptare që bashkëndienin gjendjen e shqiptarëve të Kosovës. Në këtë organizim, Lugina e Preshevës nuk qëndroi indiferente. Duke ndjerë gjendjen e shqiptarëve në Kosovë, e gjithë popullsia e Luginës, si me iniciativa vetjake, ashtu edhe duke u organizuar nëpërmjet institucioneve-shoqatave të ndryshme, shprehu solidaritetin ndaj popullsisë shqiptare në Kosovë. U mblodhën dhe dërguan ndihma me ushqime e veshmbathje dhe u derdhën mjete të konsiderueshme financiare nëpër fondet e solidaritetit, që u ngritën për këtë qëllim.

Solidariteti i shqiptarëve të Luginës së Preshevës me shqiptarët e Kosovës kishte filluar edhe më herët, edhe para krijimit të fondeve të solidaritetit. Në këtë drejtim është për t'u përmendur mbledhja e mjeteve financiare për përmirësimin e gjendjes financiare të Radiotelevizionit të Prishtinës. Kjo erdhi pas apelit të bërë nga udhëheqësit e Radio Televizionit të Prishtinës ndërmjet viteve 1989-1990. Popullata e Luginës së Preshevës, në masë të madhe, iu përgjigj këtij apeli duke grumbulluar mjete financiare të cilat iu dorëzuan më 5 korrik të vitit 1990 këtij institucioni pak kohë para mbylljes së tij nga forcat policore serbe.

Shqiptarët e Luginës së Preshevës pa hezitim shprehën ndjenjat solidare edhe pas ftesës së Sindikatës së pavarur të Kosovës dhe të Partive Politike Shqiptare të Kosovës, për ndihmë, e cila u ndërmor me moton "Familja ndihmon Familjen". Shumica e punëtorëve të përkohshëm të Preshevës, të punësuar në shtetet e Perëndimit, ndërmorën iniciativën që të mbajnë nga një familje në Kosovë. Në të njëjtën kohë nga mërgata shqiptare e Luginës së Preshevës, edhe pse formalisht ishin jashtë kufijve administrativë të Republikës së Kosovës të shpallur me referendum dhe vendimet e Qeverisë së Kosovës në egzil nuk e obligonin atë të kontribuonte në fondin e kësaj qeverie, i paguanin Qeverisë së Kosovës 3% në baza vullnetare gjatë tërë kohës deri në mbarim të luftës së Kosovës. Në fakt qëndrimi që e shprehnin ishte se, gjithherë e kishin konsideruar veten si pjesë e Kosovës. Në këtë formë kjo mërgatë që nga viti 1993 dha dhe derdhi shumë mjete financiare për fondin "Vendlindja thërret". Një pjesë e mërgatës së kësaj treve ishin edhe shumë aktivë në grumbullimin e mjeteve për këtë fond nga bashkëvendësit.

Është për t'u theksuar se në fund të viteve 80-të dhe në fillim të viteve 90-të, gjendja ekonomike, financiare e shqiptarëve të kësaj treve ishin shumë mirë. Prandaj nga kjo pjesë e shqiptarëve në asnjë lëmë nuk mungoi ndihma e dedikuar për Kosovën. Po ashtu edhe gjatë viteve 90-të, me iniciativa të ndryshme nga popullsia e kësaj treve disa herë ndërmerreshin aktivitete nëpër fshatra dhe qendra komunale për grumbullimin e mjeteve financiare, mallrave për konsum familjar, duke u nisur nga ushqimi e deri te veshmbathja. Gjithë këto ndihma në mjete materiale e financiare janë të pallogaritshme dhe kapin shifra të larta. Është për t'u theksuar se shumica e këtyre aktiviteteve janë zhvilluar dhe udhëhequr nga shoqata "Nënë Tereza" në Preshevë dhe Bujanovc. Mjetet financiare dhe të mirat materiale

të grumbulluara nga kjo shoqatë i dorëzoheshin shoqatës simotër "Nënë Tereza" në Prishtinë[26]. Gjithë ky aktivitet ishte mjaft i vështirë, pasi shpesh aktivistët e shoqatës "Nënë Tereza" në Preshevë e Bujanovc burgoseshin, rriheshin e masakroheshin nga strukturat militare policore e paramilitare serb. Shpesh ndihmat konfiskoheshin për t'i penguar të mbërrinin në destinacion dhe për të demoralizuar dhuruesit.

Është e njohur se popullsia shqiptare e Luginës së Preshevës është treguar shumë solidare, çdo herë kur e kërkonte nevoja. Do të duhej përmendur me këtë rast organizimi dhe grumbullimi i ndihmave për ndërtimin e Shkupit, i cili ishte shkatërruar nga tërmeti në korrik të vitit 1963. Veçanërisht kur bëhet fjalë për Kosovën, popullsia shqiptare e Luginës së Preshevës gjithherë e konsideronte veten si pjesë e të njëjtit trung, por të ndarë dhunshëm.

Po ashtu është për t'u theksuar se gjatë luftës në Kosovë, sidomos pas fillimit të bombardimeve të NATO-s, nga 24 marsi i vitit 1999, në Luginë të Preshevës situata ishte më e mirë. Një pjesë e qytetarëve të Kosovës, sidomos ato familje që kishin lidhshmëri me Preshevën, gjetën strehë në Bujanovc dhe në Preshevë. Popullsia shqiptare e Luginës së Preshevës solidaritetin e saj e shprehu edhe me inkuadrimin e shumë të rinjve të kësaj treve në radhët e Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës. Përveç kësaj, shqiptarë të Luginës së Preshevës, respektivisht persona të caktuar, me frymëzim patriotik e solidar të kësaj treve, kontribuuan edhe në furnizimin me armatim të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës gjatë luftës në Kosovë. Ky solidaritet në masë edhe më të madhe Luginës së Preshevës iu kthye në Luftën e UÇPMB-ës në vitin 2000, ku shumë djem e patriotë shqiptarë të tëra viseve shqiptare, duke filluar nga Kosova, Maqedonia e Shqipëria, luftuan bashkërisht me shqiptarët e Luginës së Preshevës, dhanë edhe jetën për mbrojtjen e territoreve më lindore të banuara me shqiptarë.

Duke pasur shtrirje gjeografike të përshtatshme, Lugina e Preshevës, e ndodhur në kryqëzim të rrugëve që lidhin Maqedoninë, Bullgarinë me Kosovën dhe Serbinë ka patur e ka një aktivitet të zhvilluar çka ka ndikuar që në aspektin ekonomik-financiar të jetë më mirë në krahasim me trevat e tjera shqiptare. Por, duke qenë pjesë e Serbisë, kjo trevë, më tepër se pjesët e tjera të trevave shqiptare, në Jugosllavi, e ka ndier dhe e ndien ende shtypjen dhe zullumin shtetëror serb. Këto rrethana ndikuan në kalitjen e kësaj popullsie duke e shndërruar në punëtore, të pathyeshme dhe rezistente në valët e jetës. Gjithë këto peripeci ndikuan që shqiptarët e Luginës së Preshevës të jenë shumë solidarë.

[26] Intervistë me Ibrahim Kadriun – udhëheqës i shoqatës "Nën Tereza" në Preshevë, Preshevë më 20.07.2012.

LITERATURA:

Atanasije Jevtić - *Stradanja Srba na Kosovu i Metohiji od 1941.do 1990 godine*, Jedinstvo Priština, 1990,

Latifi, Skënder - *Rrugëtimi Nëpër Luginë të Preshevës,* Botues autori, Preshevë, 2006.

N.A.B.Ф. Скупштина општина Прешево- Прешево, Д. 007, 16.10.1988.

Muharremi, Ismail - *Shqiptarët e Medvegjës nëpër shekuj (Rrënjët e lëkundura),* Libri 1,2, Shtëpia Botuese Libri Shkollor, Prishtinë, 2010.

Gazeta ditore, *Bujku*, 3 mars 1992, Prishtinë, *Referendumi-Sintezë e Kërkesave Populllore*, fq.2.

Buxhovi, Jusuf - *Kosova* Libri I-II-III, Prishtinë, Faik Konica, 2012.

Intervistë me Ibrahim Kadriun, profesor i Sociologjisë, Kryetar i Kuvendit të referendumit në Luginë të Preshevës gjatë 1-2 marsit 1992, 20.07.2012, Preshevë.

ILIR A. ZYLFIU

FILLESAT E ARSIMIT SHQIP NË PRESHEVË E RRETHINË

Zhvillimin e arsimit, si në të gjitha viset shqiptare, duke përfshirë këtu edhe komunën e Preshevës, e shoqëruan kushte specifike në krahasim me viset e tjera të ish-Jugosllavisë. Arsimi në komunën e Preshevës hasi në pengesa të mëdha të natyrës ekonomike, politike, mungesës së kuadrit arsimor, por mbi të gjitha ishte prapambetja arsimore e kulturore e trashëguar nga e kaluara si pasojë e një politike diskriminuese e pushtetit të atëhershëm jugosllav.[1]

E drejta për arsim ishte e përcaktuar si e drejtë kushtetuese me Kushtetutën e 31 janarit të vitit 1946 të RFPJ –së. Në kushtetutën e lartpërmendur theksohej se shkollimi fillor ishte i detyrueshëm dhe pa pagesë, shkollat dhe institucionet arsimore ishin të hapura për të gjitha shtresat popullore. [2]

Shkollat fillore në të gjitha viset shqiptare, duke përfshirë këtu edhe komunën e Preshevës në periudhën e viteve 1945 – 48 punuan në bazë të një dokumenti të Ministrisë së Arsimit të Federatës Jugosllave, të lëshuar më 10 gushtë 1945 me titull "Drejtimet për punën e shkollave të pakicave kombëtare". Me këtë dokument ishte përcaktuar se kur mund të hapet një shkollë me mësim në gjuhën e pakicave, sa nxënës duhet të ketë paralelja, kush mund të zhvillojë procesin mësimor etj.[3] Pra, Ministria e Arsimit kishte parashikuar këto orientime për hapjen e shkollave për pakicat kombëtare [4]:

- *Për të gjitha pakicat kombëtare hapen shkolla në gjuhën amtare, nëse së paku ka 20 nxënës dhe nuk ka shkollë tjetër. Nëse në atë vendbanim ekziston shkolla fillore, pranë kësaj shkolle hapet paralelja për pakica vetëm nëse ka 30 nxënës.*

- *Çdo republikë kujdesej për hapjen e mbarëvajtjen e shkollave fillore dhe të mesme për pakicat.*

- *Prej klasës së tretë në shkollat e pakicave mësohej gjuha e njësisë federale amë, nga tri orë në javë .*

[1] Ilir Zylfiu, Arsimi shqip në Luginë të Preshevës gjatë shek. XX, *Presheva, Bujanoci dhe Medvegja Dje, Sot dhe Nesër,* Instituti Albanologjik, Prishtinë, 2015,f.202.
[2] Kushtetuta e RFPJ-së (Službeni list FNRJ) nr. 10, shkurt 1946, neni 37.
[3] Ana Lalaj, Kosova rruga e gjatë e vetëvendosjes 1948-81, Tiranë, 2000, f.115.
[4] Avzi Mustafa, Zhvillimi i arsimit fillor shqip në Republikën e Maqedonisë 1945-1975, Shkup, 1998, f.79.

- *Duke pasur parasysh që te disa pakica kombëtare mungonte kuadri arsimor, qe parashikuar që deri në vitin 1951 të pranohen si mësimdhënës edhe shtetasit e huaj që kanë kualifikim të nevojshëm.*
- *Shkolla parashihej që me dispozita ligjore të ishte nën mbikqyrjen e pushtetit popullor.*
- *Për tekstet shkollore parashihej që të botoheshin në vend. Ato tekste që nuk mund të botohen, do të importohen nga jashtë me leje të autoriteteve arsimore.*

Mbi bazën e dokumentit të lartpërmendur edhe në komunën e Preshevës filluan të hapen shkolla fillore. Një rol të rëndësishëm në hapjen e shkollave të para në gjuhën shqipe ka luajtur Abdulla Krashnica.[5] Sa i përket hapjes së shkollës së parë në gjuhën shqipe në komunë të Preshevës edhe sot e kësaj dite ka një konfuzion. Në monografinë e Haki Sylejmani, Selver Murati, Rexhep Selimi, "Arsimi Fillor Shqip në Komunën e Preshevës 1945 – 1995'', Preshevë, 2001, thuhet se shkolla e parë u hap më 6 shkurt në fshatin Raincë.[6] Mirpo, në fletoren e shkollës fillore 'Zenel Hajdini' në Raincë thuhet se shkolla në mënyrë solemne u hap më 10 shkurt të vitit 1945.

Në Preshevë shkolla fillore katërvjeçare me mësim në gjuhën shqipe, u hap më 7 shkurt të vitit 1945 në mënyrë solemne. Nëse marrim parasysh hapjen solemne të shkollave, atëherë mund të vijmë në përfundim se shkolla e parë në gjuhën shqipe në komunën e Preshevës është hapur më 7 shkurt të vitit 1945 në Preshevë. Objekti shkollor ka qenë Villa Letafet - shtëpi private (pronë Abdullah Veliut). Shkolla mbante emrin "Selami Ibrahimi". Shkolla kishte dy paralele, kuadri arsimor ishte i pamjaftushëm.mësimet i vijonin 32 nxënës. Në këtë vit shkollor në komunën e Preshevës gjithsej ishin 130 nxënës prej tyre 27 femra dhe 103 meshkuj.[7] Ndërsa te monografia e Haki Sylejmanit, Selver Muratit, Rexhep Selimit të regjistruar paraqiten 227 nxënës. Mësuesit e parë të kësaj shkolle kanë qenë Hilmi Qerimi, Abdulla Ukshini, Tajar Zylfiu nga Elbasani, Demirali Ramadani. Në periudhën 1945-49 në komunën e Preshevës janë hapur 14 shkolla fillore katër vjeçar me mësim në gjuhën shqipe.[8] Sipas dokumentit që ka të bëjë me listën e shkollave të rrethit të Preshevës, që i përket datës 18. IX 1945, mësojmë se shkollat e para shqipe u hapën në pjesën e dytë të vitit shkollor 1944/45 edhe atë në Preshevë, Miratocë, Rahovicë.[9]

[5] Shiko më shumë: Skender Latifi, Rrugtimi nëpër Luginë të Preshevës, Preshevë, 2006, f.93.
[6] Haki Sylejmani, Selver Murati, Rexhep Selimi, Arsimi Fillor Shqip në Komunën e Preshevës 1945-1995, Preshevë, 2001, f. 47.
[7] Arkivi i Serbisë, Fondi Ministarstvo Prosvete, f.89, br.29, Statistički list za osnovne škole školske 1945/46 godine.
[8] Sylejmani, Murati, Selimi, Arsimi fillor ... , f. 84.
[9] AS, Fondi Ministarstvo Prosvete, fsc.74, Kontrolni Spisak Manjinski Škola Srez Presevski 18.IX1945.

Në fshatin Miratoc shkolla fillore katër klasëshe me mësim në gjuhën shqipe ka filluar punën në mars të vitit 1945. Në mungesë të kuadrit arsimor ishte angazhuar nga Komiteti i Rrethit të Preshevës i quajtur Isuf Asan Skoro nga Struga. Me fillimin e veprimtarisë edukativo-arsimore në vitin 1945, disa shkolla në territorin e komunës së Preshevës nuk kishin emra përcaktues.[10]

Në fshatin Rahovicë mësimi ka filluar në muajin shkurt të vitit 1945. Mësimi është zhvilluar në lokalet e shkollës fetare. Mësuesi i parë ka qenë Hysen Struga.[11] Në fshatin Tërrnavë mësimi ka filluar me 10.12.1945. Në listën e regjistrimit të shkollës fillore – Tërrnavë 19.09.1945 në klasën e parë gjithsej ishin 31 nxënës. Prej tyre 20 meshkuj dhe 11 femra.[12] Në vitin shkollor 1946/47, shkolla në Tërrnavë ka pasur paralele ku mësimi është zhvilluar në gjuhë serbe dhe në gjuhën shqipe. Me mësim në gjuhën shqipe në klasën e parë kanë qenë të regjistruar 49 nxënës, në klasën e dytë 31 nxënës.[13] Gjatë vitit shkollor 1945/46 në komunën e Preshevës u hapën gjashtë shkolla fillore katër vjeçare me mësim në gjuhën shqipe, si në fshatin Corroticë, Zhunicë, Norçë, Bukuroc, Geraj. Shkolla fillore katërvjeçare u hapen në vendbanimin Ilincë dhe Bushtarn. Përveç shkollave të lartpërmendura që vazhdojnë punën, në vitin shkollor vijues u hapën dy shkolla fillore katër vjeçare në fshatin Corroticë dhe Strezoc. Hapja e shkollave në gjuhën shqipe vijoi edhe në vitin shkollor 1948/49 si në Depcë, Buhiç dhe Gare.[14]

Hapjen e shkollave nuk e ka shoqëruar një trend i vazhdueshëm. Ndodhte që viti shkollor në disa shkolla të fillonte në shtator e në disa shkolla tjera në muajin shkurt të vitit vijues. Kjo gjendje na paraqitej nga mungesa e kuadrit arsimor, lokalit. Hapja e shkollave shoqërohej edhe me problemet të natyrës politike dhe religjioze. [15]

Zhvillimi i arsimit në komunën e Preshevës, pas Luftës së Dytë Botërore, u zhvillua mbi një bazë të kuadrit të dobët për nga numri. Në Preshevë, kuadrot e para ishin mësues të ardhur nga Shqipëria, Peja, Istogu, Vushtrria, Mitovica, Kamenica, Rogoçica, Struga të cilët dhanë një kontribut të jashtëzakonshëm. Ardhja e mësuesve dhe mësueseve nga Shqipëria ka të bëjë me marrëdhëniet e mira në mes dy shteteve. Ardhja e mësuesve nga shteti amë ishte parashikuar edhe në orientimet e Ministrisë së Arsimit ku thuhej : "*Duke pasur parasysh që në disa pakica kombëtare mungonte kuadri arsimor qe parashikuar që deri në vitin 1951 të pranohen si mësimdhënës edhe shtetasit e huaj që kanë kualifikim të nevojshëm".* Pas vitit 1948, me ngjarjet e informbyrosë, marrëdhëniet në mes dy shteteve prishen. Prishja e marrëdhënieve ndërshtetërore u reflektua edhe në fushën e

[10] Gafur Hyseni, Historiku i Shkollës Fillor " Abdullah Krashnica", Miratoc, 2000, f.36.
[11] Sylejmani, Murati, Selimi, Arsimi Fillor , f. 53.
[12] AS, Fondi Ministarstvo Prosvete, fsc. 89, nr. 29, Statistički list za osnovne škole u selu Trrnave školske 1945 godine.
[13] AS, Fondi Ministarstvo Prosvete, fsc. 89, Statistički list za osnovne škole u selu Trrnave školske 1946/47 godine.
[14] Shih më tepër: Ilir Zylfiu, Zhvillimi i arsimit shqip në Komunën e Preshevës, KOSOVA, nr. 35,36, Instituti Historik, Prishtinë, 2012,f. 364.
[15] AS, Fondi Savet za Prosvetu i Kulturu, fsc. 20, Spisak Osnovnih škola sreza bujanovačkog u koji rade 2 ili više učitela 1952/53 godine.

arsimit. Mirëpo me kohë u bë edhe kuadri vendas. Për disa vite për t´u aftësuar kuadri arsimor u organizuan kurse e seminare të ndryshme.[16]

Kontribut të madh në fillet e arsimit shqip në komunën e Preshevës dhanë mësues të ardhur nga viset e ndryshme shqiptare si**:** Abdullah Ukshini – Vushtrri, Ali Bektashi - Nasalcë, Ali Turbetari – Prishtinë (Mazgit), Enver Keka - Kamenicë, Fehmi Salihu Përlepnicë - Gjilan, Fetah Alifeta – Lotovicë/Bujanocë, Hysen Struga – Strugë, Isuf Skoro - Strugë, Jusuf Selimi Nasalcë, Mark Gjecaj – Shkodër, Marko Gashi – Selishtë/Viti, Mefail Abdullahu - Tërrnovc, Mehmet Halili Hoxha, Mustafë Venhari - Vushtrri, Nexhat Boriqi – Shkodër, Ndoc Stojku – Shkodër, Rexhep Gashi – Pejë, Salih Jonuzi – Nasalcë/Bujanocë, Sejdi Kryeziu – Kamenicë, Selim Elashanaj - Pejë, Shefqet Karakashi – Vushtrri, Shukri Rahimi - Nasalcë/Bujanocë, Skender Burgia – Mitrovicë, Sylejman Hana – Prishtinë, Tajar Zylfiu – Elbasan, Tefik Geci - Gjilan, Tefik Kallaba – Rogoçicë, Zeqir Jakupi-Medvegjë, Zija Myftia - Shkodër. Por, rol të rëndësishëm në fillet e arsimit shqip në komunën e Preshevës dha edhe femra shqiptare. Mësueset e para kryesisht vinin nga viset tjera, si: Anastasie Elshanaj – Pejë, Cicilie Gashi - Prishtinë, Ilmie Turbetari – Prishtinë, Lara Stojku – Shkodër, Kadrije Qerimi - Preshevë, Mediha Karaxha, Mysherefe Mustafa – Mitrovicë, Nazmie Karaçeva – Kamenicë, Sadie Limani – Pejë.[17] Në vazhdim paraqesim pasqyrën e kuadrit arsimor të komunës së Preshevës dhe kualifikimin e tyre që kanë punuar në shkollat fillore në Komunën e Preshevës gjatë peridhës kohore 1945-49:[18]

Abedin Memeti – kurs pedagogjik në vitin 1945, në Shkup.

Adem Memeti – kurs pedagogjik në vitin 1945.

Emin Ramadani – kurs pedagogjik në vitin 1949, në Shkup.

Esat Ibrahimi – 6 muaj kurs pedagogjik në vitin 1945, në Shkup.

Fahredin Mustafa – kurs pedagogjik në vitin 1946, në Shkup.

Hilmi Qerimi - 1941/42 klasë e pestë të Shkollës Normale – Gjimnazi "Sami Frashëri" në Prishtinë e gjatë verës 1942 kursin pedagogjik në Prishtinë.

Hulusi Ibrahimi – kurse Pedagogjike në vitin 1945/46, 1947, në Shkup.

Isa Selimi – kurs pedagogjik në vitin 1948, në Prizren,Gjakovë dhe Shkup.

Kadrije Qerimi – kurs pedagogjik në vitin 1947 në Shkup.

Memet Kadriu – kurs pedagogjik 1945/46, në Pejë.

Nevzad Jashari – kurs pedagogjik në vitin 1949, në Prizren.

Nexhati Ramadani – kurse pedagogjike tre mujore 1945, 1946, 1947, në Shkup.

Ramiz Duraku – kurs pedagogjik në vitin 1948, në Shkup.

Rexhep Salihu – kurs pedagogjik ne vitin 1949, në Prizren e Pejë.

Sadri Ymeri – kurse të gjimnazit pedagogjik në vitin 1949, në Prizren.

---

[16] Zylfiu, Zhvillimi i arsimit shqip, f.365.

[17] Tahir S. Berisha, Emërat që nuk harrohen 1,2, Prishtinë, 1994, 1996 dhe shënime nga vet mësuesit dhe familjarët.

[18] Arkivi i Shkollës Fillore " Ibrahim Kelmendi" , Preshevë, dok. biografit e mësimëdhënësve.

Shukri Shaqiri – kurs pedagogjik në vitin 1945, në Shkup.
Xhavit Limani – kurs pedagogjik në vitin 1949, në Prizren.
Zejush Shabani – kurs pedagogjik 1945/46, në Pejë e Prizren.

Mësuesit caktoheshin me dekret nga Ministria e Arsimit të R.P të Serbisë. Mësuesit përveç betimit ishin të obliguar të sillnin edhe këto dokumente, certifikatën e drejtësisë, të shtetësisë, datëlindjes, mjekut, dëftesën për shkollën e kryer.[19]

Shkolla shqipe gjatë periudhës 1945-49 ballafaqohej me mungesën e lokalit shkollor. Në shumë raste çështja e lokalit zgjidhej edhe me meremetimin e objekteve të dëmtuara gjatë luftës.

Në këto rrethana, për sigurimin e objekteve shkollore përveç organeve kompetente, kontribut të jashtëzakonshëm dhanë mësimdhënësit dhe populli. Shumë shtëpi private qenë lëshuar për shkolla. Mirëpo, e gjithë kjo gjendje pasqyrohej krahas zhvillimeve ekonomike, shoqërore dhe marrëdhënieve politike, çka mund të jetë e qartë duke e marrë parasysh që Presheva me rrethinë ishte një ndër komunat më të pazhvilluara, andaj edhe objektet shkollore ishin në gjendje të palakmueshme.[20] Procesi mësimor në periudhën 1945-49 në Preshevë e rrethinë u zhvillua në objektet e xhamisë (8 objekte të xhamisë), shtëpitë private (3 shtëpi private) dhe objekte shkollore (1 objekt shkollor edhe atë në fshatin Bushtran), ndërsa në fshatin Tërrnavë u shfrytëzua lokali e minierës në Tërrnavë). Si objekte shkollore me numër më të madh ishin objektet e xhamisë.[21]

[19] Hyseni, Historiku i Shkollës Fillore..., f.41.
[20] AS, Fondi Ministarstvo Prosvete, fsc.74, Kontrolni Spisak Manjinski Škola Srez Presevski 18.IX1945.
[21] Ilir Zylfiu, Arsimi shqip në Luginë të Preshevës, f. 207.

SEVDAIL DEMIRI

KONTROLLI POLITIK NDAJ PUNËS DHE PËRMBAJTJES SË GAZETËS "FLAKA E VËLLAZËRIMIT" NË SHKUP

Gazeta shqipe në Shkup "Flaka e Vëllazërimit"[1] ishte themeluar me vendim politik të partisë e cila kishte dalë fituese e Luftës së Dytë Botërore, dhe në njëfarë forme ishte zëdhënëse e saj partiake. Konkretisht, në fillim ishte organ i Frontit Popullor të Maqedonisë (FPM), më pas organ i Bashkimit Socialist të Popullit të Punues Maqedonisë (BSPPM), që ishte reprezentuesi kryesor i politikave të Partisë Komuniste të Maqedonisë (PKM). Së këndejmi, gjatë gjithë periudhës së funksionimit të saj, deri në vitin 1992, kjo gazetë do të jetë organ i besueshëm i Komitetit Qendror të PKM-së.

Bazuar në këto premisa reale të funksionimit të saj, gazeta "Flaka e Vëllazërimit" (shkurtimisht "Flaka") që në ditët e para të saj ishte thellësisht e kontrolluar nga ana e Komisionit të formuar për Agjitacion dhe Propagandë në kuadër të Frontit Popullor të Maqedonisë. Çdo material i cili planifikohej të botohej nga ana e gazetarëve e redaktorëve të gazetës, fillimisht duhej të kalonte në Komisionin e Censurës, përkatësisht nëpër duart e anëtarëve të Agjit-Propit, të cilët duhej të jepnin pëlqim apo mospëlqim për një tekst të caktuar. Për këtë shkak, në fillim ishte i barabartë numri i gazetarëve me numrin e përkthyesve (2+2). Pra, dy përkthyes vazhdimisht duhej të përkthenin tekstet e gazetave maqedonasve në gjuhën shqipe, dhe anasjelltas, të gjitha tekstet origjinale shqipe duhej të përkthenin në maqedonisht për nevojat e organit të censurës së Agjit-Propit[2].

Pa dyshim se kjo fillimisht ishte një punë e lodhshme për vetë ekipin e vogël të gazetës, i cili duhej të bënte punë dy herë, dhe së dyti vihej në pikëpyetje edhe aftësia profesionale e gazetarëve, të cilët duhej të mendonin mirë para se ta shkruanin një tekst për një problematikë të caktuar, e cila gjithnjë duhej të ishte në frymën e "vëllazërim-bashkimit" të popujve dhe politikës jugosllave që udhëhiqej prej Beogradit nga Josip Broz - Tito.

[1] Gazeta e parë dhe e vetme informative shqipe në Maqedoni deri në kohën e pluralizmit politik, filloi botimin më 04.04.1945. "Flaka...", sikurse edhe "Nova Makedonija" në gjuhën maqedonishte dhe "Birlik" në gjuhën turke, kishin shumë ngjashmëri njëra me tjetrën. Ato ishin organe të Frontit Popullor të Maqedonisë, dhe e reflektonin strukturën nacionale të vendit. Redaksitë e këtyre gazetave u formuan në Shkup, kurse materialet e tyre u shtypën në shtypshkronjën "Goce Dellçev" në fshatin Vranovc i Epërm i Velesit. Përgatitjet rreth hapjes së këtyre gazetave, i kishte bërë Shtabi kryesor i Frontit Popullor të Maqedonisë, me një grup të aktivistëve shqiptarë dhe turq.

[2] Arkivi Shtetëror i Republikës së Maqedonisë (ASHRM) - Shkup, 1.464.1.168/388

Censura[3] nuk do t'i hiqej nga qafa kësaj gazete gjatë gjithë funksionimit të saj. Madje, ironik është fakti se kjo censurë do të vazhdohet edhe në periudhën paskomuniste, kur me këtë gazetë, e cila ende ishte pronë shtetërore, udhëhiqnin partitë politike që vinin në pushtet, përkatësisht PPD, PDSH, dhe në fund BDI.

Ç'është e vërteta, në numrat e parë të gazetës "Flaka", vërehej një hapësirë dhe liri më e madhe veprimi, me gjithë ndikimin politik që kishte. Por ky ndikim do të rritej ashtu siç forcoheshin organet e pushtetit të ri popullor, kur në mënyrë të organizuar shtetërore, kontrollohej e gjithë veprimtaria politike, ekonomike, arsimore e kulturore. Kështu në një raport të Komisionit shqiptar për kulturë e arsim, kur analizohet puna e gazetës "Flaka", veç të tjerash thuhej: *"Gazeta shpeshherë ka pasur qëndrime jo të mira rreth çështjes nacionale, e cila nuk njihet mirë nga ana e redaksisë. Gazeta shpeshherë është kthyer në rrugë të gabuar, dhe dukej si të ishte gazetë nga Shqipëria. Kështu për shembull, në çdo numër merren me atë se a do të pranohet Shqipëria në Kombet e Bashkuara apo jo. Pastaj shkruan për Çamërinë... etj*"[4].

Mbledhjet e komisionit të Agjit-Propit ishin të rregullta dhe nga ato mbledhje dilnin konkluzione lidhur me politikën redaktuese të gazetës "Flaka...". Janë të shumta dokumentet të cilat flasin për raporte, procesverbale dhe instruksione të tjera të organeve të pushtetit popullor, që në fakt paraqesin ndërhyrje të drejtpërdrejtë në punën e gazetarëve. Në vazhdim po citojmë një dokument nga mbledhja e Komisionit shqiptar për arsim dhe kulturë të datës 12.08.1946, ku kishin marrë pjesë: Murteza Peza, Lutfi Rusi, Petro Janura, Ali Shehu dhe Abdulla Sakipi. Në këtë mbledhje ku ishte debatuar edhe lidhur me punën e gazetës "Flaka", ishin dhënë disa rekomandime: *"Duke filluar nga data 1, të bëhet raport për çdo numër dhe përmbajta e titujve, dhe në të ardhmen të praktikohet për çdo numër dhe të dorëzohet në sekretariatin e Frontit Popullor në dy kopje; Për përpunimin e detyrave nga kongresi i parë, dhe për zgjedhjet e delegatëve popullorë, të shkruajnë Nexhat Agolli dhe Esad Doko, për përgatitjet teknike të zgjedhjeve të shkruajë Esad Doko; Të shkruhet për Shqipërinë dhe Konferencën e Paqes, për qëndrimin e delegacionit jugosllav rreth Shqipërisë, fjalimin e Mosha Pijades në lidhje me Shqipërinë; Të shtypet artikulli i Dare Xhambazit, i cili do të botohet në gazetën 'Nova Makedonija', etj*"[5]. Siç do të vërejmë nëpër faqet e numrave të radhës të gazetës "Flaka...", të gjitha këto rekomandime do të jenë të realizuara në tërësi nga ana e kolegjiumit redaktues të gazetës, në bazë të diktatit të dhënë.

---

[3] Censura, që kur njihet në kohërat më të hershme, nga Roma e vjetër e këtej, nënkuptonte tendencën për kufizimin e mendimit dhe lirisë së shprehjes. Censura është sinonim i sistemeve shtetërore autoritare, të cilat ushtrojnë kontroll të rreptë në të gjitha veprimtaritë shoqërore, që individë apo grupe të caktuara të mos mund të zhvillojnë veprimtari kundër rendit politik shtetëror. Censura apo ndikimi dhe kontrollimi politik i mediumeve, është cilësi e shumë regjimeve shtetërore gjatë gjithë historisë njerëzore. Sistemi komunist, gjithkah nëpër botë, edhe tek ne, është i njohur për censurën e rreptë nëpër media dhe veprimtaritë e tjera shoqërore.

[4] ASHRM, 1.464.4.67/97

[5] ASHRM, 1.464.4.69/102

Ndikimi i theksuar politik do të vërehet lehtë në gjithë periudhën e botimit të gazetës "Flaka...". Titujt kryesorë të gazetës rregullisht lidheshin me figurat kryesore të RSFJ-së, siç ishin Josip Broz Tito, Kërste Cërvenkovski, Llazar Mojsovi dhe të tjerë. Fjalimet e tyre nëpër konferenca politike e të ngjashme, jepeshin në formë integrale, pa kurrfarë ndryshimesh, duke e përcjellë te masa shqiptare politikën e "vëllazërim-bashkimit". Edhe pse në fillim gazeta kishte fare pak ilustrime, në to kryesisht botohej fotografia e Titos, dhe më rrallë e udhëheqësve të tjerë komunistë të vendit. Më tutje, në faqet e kësaj gazete rregullisht do të hasim shkrime të porositura, të cilat madje nuk mbajnë as emrin e autorit, ndërkohë që bëjnë fjalë për "gjendjen e pakicës shqiptare në Jugosllavi, përparimin e saj në të gjitha sferat, largimin nga e kaluara, demaskimin e politikës së Enver Hoxhës në Shqipëri", etj.

Kjo censurë do të jetë më e shprehur gjatë kohës së Informbyrosë, kur dhjetëra intelektualë të shquar shqiptarë do të persekutohen ose eliminohen edhe fizikisht. Njëri ndër ta ishte edhe ministri i parë shqiptar i qeverisë së Maqedonisë, dr. Nexhat Agolli, njeriu kyç me të cilin lidhet edhe themelimi dhe funksionimi i gazetës "Flaka". Pas eliminimit të tij nga skena politike jugosllave në vitin 1949, në disa raste do të përmendet në faqet e kësaj gazete roli i tij "armiqësor, antishtetëror", etj.

Më tej, censura ndaj kësaj gazete do të ashpërsohet edhe me rastin e demonstratave shqiptare të Kosovës në vitin 1968 e 1981, të cilat do të reflektohen në mënyrë të drejtpërdrejtë edhe ndër shqiptarët e Maqedonisë. Gjatë këtyre periudhave, një numër i madh i teksteve të porositura do të botohen kundër këtyre demonstratave dhe kundër aspiratave të shqiptarëve të Kosovës për më shumë të drejta kombëtare. Në këto periudha do të kemi edhe diferencimin e një numri të madh të gazetarëve shqiptarë nga gazeta "Flaka", të cilët u akuzuan se kanë punuar nga pozitat e "nacionalizmit dhe irredentizmit shqiptar". Por, megjithëkëtë, gazeta "Flaka" mbeti një dritare e veçantë e informimit publik në gjuhën shqipe në Maqedoni.

Rrethanat në të cilat filloi botimi i gazetës "Flaka..." ishin shumë specifike, ndërsa kushtet e botimit ishin jashtëzakonisht të rënda. Në njërën anë ishte mungesa e theksuar e kushteve teknike, kurse në anën tjetër mungesa e kuadrit të nevojshëm profesionist nga sfera e gazetarisë. Këto rrethana ndikuan që në vitet e para, kjo gazetë të dalë në mënyrë të parregullt, një herë në dy javë apo tre javë, si dhe të jetë e dominuar kryesisht me përkthime të teksteve gazetareske kryesisht nga dy gazetat tjera simotra "Nova Makedonija" dhe "Birlik". Tekstet autoriale ishin të pakta, por edhe kur botoheshin tekstet e tilla, ishin kryesisht pamflete politike të cilat synonin të "edukonin" masën gjerë shqiptare me frymën e re socialiste.

Edhe pse gazeta ishte themeluar të ishte një lloj organi propagandistik i Partisë Komuniste të Maqedonisë, roli i saj do të bëhet i pakontestueshëm edhe në informimin e gjithanshëm të publikut lexues shqiptar, i cili po shtohej dita-ditës, si rezultat i reformave të mëdha që po bëheshin që nga viti 1945 e këndej, me hapjen e shkollave fillore shqipe gati në të gjitha pjesët e shtetit jugosllav të banuara me shqiptarë.

Gazeta rëndom fillonte me informacionet kryesore të cilat ishin të natyrës politike, dhe vazhdonte me aktualitete nga sfera ekonomike, sociale, arsimore, kulturore, sportive dhe në fund argëtuese. Këto rubrikat e fundit shtoheshin me kalimin e kohës dhe me zgjerimin e kapaciteteve teknike dhe kadrovike të gazetës.

Si duket më tepër për shkak të klisheve të njohura politike të kohës, si dhe për shkak të ikjes nga banaliteti i kohës, gazeta sidomos që nga vitet e 50-ta e këndej, një rëndësi të veçantë filloi t'u kushtojë faqeve të arsimit dhe kulturës shqiptare. Në këto sfera shqiptarët e shihnin lirinë më të madhe të shprehjes së mendimit të lirë, përkundër pjesës politike, e cila siç dihet ishte e kontrolluar në mënyrë të drejtpërdrejtë nga ana e censorëve të Komisionit për Agjitacion dhe Propagandë. Në këtë mënyrë, gazeta më tepër kishte filluar të profilizohej si një gazetë kulturore se sa politike, për çka edhe ishte kritikuar hapur nga ana e udhëheqësve të lartë të shtetit komunist.

Nga viti në vit gazeta "Flaka" shënonte përparime të dukshme në cilësi, dhe sidomos që nga vitet e '50-ta e këndej, kur filloi të dalë një plejadë shumë e fortë e gazetarëve dhe shkrimtarëve shqiptarë të shkolluar nëpër kryeqendra e Jugosllavisë, të cilët do të lënë gjurmë të pashlyeshme në historinë e shtypit shqiptar në Maqedoni dhe më gjerë. Në këtë mes bënin pjesë gazetarët Petro Janura, Myrteza Peza, Lutfi Rusi, pastaj Ramiz Kelmendi, Ali Aliu, Luan Starova, Naxhi Ndoci, Halit Basha, Masar Kodra, Xhevat Gega, Rexhep Zllatku, e më vonë Teki Dervishi, Jusuf Gërvalla, Xhabir Ahmeti, Resul Shabani, Fejzi Bojku, e deri te Shkëlzen Halimi, Ahmet Selmani, Daut Dauti, etj., të cilët veçanërisht do të japin kontribut në sferën e arsimit dhe kulturës shqiptare.

Njëri nga gazetarët e brezit të ri të kësaj gazete, Daut Dauti, do të konstatojë se "Flaka", e vrojtuar vazhdimisht nga "sytë kujdestarë" të Partisë dhe të shërbimeve sekrete të kohës, ka ditur dhe të rezistojë dhe të fitojë ndonjë betejë jo të vogël. Në këtë drejtim, nga treshja medieve të asaj kohe, "Flakës së vëllazërimit", Radio Shkupit dhe Televizionit të Shkupit, vetëm, "Flaka..." arriti ta fitojë betejën kundër imponimit të dhunshëm të toponimeve jo shqipe. Shumëkush, si atëherë, ashtu dhe sot, shpreh habinë si arriti një fitore kaq të madhe kundrejt fushatës së egër ideologjike. Gjurmët dhe përgjigjet se si u ruajt toponimia shqipe në gazetë dhe botimet tjera të saj, mund të gjenden edhe në dokumentet e ruajtura në Arkivin e Maqedonisë. Është e pabesueshme, por "Flaka" ia doli në një situatë të fushatës së vrazhdë që zhvillohej në emër të luftës kundër nacionalizmit dhe separatizmit shqiptar, ku në shënjestër ishin institucionet dhe intelektualët shqiptarë [6].

Në të vërtetë, kjo gazetë do të arrijë që shpeshherë të bëhet barrierë e fuqishme nga sulmet e paskrupullta të organeve të pushtetit, duke mbrojtur linjat e qenësisë kombëtare të shqiptarëve të Maqedonisë. Prandaj, shuarja e saj në vitet e demokracisë, është një humbje e madhe për shoqërinë shqiptare.

[6] Daut Dauti, *Një betejë madhore e fituar në monizëm*..., SCUPI-10, "70−vjetori i botimit të gazetës "Flaka e vëllazërimit" (Tribunë shkencore, 4 prill 2015), ITSHKSH, Shkup, 2015, fq.120.

ERMAL MEHMETI

TRADITA E KËNDIMEVE POLIFONIKE

Polifonia klasike (rrjedh nga fjalët antike greke 'shumë-zërash') dhe ajo veprimtari muzikore përfaqëson kombinimin e më shumë zërave të pavarur, të cilët janë të lidhur me zërat e tjerë sipas ligjeve të harmonisë. Megjithëse etimologjia e fjalës polifoni rrjedh nga fjala greke, ajo nënkupton 'më shumë zona'.

Shikuar nga aspekti gjeneral, konceptet polifoni dhe harmoni mund të konsiderohen si sinonime të cilët e shënojnë prosedenë muzikore duke përdorur simultimin e zëshëm dhe tingëllues. Në praninë e kësaj teze, polifonia në mënyrë ekuivalente, respektivisht harmonia i kundërvihet monodisë.

E marrë në mënyrë më precize dhe mbi shembujt e muzikës perëndimore të mësuar, polifonia simbolizon sistem muzikor i cili përdoret nga shekulli 12 deri në periudhën e Renesancës evropiane. Ajo atëherë iu kundërvu harmonisë, si një sistem i cili do ta trashëgojë përgjatë gjysmës së dytë të shekullit 12.

Polifonia ose çdo shumëzëshmëri, apo në kuptimin më të ngushtë rrokja muzikore, është e përbërë nga dy ose më shumë vija melodike të pavarura, respektivisht pjesë ose zëra. Kështu, sipas kësaj, në kuptimin e polifonisë nënkuptohet vepër e ndërtuar mbi rregullat e kontrapunktit, që do të thotë se është primare horizontale, për dallim nga *homofonia*, e cila e realizon rrokjen primare vertikale harmonike.

Në literaturën antike greke termi polifoni është përdorur rrallë në kuptimin muzikor, por kryesisht në kuptimin e shumëllojshërisë së tingullit, për shembull në aulosin (e Plutarhut) ose në kuptimin e gjerë, për shembull në cicërimën e zogjve. Si shenjë e muzikës shumë zëshe, fjala polifoni paraqitet rreth vitit 1300 në traktatin anonim *Summa musicae* ku në njëzëshmërinë kundërvihet si *modus canendi a pluribus diversam observantibus melodiam.*

Megjithatë, historia e polifonisë në botë fillon shumë më herët, me zhvillimin e zërave dhe formave polifonike mesjetare. Kështu, në kohërat antike, kisha politeiste e atëhershme, njihte vetëm harmoninë. Me të drejtë harmonia do të njihet si zbulim i shekullit të mesëm. Polifonia paraqitet në shekullin 11. Në paraqitjen e saj bën një aluzion filozofi Skot Erxhen, në veprën e tij *De Divisione Naturae,* ku flet për *'interpretimin e më shumë pjesëve muzikore.'* [1]

[1] Shiko: : S. Günther, *Moderne Polyphonie*, Berlin, 1930. -A. T. Merritt, *Sixteenth Century Polyphonie*,Cambridgge,1939. - L. Spiess, *Polyphony in Theorie and Practice from the 9th Century to the close of the 13th Century*, Harward University, Cambridgge (Mass.) 1947.. - J. P. Thilmann, *Probleme der neuen Polyphonie*, Dresden, 1950. -E. W. Mulder *Polyphonie*, Utrecht,1955. P. Hamburger, *Studien zur Volkapolyphonie*, Wiesbaden,1976. – H. Sanden, Antike Polyphonyie, Heidelberg,1957. -С. С. Скербаков, *Полифониà и*

Historia e fillimeve të polifonisë në botë mbetet e errët dhe jo e plotë. Megjithatë, duhet të theksohet se qysh atëherë mund të dallohen dy lloje të polifonive: polifonia popullore dhe ajo e mësuar.

Polifonia popullore karakterizohej me një spontanitet të theksuar, e cila rridhte nga instinkti muzikor natyral. Ajo nuk ishte nën ndikimin e kurrfarë teorive muzikore nga më të ndryshmet dhe më së shpeshti zhvillohej në mënyrë shumë më të spikatur sesa në ndonjë shtet tjetër, e cila është e larguar nga vendet mediterane, dhe i ka evituar më shumë se vendet e tjera, ndikimet greko-latine. Për zhvillim të tillë të polifonisë shkencore ka qenë shembull tipik Anglia. Në këtë shtet polifonia shkencore (kundrejt asaj popullore), është dalluar nga polifonia e popujve të tjerë me përdorimin e dy teknikave të cilat kanë qenë të veçanta dhe të cilat më se e besueshme që kanë qenë të trashëguara nga gjeniu popullor: *gemellum* dhe *faux-bourdon,* që karakterizohen bindshëm me terca dhe seksta. *Gemellum*-i, sikurse simbolizon vetë fjala, është këngë me dy zëra të cilës zëri i dytë shoqërohet në tercën e brendshme ose është mbi temën e dorëzuar nga zëri i parë. Që të dy zërat duhet 'të mbyllen' njëri në tjetrin, respektivisht të shoqërohet deri në bashkimin me lëvizjet e kundërta.

Faux-bourdon –i është këngë me tre zëra e cila duhet ta shkaktojë njëkohësisht melodinë kryesore sikur dy melodité e tjera paralele në tercën dhe kuintën e brendshme, - me sa duket në kuintën e brendshme, por e shënuar vetëm për t'u parë, sepse pjesa e tretë e cila mesa duket është bas-i, ose siç quhej dikur 'bourdon' (zukatje), në fakt është basi i gabuar, ose burdoni i rremë; duhet të këndohet një oktavë më lart nga e shkruara, respektivisht ajo tingëllon si kuartë e madhe dhe jo si kuintë e vogël si në temën e dhënë.

Prandaj, mund të kuptohet pse përpjekjet e para për polifoninë e mësuar, ose polifoninë jo popullore, do të sjellin rezultatet jo të zakonshme. Pozicioni apriori që të anashkalohen tercat dhe sekstat dhe të lejohen sikur konsonanca vetëm oktavat, kuartat dhe sekstat, do të sjellë krijimin e procedesë polifonike të njohur si diafoni ose organum.

Megjithatë, duhet të theksohet se polifonia lulëzimin më të madh e përjeton në periudhën e Renesancës, me polifoninë vokale të kompozitorëve holandezë. Në Francë, për shkak të trazirave që kanë sunduar përgjatë periudhës njëqindvjeçare të luftës me Anglinë, kultura muzikore do të zhvendoset në pjesët veriore të Flandrisë si dhe në territorin e Burgundisë.

Oborri në Burgundi do të shndërrohet në qendrën e rindërtimit artistik, i cili do të mbledhë muzikantë nga Franca, Holanda, Burgundia dhe Anglia, të cilët do të përhapin krijime të reja muzikore, duke e përfaqësuar në mënyrë të posaçme polifoninë. Në atë periudhë polifonia do të zhvillohet në dy mënyra: muzika religjioze, e cila do të krijohet nëpër katedralet veriore (Kambre, Turne, Brizh, Anvers etj.), si dhe këngët polifonike të karakterit feminist të cilat kryesisht do të jenë të krijuara në oborrin e dukës burgun në Dizhon.

полифоницские формÝи, Москва, 1962. – B. Cervenca, II *Contrapupuno nella polifonia vocale classica*, Bologna, 1965.

Mjeshtrit e vërtetë e asaj periudhe ndërtonin forma të përkryera polifonike të *shansoneve, moneta* dhe mesha, zhvillonin teknikën e imitimit, në veçanti atë kanoniken, duke i përpunuar me një mjeshtri virtuoze të gjitha mundësitë të saj, që nga imitimi, diminuimi dhe augmentimi. Veprat e tyre janë të shkruara në trezëshmëri, katërzëshmëri ose shumëzëshmëri, që shpeshherë arrijnë deri në tetë zëra realë.

Nga viti 1420 në Flandri (Holandë dhe në një pjesë të Belgjikës së sotme), si dhe në Francën Veriore, polifonia do te shfaqet edhe si stil i ri në produkcionin muzikor me më shumë gjenerata muzikantësh, të cilët do ta përhapin artin e tyre muzikor edhe në të tjera shtete evropiane, në radhë të parë në Itali. Krahas flamanëve ose holandezëve, kontribut të veçantë në zhvillimin e polifonisë së Renesancës nga shekulli 16 do të japin edhe italianët, në veçanti mjeshtrit e shkollës së famshme Romake.

Karakteristikat kryesore të stilit të tyre polifonik do të jenë qartësia dhe kompaktësia në mes të muzikës dhe tekstit, kryesisht me udhëheqje diatonike të zërave, me anashkalimin e kërcimeve më të mëdha diatonike, si dhe zgjidhja rregullare të disonancave. Në meshat dhe motetet në mënyrë të posaçme do të kultivohet madrigali, kurse në kompozimin në përgjithësi dominonin një numër i madh shumëzërash nga gjashtë deri në dymbëdhjetëzërash.

Në periudhën e barokut shfaqja e teknikave dhe formave të reja monodike dhe forma koncertale dhe teknike, e shtyp stilin tradicional të polifonisë vokale. Megjithatë, polifonia vazhdon të jetojë në sajë të stileve të ndërlikuara vokale-instrumentale të polifonisë vokale, siç janë koncepti shumëfjalësh, pasia, oratoriumi, ku fjalët e shkruara polifonike (korale) zëvendësohen me ato homofone. Në të njëjtën kohë, lindet dhe një stil i ri i muzikës instrumentale polifonike; krijohen forma të reja të shkruara me teknikën e re të kontrapunktit: kancona, tokata, mbi të gjitha fuga, e cila kulmin e saj do ta arrijë me veprat e Johan Sebastijan Bah.

Kështu si, zhanre dominante klasike polifonike do të shfaqen kanoni dhe fuga. Ato do të afirmohen si forma universale muzikore të pavarura, por veçanërisht në muzikën e mëvonshme të gjysmës së dytë të shekullit 17, si dhe krijimet më të mëdha muzikore: suita, sonata, koncerte, sinfoni. Krahas Johan Sebastian Bah, i cili do ta sjellë në majë mjeshtërinë polifonike, duhet të theksohet se krijues si Ludvig Van Betoven, do të krijojnë shembuj polifonikë brilantë, duke e mirëmbajtur madhështinë klasike të polifonisë kundrejt tendencave të reja bashkëkohore në krijimtarinë muzikore.

Megjithatë, polifonia do të jetë në zemrën e krijimtarisë muzikore dhe të kompozitorëve të mëdhenj të botës siç janë: Paul Hindemith, Kshizhof Penderetski dhe Alfred Shnitke, të cilëve u janë të afërta format polifonike.

Duhet theksuar se me infiltrimin e ndërgjegjes harmonike, polifonia në periudhën e barokut adaptohet dhe rreshtohet në lëvizjet harmonike dhe funksionet tonale. Dhe më në fund në saj të formave të përkryera harmonike primare klasike dhe romantike, polifonia dhe format e saj përdoren më rrallë, kryesisht për efekte më të spikatura dramatike, për shembull në interpretimet sonatike dhe në interpretimet finale.

Në kalimin e shekullit 20 përsëri në botë ringjallet interesimi për polifoninë, në veçanti për format lineare, dhe deri tek renovimi i teknikave klasike të imitimit (neoklasicizmi), kurse rëndësi të veçantë fiton në dodekafoninë. Dhe përgjatë shekullit 21 polifonia nuk do të shuhet, por do të adaptohet edhe në sfidat e reja të muzikës elektronike. Polifonia do të jetë e përdorur si materie në muzikën elektronike dhe do të vijë në shprehje kapaciteti i saj të interpretohet në shumë nota njëkohësisht. Por kjo është një temë tjetër.

Polifonia në përgjithësi në vise të ndryshme të botës, ka lëvizur nëpër drejtime të ndryshme në zhvillimin e saj, duke u adaptuar edhe në kushtet konkrete historike, ekonomike, kulturore dhe shoqërore. Dhe prandaj polifonia sot në shtete të veçanta vepron si e zhvilluar dhe në kontinuitet, diku shënon zhvillim më të rëndësishëm, kurse sot është në stagnim.

Megjithatë, kudo që të përballet polifonia me homofoninë, përsëri zë vend më të kufizuar dhe mund të konsiderohet si relikt i kohërave të kaluara, dhe diku si dhe një lloj kodi identiteti i kulturës së një populli. Duhet të theksohet se zonat ku është përkufizuar dhe mbajtur këndimi polifonik, janë kryesisht zona malore, siç janë për shembull zonat polifonike shqiptare në kolonitë e arbëreshëve në Kalabri dhe Sicili, viset polifonike në Bosnje dhe Hercegovinë, në Malin e Zi, Maqedoni, Bullgari, Greqi, Rumani, Shqipëri, Kosovë etj. Në Gadishullin Ballkanik, pastaj në Ermeni, Spanjë (te Baskët), në Francë (në Korsë), në Gjeorgji, Kaukaz, në Sardenjë në Gadishullin e Apenineve, dhe vise të tjera. Megjithatë, nëpër të gjitha fazat e zhvillimit të saj polifonia shqiptare, pavarësisht se ku është krijuar dhe krijohet (Shqipëria, Mali i Zi, Kosovë, Maqedoni, Greqi ose në diasporën shqiptare), ka arritur gradualisht të kristalizohet në struktura dhe stile të ndryshme, që nga format më të thjeshta deri tek ato më të ndërlikuarat[2].

[2] Shiko:Beniamin Kruta, *Polzphonie albanaise- trait commun et difference dialecta,* Studia Albanica, Nr2" 1991, pp. 29-44. – B. Kruta *Aperçu général de la polzphonie albanaise et certains aspects des genèse,* in: Kultura popullore, Tirana, 1198O, Nr. 1. – B. Kruta, Polifonia dyzërëshe e Shqipërisë Jugore (Tipologia),Tirane,1989.

ANGJELINA HAMZA

ROLI FEMRËS NË FAMILJE

Përmbajtja e shkurtër

Për shekuj me radhë, gruaja dhe rinia kanë qenë dy shtresat me të shtypura të shoqërisë shqiptare. Gjurmët e kësaj shtypjeje mbi to janë ende të gjalla.

Emancipimi i tyre, dhe synimet për të arritur qëllimet e tyre në çdo aspekt jetësor është edhe sot një problematikë e dukshme e veçanërisht në aspektin e dallimeve gjinore.

Për femrën dhe detyrat e saj në përgjithësi është shkruar edhe në librat e shenjtë Bibël dhe Kur'an, e për femrën shqiptare në veçanti është Kanuni i Lekë Dukagjinit si dëshmitar i një mënyre jetese të femrës, dokeve dhe zakoneve të një periudhe të kaluar historike.

Tema ime është e përqendruar më shumë në aspektin krahasimtar të se djeshmes së largët, dhe jetën e një femre sot.

Personaliteti i femrës shqiptare në disa këndvështrime

Femra shqiptare si në çdo periudhë historike ka forcën dhe energjinë e madhe të demonstrojë aftësitë e saj në çdo aspekt qoftë në familje qoftë në jetën jashtë familjare.

Shekulli i njëzetë ka qenë dhe besoj do të mbetet në histori si periudhë e ndryshimeve të mëdha dhe e zhvillimit më të madh të epokave historike të teknikës e teknologjisë dhe bashkë me këtë qindvjeçar edhe shekulli i ndryshimeve të mëdha në marrëdhëniet shoqërore, ndërfamiljare dhe veçmas atyre gjinore.

Për personalitetin e gruas është shkruar e është folur shumë nga dy krahë të kundërt, janë theksuar herë superioriteti i saj social e herë të tjera inferioriteti i saj.

Duke u nisur nga fakti që sot femra më nuk është dhe nuk shikohet vetëm si një nënë amvise, dhe duke bërë krahasime me të kaluarën e femrës shqiptare, tashmë me transformimet e mëdha shoqërore, kemi edhe femrën si një subjekt mjaft aktiv i kyçur në jetën publike, faktor ky i cili ka ndryshuar rrënjësisht raportet e saja edhe me familjen dhe vetë rolin e saj.

Te gjithë e dimë që një rol të madh në shoqëri e luan edhe femra dhe më saktësisht edhe gruaja.

Sot në shoqërinë tonë, femra është një forcë e madhe lëvizëse.

Më parë femra shikohej dhe vlerësohej më tepër në sajë të dy funksioneve:

-e destinuar për të kryer punët e shtëpisë dhe

-e destinuar si riprodhuese e shtimit të njerëzve në familje, për të mos e mbyllur apo fikur derën ose në gjuhën popullore oxhakun e asaj familjeje.

Në sajë të këtyre botëkuptimeve që ekzistonin për femrën, ajo nuk mund të nxirrte në pah vlerat e saj. Por me evoluimin dhe emancipimin e pareshtur të shoqërisë edhe femra mundohet ta zërë sot vendin e saj qe i takon në shoqëri.

Roli i saj sot nuk është i pakët. Femra është e aftë duke vënë në funksion të gjitha potencialet e saj, duke qenë prezent edhe në detyrat e mëdha shtetërore, nga ato me të thjeshtat deri tek funksioni si ministre , drejtore, menaxhere firmash, kryetare parlamenti e edhe kryetare shteti, e shumë funksione të tjera me rëndësi.

Pos këtyre femrën me rol të rëndësishëm e kemi edhe në të gjitha fushat e artit, si një subjekt mjaft i spikatur. Kontributi i tyre është i konsiderueshëm në emancipimin e secilës femër. Role të bukura dhe të mëdha kanë realizuar dhe vazhdojnë të realizojnë aktoret tona të mëdha.

Në fushën e mjekësisë kemi doktoresha që operojnë me sukses dhe shpëtojnë jetë njerëzish, kemi edhe shkencëtare të zonjat të cilat pandarë japin kontribute në lami të ndryshme shkencore e kulturore.

Duke u bazuar në këto çështje, themi që roli i femrës është shumë i madh në shoqëri ashtu sikurse në familje.

Por, cili vazhdon te jetë roli i saj në familje, cilat janë sakrificat e shumta të saj qe të jetë nënë dhe njëkohësisht e suksesshme në karrierë prandaj duhet theksuar faktin qe gruaja ishte dhe vazhdon te jetë kryeadministratorja e ekonomisë shtëpiake, e punëve shtëpiake. Ajo kryen përditë punët shtëpiake, pastron për çdo ditë, bën gatimin e ushqimeve të përditshme, njëherësh duke u kujdesur edhe për gjendjen dhe sistemimin e rezervave ushqimore, mbarëvajtjen e rrobave të saja dhe të gjithë pjesëtarëve të tjerë të familjes.

Në një ambient familjar, detyrat e prindërve janë të ndara. Nëna njihet për cilësitë dhe rolet e saj kundrejt fëmijëve dhe bashkëshortit. Ajo është e ndjeshme, e dhimbsur dhe e mëshirshme, kurse babai, me tipare më disiplinore duhet të jetë më i kujdesshëm, më i qëndrueshëm, më i fortë dhe që "përhap" ndjenjën e sigurisë në familje.

Roli i femrës e më konkretisht roli i nënës në shoqëri dhe familje është i madh. Të mëdha janë dhe sfidat që asaj i sjell jeta, sakrifica të shumta e të dhimbshme.

Zoti e nderoi atë me detyrën më të shenjtë, ia besoi rritjen dhe edukimin e fëmijëve prandaj ajo do duhej që këtë detyrë ta kryejë me nder. Këtë detyrë duhet ta kryejë nëna, sepse ajo është më afër fëmijës dhe mu ajo ndikon që nëna ta "dojë" më shumë dhe të kujdeset më shumë për edukimin e fëmijëve,përkundër asaj që është shumë e ngarkuar, i ikën pothuaj e gjithë dita në punë, dhe e ka të vështirë ta ekuilibrojë këtë ngarkesë të dyfishtë. Pra, para se gjithash femrën e shohim gjithmonë si më te inkuadruar në familje .

Shumë kohë i merr gruas kujdesi për fëmijët, mbarështimin e tyre. Veç preokupimeve shpirtërore, janë edhe shumë ngarkesa konkrete praktike të lidhura me nevojat dhe kërkesat e fëmijëve, për ushqim, për pastrim, për veshmbathje, edhe për lodra e për argëtim. E mbi të gjitha është shëndeti i fëmijëve. Gruaja ka edhe ngarkesën e vet mendore. Veç ngarkesës së njohur për çdo njeri, ajo ka edhe "kasavetet", përkujdesjet e veta specifike. Janë përkujdesje jo vetëm për vete, por

për familjen, për pjesëtarët e saj, të rritur, të rinj e të vegjël, për plotësimin e nevojave të tyre, për zgjedhjen e halleve që ata kanë. Kjo është edhe një ngarkesë shpirtërore e saj.

Në fakt të gjitha llojet e ngarkesës së femrës, të cilat i përmendem më lartë në pika të shkurtra, kanë pamjet e veta neuropsiqike, si të përgjithshme njerëzore, ashtu edhe specifike femërore. Gruaja është e zhytur në një mori punësh, më të mëdha e më të vogla, shpesh tejet të vogla. Punë që përsëriten pa ndërprerje, punë rutine, sa më në kushte të rënda të zhvillohen ato, aq më shumë e rëndojnë gruan. Ato kthehen në një rutinë të lodhshme.

Puna shtëpiake mbetet gjithmonë një fushë kryesore e veprimtarisë së gruas me të cilat ajo ndeshet ditë për ditë e orë për orë.

Prandaj ky rol i saj spikat me forcë edhe në fjalët e urta të popullit : gruaja është kyçi i shtëpisë, gruaja është dritë e shtëpisë, gruaja është shpirti i shtëpisë.

Kur jemi tek të gjitha këto ngarkesa vetëm brenda familjes duke tejkaluar profesionin dhe punën jashtë familjes, po të bëjmë krahasime me disa nga shoqëritë bashkëkohore, e sidomos në vendet e zhvilluara, gruaja është çliruar ose e lehtësuar nga mjaft prej këtyre punëve. Familja, shteti dhe vetë institucioni ku ato punojnë dhe veprojnë ju ofron përkrahjen në realizimin me sukses të detyrave të tyre.

Por, edhe përkundër këtyre vlen të theksohet që Gruaja shqiptare si nënë nuk ka çka të marr nga ato të perëndimit, sepse ajo është nënë e familjes në kuptim më të thellë të fjalës.

Po te dalim jashtë jetës së gruas në familje, për të trajtuar çështjen e punësimit të saj, duhet cekur qe : puna është një ndër faktorët më të rëndësishëm për njeriun, sepse nëpërmjet të punës secili shpreh vetën, e zhvillon dhe e realizon ardhmërinë e vet. Gratë të cilat nuk kanë pasur mundësi të punojnë, nuk kanë pasur mundësi as të arrijnë lirinë dhe realizimin personal-shoqëror. Ky fat e ka përcjell gruan në tërë harkun e jetës dhe e lidh atë me një realitet.

Nëse bëjmë krahasime në mes të grave të punësuara të zonave rurale dhe atyre në zonat urbane, shumë qartë edhe këtu vërehen vështirësitë dhe sakrificat e shumta, si në punë po ashtu edhe në familje. Nga disa të dhëna vetjake të marra në terren, më rastis të dëgjoj për vështirësitë qe kanë femrat të cilat kanë vendpunësim në qytet. Ato që në orët e hershme me shume vullnet zgjohen, mbarojnë disa punë në shtëpi, vrapojnë për të zënë udhëtimin qe te jenë në punë me kohë, shumë shpesh duke lënë edhe ndonjë fëmije të sëmurë. Por ju duhet të punojnë, ngase ka nga ato qe janë mbajtëse të familjes. Por vullneti nuk mungon asnjëherë.

Në këtë gjendje puna mund të jetë një mundësi reale për ta shpëtuar gruan. Këtu është fjala për punën si aktivitet i gruas jashtë shtëpisë dhe ambientit familjarë në të cilin ajo vepron dhe jeton, domethënë pra edhe fitim material.

Puna si më e lehtë është në zonat urbane, ku jo çdoherë është e nevojshme të zgjohen shumë herët, kushtet janë më të lehta, afërsia më familjen po ashtu është më e shpejtë.

Ka disa raste ku gruaja edhe përkundër shkollimit, ka lënë punën, dhe iu ka përkushtuar familjes në çdo aspekt, në veçanti rritjes dhe edukimit të fëmijëve .

Në këto krahasime sipërfaqësore, gruaja duke ia shtuar rolit tradicional, familjar, rolin e punëtores, përmirëson me një anë situatën ekonomike, por në anën tjetër ngarkohet si me role si me punë. Dhe asnjëra prej grave të pyetura , qofshin të punësuara apo jo, sot nuk dëshirojnë qe bijat e tyre të mbesin pa punë, në shtëpi, sipas tyre, secila duhet të ketë bukën në duar të veta, po ashtu secila nga ato dëshiron që vajzat e tyre të mos punonin punë fizike apo edhe punëdore, por të shkollohen dhe të kenë punë të mirë.

Këtu vërehet pak a shumë vetëdijesimi dhe thyerja në rrugë e sipër e jetës dhe mendimeve tradicionale edhe nëpër ato vende qe janë më pak të lidhura më jetën bashkëkohore. Për disa puna nuk është mjet magjik për ti zgjedhur të gjitha problemet shoqërore dhe familjare, përkundrazi duke i zgjedhur disa lindin shumë të tjera. Por vetëm për faktin që ajo punon jashtë shtëpisë, fiton, jeton në një marrëdhënie barazie me mashkullin, provon një rol të ri, doemos e ndërron mënyrën e mendimit dhe të veprimit te femra, te burri dhe të familja.

Duke e kaluar pjesën e shumtë të ditës jashtë shtëpisë, në vend të punës, kontribuon në shpenzimet familjare, e përforcon sistemin vetëqeverisës me kontributin që e jep në shoqërinë e punës, gruaja që punon, bën që zhvillimi familjar të jetë më i shpejtë kah forma moderne me pjesëmarrjen e saj të shpejtë në globalizimin e zhvillimit shoqëror.

Përfundim

Prandaj unë mendoj që edhe sot femra pos që është një amvise e zonja dhe një edukatore e pakrahasueshme në shtëpi, ajo është e zonja edhe në rolet e saja jashtë ambientit familjarë, gjithmonë duke mos e lënë anash familjen dhe detyrimet, dhe përkushtimin ndaj saj.

Shkolla, edukimi dhe puna e planifikuar, sipas nevojave dhe mundësive reale të femrës, janë të vetmet rrugëdalje nga tradita shekullore, si rrugë të vlefshme, për ta nxjerrë gruan prej humnerës në të cilën ka ra gjatë shekujve, për t'ia dhënë dinjitetin dhe vendin që i takon, për ta aftësuar që të jetojë si anëtar i plotë në kushtet e jetës së sotshme, për ta aftësuar për jetë dhe punë. Pra puna dhe shkolla janë dy mjete efikase për ti ndihmuar gruas shqiptare të emancipohet, edhe përkundër vështirësive që mund ti dalin gjatë rrugëtimit të synimit të tyre.

Prandaj si përfundim vlen të theksohet edhe njëherë se gruaja, femra është bartëse e jetës, pos asaj qe është grua, është motër, është NËNË, qenie e shenjtë, mirëpo, jeta e gruas dhe femrës në përgjithësi do ishte dhe është e zbrazët në qoftë se nuk e plotëson dashuria, dhe i mungon përkrahja nga të gjithë.

Pra, mbi të gjitha femrës i duhet përkrahja nga e shoqëria dhe familja në veçanti.

BIBLIOGRAFIA

DR.Valbona Begolli, ‘Pozita e gruas në Kosovë me një vështrim të posaçëm në të drejtën zakonore”Rilindja, 1984, Prishtinë.

DR.Lush Gjergji,’Roli i femrës shqiptare në familje dhe në shoqëri”, 1977, Sarajevë.

Dilaver Sadikaj, “Lëvizja për emancipimin e plotë të gruas në vitet 1967-70”Tiranë, 1982.

Hamit Beqja,” Gruaja, kjo qenie e shenjtë”, Tiranë, 2003.
Intervista vetjake në terren

FAQE KUJTIMI E LAVDIE

ISMET JASHARI- KOMANDANT KUMANOVA

Toka martire e Karadakut dha shumë bijë, burra të kombit. Ata, duke ecur rrugës së Rilindësve tanë, u qëndruan besnikë mësimeve të tyre, mësuan, punuan e luftuan për liri, nuk gabuan, madje u ndihmuan edhe të tjerëve kur patën nevojë, në luftërat e tyre të drejta, e dhanë jetën dhe hynë në histori, u bënë të pavdekshëm, të dashur e të paharruar të kombit.

I tillë ishte edhe Heroi i ditëve tona ISMET JASHARI-KOMANDANT KUMANOVA.

Ismet Jashari lindi në fshatin Orizare të Karadakut të Kumanovës, më 16 prill 1967, në një familje (muhaxhere) fshatare, punëtore, mikpritëse, bujare e atdhetare, nga prindërit Nurije dhe Jashar Jashari. Qysh si i vogël, u dallua me shkathtësinë dhe mendjemprehtësinë që kishte. U pa dhe u bë pika djalit. Ndonëse i ri, nuk iu nda të mëdhenjve, u bë burrë para kohe, thonë ata që e njohën. Herët e kuptoi pse populli i tij ishte i varfër dhe i robëruar. Kur dëgjonte për mençurinë dhe trimërinë e burrave të Karadakut, mahnitej dhe përgatitej ta ndiqte rrugën e tyre, të cilën tashmë e kishin nisur më parët dy vëllezërit e tij, Xhema e Murati.

Ismeti u bë i afërt dhe i dashur për të gjithë, në shtëpi, në fshat, në shkollën fillore, të cilën e kreu në vendlindje, e në të mesmen që e nisi në Kumanovë. I pa dashur e ferrë në sy, Ai dhe familja e tij, u bënë për pushtetin. Djemtë e Jasharajve ku do që silleshin përcilleshin. Shtëpia e tyre, në Orizare të Kumanovës, në këtë anë të Karadakut, u bë si ajo e Jasharajve në anën tjetër në Prekaz të Kosovës. Kjo shtëpi, simbol i guximit dhe qëndresës, u bë vatër e fuqishme e protestës kundër dhunës, shtypjes, robërisë e vuajtjeve të shqiptarëve, prandaj disa herë rrethohet e kërcënohet madje edhe me vdekje, pa gjyq nga pushteti, policia, e cila kishte argat edhe ndonjë shqipfolës të mjerë.

Ismeti në shkollë u bë i pa dëshiruar, u klasifikua si nacionalist, separatist, irredentist, armik i përbetuar i shtetit dhe regjimit komunist. Si të tillë, drejtoria e përjashtoi, por pa humbur kohë shkollimin e vazhdoi në Preshevë në gjimnazin "Skënderbeu", edhe e mbaroi me sukses.

Në kohën kur ai duhej t'i fillonte studimet në Prishtinë, gjendja e popullit shqiptar ishte vështirësuar shumë, jo vetëm në Preshevë e Kumanovë, por edhe në Kosovë e në vise të tjera të banuara me shqiptarë në ish-Jugosllavi. Pushteti gjakatarë serb, i ndihmuar nga ai malazez e maqedonas, e shtonte dhunën dhe terrorin mbi shqiptarët, gjithnjë e më shumë, duke bërë burgosjen dhe vrasjen e veprimtarëve atdhetarë dhe patriotëve të njohur shqiptarë. Veprimtarët e çështjes kombëtare kudo që ishin ndiqeshin këmba- këmbës nga pushteti i atëhershëm komunist. Ismeti, ndonëse i ri, ishte brumosur mirë me ide të larta patriotike, u jepte krah atyre shqiptarëve që luftonin kundër armikut. E forconte qëndresën e shqiptarëve ku ishte nevoja, e edhe në Kumanovë. Me një grup të vogël intelektualësh arrin ta ngrinte në masë të konsiderueshme moralin luftarak në

popull. Si rezultat i saj, ndodhën disa kundërshti e protesta dhe Demonstrata e madhe e 29 Gushtit 1988 në Kumanovë, për mbrojtjen e arsimit të mesëm shqip (ku mori pjesë edhe Adem Jashari-Komandanti legjendar), për shkak të cilës u rrahën dhe u burgosën mbi 300 shqiptarë. Vetëm familjes Jashar Korexhi i dhanë 50 vjet burg. Tani si për shumë veprimtarë të tjerë edhe për Ismetin, hapësira e veprimtarisë së tij patriotike u ngushtua shumë, kështu që u detyrua të emigrojë përkohësisht në Zvicër.

Ismeti, edhe në këtë vend, nuk pushoi së vepruari. Aty kyçet në radhët e LPRK-së, ku dha kontributin e tij, së bashku me vëllanë Muratin dhe shokët e ideali. Ai ishte i bindur se me konferenca retorike për shtyp e fjalë të mëdha, nuk çlirohet Atdheu, por duhen veprime e sakrifica konkrete. Bindjen se liria e një populli mund të fitohet vetëm me luftë, ai e shprehte nëpër tubime, demonstrata, në mbledhi te bashkatdhetarët po edhe me shokët zviceranë e të tjerë, që në fund të kalojë nga fjalët në vepra dhe ndër të parët të rreshtohet në radhët e luftëtarëve të lirisë. Jo rastësisht e kishte marrë pseudonimin ILIR KUMANOVA. E kishte lënë të shtypur Kumanovën e e donte të lirë. Me mburrje thoshte "Atdheu mbi të gjitha", për të shtuar më tej "Nga lufta vijmë në luftë shkojmë". Ismeti vetëm me trup ishte jashtë Atdheut, ndërsa mendja gjithmonë i rrinte në vendlindje, te: Orizara shqiptare, Kumanova krenare, Karadaku legjendar, Kosova martire. Preokupim kryesor kishte Atdheun e robëruar, çlirimin e Kosovës. Në kërkesën e tij kryesore, ai qe shumë i qartë -Dëshironte Çlirimin dhe Bashkimin Kombëtar. Thirrjes së Shtabit të Përgjithshëm të UÇK-ës për mbrojtje të Kosovës, që u bë pas pushkës së Ademit dhe qëndresës së Jasharajve, në mars të vitit 1998, pa hezitim iu përgjigj Ismeti.

Lamtumirë të gjithëve, mirë u pafshim në liri, o sot o kurrë, toka arbërore ka nevojën time, ç'farë më duhet jeta e robit pa tokën stërgjyshore, pa lirinë…Jetova për Kosovën, Shqipërinë, për UÇK-në, nuk mund të ndahem nga luftëtarët e lirisë. Më thërret gjaku i Ademit tonë të madh. Me këto fjalë ai u përshëndet me bashkëshorten, pesë vajzat e tij dhe farefisin JASHARI në Zvicër.

Nga Zvicra, me Femi e Xhevë Lladrovcin, Fatmir Limën e shumë të tjerë, luftëtarë të lirisë, arriti në Shqipëri, pas dy ditësh në Tiranë, zhvendoset në Has, e nga këtu futet në Kosovë dhe vendoset në fshatin Javor, në Drenicë, shtëpitë e të cilëve në atë kohë ishin bërë vatra të para të qëndresës shqiptare. Drenica dhe Kosova e atyre ditëve ishte vendi ku ishin grumbulluar forca të mëdha ushtarake e policore serbe të përcjella me armatim të llojllojshëm luftarak. Ismeti, nën uniformë të UÇK-ës, filloi të tubojë rininë dhe burrat e grykës së Llapushnikut e më gjerë, për luftë çlirimtare. Zemërgjerësia, afërsia dhe trimëria, ishin tiparet mobilizuese të karakterit të tij. Në shpirtin e tij nuk kishte vend urrejtja, përpos ndaj robëruesve serbë. Pushka çlirimtare në duart e tij u bë top për lirinë e Kosovës. Ai nuk qe oficer, por mësoi dhe e respektoi deri në fund hierarkinë ushtarake të UÇK-ës. Së shpejti bëhet shembull i vetëflijimit. Me njësitin e tij që e komandonte, luftoi me përkushtim në grykën e Llapushnikut, në Likoc, Drenoc, Lladrovc, Kleçkë, Jezerc, Qafë të Dulës, Malishevë dhe kudo e kurdo që e kërkoi nevoja. Vdekja e përcillte në çdo hap. Dhe ajo do ta gjejë në Luzhnicë të Malishevës, më 25 gusht 1998, gjatë aksionit të ndërmarrë për tërheqjen e shokëve bashkëluftëtarë të rënë

nga plumbat armikut serb. U varros me ata që luftoi e ranë për lirinë e Kosovës, në fshatin Kleçkë. Fitoi përjetësinë dhe hyri me meritë në histori, Dëshmor i Kombit. Këtij burri të kombit, luftëtari trim, HERO, jo vetëm i anëve tona, udhërrëfyes i gjeneratave të reja, më 2006 iu ngrit Shtatorja e Lirisë në sheshin e fshatit Orizare, ku për çdo ditë e vit, para përmendores së tij, në shenjë nderi e respekti po përkulen shumë vizitorë. Për vizitorët dhe njerëzit në tërësi, populli i kësaj ane ka një porosi: "Mos harroni! Ejani, shkoni! Vizitoni Shtatoret! Vizitoni përmendoret! Vizitoni Dëshmorët! Filloni nga Jasharajt e Kosovës e ejani këndej te Jasharajt e Kumanovës!, se populli që ka Dëshmor e Hero si Ismet Jashari, nuk ka pse brengoset për ardhmërinë e tij''.

Lavdi Ismet Jasharit-Komandant Kumanovës!

Naim HALIMI

GABRIELA TOPUZOVSKA

AKTIVITETI I MINISTRISË SË SHËNDETIT POPULLOR DHE ZHVILLIMI I SHËRBIMIT EPIDEMIOLOGJIK NË MAQEDONI (1945-1947)

Abstrakt

Fundi i Luftës së Dytë Botërore, nuk nënkuptonte edhe fundin e veprimeve luftarake, çlirim nga okupatori dhe vendosjen e pushtetit popullor, por fillim të luftës së re për ballafaqimin me problemet e reja ekonomike, sociale, kulturore dhe shëndetësore, të cilat paraqisnin sfidë të re dhe obligim për shtetin e porsaformuar.

Zgjerimi i sëmundjeve ngjitëse në Maqedoni, në vitet menjëherë pas luftës nuk kishte të ndalur. Populli maqedonas ishte njëri nga popujt më të varfër, i cili gjendej në gjendje jashtëzakonisht të keqe shëndetësore, krahasuar me popujt e tjerë jugosllavë. Gjendja e keqe shëndetësore ishte pasojë e kushteve ekstremisht të këqija sociale-ekonomike dhe vetëdije të ulët shëndetësore te popullsia.

Pikërisht rrethanat e këtilla ishin arsye më shumë për ndërmarrjen e disa masave dhe aktiviteteve nga ana e Ministrisë së Shëndetit Popullore, hapjen e institucioneve shëndetësore, detyra parësore e të cilave ka qenë zbatimi i edukimit shëndetësor dhe mbrojtja shëndetësore e popullsisë dhe parandalimi i sëmundjeve ngjitëse.

Fjalë kyçe: Ministria e Shëndetit Popullor, mbrojtja shëndetësore, sëmundjet ngjitëse.

Abstract

The end of the Second World War did not mean the end of military actions, the release of the occupier and the establishment of a new popular government, but the beginning of a new phase to cope with the new economic, social, cultural and health issues, which represented a great challenge and responsibility for the newly created state.

The spread of infectious diseases in Macedonia in the years immediately after the war is not stopped. Macedonian nation was one of the poorest nations, who was in extremely serious condition, compared to the other Yugoslav peoples. Poor health was the result of extremely poor socio-economic conditions and low health awareness among the population.

Exactly these similarities were reason for taking a series of measures and activities by the Ministry of Public Health, opening health facilities, whose primary

task was to implement health education and health care to the population and prevention of infectious diseases.

Keywords: Ministry of Public Health, health care, infectious disease.

Trashëgimia shëndetësore maqedonase e Jugosllavisë së paraluftës e varfër në çdo aspekt, gjatë kohës së Luftës së Dytë Botërore bëhet ende më e varfër. Përgatitjet dhe fillimet e rilindjes shëndetësore fillojnë që në vitin 1944, në mbledhjen e tretë të Presidiumit të KAÇPM-së në periudhën nga 2 deri në 5 shtator, në manastirin Prohor Pçinski, ku janë sjellë dy aktvendime, të cilat në fakt paraqesin ligjet e para për organizimin e shëndetësisë dhe shërbimit shëndetësor në Maqedoninë e lirë: Aktvendimi për themelimin e shërbimit shëndetësor shtetëror dhe Aktvendimi për organizimin e shërbimit të barnatoreve, për mobilizimin e farmacistëve dhe blerjen e barnatoreve.[1]

Përmbajtja e Aktvendimit për themelimin e shërbimit shtetëror shëndetësor, edhe pse përmban vetëm tre nene, paraqet themel të rregullores për zhvillimin e përgjithshëm të shërbimit shëndetësor në Maqedoni.[2]

AKTVENDIM PËR THEMELIMIN E SHËRBIMIT SHTETËROR SHËNDETËSOR[3]

Neni 1

Shërbimi shëndetësor, shëndetësia, është themel shërbim shtetëror. Shërimi është falas. Shërbimi shëndetësor është i organizuar nga ana a spitaleve si institucione shtetërore, si edhe ambulancat dhe brigadat lëvizëses sanitare dhe flesherët, të cilët janë nëpunës shtetërorë.

Neni 2

Duke e pasur parasysh këtë, mjekët privatë mobilizohen dhe vendosen në shërbim shtetëror me pagesë të caktuar.

Neni 3

Ky aktvendim hyn në fuqi në ditën e shpalljes.

Në manastirin “Shën Ati Prohor Pçinskki”, 2-5 shtator 1944

Për presidiumin e KAÇPM-së

Sekretar
Vl. Polezhina, d.v.

Kryetar
Metodija A. Çento, d.v.

[1] Боро Николовски, Прилози за историјата на здравствената култура во Македонија. Македонско фармацевтско друштво, Скопје, 1955, 297.
[2] Зборник на документи од АСНОМ, Институт за национална историја, Скопје, 1964.
[3] Боро Николовски, Прилози за историјата...., 297.

Pas çlirimit, si edhe në republikat e tjera të shtetit jugosllav, ashtu edhe në RP të Maqedonisë u fillua me aftësimin në masë të popullsisë për shkrim e lexim. Me këtë rast u organizuan kurse për edukim shëndetësor dhe ngritje të vetëdijes shëndetësore të popullsisë, përvetësimin e shprehive themelore higjienike, me qëllimi të pengimit dhe zvogëlimit të përhapjes së sëmundjeve ngjitëse. Me këtë rast janë angazhuar shumë organizata, në mesin e të cilave edhe: Kryqi i Kuq, Fronti Antifashist i Grave (FAG), Rinia Popullore, Shoqata e Mjekëve të Maqedonisë etj.[4]

Në raport me rilindjen shëndetësore, ka qenë e nevojshme që të fillohet nga fillimi në çdo segment të veprimtarisë shëndetësore. Që në ditët e para pas çlirimit, është filluar puna për organizimin e kurseve speciale për trajnim të kuadrit ndihmës dhe të mesëm mjekësor. Në periudhën nga viti 1945 deri në vitin 1949, në Maqedoni janë organizuar 14 kurse për trajnim të kuadrit të mesëm mjekësor dhe kuadrit ndihmës mjekësor, me gjithsej 318 kursistë.[5] Njëkohësisht, shumë punëtorë shëndetësorë janë dërguar në riaftësim në entet shëndetësore në republikat tjera jugosllave.

Nga Shoqata e Mjekëve të Maqedonisë, është organizuar aksioni qytet-fshat, me ç'rast një herë në javë janë organizuar ekipe mjekësore nga qytetet të cilat kanë ofruar ndihmë mjekësore, kanë kryer kontrollime shëndetësore dhe edukim shëndetësor të popullsisë së fshatit. Kryqi i Kuq ka qenë i angazhuar për zbatimin e vaksinimit kundër tuberkulozit, difterisë, tetanusit, tifos së morrit, kollës së madhe, tifos së zorrëve, dizenterisë, si edhe zbatimit të aksioneve për zhdukjen e malaries në Maqedoni.[6]

Lufta për rilindjen shëndetësore është zhvilluar në më shumë fronte në vend, është zhvilluar beteja me sëmundjet e rënda ngjitëse, kujdes i madh i është kushtuar edukimit shëndetësor të popullsisë por edhe vendosjen e rrjetit të ri, të qëndrueshëm dhe cilësor shëndetësor me mbrojtje parësore dhe sekondare shëndetësore.

Më 12 dhjetor 1945, Sektori PÇ i Shkupit, është drejtuar Ministrisë së Shëndetit Popullor me kërkesë nr. 5499, për hapjen e shërbimeve të reja shëndetësore. Pesë ditë më vonë, më 17 dhjetor 1945, me letrën nr. 6282 është miratuar kërkesa nga ana e Ministrisë së Shëndetit Popullor. Sipas propozimit, në qytetin e Shkupit është dashur të hapet Poliklinika e re Qendrore e Qytetit me ambulancat vijuese speciale.

- Entet rajonale ambulatore-poliklinike;
- Stacionet e ndihmës së shpejtë me garazhe dhe automjet të ndihmës së shpejtë;
- Spital qyteti me të gjitha repartet;
- Materniteti i qytetit me këshillimore për gra;
- Poliklinikë fëmijësh me repart fëmijësh, kuzhina qumështi, çerdhe;

[4] Po aty, 229.
[5] Ристо Брезјанин, Историја на здрваствената култура на Македонија, Монографија во ракопис, ИНИ, Скопје, 1960, 220.
[6] Po aty, 230.

- Reparti i qytetit kundër tuberkulozit me degë në rajonet me njësi spitali për tuberkuloz dhe shtëpi për tuberkulozë;
- Stacioni sanitar-epidemiologjik i qytetit, me ndërmarrje për dezinfektim dhe dezinsektim, banja dhe repart infektiv spitalor;
- Dispanzerë antivenerikë;
- Inspeksion sanitar qytetës;
- Barnatore qyteti sipas regjioneve".[7]

Në mënyrë të ngjashme janë formuar shërbimet shëndetësore edhe në qytetet tjera në Maqedoni.

Duke u ballafaquar me ekspansionin e tuberkulozit, shefi i repartit kundër tuberkulozit Gligor Muratovski, më 12 dhjetor 1945, me letër nr. 5492, drejtuar Ministrisë së Shëndetit Popullor, dorëzon "Plan pesëvjeçar për përmirësimin dhe përsosjen e punës në repartin e enteve kundër tuberkulozit". Përveç kësaj, në letër thuhet: "Tuberkulozi është një nga sëmundjet më të përhapura dhe më të rrezikshme në Maqedoni. Prej saj në vend gjatë vitit vdesin mbi 3000 njerëz, ndërsa vuajnë mbi 30.000 njerëz. 1/7 deri më 1/5 e rasteve të vdekjes e të gjitha grupeve të moshave të rritura i takojnë tuberkulozit. Për popullatën prej 18-35 vjeç përqindja e vdekshmërisë nga tuberkulozi është më e lartë se 1/3 deri ½. Vdekshmëria te punëtorët arrin 46%, që paraqet shkallë më të lartë të vdekshmërisë për 6 deri në 7 herë, krahasuar me njerëzit e pasur. Tuberkulozi është sëmundje e të rinjve, të varfërve dhe punëtorëve. Krahas kësaj, edhe humbjet materiale janë të larta dhe vlerësohen deri në 1.000.000.000 dinarë në vit. E tërë kjo ka manifestim të madh ndaj fuqisë së gjallë dhe vlerës biologjike të popullit. Në 3 deri në 6 vitet e ardhshme pritet që tuberkulozi të marrë hov më të madh. Prandaj krahas dy qendrave të tuberkulozit në Shkup dhe Manastir, në periudhën e ardhshme pesëvjeçare është e nevojshme të hapen:

Në vitin 1946:

- Qendra kundër tuberkulozit në Strugë, Veles dhe Kumanovë, me 20-30 shtretër;
- Në Leshkë, në kuadër të hapësirës së manastirit të hapet vend për shërim për sëmundjet e gjoksit me kapacitet prej 80-100 shtretërve;
- Në Shkup të ndërtohet reparti i tuberkulozit me 120-150 shtretër;
- Të ndërtohet sanatoriumi për sëmundjet e gjoksit me 300-400 shtretër spitali;
- Të aftësohet shërbimi i dispanserit me 4 deri 5 mjekë, të cilët do të ndjekin kur të shkurtër fiziologjik, dhe njëri të dërgohet në specializim.

Në vitin 1947:

- Qendër kundër tuberkulozit në Tetovë dhe Kërçovë, me 20-30 shtretër;

[7] Државен архив на Република Македонија, Скопје (натаму: ДАРМ), Ф.898: Републички завод за здравствена заштита, к. 24, а.е. 3.

- Të ndërtohet sanatorium për të sëmurë kirurgjikë-tuberkulozë me 150-200 shtretër spitali;
- Të dërgohen dy mjekë në specializim.

Në vitin 1948:
- Qendër kundër tuberkulozit në Pehçevë dhe Gjevgjeli, me 20-30 shtretër:
- Edhe në Shtip me 80-100 shtretër spitali.

Në vitin 1949:
- Dispanser kundër tuberkulozit në Shkup.

Në vitin 1950:
- Përfundohet dispanseri kundër tuberkulozit në Shkup.

Shefi, D-r. Gligor Muratovski".[8]

Në periudhën e njëjtë Ministria e Shëndetit Populllor Qeverisë së shtetit të ri maqedonas i dërgon propozim lidhur me ndryshime dhe plotësime të Kartës për rregullimin e dispanzerëve të lëvizshëm kundër tuberkulozit, detyra themelore e të cilave do të ishte zbulimi i hershëm i sëmundjeve të tuberkulozit te popullsia.

"Ministria e Shëndetit Populllor më 18 dhjetor 1945, me shkresën nr. 2926, për Kryesinë e Qeverisë Populllore të Republikës Federale të Maqedonisë, dërgon propozimligj për ndryshime dhe plotësime të Kartës nr. 11 të datës 27 janar 1945 të Presidiumit të KAÇPM-së me lutje që ky t'i propozohet Presidiumit të Kuvendit Populllor të Maqedonisë.

Zëv. Ministri i Shëndetit Populllor
Mr. f. Dare Xhambaz, d.v.

Ligj
për ndryshimin dhe plotësimin e Rregullores për sistemin e dispanserive të lëvizshme kundër tuberkulozit.

Neni 1

1/Neni 1 ndryshohet dhe thotë: Për zbulimin e sëmundjeve të hershme të tuberkulozit pranë Ministrisë së Shëndetit Publik krijohen dispanseri kundër tuberkulozit;

Neni 2

2/Neni 2 ndryshohet dhe thotë: Dispanseritë kundër tuberkulozit kryejnë shërbim para së gjithash në mesin e punëtorëve dhe prodhuesit e duhanit dhe punëtorët e tjerë në vendbanime të tëra;

[8] ДАРМ, Ф.898: Републички завод за здравствена заштита, к. 24, а.е. 5.

Neni 3

3/Neni 3 ndryshohet dhe thotë: Për mbulimin e të dalave krijohet fondi zonal pranë Ministrisë së Shëndetit Popullor në llogari të të cilit mblidhet nga një dinar për kilogram duhani nga prodhuesit gjatë grumbullimit të duhanit nga shteti;

Neni 4

4/Neni 4 ndryshohet dhe thotë: Organizimin e mbikëqyrjes supreme mbi dispanseritë kundër tuberkulozit e kryen Ministria e Shëndetit Popullor;

Neni 5

Ky ligj hynë në fuqi me ditën e shpalljes në "Gazetën Zyrtare" të Republikës Demokratike Federale të Maqedonisë.

Sekretar
D-r Boris Spirov, d.v.

Kryetar
Metodia A. Çento, d.v."[9]

Si rezultat i nismave të mëparshme, Ministria e Shëndetit Popullor, vazhdon me aktivitetet e saj, e prandaj me letrën nr. 73 të datës 18 janar 1946, parasheh dhe përgatit aktivizimin e planit themelor pesëvjeçar për zhvillimin e shërbimit epidemiologjik në Maqedoni.

Ky plan ka paraparë organizim të ri të shërbimit kundër epidemisë. Gjatë kësaj është planifikuar Drejtoria e Entit Kundër Epidemisë, sektori i epidemiologjisë, i cili është dashur të jetë përgjegjës për udhëheqjen, koordinimin dhe kontrollin e shërbimit kundër epidemisë në Republikën Federale të Maqedonisë.

Është paraparë edhe formimi i institutit federal bakteriologjik dhe instituti i parazitologjisë-malaries, entet dokumentuese dhe pedagogjike të Republikës Federale të Maqedonisë.

Pranë KP-ve të rretheve, është dashur të hapen Stacione Shëndetësore, të cilat krahas funksioneve të tjera do të përgatisnin raporte për punën e shërbimeve të këtilla kundër epidemisë.

Në pajtim me planin pesëvjeçar, është shfaqur nevoja edhe për kuadër përkatës:

- "...**Shtatë** epidemiologë: 1 për Ministrinë, 4 për rrethet dhe 2 për institucionet:
- **Gjashtë** bakteriologë: 2 për institutin, 4 për rrethet;
- **Një** parazitolog; 1 për institutin;
- **Pesëdhjetë e tre** ndihmës epidemiologjikë dhe bakteriologjikë: 2 për ministrinë, 6 për institutin, 12 për qarqet, 33 për rrethet;
- **Dyzetepesë dezinfektues:** 12 për stacionet e qarkut për dezinfektim, 33 për stacionet e rrethit për dezinfektim..."[10]

Për organizimin e shërbimit të ri epidemiologjik, shefi i Drejtorisë së Shërbimit kundër epidemisë dr. Done Miovski, e ka shfrytëzuar modelin e Shërbimit të mëhershëm Higjienik, si edhe strukturën organizative të Entit ekzistues të Institutit

[9] ДАРМ, Ф.898: Републички завод за здравствена заштита, к. 24, а.е. 9.
[10] ДАРМ, Ф.898: Републички завод за здравствена заштита, к. 24, а.е. 7.

Epidemiologjik-Bakteriologjik dhe Institutit të Malaries-Parazitologjisë. Lloji i ri i shërbimeve kundër epidemisë në qytetet e tjera është dashur të krijohet nëpërmjet riorganizimit të shtëpive të shëndetit të rretheve dhe stacioneve sanitare-epidemiologjike.

Territori i Maqedonisë ka paraqitur një mozaik laraman të vatrave ujore anofele, të cilat kanë qenë të shpërndara nëpër ujërat e qeta dhe të rrjedhshme në vend. Veçanërisht është karakteristike ajo që edhe në muajt e thatë të vitit një numër shumë i vogël i rrjedhave ujore dhe lumenjve janë shterur, ndërsa rrjedhat e vogla ujore janë shndërruar në shtretër të volitshëm anofele.[11] Vlerësimi i Qeverisë së RP të Maqedonisë, menjëherë pas çlirimit ka qenë se malaria ka paraqitur problem të madh shëndetësor dhe socio-ekonomik. Në kushtet kur gjendja kadrovike dhe materiale në shtetin e ri ka qenë në margjina, aktivitetet për mbajtje dhe kontroll të kushteve higjienike si edhe kontroll të ujit dhe produkteve të jetës, është dashur të zhvillohen nëpërmjet veprimtarisë ambulatore poliklinike, deri në momentit e formimit të shërbimit higjienik. Gjithashtu është planifikuar edhe krijimi i kuadrit epidemiologjik me arsimim të lartë, kuadrit të mesëm epidemiologjik dhe kuadrit ndihmës. Të gjitha këto aktivitete është dashur të shërbejnë në luftën e mundimshme kundër malaries dhe sëmundjeve të tjera shoqëruese ngjitëse. Në një situatë të tillë specifike dhe veçanërisht të vështirë, ka qenë e nevojshme edhe angazhimi dhe koordinimi i më shumë institucioneve, qëllimi i vetëm i të cilave ka qenë gjetja e zgjidhjes për zbatim të suksesshëm të aktiviteteve në luftën kundër malaries.

Krahas institucioneve të tjera sanitare dhe shëndetësore në fushën e parandalimin e sëmundjeve ngjitëse është theksuar edhe Instituti i Malaries-Parazitologjisë në Shkup. Për vëllimin e punës që e ka pasur ky Institut, kuptojmë nga raportet për kryerjen e aktiviteteve të cilat janë përgatitur nga ana e të punësuarve në Institut në nivel të mesëm edhe në të cilat është referuar për kontrollimet e kryera në Institut, si edhe për mënyrat e mundshme për shërimin e të sëmurëve, por edhe për parandalimin e të sëmurëve të rinj. Për vërtetësinë e të dhënave garantonte shefi i Institutit dr. Nikolaenko.[12]

Sipas raportit për muajin maj të vitit 1946, mësojmë se nga ana e Institutit të Malaries-Parazitologjisë më Shkup, në aksionin për parandalimin e malaries janë kryer "...1631 kontrollime, prej të cilëve 836 në ambulanca, 223 ndaj të shtruarve, 632 ndaj nxënësve, 163 ndaj ushtarëve. Në krahasim me vitin e kaluar numri i të shtruarve është zvogëluar për gjysmë, me disa raste të rënda. Janë kryer 157 kontrollime parazitologjie-dermatologjike nga Spitali Shtetëror, dispanseri i lëkurës-venerik, ambulancat dhe mjekët privatë. Në mënyrë sistematike është kryer

[11] Боро Николовски, Прилози за историјата ....., 330; Гавриловски Ѓорѓи, Организација на маларијата после ослободувањето во СР Македонија, Зб. Ерадикација на маларијата во Југославија, Монографија, Скопје, 1973.

[12] D-r Nikolaenko në raportin e datës 12.06.1946 ka dorëzuar edhe informacion të bollshëm për barërat anti malaries për gjashtë muajt e parë të vitit 1946, ndërsa ndaj raportit të njëjtë është bashkëngjitur edhe Raporti Vjetor i preparateve të kontrolluara me mikroskop nga e tërë Maqedonia në vitin 1945.

procedura me vajguri në çdo 12-13 ditë në të gjitha 6 sektorët, me ndihmën e ushtrisë. Nga ana e Sindikatës së Ujit, janë pastruar dhe mbushur kanalet në gjatësi prej 12 km, në fshatrat Orman, Volçi Doll, Vllae etj. Në frontin e Vodnos së Poshtme janë mbushur 24 gropa bombash me 2200 m kub. Tokë...". Ky aksion është zbatuar me ndihmën e personelit të Ministrisë së Shëndetit Popullor, në krye me ministrin dr. Gjorgji Gavrilski.[13]

Në drejtim të parandalimit të malaries, e në pajtim me raportin e Institutit të Malaries-Parazitologjisë, është planifikuar "... të rregullohet shtrati i vjetër i lumit Vardar, deri te centrali elektrik, të pastrohet vija në Parkun e Qytetit. Të dërgohen mjete larvicide te të gjitha stacionet dhe rregullisht të dërgohen raporte për gjendjen shëndetësore...".[14]

Për seriozitetin e epidemisë dhe pasojat nga dëmet të cilat i ka shkaktuar ajo, kuptojmë nga të dhënat që janë drejtuar te Ministria e Shëndetit Popullor të RPM-së. Nga raportet është fituar pamje e qartë për masivitetin e sëmundjes, numrin e personave të sëmurë si edhe aktivitetet dhe masat e ndërmarra nga ana e shërbimeve shëndetësore, në raport me kontrollimet dhe shërimin e të sëmurëve nga malaria, në regjionin e Resnjës, Ohrit, Shtipit dhe Shkupit, në periudhën prej

[13] Prim. d-r. Gjorgji Gavrilski ka lindur në Shën Nikollë, në vitin 1911. Shkollimin fillor e ka kryer në vendlindje, gjimnazin në Shkup, ndërsa studimet e mjekësisë i ka kryer në Beograd në vitin 1937. Pas mbarimit të studimeve të mjekësisë, si mjek i praktikës së përgjithshme, menjëherë punësohet në Shtip, ku posaçërisht dhe drejtpërdrejt i është përkushtuar angazhimit në luftën kundër malaries, sëmundjes e cila në atë kohë i ka shkretuar këto vise. Vitin shkollor 1938/1939, ai e kalon në përsosjen e Institutit Tropikal të Jugosllavisë, te prof. d-r Çedomir Simiq. Pas çlirimit, primarius d-r Gjorgji Gavrilski, vazhdon të japë kontribut në mënyrë më aktive në luftën kundër malaries, në cilësinë e drejtorit të Institutit Federativ të Sëmundjeve Tropike, në vitet 1949 deri në vitin 1951. Prim. d-r Gjorgji Gavrilski ka qenë anëtar i Komitetit Ekzekutiv të FP të Maqedonisë, deputet republikan federativ, në qeverinë e RP të Maqedonisë në një mandat është zgjedhur si sekretar i Qeverisë, ndërsa në një mandat tjetër si ndihmësministër i shëndetit popullor. Përveç kësaj, është zgjedhur si nënkryetar i Këshillit Republikan të Kryqit të Kuq dhe si anëtar i Këshillit Drejtues të Lidhjes së Mjekëve të Mjekësisë së Përgjithshme në Jugosllavi. Prim. d-r Gjorgji Gavrilski, në cilësinë e anëtarit të Komisionit Amë, në mënyrë të drejtpërdrejtë ka marrë pjesë në themelimin e Fakultetit të Mjekësisë në Shkup, në cilësinë e prodekanit të parë ai në mënyrë të drejtpërdrejtë ka marrë pjesë në organizimin e tij, ndërsa ka marrë pjesë edhe në arsim si profesor me korrespondencë i epidemiologjisë. Në periudhën prej vitit 1955 deri në 1960 punon si mjek i mjekësisë së përgjithshme, ndërsa nga viti 1961 deri në vitin 1981 është drejtor i Shtëpisë së Shëndetit të punonjësve të hekurudhës së RS të Maqedonisë. Në vitin 1981 pensionohet. Ai është specialisti i parë i mjekësisë së përgjithshme dhe primarius i parë në këtë specialitet, si themelues i Seksionit të mjekëve të mjekësisë së përgjithshme në Maqedoni. Ka qenë fitues i shumë mirënjohjeve, prej të cilave më të dashur e ka pasur mirënjohjen "Trifun Panovski" në vitin 1985. Димитријевски Марјан, Ковачески Стојан, Прим. д-р Ѓорѓи Гаврилски (1911-1987), Здружение на лекарите по општа медицина при Македонското лекарско друштво-Скопје, општина Свети Николе, ЈЗО Здравствен дом "Прим. Д-р Ѓорѓи Гаврилски"-Свети Николе, Скопје-Свети Николе, 2007.

[14] ДАРМ, Ф.898: Републички завод за здравствена заштита, к. 24, а.е. 10.

vitit 1945 deri në vitin 1947.[15] Metodologjia dhe aktivitetet që janë ndërmarrë në atë periudhë, kanë qenë të vetme për tërë territorin e shtetit të ri maqedonas dhe janë organizuar dhe udhëhequr nga ana e Ministrisë së Shëndetit Populllor, e në bashkëpunim me Institutit Federativ të sëmundjeve tropikale në Shkup.

Të gjitha aktivitetet, aksionet dhe operacionet në periudhën e pasluftës, të ndërmarra në fushën e rilindjes shëndetësore në vend kanë pasur domethënien se për një kohë shumë të shkurtër është dashur të kryejnë shumë punë "... Është dashur të zbatohet alfabeti drejtshkrimi maqedonas, por edhe të formohet universiteti. Është dashur të punësohen një armatë e njerëzve të papunë, por edhe të krijohen kushte për jetë normale. Është dashur të ndërtohen objekte kapitale ekonomike për ardhmërinë, por edhe në të njëjtën kohë të ndërtohen edhe shkolla, spitale dhe objekte të tjera të domosdoshme nga infrastruktura komunale dhe sanitare. Është dashur të krijohet rrjeti i organizatave shëndetësore për mbrojtjen primare dhe sekondare shëndetësore – ambulanca, poliklinika, dispanserë, spitale, por edhe në të njëjtën kohë është dashur të krijohen institucione të posaçme për mbrojtje specialiste dhe subspecialite shëndetësore – klinika, institucione, ente. Por para së gjithash është dashur të krijohen kuadro, kuadro profesionale mjekësore..."[16].

Në atë mënyrë ka filluar lufta e shëndetit popullor, lufta kundër sëmundjeve, varfëria, prapambeturia shëndetësore, ndërsa kjo ka qenë fillimi i luftës për pranim të identitetit nacional dhe vetëqenies së popullit maqedonas.

Burimet:

A. Државен Архив на Р.Македонија, Скопје:

- Фонд: 898, Републички завод за здравствена заштита, К. 24.

Literatura:

1. Николовски Боро, Прилози за историјата на здравствената култура во Македонија. Македонско фармацевтско друштво, Скопје, 1955.

2. Брезјанин Ристо, Историја на здрвaствената култура на Македонија, Монографија во ракопис, ИНИ, Скопје, 1960.

3. Димитријевски Марјан, Ковачески Стојан, Прим. д-р Ѓорѓи Гаврилски (1911-1987), Здружение на лекарите по општа медицина при Македонското лекарско друштво-Скопје, општина Свети Николе, ЈЗО Здравствен дом "Прим. Д-р Ѓорѓи Гаврилски"-Свети Николе, Скопје-Свети Николе, 2007.

4. Гавриловски Ѓорѓи, Организација на маларијата после ослободувањето во СР Македонија, Зб. Ерадикација на маларијата во Југославија, Монографија, Скопје, 1973.

5. Зборник на документи од АСНОМ, Институт за национална историја, Скопје, 1964

[15] ДАРМ, Ф. 898: Републички завод за здравствена заштита, к. 24, а.е. 4.
[16] Боро Николовски, Прилози за историјата ....., 330.

RECENSIONE

NJË VEPËR ORIGJINALE DHE JOKONVENCIONALE

Libri "Shqiptarët dhe të tjerët: nga Madona e Zezë deri te Molla e Kuqe" i historianit Ylber Hysa, do të duhej të ishte lekturë e obligueshme për të gjithë studentët shqiptarë të historisë. Në shumë pika Hysa shkruan ndryshe nga shkenca e zakonshme shqiptare

Historiografia shqiptare në Europën Juglindore njeh një rend temash të përhershme, të cilin e ndjekin shumica e historianëve deri më sot. Prandaj të befasuar marrim në dorë një libër, i cili përpiqet të ecë rrugëve të reja dhe qëllimisht rrok tema jokonvencionale. Ylber Hysa ka shkruar një vepër, e cila ofron një përzgjedhje interesante të trajtesave. Ai merret me çështjen e herezisë dualiste dhe heterodoksisë në Shqipërinë mesjetare, të cilën flamurtarët e ateizmit në Shqipërinë e Enver Hoxhës me qejf e përmendin si argument historik për distancën e shqiptarëve ndaj dy kishave) (fq. 11-39); vijojnë pastaj një punim për Stećci, (formë mesjetare e gurëve të varrit, v.j.), (fq. 41-60); thelbi i veprës i kushtohet popullsisë me prejardhje afrikane të Ulqinit (fq. 61-107); autori mandej ndjek "gjurmët e ortodoksisë te shqiptarët e Maqedonisë" (fq. 113-142); "Sinan Pasha dhe shafrani në Kaçanik" përbën objektin e kapitullit pasues (143-177); dy kapitujt e fundit rrokin titullin e librit – "Madona e zezë në Kosovë" (fq. 185-234) dhe "Molla e kuqe" (fq. 235-267). Në fillim Hysa paraqet mendimet e tij metodologjike. Me këtë rast ai fillimisht i qaset prezantimit të historisë shqiptare nga ata historianë serbë dhe bullgarë, të cilët shqiptarët i shihnin kryesisht si malësorë pa histori, të cilët jetonin në katërkëndëshin e konstruktuar nga albanologu kroat Milan Shuflaj Shkodër-Prizren-Ohër-Vlorë, përtej rrugëve të mëdha. Lidhur me fjalinë se "çfarë është për grekët deti dhe për sllavët rrafshina, për shqiptarët janë malet" (fq. 7) Hysa flet për një pikëpamje "horizontale". Paraqitja e hulumtimeve serbe është e diferencuar, pasi Hysa nuk merr qëndrim vetëm kundër autorëve nacionalistë, por thekson edhe punimet e shkencëtarëve nga Ilarion Ruvarac deri tek Olga Zirjoviq. Një pikëpamje "vertikale" Hysa e konstaton në anën e historiografisë shqiptare, e cila, sipas tij, niset nga prania pothuaj e përhershme "metafizike" iliro-shqiptare në viset që sot banohen nga shqiptarët dhe "përtej tyre" (fq.9). Këtu ai përpiqet të qëmtojë elemente dinamike në imazhin statik të historisë. Në shumë pika Hysa shkruan ndryshe nga shkenca e zakonshme shqiptare: kjo bëhet e qartë në shembullin e popullsisë zezake dhe shqipfolëse në portin e piratëve Ulqin. Si duhet të kategorizohet ajo? Nga njëra anë është krenaria mbi të kaluarën e qytetit, i cili në Epokën e re të hershme përbënte një qendër të pashembullt piratësh në Adriatik, nga ana tjetër paqartësia, e cila krijohet nga përkatësia kombëtare që bazohet në prejardhje, kur ajo përballet me fenomenin e afrikanëve albanofonë. Fakti që një historian merret me të kaluarën osmane përtej kryengritjes dhe represionit po ashtu duhet të vihet në dukje: Hysa është njëri prej historianëve të parë shqiptarë që hulumton një temë të kulturës materiale, fjala


është për shafranin e rëndësishëm në periudhën osmane dhe të njohur në mbarë Europën Juglindore, i cili mbillej në Kosovë. Gjatë trajtimit të Stećci boshnjak (formë mesjetare e gurëve të varrit, v.j.) Hysa mban anën e atyre shkencëtarëve, të cilët ata nuk i shohin si dëshmi të Kishës Boshnjake, por si monumente të lashta ballkanike – më saktë ilire. Referencat ndaj mendimtarëve të njohur vërehen edhe gjatë trajtimit të ortodoksëve shqiptarë të ritit sllav. Zakonisht në shkencën shqiptare dhe në historiografinë shqiptare ortodoksia kufizohet në Shqipërinë e sotme jugore, e cila deri në shekullin XX ka ndjekur ritin grek. Sa i përket Kosovës mesjetare, përkatësia e shqiptarëve ndaj ritit ortodoks hidhet poshtë me vërejtjen se të gjithë (ose shumica) e shqiptarëve të krishterë paskëshin ndjekur ritin romak. Edhe atëherë kur hulumtohet çështja e ortodoksëve albanofonë të ritit sllav (Pejë dhe Ohër), vështrimi jo përherë është i çliruar nga shtesat nacionale; thuhet se ky grup i ortodoksëve dalëngadalë edhe gjuhësisht iu kishte përshtatur shumicës sllave, në rastin konkret asaj maqedonase, kështu që pastaj portat janë të hapura për teorinë se disa, shumë ose të gjithë – varësisht nga orientimi politik – ortodoksët maqedonas të një rajoni të caktuar qenkan "në fakt" ortodoksë të asimiluar albanofonë, ose edhe më mirë: shqiptarë ortodoksë. Hysa sjell shembuj interesantë për shkrimin e shqipes me alfabet cirilik (fq. 122-123, shënim varri i Andçes, i biri i Duko, në Tetovë, dhe tërheq vëmendjen te publicisti Josif Bageri nga Reka, i cili ishte botues i revistës "Shqypeja e Shypënis/Albanski orel" në Sofje. Për Hysën, asimilimi i shqiptarëve ortodoksë është një "dëm kolateral" (fq. 144) i krijimit të shtetësisë maqedonase dhe identitetit nacional maqedonas. Kësaj ai ia kundërvë traditën shqiptare të identitetit mbifetar. Grupin e ortodoksëve shqiptarë të maqedonizuar, ai e sheh në fushën e tensionuar të "asimilimit të plotë ose ruajtjes së trikonfesionalitetit". Për hulumtimet shkencore shqiptare, i pazakonshëm është përdorimi i gjerë i bibliografisë ndërkombëtare dhe sidomos i literaturës në gjuhët sllave. Përzgjedhja e temave, metodologjia, kontekstualizimi i historisë shqiptare në një kornizë më të gjerë hapësinore, si dhe marrja parasysh e literaturës sekondare ndërkombëtare e bëjnë librin e Hysës një ndër veprat më origjinale, në mos veprën më origjinale të historiografisë shqiptare të decenieve të fundit. Nuk është e thënë të jemi të një mendimi me autorin në të gjitha detajet, por qasja e tij kritike ndaj ideologjisë dhe distanca e tij ndaj ngurtësive të prezantimit nacionalstalinist të historisë e karakterizojnë këtë libër, i cili do duhej të ishte lektyrë e obligueshme për të gjithë studentët shqiptarë të historisë.

Oliver Jens SCHMITT

Nga gjermanishtja: Enver Robelli

PREZANTIM I DENJË I MITOLOGJISË DHE KULTURËS POPULLORE SHQIPTARE

Elsie Robert, A Dictionary of Albanian Religion, Mythology and Folk Culture, Hurst & Company, London 2001, f.357; Elsie Robert, Leksiku i Kulturës Populllore Shqiptare- besime, mitologji, fe, doke, rite, festa dhe veçori kulturore, Skanderbeg books, Tiranë 2005, f.282.





Ka kohë qysh se trojet shqiptare dhe shqiptarët në përgjithësi ishin dhe janë temë e diskutimeve kryesisht politike ose "shkencore" nga ana e autorëve të huaj më qëllime të ndryshme. Janë në radhë ata si Stephen Schwarz, Noel Malcolm, Tim Judah, Edwin Jacques, dhe një pakicë e autorëve të tjerë të huaj që përpiqeshin t'i paraqesin shqiptarët dhe qytetërimin e tyre ashtu siç janë në të vërtetë dhe pa paragjykime. Në mesin e tyre është edhe studiuesi kanadez me vendqëndrim në Gjermani Robert Elsie, i cili dha kontributin e vet me disa artikuj nëpër revista të ndryshme shkencore (p.sh. Balkanistika, University of Mississipi), ndërsa para disa vitesh nxori edhe librin: A Dictionary of Albanian religion, mythology and folk kulture (Hurst&Company, London 2001, f.357), i cili në fund të vitit 2005 u botua i përkthyer në gjuhën shqipe me disa përmirësime dhe plotësime me titull: "Leksiku i kulturës popullore shqiptare - besime, mitologji, fe, doke, rite, festa dhe veçori kulturore, nga shtëpia botuese "Skanderbeg books" e Tiranës.

Teknikisht varianti i librit në gjuhën shqipe përbëhet nga tri pjesë kryesore: nga parathënia (f.7-10), leksiku (f.11-227) dhe bibliografia (f. 229-282).

Këtë vepër autori e ka konceptuar në formë fjalori (përkthyesi i thotë leksik) shpjegues të nocioneve nga fusha e mitologjisë, religjionit dhe kulturës popullore në mbarë trojet shqiptare. Thelbin e këtij fjalori e bëjnë studimi dhe shpjegimet e besimeve të ndryshme që pasqyrohen përmes spektrit të gjerë të mitologjisë shqiptare, besimeve religjioze, bashkësive fetare, rendeve dhe sekteve, njerëzve dhe grave të shenjtë, vendeve të kultit, festave kalendarike, të ritualeve dhe besëtytnive popullore të cilat janë ruajtur gjatë shekujve dhe falë izolimit komunist i cili zgjati për shumë decenie tash paraqesin "madenin e artë" për studiuesit e etnologjisë të disiplinave simotra madje jo vetëm të tyre.

Fjalori përmban shpjegimet e më së një mijë nocioneve, të cilat mund të thuhet që i takojnë tematikisht dhe kronologjikisht 3 kategorive kryesore: mitologjisë, religjionit dhe kulturës popullore të qytetërimit të pasur shqiptar.

Botën e begatshme të mitologjisë shqiptare, e cila shtrihet që nga kohërat parahistorike, përmes antikës, antikës së vonshme, mesjetës e deri në ditët tona, Elsie e prezanton përmes qenieve mitologjike nga më të ndryshmet, duke filluar nga bolla që vazhdon në njëfarë mënyre kultin ktonik të gjarprit nga koha ilire, fatitë - qeniet mitologjike të cilat njeriut ia falin jetë dhe ia caktojnë fatin, e të cilat e kanë origjinë nga moiret greke ose parkat romake, orët, që janë thuajse identike me fatitë, pastaj zanat-bukuroshet e maleve që kanë lidhje të drejtpërdrejt me hyjneshën Diana, pastaj Bardha (shpirti i bardhë), shtojzovallet që kanë ngjashmëri të madhe me zanat, të shenjtin e krishterë Shën Nikolla, i cili ndër shqiptarë njihet me emrin Shën Kolli, Nikolla dhe Koleci, dhe i cili si mbrojtës i marinarëve dhe i ujërave trashëgon veçoritë e hyjit antik grek- Posedonit (tek romakët Neptuni). Autori po ashtu prezanton edhe Shën Premten (Parasqevin) ose Shën Venerandën, nderimi i së cilës ka të bëjë me kultin e hyjneshës Venera. Shpjegime interesante Elsie jep edhe për figurat e tjera mitologjike: gjarprin, vitoren - gjarprin e shtëpisë, ashqitin, të Bukuren e Qiellit, Dheut ose të dynjasë, kulshedrën, shlligën-klyshin e kulshedrës, dhampirin, lugatin, divin, gogolin - me të cilin nënat i frikësonin fëmijët e padëgjueshëm, laurën, syqenëzin, sprijen që i përngjan hidrës nga mitologjia greke, xhindët, vurkollakun, xhixhibreshkën, xhuxhmaxhuxhat të cilët luanin edhe rolin e shkurtabiqëve në variantin shqiptar të përrallës mbi Borëbardhën, pastaj pëlhurazën, perriat ose pehriat- figurat femërore mitologjike me bukuri të jashtëzakonshme (shtatë pëllëmbë mjekër dhe një pëllëmbë shtat-figurë kjo mitologjike që karakterizohej për nga shtati tejet i vogël dhe aftësitë e jashtëzakonshme mendore dhe shumë e shumë të tjera.

Në bazë të këtyre nocioneve mund të kuptohet begatia e mitologjisë popullore shqiptare në të cilën janë ruajtur elemente qysh nga kohët më të lashta, përmes periudhës antike dhe mesjetare e deri në ditët tona.

Një pjesë e madhe e librit i kushtohet fushës së besimeve religjioze, të cilat, përkundër pengesave, ndalesave dhe torturave nga ana e regjimeve totalitare në Shqipëri dhe në trevat e ish-Jugosllavisë, kanë lënë gjurmë të pashlyeshme në të gjitha trojet e banuara me popullsi shqiptare.

Në këtë mënyrë prezantohet judaizmi, religjion i hershëm monoteist, i cili paraqitet në trojet shqiptare përmes ardhacakëve çifutë, për të cilët nuk dihet me saktësi kur filluan të imigrojnë në trojet shqiptare, por kemi gjetjet të simboleve

judaiste në disa lokalitete antike në Kosovë (Pejë, Papaz afër Therandës e disa lokalitete të tjerë), e madje edhe reliktet e një sinagoge që u zbulua tash së voni në Shqipëri (**v.j**.). Dihet që gjatë regjistrimit të vitit 1930 ishin 204 persona me përkatësi çifute në Shqipëri, shifër kjo e cila u shtua shumëfish gjatë Luftës së Dytë Botërore, kur arritën mijëra çifutë nga Gjermania dhe Austria dhe shpëtuan nga persekutimet naziste falë mikpritjes dhe besës shqiptare. Diç e ngjashme ndodhi edhe në Kosovë ku arritën shumë familje çifute nga Kroacia dhe Serbia (posaçërisht në Prizren, Mitrovicë, Prishtinë dhe Pejë **v.j**.) dhe shpëtuan falë mirësisë së shqiptarëve kosovarë. Pas lufte, e posaçërisht pas viteve të nëntëdhjeta, thuajse të gjithë çifutët nga trojet shqiptare emigruan në Izrael, duke mos i ndërprerë lidhjet me miqtë e tyre shqiptarë.

Krishterimi paraqitet në trojet shqiptare shumë herët, qysh nga kohët apostolike (në Iliri e sollën Shën Pjetri e Shën Pali, ndërsa në Dardani Shën Mateu), ndërsa gjatë shekujve të fundit përfaqësohet me kishën katolike dhe atë ortodokse. Bartësit më të hershëm të krishterimit pas apostujve të shenjtë ishin shtresat e ulëta popullore nga të cilat rrjedhin edhe martirët e hershëm krishterë të antikës dhe të mesjetës së hershme (duke filluar nga martirët e hershëm dhe shenjti i parë Shën Shtjefni), ndërsa gjatë mesjetës bartës ishin murgjit e rendit benediktin (ky rend u themelua në shekullin VI, kurse ndër shqiptarë paraqiten nga mesjeta), e më vonë edhe murgjit e rendit françeskan (janë prezentë në Shqipëri prej vitit 1248), dhe ata të rendit dominikan (paraqitën në Shqipëri që nga viti 1278).

Të krishterët nderonin shenjtorët e ndryshëm: Shën Vllashin, Shën Lleshin, Shën Dimitrin që paraqitet edhe si Shën Mitri ose Shëmitri, Shën Markun, Shën Gjergjin (një nder shenjtorët më të popullarizuar ndër shqiptarë), Shën Premten që paraqitet edhe si Shën Parashqevi dhe Shën Veneranda, Shën Thanasin ose Tanushin, 40 të shenjtët (martirë nga Sebastea e Armenisë) sipas të cilëve edhe u pagëzua qyteti i Sarandës (greqisht:saranda=dyzet,) si dhe shenjtorët e tjerë për nder të të cilëve u ndërtuan shumë kisha dhe objekte të tjera riti në mbarë trojet e banuara me shqiptarë. Po ashtu, autori shpjegon edhe kuptimin e nocioneve religjioze siç janë: Krishtlindja, Buzmi, Pashkët e të tjera.

Është me interes të përmendet në kuadër të krishterimit edhe ekzistenca e Kishës Uniate të ritit bizantin, respektivisht kishës katolike të ritit oriental që ekziston edhe sot e kësaj dite, dhe është posaçërisht e përhapur ndër arbëreshët e Italisë, priftërinjtë dhe murgjit e së cilës kanë veshjen që i ngjan asaj të priftërinjve dhe murgjve ortodoksë, kurse liturgjia kishtare, edhe pse katolike, zhvillohet në gjuhën greke.

Autori nuk harron as të shpjegojë kuptimin e nocionit kripto-krishtërim, fenomen ky mjaft i përhapur ndër shqiptarë posaçërisht në formën e kripto-katolicizmit, që është karakteristikë thuajse kryesisht për viset kosovare ku brenda një familjeje janë pranishme si besimi mysliman ashtu edhe ai katolik dhe ku bartësit e këtij fenomeni njihen me emrin *laramanë* (**v.j**).

Elsie trajton dhe shpjegon edhe nocionet e fesë myslimane duke filluar prej nocionit islam e tutje, ndërsa kujdes të veçantë u kushton dervishëve dhe rendeve të tyre të shumtë siç janë: rendi Bajrami, pastaj Bektashi, Halveti, Rufai, Sa'adi, Kadiri, Tigjani, Djelveti, Sinani, Mevlevi, Melani, Nakshibandi, Badavi, Jezevi,

Shahzeli, Desuki etj. të cilët kanë lënë më pak ose më shumë gjurmë nëpër trojet shqiptare, madje njëri prej tyre: ai Bektashi që nga viti 1925 e kishte qendrën botërore në Tiranë, kurse disa nga këta rende ishin dhe janë prezente nëpër vise të ndryshme të banuara me popullsi shqiptare (Prizren, Rahovec, Gjakovë, Gjilan, Pejë, Preshevë, Bujanoc, Shkup etj.).

Krahas shpjegimeve të përmendura, autori e njofton lexuesin edhe me njerëzit e shenjtë siç ishin: Baba Tomori dhe Sari Salltëku, si dhe me gra të shenjta (për të cilat dihet shumë më pak) siç ishte, bie fjala, Dervish Hatixheja e lindur në vitin 1798, e po ashtu shpjegon edhe nocionet e religjionit islam: Bajrami i Madh, Bajrami i Vogël, Ramazani dhe shumë nocione të tjera që janë ngulitur në mesin e shtresave të gjera popullore shqiptare të besimit mysliman.

Prezantimi i kulturës popullore përfshin shumë nocione duke filluar nga zakonet e lindjes nëpër treva të ndryshme të banuara me shqiptarë, zakonet martesore dhe raportet seksuale e deri te doket dhe zakonet e varrimit dhe besimet, legjendat e gojëdhënat e ndryshme. Në këtë kontekst trajtohet prerja rituale e flokëve që është e lidhur me kumbarinë, mikpritja, besa, festat e ndryshme si ajo e të korrurave, pastaj fenomenet siç janë: kuvada, homoseksualiteti, tabuja e incestit, pederastia, prostitucioni, duke e përfshirë këtu edhe prostitucionin në shërbim të mikpritjes në disa vise malore të Shqipërisë, pastaj fenomeni i virgjëreshave-vajzave të cilat nuk martoheshin dhe mishëroheshin me rolin e mashkullit, ai i aplikimit të tatuazhit nëpër pjesët e ndryshme të trupit e tjera. Autori po ashtu zë ngojë edhe besëtytnitë dhe besimet popullore siç është syri i keq, besimet lidhur me gurin dhe me diellin, pastaj besimet lidhur me ditët e caktuara të javë, sipas të cilëve disa ditë siç janë dita e hënë dhe ajo e enjte janë të mira dhe të mbara për disa punë,l ndërsa ditë e tjera siç është bie fjala dita e martë janë ditë terse, si dhe disa gojëdhëna dhe legjenda, si bie fjala legjenda mbi Doruntinën, e cila paraqitet edhe me emra të tjerë në vise të ndryshme shqiptare: Garentina dhe Fjoruntina (në versionin italo-shqiptar), por edhe me emrin Dhoqina në jug të Shqipërisë, pastaj legjenda mbi ndërtimin e kalasë së Rozafasë, etj.

Se çfarë pune ka bërë autori derisa e nxori këtë vepër dëshmon edhe bibliografia e literaturës së konsultuar me 1023 njësi bibliografike të 525 autorëve të ndryshëm, prej atyre më të hershëm e deri në vitin 2000, që janë botuar mbarë trojeve shqiptare dhe nëpër botë. Duhet cekur që një pjesë e konsiderueshme e autorëve në fjalë janë autorët që jetuan dhe vepruan ose ende jetojnë dhe veprojnë në Kosovë siç janë bie fjala autorët: Sh.Gjeçovi, A.Çetta, M. Krasniqi, R. Ismajli, J. Drançolli, Z. Mirdita, S. Rizaj, R.Ushaku, A. N. Berisha, M. Mustafa, A. K.Berishaj, J. Rexhepagiqi, S. Krasniqi, R. Krasniqi, E. Sedaj, N. Ferri, D. Shala, B.Ahmeti, B. Reka, Sh. Pllana, e mjaft autorë të tjerë kosovarë.

Meqë asnjë vepër nuk është e përsosur, edhe vepra në fjalë i ka disa mungesa siç janë p.sh. mospërfshirja e disa nocioneve të rëndësishme siç janë disa elemente nga e drejta kanunore si dhe mungesa e legjendave popullore që kishin të bëjnë me shpërnguljen e simboleve (shtatoreve) të shenjtorëve të krishterë dhe zhvendosja e kishave të tyre prej një lokacioni në të tjetrin. Njëra nga këto gojëdhëna është ajo lidhur me Zojen e Cërnagorës e cila, sipas një legjende popullore, është shpërngulur nga Shkupi në Letnicë ku edhe sot e ka kishën nga e cila ishte

frymëzuar edhe vetë Nëna Tereze dhe prej aty kishte filluar veprimtarinë e saj humaniste anembanë botës. Zoja e Cërnagorës, apo edhe siç njihet në popull Zoja e Zezë, në njëfarë mënyre mund të krahasohet edhe me të famshmen Zojen e Shkodrës, dhe pa dyshim është një ndër shenjtoret më të rëndësishme në Ballkan, të cilën e nderojnë jo vetëm të krishterët shqiptarë, por edhe të tjerët. Festa e saj bie më 14 gusht në mbrëmje kur shtatorja e saj merr ngjyrë të mbyllët, ndërsa një ditë më vonë, pra më 15 gusht shtatorja zbardhet. Gjatë festës së saj, para luftës në Kosovë, kishën e vizitonin edhe jevgjit, madje jo vetëm ata kosovarë. Diç të ngjashme hasim edhe në Pejë ku besohet se shtatorja e Shën Katarinës disa herë ka fluturuar nga "Mëhalla e Arsllan Çeshmës" ku thuhet se ishte kisha e mëparshme katolike, dhe shpërngulej në pronën e familjes myslimane Çavdarbasha e cila pas "këmbënguljes" së shenjtores edhe e dhuroi një pjesë të pronës së vet për ndërtimin e kishës dhe kjo kishë gjendet edhe sot e kësaj dite në "Mëhallën e Çavdarbashëve" (e cila më vonë u riemërua në "Mëhalla e Katolikëve") dhe bart emrin e Shën Katarinës.


Mungojnë po ashtu edhe shpjegimet lidhur me kurbanët dhe disa relikte të tjera pagane të ngulitura si ndër shqiptarë myslimanë ashtu edhe tek ata të krishterë-katolikë (kurbanët me rastin e festës së Kurban Bajramit pastaj ato për nder të Shën Kollit më 6 dhjetor dhe llojet e tjera të flijimeve).Një tjetër vërejtje mund t'i bëhet kësaj vepre lidhur me faktin qe gjatë trajtimit të materialit në aspektin gjeografik më tepër është përfshirë territori i Shqipërisë ndërsa më pak trevat e Kosovës, Kosovës Lindore, të Maqedonisë apo ato të Malit të Zi, gjë që mund t'i falet një autori joshqiptar e aq më tepër kur e dihet që kjo gjë nuk është bërë me qëllime të këqija.

Vlen të përmendet se varianti i kësaj vepre në gjuhën angleze botuar në vitin 2001, sipas pohimit të vetë autorit, ishte i dedikuar që ta njoftojë botën perëndimore më aspektet e ndryshme të kulturës shqiptare, ndërsa versioni i saj në gjuhën shqipe i cili ka pësuar disa ndryshime dhe plotësime duke i evituar disa gabime të paqëllimshme dhe duke i plotësuar disa mangësi më qëllim të ngritjes së cilësisë së veprës(edhe pse në variantin në gjuhën shqipe mungojnë disa pjesë origjinale në mesin e tyre edhe shkurtesat bibliografike dhe harta e trojeve të banuara me popullsi shqiptare), synon t'ua ofrojë në një vend, t'ua prezantojë dhe t'ua bëjë më të afërt një pjesë të madhe të thesarit të begatshëm të trashëgimisë kulturore shpirtërore shqiptare (pjesët e së cilës kanë filluar të zhdukën ose tashmë edhe janë zhdukur) masave të gjëra të lexuesve shqiptarë.

Naser FERRI

ASPEKTE INTERESANTE TË BESIMEVE POPULLORE SHQIPTARE

Azem Qazimi, Fjalor i mitologjisë dhe demonologjisë shqiptare, të kremte, rite e simbole, SHB Plejad Tiranë, 2008, f.196.



Mitologjia shqiptare është fushë mjaft e pa studiuar dhe e pa eksploruar dhe mund të thuhet pak e studiuar. Deri më tash disa autorë janë marrë me çështje të caktuara të besimeve, ose janë përpjekur që në kuadër të fjalorëve të përgjithshme mitologjike t'i inkorporojnë elementet e caktuara nga mitologjia dhe besimet popullore të trevave të caktuara shqipfolëse. Në veprën e vet "Fjalor i mitologjisë dhe demonologjisë shqiptare" autori Azem Qazimi, pos elementeve të njohura të mitologjisë shqiptare ka përfshirë edhe një varg nocionesh e zërash me pak të njohura ose edhe të njohura, por të patrajtuara sa duhet dhe të papublikuara më herët nga fusha e demonologjisë me synim që t'i përfshijë sa më shumë territore të banuara me shqiptarë: Shqipërinë (jugu i Shqipërisë, Myzeqeja, Permeti, Labëria, Tirana, Puka, Malësia), Dukagjinin, Maqedoninë (Liqeni i Ohrit), Malin e Zi (Ulqini), Greqinë (Çameria) si dhe Italinë (arbreshët e Sicilisë, të Kalabrisë e të Pulias).

Në 196 faqe vepra në fjalë trajton 90 nocione nga lëmi i mitologjisë dhe i demonologjisë, e po ashtu ka tri shtojca. Në të parën shpjegohen 19 simbole më karakteristike ë lashta: dielli, disku, djepi, dora, furka, gjysmëhëna, hekuri, kryqi, kryqi me gjysmëhënë, molla, parmenda, svastika (kryqi gremç), shega, shenja "S" dhe shqiponja, në shtojcën e dytë janë të përfshira 21 kremte popullore të motmotit, sipas kalendarit të lashtë popullor shqiptar: Dita e Gushtit (1 gushti), Dita e Shën Llazarit (e shtuna e fundit e Kreshmave të mëdha), Dita e Verës (më 1 ose 14 mars), Dita e Vjeshtës (që në rrethinë të Kurveleshit konsiderohej ditë e parë e vitit), E Hëna e minjve (dita e parë e Kreshmëve të mëdha), Festa e Gjallicës (kremtohet më 10-15 gusht në majën më të lartë të Lumës), Festa e Shndritatit (kremtohet më 2-15 gusht në majën e Pashtrikut), Festa e Tomorit (më 15 gusht në Kulmak dhe majën e Qukës në Tomorr), Llazoret (një javë para Pashkëve), Mesi i Verës (festë kolektive nëpër maja të larta malesh), Nata e Buzmit (24 dhjetor-e kremtë e kthimit të diellit ka vera), Rite që lidhën me Shën Mërinë (kremte kryesore për katolikët më 15, ndërsa për ortodoksët me 27 gusht me ç'rast bëhën pelegrinazhe në maja të maleve: Tomor, Gjallicë, Shën Llesh e Pashtrik), Shëngjergji (më 6 maj), Shëngjini (në fund të qershorit), Shënkolli (6 dhjetor), Shënmitri (fillimi i dimrit, njihet edhe si fillim i vitit), Shkundadimni (ditët e fundit të marsit ose të fillimit të prillit, njihet edhe si Ditët e Plakave, Ujët e Bekuar (6 janar, njihet edhe se Epifania), Viti i Ri (fillimi i mbjelljes), Zoja e Të Vjelunave (vjelja e rrushit), ndërsa në të tretën shtojcë trajtohet faltorja e Baba Tomorit në Shqipëri (vend i shejtë me të cilin "kurrkush nuk ban be rrenë"). Lëndës kryesore i paraprin tryeza e lëndës (treguesi) dhe fjala e recensentit të kësaj vepre, ajo e arkeologut dhe njohësit të shquar të mitologjisë Moikom Zeqo.



Maja e malit Tomorr, vend i shenjtë për shumë shqiptarë

Në mesin e nocioneve të përfshira në këtë fjalor interes të veçantë zgjojnë qeniet dhe fenomenet e ndryshme negative e pozitive demonike siç janë bie fjala: Azma, Njëbrirëshi, Barboqja (mësyshi, të cilin për ta prishur përdoret druri i manit dhe uji i gacave-kllogja), Bullari, Dhranondai, Eshderhaja, Ferriçka, Kacneta, Katraveshi, Koret, Ltiîjt, Manaqeli, Mileçja, Stihia, Shënëndreu, Të Jashtësmet, Të Lumet e natës, Të Mirat e malit (Oret), Veshendeleza, Vova, Xhigerrakja, Macja, Gjeli (krijesë qe ka fuqi të madhe kundër demonëve) e mjaft të tjera.

Autori e ka sajuar veprën e vet duke kërkuar rrënjët e mitologjisë popullore përmes mbijetesës së asaj pagane ilire e shqiptare në substancën historike, siç e cek Moikom Zeqo në fjalën e tij. Lidhur me këtë Zeqo bazohet mbi pohimin e antropologut të madh Claude Levy Strauss, sipas të cilit:"nuk mund të ketë një popull pa mitologji pagane".

Në shumë rasti Qazimi shënon variante të ndryshme për qenie të caktuara, siç është rasti bie fjala me gjarprin i cili paraqitët në kontekste pozitive (Vitore, Orë) apo edhe negative (Bullari, Grabofçi,), pastaj me qeniet të afërta me shtrigën siç janë: Memoja, Stihia, Xhigërrakja, Kacneta, Lia, Lubia, shoqëruesi i shtrigave Steneci, e të ngjashme, pastaj me përfundimin e dimrit që në disa rajone shqiptare quhet "Plakat" e në disa të tjerë "Shkundadimni" e kështu me radhë..

E veçanta e Qazimit në këtë rast është që ai në mënyrë të veçantë i ka studiuar dhe trajtuar dhe i ka renditur (recensenti i kësaj vepre Moikom Zeqo thotë se: "Fjalorët dhe enciklopeditë nuk janë shpikje, por janë rend") në këtë fjalor edhe figurat, simbolet, ritet e të kremtet pagane të lidhura me krishterim: Bullari, Buzmi, Djalli, që identifikohet me gjarprin, Ferri, i huazuar nga mitologjitë pagane, macja, e huazuar nga mitologjitë e lashta pagane për të cilën besohej që ka dalë nga mënga e Jezu Krishtit, Shën Ilia, i cili identifikohet me dragoin, Shën Marena, Zoja Prende, kulti i së cilës rrjedh nga kulti i Venerës romake, dhe me besime islame: Arapi, (Xhind i cili banon ne gur të një unaze), Demirçili-kal që flet e mendon si njeri, Dërdyli-kali i imam Aliut, Perritë- vasha shumë të bukura, Qerosi- dinak i madh e i zgjuar, tërana-sëmundje që merr njeriu kur ua prish qetësinë xhindëve duke shkelur mbi ta, Texhalli apo Dexhalli (njëri i pandershëm, ekuivalent me antikrishtin), Thopçit, Thopërçit, Thopërk- Xhind të vegjël, Xhindet, T'Mirazt- e të ngjashme.

Të dyja këto fe abrahamike, e në mënyrë të veçantë krishterimi ishte përpjekur t'i ç'rrënjoste elementet e trashëguara pagane nga kultura dhe besimet popullore (psh. beja me gur, me diell, hënë e të tjera, e jo me Zot, kryq e të ngjashme), siç kishte urdhëruar, bie fjala, papa Klementi XI në Kuvendin e Arbënit në vitin 1703, por përkundër të gjitha përpjekjeve të institucioneve islame e krishtere, besimet pagane nuk u çrrënjosjen, ndërsa priftërinjtë e hoxhallarët për kohë të gjatë "profesion kryesor" i kishin pasur ritet dhe veprimet e ndryshme magjike si dhe shkrimin e hajmalive me citate nga Bibla e Kur'ani, gjë që një pjesë e tyre e bëjnë edhe sot e kësaj dite.

Për "renditjen" e këtij fjalori Qazimi ka përdorur burime të shumta relevante të cilat i ka cekur brenda shpjegimeve veç e veç, por edhe në listen e literaturës së pasur me mbi 100 njësi bibliografike të autorëve mesjetar, por edhe të atyre të Rilindjes, të kohëve të mëvonshme si dhe të kohës aktuale siç janë: Bogdani, Budi,

Gazulli, Cordignano, Giordano, Dozon, Durham, S.Frashëri, Hahn, Lamberz, Gjeçovi, Mayer, Kotte, Konica, Koliqi, Çabej, H.Ceka, Pedersen, Cooper, Elsie, M.Prelaj, Xhagolli, Zojzi, Dhama, Hasanaj, Haxihasani, Luli, Mihaçeviq, Pano, Zeqo, D. Rendiq-Mioçeviq, Stipçeviq, Dhama, Krasniqi, Tirta, Ushaku e shumë të tjerë.

Edhe pse jo i madh me vëllim, dhe më ca mangësi (nuk e trajton bie fjala Ditën e Nevruzit) Fjalori i Azem Qazimit ka rëndësi të posaçme, meqë trajton elemente të reja nga fusha e mitologjisë dhe demonologjisë shqiptare, ndërsa në shumë raste hedh dritë të re në disa sosh të njohura që më herët.

Lënda e renditur në këtë fjalor përfshin elemente nga mitet, legjendat, religjionet monoteiste, nga folklori popullor e të ngjashme, dhe për këtë arsye me të drejtë Moikom Zeqo e cilëson këtë vepër si "fjalor diturak, rekonstruktues, që i shërben të gjithëve."

Naser FERRI

KRONIKA SHKENCORE DHE KULTURORE

NJË VIT I FRYTSHËM BOTIMESH

Instituti i Trashëgimisë Shpirtërore e Kulturore të Shqiptarëve në Shkup është bërë tashmë një qendër shkencore me sukses jo vetëm në Maqedoni, por edhe kudo gjetkë krahas gjithë institucioneve të tjera të këtij lloji të shqiptarëve.

Natyrisht, kjo është rrjedhojë e punës së tij të gjerë dhe të shtrirë në një varg vitesh. Ndërkaq, për mendimin tim, një arsye tjetër e suksesit është edhe synimi i tij dhe aftësia për të mbledhur në gjirin e tij po edhe rreth vetes punonjës shkencorë me peshë, autorë që kanë bërë emër në fushën e tyre dhe që paraqesin këtu frytet e punës së vet, sepse e dinë që jo vetëm gjejnë një atmosferë zemërdhënëse, por edhe sepse do të kenë mbështetjen për të dalë veprat e tyre me cilësi të lartë.

Kur një studiues ka sigurinë se, pavarësisht nga vështirësitë e pengesat në rrethanat e njohura, do të gjejë një qendër të tillë studimore kushtuar një objekti kaq fisnik, siç është trashëgimia kulturore e shpirtërore, ai punon me dëshirë dhe jep produkte të një niveli të lartë, sepse dhe e ndien përgjegjësinë e vet. Si shembullin më të parë do të sillja emrin e Qemal Muratit. Ne tashmë kemi prej tij një varg librash, madje mund të them se ndoshta është gjuhëtari që ka më shumë libra të botuar. Ndër këta kanë qenë edhe një varg fjalorësh.

Së bashku me një grup autorësh më 1988 Q. Murati ka marrë pjesë në përgatitjen e Fjalorit të fjalëve dhe shprehjeve të huaja dhe po atë vit botoi *Fjalorin e shqipes truallsore të Maqedonisë.* Pas pesë vjetësh i erdhi radha *Fjalorit të fjalëve të rralla të përdorura në viset shqiptare të Maqedonisë* dhe një vit më vonë *Fjalorit të sllavizmave në të folmet shqiptare të Maqedonisë.* Dhe brenda dhjetë vjetësh, domethënë më 2008 me *Fjalorin toponomastik të tërthoreve shqiptare të Maqedonisë* dhe me *Gjuha e medieve. Fjalor i gabimeve* bëhen kështu shtatë punime leksikografike. Nuk është e rastit atëherë që më 2015 doli *Fjalori i fjalëve dhe shprehjeve nga trojet e shqipes në Maqedoni.*

Ndonëse titulli është i gjatë, ai përsëri nuk e mbulon pasurinë e vërtetë që ka ky vëllim prej mbi 800 faqesh, me mbi 20 mijë leksema, frazeologji dhe topoleksema. Si një përmbledhje e gjithë punimeve të mëparshme, ai përbëhet prej 7 pjesësh. Pjesa e parë është më e gjera dhe zë pothuaj një të tretën e librit. Është njëkohësisht edhe pjesa më e rëndësishme e vëllimit, sepse jo vetëm nga ana leksikografike ka vlera të reja, por edhe sepse mund t'i shërbejë lexuesit të gjerë, domethënë shkrimtarëve, gazetarëve, dashamirësve të shqipes së pasur. Pasohet nga pjesa e dytë me shprehjet që quhen frazeologji, por autori ka zgjedhur një këndvështrim të veçantë, domethënë i ka parë edhe nga ana e jetës sociale dhe prandaj aty kanë gjetur vend gjithashtu tabutë e eufemizmat, që janë pikërisht dukuri etnokulturore dhe jo thjesht gjuhësore.

Tri pjesët që vijojnë janë të përbashkëta në thelbin e tyre, sepse përbëjnë fushën e etimologjisë, domethënë: turqizmat, 3600 huazime; sllavizmat, 1200 nga maqedonishtja dhe albanizmat. Pjesa e gjashtë është në të vërtetë një fjalorth

dygjuhësh, d.m.th. shqip e maqedonisht. Ndërsa pjesa e fundit e kapërcen leksikografinë dhe i përket onomastikës në dy aspekte: emrat e vendeve, toponomastikë, dhe emrat e njerëzve, patronimi, gjithsej 5000 njësi.

Vëllimi shoqërohet me recensionet nga 6 autorë. Duke mos përsëritur vlerësimet e tyre, do të shprehem se ato së bashku, ndonëse u përkasin viteve të ndryshme, dëshmojnë se ky libër është përgatitur pa ndërprerje prej pothuaj 40 vjetësh, kurse do të shtoja se në këtë mënyrë ky libër gjithashtu do të jetë i dobishëm jo vetëm për ditët e sotme, por edhe për shumë kohë në të ardhmen.

Në Hyrjen e shkurtër bien në sy dy gjëra. Së pari, përballë forcës ndryshuese dhe gërryese të rrjedhës së kohës, autori i ka vënë vetes detyrë që të ruajë ato thërrmija, të cilat përndryshe do të vdareshin. Së dyti, edhe për shkak të specifikës së truallit gjuhësor ku është përqendruar, ai e ka rrokur drejt se shqipja nuk mund të ishte një dukuri e veçuar, por detyrimisht do të kishte marrëdhënie të pandërprera me gjuhë të tjera. Kështu libri është kthyer edhe në një burim për studime ballkanologjike. Siç dihet, vetë ballkanologjia si disiplinë ka nisur pikërisht me fjalorë, në të cilët kanë dalë së bashku gjuhë të ndryshme të kësaj treve.

Autori ka vënë në dukje se kjo lëndë nuk është thjesht grumbullim në një rend i veprave të botuara më parë, por ka bërë plotësime të ndjeshme të tyre. Me këtë ai ka bërë kureshtarë për ta studiuar si vepër të re me interes. Lidhur me vështirësitë e një pune të tillë, mua do të më lejohet që t'i ritheksoj, sepse po këtë rrugë e kam përshkuar edhe vetë prej dhjetëra vjetësh dhe forca për të mos u përkulur para vështirësive më ka bërë ta vijoj edhe sot. Kjo lëndë kaq e gjerë, natyrisht, ngre mjaft probleme. Do të prek fare shkurt vetëm një prej tyre. Në të gjithë fjalorët dialektorë mbetet të dallohen me kujdes fjalët prej varianteve të tyre. Po marr vetëm një rast që e gjej te autori: *cajngsh – fëmijë qaraman; cinksh – njeri grindavec*. Në të vërtetë është një fjalë dhe jo dy, pra janë variante shqiptimore dialektore. Anasjelltas, disa raste janë të njohura si fjalë të mbarë shqipes. E tillë është *pordhash*, të cilën e ka regjistruar S. Mann-i që më 1948. Ose te togu *orta kakaçkë* fjala "orta" është thjesht turqizëm dhe nuk përbën ndonjë pasuri të leksikut të shqipes.

Në disa raste kemi të bëjmë me dukuri të përgjithshme për një të folme, si p.sh. mosshqiptimi i një "h"-je nistore. Atëherë nuk është nevoja të jepen si fjalë më vete të gjitha rastet pa "h" nistore ose me ndonjë dukuri tjetër; këto shpjegohen në përshkrimin dialektor dhe nuk përfshihen njësitë si leksema më vete. Rrjedhimisht, nuk e kanë vendin si fjalë më vete as në fjalor, as në turqizmat: ajmali, ajvan, ajvon, ak, albuqi, allall, amon, anko, aps, arshejn, asm, ashajk, ombër etj., etj. Është e vërtetë, që në disa të folme fjala *kënd* shqiptohet "kon", prandaj kjo nuk përbën ndonjë diçka me interes te shqiptarët e Maqedonisë, madje me këtë trajtë prej kohësh bëhet shaka te ne: një mësues shpjegon gjeometri në klasë dhe thotë se ka kënde të barabarta, domethënë ky kënd është i njëjtë me këtë kënd. Për humor thuhet se një nxënës tiranas e shqiptoi kështu këtë fjali: " Ky koni kho osht kon e kon me kte konin kho". Ndërsa te frazeologjitë, që paraqesin mjaft interes, do të mënjanohen ato më të njohurat, si dhe rastet kur nuk kemi frazeologji, por kuptime të figurshme të fjalëve të veçuara, si: qahem, i padallkatët, pendulit, sallaisem etj.

Te turqizmat përfshirja e varianteve të shqiptimeve dialektore nuk sjell ndonjë gjë të re, përkundrazi, e zmadhon në mënyrë të padrejtë numrin e turqizmave. Përgjithësisht tashmë kemi Fjalorin e Tahir Dizdarit për orientalizmat dhe është e domosdoshme të këshillohemi me të, sepse nuk mund të paraqitet si dukuri e një treve një huazim që njihet madje në shkallë ballkanike. Nuk e kam fjalën se puna e madhe e T. Dizdarit është e paqortueshme, përkundrazi, e vlen të shkohet më tej edhe në këtë fushë. Do të sillja si shembull fjalën "duhan" dhe të prejardhurën prej saj "duhanxhi". Pavarësisht se edhe P. Skoku e përfshin në turqizmat, nuk ka në turqishten një fjalë të tillë, sepse turqisht është "tütün", kurse duhani ka ardhur te ne pas shekullit XVII nëpërmjet arabishtes.

Te sllavizmat shfaqet një problem i jashtëm për shqipen. P.sh., kur bullgarët e bënë kryeqytet Beratin në shek. IX, a mund të thuhet se huazimet e asaj kohe ishin nga maqedonasit? Do të detyroheshim të shpreheshim atëhere se Beratin e kishin pushtuar maqedonët. Prandaj jam i një mendjeje me Q. Muratin, se më e drejtë është të flasim për sllavizma. Por edhe në këtë rast mbetet detyrë për të dalluar sllavizmat me prejardhje veriore nga ato jug-lindore, diçka që është shpjeguar drejt me dallimin ndërmjet *opangë* dhe *opingë*, që përbën një prej dallimeve ndërmjet dialektit të veriut dhe të jugut për shqipen. Ndërkaq, del me interes dallimi, që ka përmendur autori ndërmjet fjalëve nga gjuha e folur dhe fjalëve nga maqedonishtja e shkruar ose zyrtare. Në këtë rast e vlen paraqitja e fjalës në trajtën shkrimore të maqedonishtes.

Pjesa e gjashtë për albanizmat e maqedonishtes mbështet tezën e I. Popoviqit, se ndikimi i shqipes mbi të folmet sllave është më i madh sesa është paraqitur zakonisht. Në pjesën VI vjen një fjalor idiomatik dygjuhësh me mjaft interes. Gjithsesi, edhe këtu do të duhej të mënjanoheshin fjalët e veçuara, të cilat nuk përbëjnë shprehje frazeologjike, si: bukë, burrnisht, çohet, derr, frymë, e rëndë, e shëllirtë, e vret etj. Mbyllet vëllimi me një bibliografi të pasur.

Autori tjetër është Sevdail Demiri, me monografinë "Shtypi shqiptar në Maqedoni 1945-1991, aspekti kulturor-arsimor", Shkup 2015. Krahas ndihmesave të tjera, shtypi shqiptar i kësaj periudhe ka luajtur rol të rëndësishëm për ruajtjen e trashëgimisë kulturore e historike të shqiptarëve në këto treva. Dihet se deri më 1945 nuk lejohej shtypi shqiptar në Mbretërinë e Jugosllavisë. E para gazetë shqip në Maqedoni nisi të botohej në prill 1945 me titullin "Flaka e vëllazërimit".

Kreu i parë hedh një vështrim të shkurtër mbi historinë e shtypit që nga gjurmët e tij në shek. I në Romë, ndërsa më gjerësisht na del rrjedha e shtypit shqiptar që nga viti 1848. Mund të ishte përmendur këtu bibliografia shteruese e Palokë Dakës, botuar që nga viti 1971 në "Studime historike". Gjithashtu e vlente të përcaktohej se para Kongresit të Manastirit është përdorur Alfabeti i Stambollit. Duke ardhur te Maqedonia, vihet në dukje se faktor rëndues ka qenë politika e njohur jugosllave me censurën e rreptë politike dhe sidomos gjendja e pashpresë e arsimit për shqiptarët. Në kushtet e sundimit të vonuar osman më 1911 nisën jetën në Shkup gazetat "Shkupi", "Drita" dhe "Bashkimi i Kombit". Kurse "Flaka e vëllazërimit", sipas autorit, u bë vatër e intelektualëve shqiptarë dhe universiteti i tyre, ndërsa plotësohej me redaksinë botuese pranë saj, që mundësoi shtypjen e qindra librave origjinalë e të përkthyer. Drejtori i parë ishte Petro Janura, tirazhi 2 deri 3 mijë, po

pati edhe periudha kur u dyfishua. Janë nxjerrë në dukje vështirësitë e mëdha të gjithanshme, po sidomos trysnia plotike e rëndë, e cila për fat të keq vazhdoi edhe pas vitit 1991.

Nëpërmjet një kronologjie të hollësishme autori i monografisë ka pasqyruar lëndën e pasur për kulturën, arsimin, librat e rinj, letërsinë, teatrin, filmin, historinë, gjuhën letrare etj. Aty kanë debutuar mjaft shkrimtarë, të cilët do të bëheshin të njohur më vonë. Do të më lejohet të përmend vetëm disa shkrime, që më kanë tërhequr vëmendjen posaçërisht. Janë dhënë diskutimet për standardizimin e gjuhës në mbledhjen e Prishtinës më 14-15 nëntor 1953 (numri i 17 dhjetorit). Bën përshtypje shkrimi i Cvetan Grozdanovit më 27 nëntor 1960 për Andrija Aleshin, arkitekt e skulptor dalmatin (1425-1505). Interesant është njoftimi se Fjalori esperanto-shqip nga Ysni Arifi prej Struge me 2000 fjalë u dorëzua për botim më 13 janar 1978. Të gjitha këto dëshmojnë se kjo gazetë mbetet një pasuri, që do të hulumtohet për gjithë informacionin e pasur gjatë gjysmë shekulli, ndërsa monografia e S. Demirit është si një çelës për të hyrë në këtë informacion. Prandaj më duket se do ta vlente që të kishte edhe një grupim tematik të materialeve të botuara, brenda të cilit për secilën temë do të ndiqej kronologjia.

Autori ka ndjekur të gjitha ndryshimet që kanë ndodhur deri në datën fatkeqe të mbylljes më 2004, kur tashmë kishte dhjetë vjet që ishte bërë gazetë e përditshme. Bashkëpunëtorë të saj kanë qenë edhe mjaft autorë nga Prishtina dhe gazeta ka botuar materiale edhe nga autorët e Shqipërisë, nga të cilët mjafton të përmenden emrat e shquar të E. Çabejt e I. Kadaresë. E kam për nder ta kujtoj, se edhe emri im ka dalë ndonjë herë në faqet e saj.

E vetmja revistë shqip e kulturës, artit dhe shkencës ka qenë "Jehona" që nga viti 1962. Kryeredaktor ka qenë i pari Murteza Peza, për të ardhur tek i fundit Kim Mehmeti. Pavarësisht prej rrethanave politike të njohura gjatë regjimeve të mëparshme, të vendosura pas Luftës II Botërore, që kishin sjellë në Shqipëri ndalimin madje edhe të shtypit të shqiptarëve jashtë vendit, dëshiroj ta nxjerr në pah se ne e kemi shfletuar rregullisht këtë revistë në Tiranë si një burim të pasur informacioni. Autori i monografisë na ka treguar se si ajo u mbyll më 2002 pas privatizimit të entit botues të "Flakës së vëllazërimit" dhe nga viti 2004 nisi si "Jehona e re" te SHB "Vatra". Tashmë ka një hapësirë më të gjerë për shkrimtarët dhe studiuesit. Për ta bërë të plotë tablonë, S. Demiri ka trajtuar edhe botimet për fëmijë "Gëzimi" (në fillim më 1950 si Gazeta e pionierëve, pas një viti me titullin tjetër) dhe "Fatosi" (nga viti 1955).

Punimi shoqërohet me bibliografitë dhe me Treguesin e emrave. Ky është pa dyshim një vëllim, që zë vendin e vet të domosdoshëm në studimet për shtypin shqiptar përgjithësisht, duke ndihmuar edhe studiuesit e mjaft fushave të tjera shkencore.

Përveç librave të veçantë, Instituti ka ndërmarrë edhe botimet periodike, të cilat dëshmojnë për një vazhdimësi serioze të punës së tij kërkimore. Së pari po ndalem shkurt te seria "SCUPI". Deri më tash janë botuar 13 vëllime Numri i parë ka dalë me titullin kuptimplotë "Mbrojtja e trashëgimisë kulturore shqiptare në Maqedoni". Po me këtë tematikë janë nr. 3 "Trashëgimia kulturore dhe turizmi në Maqedoni", si dhe nr. 9 "Sfidat e trashëgimisë kulturore në Maqedoni".

Nr. 2 i është kushtuar ngjarjes madhore por edhe simbolike për gjithë shqiptarët: Kongresit të Drejtshkrimit. Mendoj se ai Kongres pati rëndësi të posaçme për shqiptarët në Maqedoni dhe pa u zgjatur do të bëja pyetjen: Çfarë kuptimi do të kishte Marrëveshja e Ohrit, në rast se nuk do ta kishim një trajtë të përcaktuar të shqipes? Përndryshe edhe çdo kundërshtar do të kishte të drejtën të shprehej: Për çfarë gjuhe shqipe flisni ju, kur vetë nuk e keni të përcaktuar?

Një grup në këtë seri e përbëjnë përmbledhjet kushtuar figurave të shquara të historisë e shkencës sonë. Për mendimin tim, krijon një përshtypje të bukur renditja qoftë edhe vetëm e emrave:

4. Hasan Prishtina.

8. Shaban Demiraj.

11. Nënë Tereza.

13. Fan Noli.

Grupi drejtpërdrejt për temat historike përfshin: 7. Lufta e Parë Botërore; 12. Jeta shoqërore e shqiptarëve në Shkup dhe rrethinë ndërmjet dy luftërave botërore.

70-vjetori i gazetës "Flaka e vëllazërimit" përbën nr. 10, një gazetë për të cilën tashmë kemi monografinë, që e përmenda më lart. Ndërsa nr. 6 "Letërsia dhe shkolla", përmban sigurisht një temë tepër të mprehtë gjatë këtyre dhjetëvjeçarëve edhe te ne në Shqipëri.

Meqë seria "SCUPI" pasqyron materialet e veprimtarive të Institutit, besoj se ky grupim që rendita më sipër dëshmon më së miri orientimet themelore të punës së tij. Kështu, kjo seri është përfaqësuesja më e mirë e profilit të Institutit, si të thuash, e punës së brendshme të tij, e drejtimit të tij dhe jo të një ecurie rastësore. E thënë ndryshe, kjo është pasqyrë e një rrjedhe afatgjatë të projektuar mirë. Në nr. 1 jepet si kryeredaktor dr. Zeqirija Ibrahimi. Më lejoni që ta përshëndes në mënyrë të veçantë dhe t'i uroj që kjo rrjedhë të jetë e pandërprerë.

Mund ta them me plot gojën, se është një sukses i shënuar botimi i revistës "Studime albanologjike" që nga viti 2009 deri te numri i fundit 12. Nga njëra anë, kemi rastin e trishtuar të mbylljes së "Flakës" në Maqedoni; nga ana tjetër kemi, parregullsitë e rënda në botimin e revistës sonë qendrore "Studime filologjike", e cila jo vetëm u zvogëlua krejt si faqe botimi në vit, por me parregullsinë dhe lëkundjet e përmbajtjes e ka humbur autoritetin që kishte për albanologjinë në rrafsh ballkanologjik dhe europian. Dalja e një simotre të tillë me rregullsi na gëzon, sepse kjo do të thotë që albanologjia ka vështirësitë e veta, e megjithatë ecën, vazhdon të qëndrojë në këmbë e të përparojë.

Prandaj do të përmend së pari numrin 1 të vitit 2009. Ajo që bie në sy është përcaktimi që në fillim i rubrikave themelore, të cilat i japin të drejtën të quhet revistë e studimeve albanologjike, domethënë jo e një disipline të ngushtë. Kjo vjen sepse, siç është përcaktuar në paraqitjen e parë në faqet e kësaj reviste, mbi bazën e të dhënave dokumentare dhe të arritjeve të shkencave albanologjike do të paraqitet e do të vërtetohet vazhdimësia historike e, rrjedhimisht, autoktonia e shqiptarëve në Maqedoni, në trevat ku jetojnë shqiptarë që nga kohët më të lashta. Kështu, rubrikat janë: 1. Histori. 2. Gjuhësi. 3. Letërsi. 4. Folklor. 5. Etnomuzikologji. 6. Demografi. 7. Dokumente, dhe 8. Recensione. Në nr. 6, 2012, nuk vërehet po kjo ndarje në rubrika, por ndër studimet dhe artikujt janë përfshirë materiale po të

këtyre disiplinave. Mbeten kurdoherë me interes recensionet, të cilat janë pasqyrë e rrjedhës së studimeve dhe ajo që është me vlerë veçan, është përfshirja e recensioneve edhe për libra të autorëve të huaj.

Me kuptim simbolik është edhe skica e Urës së gurit me kalanë në sfond, sepse ajo përçon idenë, që shkenca është një urë, e cila vendos lidhje si në kuptimin historik, edhe në të sotmen. Në nr. 1 të "Studimeve albanologjike" tregohet se kryeredaktor ishte prof. dr. Ramiz Abdyli. Te nr. 6 kryeredaktor ishte prof. dr. Qemal Murati. I uroj nga zemra për këtë punë të frytshme në shërbim të shkencës shqiptare. Ndërkaq, nuk mund të mos përmend, se R. Abdylin, Z. Ibrahimin dhe Q. Muratin jo vetëm i kam njohur prej kohësh, por edhe kam bashkëpunuar prej kohësh me ta, prandaj jam i gëzuar që më jepet rasti për t'i përshëndetur publikisht.

Njëkohësisht, nuk mund t'i mbyll këto shënime pa i dhënë urimet më të mira edhe drejtorit të tanishëm të Institutit, Skënder Asani.

Qoftë e mbarë përgjithmonë puna fisnike e gjithë bashkëpunëtorëve të këtij Instituti të rëndësishëm për kulturën shqiptare.

Xhevat LLOSHI

POEZIA E JETËS SIME

(ligjërata lamtumirëse e pensionimit)

Të nderuar studentë të tashëm, ish- studentë të mi dhe të nderuar kolegë,

Kam zgjedhur sot ta mbaj ligjëratën e fundit në karrierën time aktive si profesor në universitet dhe kam dashur që në këtë ditë ta them, si të thuash, fjalën e time të fundit, që mund të merret edhe si porosia ime e fundit për ju që jeni këtu.

Unë nuk e pandeh veten si ndonjë profet, që sot do ju thotë diçka që ju nuk e keni dëgjuar, as nuk e shoh veten si ndonjë shpëtimtar që do t'ju thotë ndonjë gjë që do t'ju shpëtojë. Thjesht, ashtu siç kam qenë gjatë gjithë karrierës sime aktive si profesor, edhe dua të dal prej këtu.

Madje, nuk kam as pretendime të larta që sot të mbaj para jush ndonjë ligjëratë me përmasa historike, për arsyen e thjeshtë se pretendime të tilla nuk kam pasur as gjatë punës sime aktive në këtë universitet.

Por, kur dëshiron ta mbash ligjëratën e fundit, doemos më udhëhiqte prirja se cilat fjalë do i zgjidhja që ta përfundoj këtë karrierë dhe kjo në të vërtetë më shumë i ngjan punës së një poeti sesa të një studiuesi. Ashtu siç arrin një poet përmes një vargu, një strofe a një poezie, të na përcjellë një mesazh që një prozatori, një filozofi ose një studiuesi do t'i duhej ta shkruante një libër të tërë, e tillë do të doja të ishte sot ligjërata ime. Një poezi me disa vargje ose me disa strofa.

Në këtë mënyrë do të më lejoni që vargun e parë të kësaj poezie ta quaj "*Nuk ka rastësi, por vetëm urtësi*". Jeta më ka mësuar se, ndonëse neve disa momente të jetës na duken të rastësishme, shumë më vonë e kuptojmë se pas tyre është fshehur një urtësi, një sekret, i cili e ka mundësuar zhvillimin e një ngjarjeje. Më lejoni këtu të bëj një digresion të shkurtër. Kjo që them i ngjan rrëfimit biblik ose kuranor – si të doni merreni – me Mojsiun ose Musain, i cili derisa kthehej në Egjipt, u ndal diku rrugës dhe pa një zjarr. Mendoi se aty ishte dikush dhe shkoi të kërkojë pak zjarr prej tij, por kur shkoi aty, e dëgjoi zërin e Perëndisë, i cili e shpalli profet. U nis për të marrë një dritë, ndërsa përfundoi profet i Zotit. Po e përsëris se nuk kam pretendime të tilla, por rruga ime jetësore nisi me synimin që të mos bëhem zanatçi, por të bëhem mësues fshati, ndërsa Perëndia më bëri pedagog universiteti. Një fëmijë i varfër nga Greshnica në vitet e '50-ta të shekullit të kaluar, që vinte nga një familje mjaft e varfër për kushtet e kohës, as që ëndërronte se karriera e tij do të ishte universiteti. Krejt kjo filloi kur arsimtari im i shkollës fillore më regjistroi në Shkollën Normale në Shkup dhe këtu ishte kthesa ime. Pas shkollës normale, desha ta regjistroj psikologjinë, por atëherë nuk kishte, andaj hyra në pedagogji. Aty takova po ashtu profesorë, që dukeshin si në rastësi, ndërsa kjo ishte urtësi, të cilët ishin arsyeja që unë u punësova në fakultet para se të hapej Katedra e Gjuhës dhe Letërsisë Shqiptare. Ndonëse unë vazhdoja ta kem synim mësuesin në fshatin tim,

përfundova këtu ku jemi sot. Kjo për mua nuk është rastësi, por një urtësi, një sekret që nuk kam si e shpjegoj ndryshe, pos me terma të metafizikës. Dhe, që të jem i sinqertë, mua Zoti më ka dhënë në jetë më shumë seç kam imagjinuar vetë. Andaj i jam mirënjohës dhe ky ka qenë motivi im kryesor që edhe unë të jem si arsimtari i im i fillores për një nxënës ose të jem si profesorët e mi për një student që vjen prej diku si unë dikur. Që edhe unë t'i dukem atij rastësi, ndërsa ai pas një gjysmëshekulli ta kuptojë se ajo ka qenë urtësi.

Vargu i dytë i poezisë, është "*Arsim për të gjithë*". Dhe, kjo nuk është diçka që e unë e them së pari, as që e shpik unë, por as nuk dua ta merrni si patetike. Ndonëse ne sot hedhim gurë e dru kundër ish- sistemit socialist, madje edhe unë vetë kam plot arsye politike ta kundërshtoj atë, por ajo që dua ta vlerësoj dhe ta theksoj është se vetëm në atë sistem një djaloshi të varfër të Greshnicës iu mundësua të bëhej profesor universiteti. Unë dhe ju kemi të drejtë të jemi kundër atij sistemi për shkak të padrejtësive kombëtare që i kemi pësuar atëbotë, por nuk guxojmë të mos jemi mirënjohës për këtë fakt. Me ato pak kapacitete ne arritëm të ndërtojmë kuadro dhe ta mbajmë shkollën shqipe, madje të hapim edhe programe studimore në fakultete. A mund ta imagjinojmë sesi do të ishin shkollat tona pa Shkollën Normale dhe pa Akademinë Pedagogjike? Për këtë arsye, mund të tingëllojë jo e përshtatshme për kushtet e sotme, por unë në aspekt të arsimit do të mbetem socialist i tipit europian: do të doja që secilit fëmijë në secilin fshat të vendit t'i mundësohet arsim falas. Jam pastaj këmbëngulës që arsimi publik të jetë cilësor maksimalisht dhe të mos bëhet arsimi cilësor vetëm luks dhe vetëm mundësi e të pasurve.

Vargu i tretë i kësaj poezi do të ishte "*Çfarë është e rëndësishme në jetë*?!". Kjo është një pyetje që sigurisht i ka sfiduar edhe filozofët, edhe teologët etj., por ajo që unë dua ta theksoj këtu është se karriera ime më ka mësuar se më e rëndësishme se gjithçka në jetë është sekreti i lumturisë. Ne shumë herë në jetë insistojmë në diçka dhe mendojmë se, nëse nuk bëhet ajo, ne kemi dështuar. Kur je i varfër, kënaqesh me dy kore bukë; kur të hash bukë, kërkon diçka më shumë; kur të kërkosh punë, në fillim pranon gjithçka; kur mendon se mësuesi është kulmi dhe pastaj e arrin, e sheh se as ajo nuk ka qenë diçka shumë; pastaj kërkon të bëhesh profesor dhe e arrin edhe atë dhe e sheh se përsëri as ajo nuk ka qenë diçka që do të duhej të të mahnitë. Dhe, jo që nuk është e rëndësishme të jesh zanatçi, mësues ose profesor, por e kam fjalën që më e rëndësishme se kaq në jetë është të mësohesh të jesh i lumtur me atë që e ke. Sepse, kur je mirënjohës për atë që e ke, Zoti ta hapë një derë tjetër dhe të shpie diku që nuk e ke imagjinuar. Këtë e kam provuar vetë në jetë dhe prandaj ju flas nga përvoja. Andaj, gjatë gjithë jetës nuk jam lodhur të kem vetëm arritje, sa jam angazhuar që në atë që e bëj, të gjej lumturi dhe kënaqësi.

Vargu i tretë i kësaj poezi është "*Profesioni më i mirë është i mësuesit*". Unë e di se sot janë krijuar disa profesione që paguhen shtrenjtë, siç është fjala bie menaxher, dizajner, spin doktor, PR-menaxher dhe ato janë profesione që paguhen mjaft mirë, ama unë jam i bindur se asnjëri nga këto nuk është profesion më i bekuar se mësuesi, se profesori. Sepse profesori është një profet i llojit të vet. Derisa një inxhinieri i mundësohet të projektojë muret, një dizajneri të modelojë një pamje, profesorit shoqëria ia ka besuar qeniet njerëzore, që ai t'i modelojë dhe

t'i bëjë së pari njerëz, pastaj të ditur, më tej profesionistë, humanë dhe qytetarë të suksesshëm të shoqërisë. Dhe, unë kujtoj se kjo detyrë është më e vështira dhe njëherazi më e shenjta. Për këtë arsye unë jam i bindur se nuk ka më mirë se të jesh profesor. Bile edhe mjeku që e shëron një pacient nuk është më i lumtur se një profesor që ka krijuar me mijëra studentë. Në duar të profesioneve të tjera është e sotmja, ndërsa në duar të mësuesit, profesorit, është e ardhmja. Sa për informacionin tuaj, nëpër duart e mia kanë kaluar jo më pak se 10.000 studentë. Dhe, nëse unë jam bërë shkak që edhe 10%-shi i tyre ta kenë pasur jetën më të lehtë dhe të lumtur pasi kanë ndjekur orët e mia, unë sot me kënaqësinë më të madhe do ta kaloja pjesën e mbetur të jetës. Mësuesia nuk është profesion, por është mision. E dini që Jezuin në Bibël e quajnë Mësues.

Megjithatë, ndonëse i kam arritur këto përjetime dhe jam shumë i lumtur për to, kjo nuk është e tëra. Prandaj vargu im i fundit do të ishte "*Bëhu njeri*". Unë e di se ka studentë që më respektojnë dhe mbase ka të tjerë që, për ndonjë arsye, nuk e kanë atë qëndrim ndaj meje. Po ashtu ka edhe kolegë e miq me qasje të ndryshme. Unë e di se ka kolegë që më duan dhe më nderojnë më shumë seç meritoj, por ka edhe të tillë që ndonjëherë mund të kenë folur edhe gjëra të pakëndshme për mua dhe ja ua them këtu, ndonëse mund t'i supozoj ndonjëherë, ndaj askujt nuk mbaj hidhërim dhe të gjithëve ua fal me gjithë zemër. Krejt karriera ime në të vërtetë ma mësoi vetëm një gjë: BËHU NJERI. Para se jesh profesor i mirë, para se të jesh shkencëtar i mirë, para se të kesh shkruar e botuar dhjetëra libra e qindra artikuj, siç i kam bërë edhe unë me modestinë time, më e rëndësishme është të jesh njeri. Zaten ky, sipas meje, është misioni ynë në jetë. Dhe, përveç kësaj, me rëndësi të jesh në jetë njeri pozitiv. Sepse, siç thotë mistiku i madh Rumi:

O njeri, ti je siç dëshiron ta shohësh veten vet,
Sa për mish e kocka, dheu do t'i tretë
Nëse mendon për lule, kopsht me lule je
Nëse mendon për gjemba, shkarpa për zjarrin je.

Jam munduar që botën ta shoh si një kopsht me lule, andaj sot – kur po e përfundoj karrierën time profesionale – ndiej në zemër një buqetë me lule.

Me gjithë punën time prej profesori, me gjithë punën time prej autori të teksteve shkollore, me gjithë punën time prej studiuesi të shkollës shqipe, me gjithë punën time si autor i abetares, krejt kjo më ka mësuar se kështu unë nuk jam bërë as profesor, as shkencëtar, as pedagog, por vetëm njeri. Dhe, kjo mendoj se është arritja më e madhe. Të gjitha ato grada kanë qenë shkallët që është dashur t'i eci që të bëhem njeri. Ndërsa qëllimi i jetës nuk qenkan shkallët, por qenka lartësia e misionit.

Do ta përfundoj ligjëratën time duke ju thënë: Ju lutem shikojeni karrierën tuaj si shkallët që ju ndihmojnë të ngjiteni diku, por kurrë mos i merrni shkallët si qëllimi i jetës suaj.

Të dashur të pranishëm, koha jonë është e kufizuar. Mua më duket si katër orë ky dyzetvjeçar këtu. Nesër edhe ju do të jeni në këtë katedër. Prandaj, ju lutem jetojeni çdo ditë me këtë synim. Jetojeni çdo ditë të jetës suaj sikur të jetë dita e fundit dhe ju do ta keni dëshirën që atë ditë ta lini gjurmën tuaj më të mirë. Sepse,

në të vërtetë, gjithë jeta është një ditë e bukur, që përfundon me një muzg, siç është pleqëria.

Dikush nesër do të më kujtojë për 30 e ca librat që i kam shkruar, dikush mund të më përmendë për ndonjë artikull shkencor a artikull publicistik, por unë do të jem i lumtur nëse me këtë ditë – që thamë se e quajmë jetë – jam bërë shkak që në mendjen e tij ta kem ndezur dashurinë për të vërtetën, në zemrën e tij ta kem ndezur dashurinë për njerëzoren dhe në shpirtin e tij ta kem ndezur lumturinë nga këto dyja.

Po përfundoj duke iu rikthyer edhe një herë Rumiut, mjeshtrit të madh të zbulimit të sekreteve të jetës:

Bëhu si lumi në bujari dhe ndihmë,
Bëhu si dielli në zemërgjerësi dhe mëshirë
Bëhu si nata në mbulimin e mangësive të tjetrit,
Bëhu si i vdekuri në hidhërim dhe kërcënim,
Bëhu si dheu në modesti,
Bëhu si deti në mirëkuptim,
Si do që të bëhesh,
Ose duku ashtu si je
Ose bëhu ashtu si dukesh.

Ndërsa gjeniu i shekullit të kaluar, Albert Ajshtajni, pas kësaj do të thoshte: "Vlera e një njeriu duhet parë në faktin se çfarë jep e jo në atë se çfarë është në gjendje të marrë."

Unë kaq kisha t'ju jap dhe këtë ju dhashë! Dhe, si kundërvlerë, nuk dua asgjë!

Ju faleminderit dhe qofshi të bekuar!

Shkup, 12 maj 2016 **Avzi MUSTAFA**

INSTITUTI I TRASHËGIMISË SHPIRTËRORE
E KULTURORE TË SHQIPTARËVE - SHKUP

STUDIME ALBANOLOGJIKE

13

2016

Kopertina
Imer Bajrami

Përpunimi kompjuterik
Besnik Emini

Shtypi
Shtypshkronja
"Focus Print" – Shkup

Revista botohet me mbështetjen e Ministrisë së Kulturës të Republikës së Maqedonisë